

Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer

**PËR
KUSHTETUTËN ISLAME**

**NENET I HARTOI DHE I RENDITI
UNIVERSITETI I FAMSHËM
I EL EZ'HERI-t**

***Përktheu:
Dr. Musli Vërbani***

**Botimi i parë 1995
1416 Hixhrij – Kajro
Botimi i parë i përkthyer në gjuhën shqipe
Kaçanik 2005**

Autor:

Dr. Muhamed Sejjid Ahmed El-Musejjer

Titulli i origjinalit:

نحو دستور إسلامي

مشروع وضع موادّه الأزهر الشريف

Titulli:

PËR KUSHTETUTËN ISLAME

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Recensent:

Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore:

Mimoza Sinani

Radhitja kompjuterike,

kopertina dhe dizajni grafik

Mumin Shehu

Prishtinë

2005

Botim Privat

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM

Falënderimi i qoftë All-llahut dhe përshëndetje mbi robërit e Tij, të cilët i ka zgjedhur.

Përpilimi i këtij libri ka kaluar në tri faza:

FAZA E PARË

Kongresi i tetë: Instituti për Hulumtime Islame, i cili është mbajtur në Kajro, në muajin Dhul Hixhe të vitit 1298 (Tetor 1977). Universiteti i El Ez'herit të famshëm dhe posaçërisht Instituti për Hulumtime Islame ka porositur hartimin e Kushtetutës Islame për të qenë në dispozicion të secilit shtet, i cili dëshiron ta praktikojë Sheriatin Islam duke e jetësuar atë në praktikë.

Kongresi mendon se për hartimin e kësaj kushtetute duhet mbështetur, sa më shumë që të jetë e mundur, mbi parimet në të cilat janë pajtuar medhhebet islame.

Një vit pas marrjes së këtij vendimi suksesi u arrit dhe u realizua porosia e Institutit të Hulumtimeve Islame, në Dhul K'ade të vitit 1398 (Tetor 1978), si përgatitje për fillimin e Kongresit të Nëntë të këtij Instituti. Këtë punim e ka botuar revista "El Ez'her" në numrat e saj, të dala në Xhumadel Ula të vitit 1399 (Prill 1979). Në revistën "El Ez'her" thuhet se Imami i El Ez'herit, Dr. Abdul Halim Mahmud, ka dhënë vërejtjet e fundit për këtë projekt, i cili bazohet në mendimet e medhhebeve të ndryshme dhe në mendimet Fikhije. Nenet përfshinë të gjitha nevojat e muslimanëve.

Kaluan vite dhe ky projekt u harrua në tërësi.

FAZA E DYTË

Më 28.07.1991 revista "El Ahram" botoi punimin me titull "Këshilltari Sejid El-Ashmavi vendos Kushtetutën e re Islame". Njëri prej gazetarëve, profesori Mahmud Abdul Gafar, kërkoi prej meje për t'iu rikthyer kësaj teme.

Pasuan seri të ndryshme të punimeve me titull "Për Kushtetutën e re Islame" dhe u hetua punimi i parë, i cili vërtetoi se këshilltari Ashmavi nuk ishte kompetent që të fliste për Islamin.

Pastaj vazhdoi punimi i dytë, për të vazhduar projektin e El Ez'herit të famshëm të Kushtetutës Islame pas 13 viteve, më pas pasuan edhe punime të tjera: Nenet e Kushtetutës Islame dhe komenti i atyre neneve me argumente, urtësia e argumenteve, posaçërisht specifikat e Sheriatit Islam.

Botimet e punimeve vazhduan çdo javë, përafërsisht për 4 muaj, në gazetën "EL-AHRAM EL-MESA".

Befas botimet u ndërpre në sepse redaktorët e gazetës deklaruan se ne nuk kemi nevojë për një Kushtetutë të re Islame, pasi shteti ynë i dashur, Elhamdulillah, është musliman dhe kushtetuta e tij është islame!!!

Kështu më është thënë!!!

Mirëpo porosia erdhi!!! dhe u tejkaluan kufijtë e shtetit!!!

Një orientalist i Zelandës së Re, me emrin Wiliem Shibret¹, që ishte në fakultetin e USULI DINIT (BAZAT E FESË) në Kajro, kishte lidhje të ngushtë me rektorin e Universitetit - Mahmud Hamdi Zakzakin dhe kish kërkuar prej tij një kopje të projektit të El Ez'herit për Kushtetutën Islame.

Ia dorëzova një kopje dhe ia dhurova librin tim "Praktikimi i Sheriatit".

Abdurr-rresul Zerkani, kryeredaktor i revistës "NUR", më vizitoi dhe kërkoi nga unë një kopje të projektit të Kushtetutës Islame dhe unë ia dhashë një kopje. Këtu u ndal lapsi për plotësimin e komentit dhe të studimeve të projektit të El Ez'herit për Kushtetutën Islame ...!

1 Ky orientalist ka qëndruar në Kajro një kohë të gjatë dhe gjatë qëndrimit të tij ka tubuar Nene të kësaj lëmie. Ai në përgjithësi ka shkruar nga dr. Ahmed Eminë dhe gjithashtu ka shkruar për pozitën e jomuslimanëve në Egjipt.

FAZA E TRETË

Shkova në universitetin UMUL KURA, në Mekketul Mukerreme, në vitin 1413 h. (1993) dhe ndjenjat për të shkruar projektin e Kushtetutës Islame më shtoheshin, në kohën që shtoheshin forcat laike dhe idetë marksiste me faktorin e brendshëm, i cili i përkrahte dhe ishte viktimë e atyre ideve.

Zoti ma lehtësoi punën, më përkrahu, më ndihmoi, studimi u thellua dhe lapsi filloi të shkruajë përsëri për komentin.

Libri përfundoi në Dhul K'ade të vitit 1415 h. (1955) dhe studimi përfshiu 9 kapituj, me 93 Nene të projektit të Kushtetutës Islame e ato ishin:

KAPITULLI I PARË

Familja ndërkombëtare Islame (Ummeti)

4 nene, prej nr. 1 deri në 4

KAPITULLI I DYTË

Bazat e Familjes Ndërkombëtare Islame (Ummeti)

13 nene, prej nr. 5 deri në 17

KAPITULLI I TRETË

Ekonomia Islame

10 nene, prej nr. 18 deri në nr. 27

KAPITULLI I KATËRT

Të drejtat dhe liritë qytetare

16 nene, prej nr. 28 deri në 43

KAPITULLI I PESTË

IMAMI - KRYETARI

12 nene, prej nr. 44 deri në nr. 60

KAPITULLI I GJASHTË

Gjykata

22 nene, prej nr. 61 deri në nr. 88

KAPITULLI I SHTATË

Parlamenti, Ekzekutivi, Organi kontrollues

2 nene, prej nr. 83 deri në nr. 84
KAPITULLI I TETË
Qeveria
Dy nene, prej nr. 85 deri në nr. 86

KAPITULLI I NËNTË
Ligjet e Përgjithshme
7 nene, prej nr. 87 deri në nr. 93

* * * * *

Komenti i fundit i këtij libri iu drejtohet emrave dhe mendjeve të Ummetit (shoqërisë Islame), të rinjve dhe pleqve, meshkujve dhe femrave, qeveritarëve dhe qytetarëve që të unifikohen në një fjalë, e ajo është Njohja e All-llahut, Krijuesit Absolut, për shenjtërinë e atdheut, për nderin e njerëzve, për paqen, civilizimin dhe që e gjithë bota të jetojë në paqe dhe në ndihmë të ndërsjelltë.

Kjo është edhe lutja jonë, udhëzim prej shpalljes, e cila i drejtohet mendjes së shëndoshë:

فَلِذَلِكَ فَادْعُ وَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَقُلْ آمَنْتُ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنْ
كِتَابٍ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمُ اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ لَا حُجَّةَ بَيْنَنَا
وَبَيْنَكُمُ اللَّهُ يَجْمَعُ بَيْنَنَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ

“E për këtë shkak (të përçarjes së tyre) ti thirr dhe përqendrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre. E thuaj: Unë kam besuar në librat që i shpalli All-llahu. Jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush. All-llahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj. Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja. All-llahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm tek Ai është përfundimi.”

(Esh Shura, 15)

Mekke Mukerreme: 18.04.1995.
18.11. 1415 h.

Ebu Hudhejfe Dr. Muhamed Sejid Ahmed Mujeser
Profesor i Akides dhe Filozofisë
në Universitetin e El Ez’herit në Kajro

dhe në Universitetin Umul Kura në Mekketul-Mukerreme

HYRJET

- * Porosia e përgjithshme e Institutit për Hulumtime Islame
- * Projekti i këshilltarit Ashmavi
- * Fjala e parë e rastit

BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

PROJEKTI I KUSHTETUTËS ISLAME

HYRJE

1. Në konkluzat e Kongresit të Tetë të Institutit për Hulumtime Islame, i cili është mbajtur në Kajro, më Dhul K'ade 1397 (tetor 1977) është porositur që El Ez'heri, së bashku me Institutin e Hulumtimeve Islame të hartojnë Kushtetutën Islame, në mënyrë që ajo të jetë e gatshme për ta marrë çdo shtet, i cili dëshiron ta praktikojë Sheriatin Islam si program të tij. Është vendosur që të kihet parasysh që gjatë përpilimit të Kushtetutës me u mbështet, sa të jetë e mundur, në parimet e pajtueshmërisë së medhhebeve.

2. Për realizimin e kësaj porosie, Kongresi për Hulumtime Islame, në mbledhjen e mbajtur më 1 Muharrem 1398 (Dhjetor 1979) e obligoi, unanimisht, Këshillin për Hulumtime të Kushtetutës Islame për t'i thirrur dijetarët, të cilët do të merrnin pjesë në hartimin e këtij projekti.

3. Duke u nisur nga kjo, imami i madh i nderuar, Abdul Halim Mahmud, rektori i El Ez'herit, njëherit Kryesues i Institutit për Hulumtime Shkencore, për ta themeluar Këshillin Qendror ia bashkëngjiti anëtarëve të këshillit për hartimin e Kushtetutës personalitetet më eminentë, të cilët ishin të specializuar në Fikhun Islam dhe në Jurisprudencë, për ta kryer këtë detyrë.

4. Këshilli qendror në mbledhjen e tij, që e kryesonte imami i nderuar Shejhul-Ez'heri (rektori i universitetit) vendosi themelimin e këshillave të sektorëve (për sektorë të veçantë) për t'i koordinuar punët me Këshillin Qendror dhe për kontrollimin e punimeve të Kushtetutës.

Këshillat e sektorëve mbanin mbledhje të rregullta javore, deri sa i përfunduan punët, dhe punimet ia paraqitën Këshillit Qendror.

Ky projekt përbëhej prej nëntë kapitujve dhe nëntëdhjetë e tre neneve:

Kapitulli i parë: Ummeti islam (shoqëria islame)	4 nene
Kapitulli i dytë: Bazat e shoqërisë islame	13 nene
Kapitulli i tretë: Ekonomia Islame	10 nene
Kapitulli i katërt: Të drejtat dhe liritë individuale	16 nene
Kapitulli i pestë: Imami (Kryetari)	17 nene
Kapitulli i gjashtë: Gjykata	22 nene
Kapitulli i shtatë: Parlamenti dhe Kuvendi	2 nene
Kapitulli i tetë: Qeveria	2 nene
Kapitulli i nëntë: Ligjet e përgjithshme tranzicionale	7 nene

Kryesia e Përgjithshme (qendrore) e Institutit për Hulumtime Islame e paraqiti hartim projektin në Kongresin e Nëntë, i cili e kishte marrë si detyrë në kongresin e tetë.

All-llahu është mbrojtësi më i mirë dhe kërkojmë që Ai të jetë i kënaqur me ne.

**Kryesia Qendrore e Institutit
të Studimeve Islame**

PROJEKTI I KËSHILLTARIT ASHMAVI

Revista *El-Ahram El-Mesa* botoi artikullin “Këshilltari Ashmavi përpilon Kushtetutën e Re Islame”, në të cilën thuhet:

“Këshilltari Muhamed Sejid El-Ashmavi, njëri prej dijetarëve më eminentë në idetë islame, ka bërë punime të ndryshme në shumë fusha, prej tyre më të njohurat, janë:

Islami politik, Hilafeti Islam, Bazat e Sheriatit, dhe Frytet e mendjes.

Këshilltari Ashmavi është angazhuar për ide të shëndosha islame, sa që mendon se shumica e rrymave islame politike nuk njohin një program shoqëroro-politik të qartë. Kjo është fundosur në detin e thellë të ndjenjave të turbullta, të cilat janë të përgjithshme, e jo të veçanta, dhe paraqesin vetëm fillimin e mendimeve.

Ka një kohë të gjatë që dijetari Ashmavi, angazhohet për përgatitjen e hartimit të Kushtetutës gjithëpërfshirëse, të jetës së njeriut nga Islami, i cili ishte reflektori dhe ndriçuesi i të gjithëve.

E ka veçuar rubrikën për botimin e Kushtetutës gjithëpërfshirëse (Safhatul Islamiye) dhe kërkon nga të gjithë të interesuarit për çështjet e ideve islame që të japin idetë e tyre dhe që të çelë derën e diskutimeve për këtë çështje.

Për hartimin e kësaj kushtetute, të titulluar “Kushtetuta ndriçuese Islame”, janë paraparë këto pika:

A. NË ÇËSHTJET E POLITIKËS

- Qeveria islame qeveri e qytetarëve;
- Politika është e drejtë e qytetarit, por jo shtyllë e fesë;
- Demokracia në të gjitha fushat e jetës;
- Çështja kombëtare nuk është në kundërshtim me fenë;
- E drejtë e Ummetit për kushtetutë dhe komentim të Kur'anit;
- Qytetarët janë të barabartë në të drejta dhe obligime²;
- Hilafeti islam, epokë islame e jo shtyllë e islamit;
- Nuk ka armiqësi ndaj tjetrit, por mbrojtje të vetvetes;
- Bashkimi ndërkombëtarë islam në raport me bashkësinë ndërkombëtare.

² Revista e ka botuar këtë titull gabim. Ja si është shkruar: “Në të drejta dhe komentime”.

B. NË FUSHËN E NJERIUT (QYTETARIT)

- Liria e besimit;
- Liria e mendimit dhe të shprehurit;
- Të drejtat e njeriut janë në përputhshmëri me të drejtat islame;
- Vëllazërimi ndërkombëtar;
- E drejta për punë e femrës dhe e mashkullit;
- Respektimi i të drejtës së femrës është natyrore dhe njerëzore;
- Praktikimi i programit shkencor;
- Civilizimi dhe modernizimi duhet të jetë në përputhshmëri me moralin dhe karakterin;
- Njohja e historisë njerëzore;
- E drejta e veshjes.

C. NË FUSHËN E FESË

- Vendosija e definicionit të çdo fjale;
- Dallimi në mes të fesë, shariatit dhe fikhut;
- Programi i komentimit të Kur'anit: Teksti ka për qëllim rastin specifik jo termin e përgjithshëm;
- Drejtësia në dënime;
- Nes-hi (abrogimi) në ligjet e shariatit e jo të fesë;
- Muslimani nuk guxon t'i quajë muslimanët pabesimtarë;
- Asnjë grup nuk ka të drejtë ta quajë veten se vetëm ai është grup i muslimanëve;
- Në islam nuk ka ngatërresa, shkatërime dhe gjakderdhje;
- Feja është e vetme, ndërsa shariatet (ligjet) e shumta.

D. NË FUSHËN E EKONOMISË

- Orientimi Kapitalist i cili shpie në socializëm³
- Zvogëlimi i nevojave të shpenzimeve
- Prodhimi me teknikë bashkëkohore
- Teprica (Fajdja) nuk është Kamatë, prandaj nuk është e ndaluar në shariat.
- Plani kombëtar për punë, siguri, pensionim dhe punësim.

Dhe në fund gazeta thekson: “Paraqitja e këtij projekti islam të këshilltarit Sejid Ashmavi hap temën e diskutimit dhe angazhimit të kësaj ideje, duke u bazuar në lirinë e mendimit për arritjen sa më të mirë dhe më të dobishme të jetës së muslimanëve”.

³ Revista e ka botuar gabim. Ja si është shkruar: “është obligative”.

ARTIKULLI I PARË

Gazeta “El-Ahram El-Mesa” botoi në disa numra artikullin me titull “Për Kushtetutën e Re Islame”. Ndërsa, titulli i parë ishte si vijon⁴:

“*Këshilltari Sejid Ashmavi projektton Kushtetutën e Re Islame*”, botoi “El-Ahram El-Mesa”, data: 28.08.1991.

Në të vërtetë këshilltari Ashmavi, në fushën e Islamit përqendrohet në tri çështje:

1. ISLAMI DHE FETË

Në të bën thirrje se për jehuditë, të krishterët, për muslimanët, për të gjithë është shpërblimi i All-llahut dhe xhenneti në botën tjetër, dhe nuk janë pabesimtarë nëse nuk kanë dalë nga feja e vërtetë e tyre, sepse çështja e imanit për besimin në shpalljen e Pejgamberit të fundit Muhamedit a.s., nuk është shpallje përfundimtare e sheriatit për njeriun.

2. ISLAMI POLITIK

Në të bën thirrje për lirinë e fesë sa i përket udhëheqjes së Ummetit, dhe veçimin e Islamit të politizuar. Ai përdor parimin e mëshirës, sjelljes, edukatës dhe moralit që Islami të depërtojë me këshilla të moralit e jo të presionit dhe nuk e ka obligative për të udhëhequr.

3. ISLAMI EKONOMIK

Ai i kritikon sistemet e ekonomisë islame, dhe i kritikon dijetarët dhe fukahatë dhe posaçërisht El Ez’herin.

Këshilltari Ashmavi nuk fillon vetëm prej këtu për të folur për Islamin, apo në emër të Islamit.

Ai ka bërë thirrje edhe më herët në revistën “El-Ahram El-Mesa”. Ai për një kohë të gjatë ka kërkuar të hartohet një projekt i plotë kushtetues për jetën e njeriut, i cili buron nga idetë e ndriçuara të Islamit. Këto janë thirrje kundër të cilave ka argumente kundër thirrjes së tij, dhe janë të pabaza dhe të pabesueshme.

⁴ Është botuar më datën 01.08.1991

Ajo çka ka paraqitur këshilltari Ashmavi nuk e prezanton Islamin as për së afërmi, as për së largu. Ajo është çka i përngjan një libri vetëm me tituj dhe përmbajtje. Ata janë tituj të përgjithshëm, të cilët janë të gjitha fetë, të gjitha sektet dhe nuk prezanton veçoritë e Islamit.

Disa prej fjalëve të atyre titujve ndeshen me Islamin, siç është rasti me titujt:

- Hilafeti islam ka qenë epokë historike
- Liria e veshjes dhe mënyra e jetesës
- Teprica (Fajdja) nuk është kamatë e ndaluar.

Disa prej fjalëve janë të pakuptimta:

- Dallimi në mes të fesë, sheriatit dhe fikhut
- Dallimi në mes të fesë dhe historisë fetare.

Nuk e di a jemi para terminologjive shkencore apo para kushtetutës së re.

Disa prej fjalëve janë gabime shkencore, si p.sh.:

- Programi i tefsirit kur'anor. Teksti ka për qëllim rastin specifik, jo termin e përgjithshëm.

- Disa prej fjalëve janë të vërteta, si p.sh.:

“Unioni Ndërkombëtar Islam është në Unionin Ndërkombëtar”.

Është e vërtetë se Unioni Ndërkombëtar i Përgjithshëm është në Unionin Ndërkombëtar Islam. Nëse kemi kërkuar për bashkësinë ndërkombëtare, atëherë udhëheqja i takon bashkësisë islame.

- Disa prej fjalëve janë të përgjithshme, nevojiten të precizohen, si p.sh.: “E drejta për punë edhe e mashkullit, edhe e femrës, patjetër duhet t’iu bashkëngjitet teksti në vazhdim “... në kufi apo në kuadër të sheriatit islam”. Është e papranueshme që femrës, e cila e ka rolin e shenjtë familjar dhe në edukimin e familjes, t’i ndërrohet roli në sektorë çka nuk i takojnë asaj, dhe nuk janë në natyrën e saj.

“Nuk lejohet që muslimani të quhet pabesimtar”, këtu patjetër duhet t’iu bashkëngjitet teksti: “ ... derisa mos ta mohojë çka është e patjetërsueshme dhe e domosdoshme në fe”.

Dhe në fund, këto ishin disa vërejtje të shpejta për atë i cili ka zemër, dëgjon me vëmendje dhe është dëshmitar i të vërtetës.

Shpjegimet dhe sqarimet do të bëhen herëve të tjera – nëse dëshiron Zoti.

KAPITULLI I PARË

SHOQËRIA ISLAME (UMMETI ISLAM)

Përbëhet prej katër neneve:

Prej nenit 1 deri në nenin 4

SHOQËRI UNIKE DHE KUSHTETUTË UNIKE

Neni 1

- a. Muslimanët janë një familje dhe shoqëri unike.
- b. Sheriati Islam burimi i të gjitha ligjeve.

Koment- Sqarim:

Shoqëria unike është themeli prej të cilit ka filluar njerëzimi prej gjeneratës së parë, që i ka unifikuar besimi në një Zot dhe ka një familje të vetme prej të cilës është shtuar njerëzimi.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqërinë) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë All-llahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisin (akraballëkun) se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju”.

(En Nisa, 1)

Me shtimin e farefisit dhe me shpërndarjen e gjeneratave dhe me largimin nga bërthama është bërë shtrirja e popujve nëpër gjithë tokën- është paraqitur pabesimi dhe idhujtaria nga qenia njerëzore në tërësi dhe janë formuar grupe dhe parti...

Zoti i Madhëruar thotë:

كَانَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً فَبَعَثَ اللَّهُ النَّبِيِّينَ مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ وَأَنْزَلَ مَعَهُمُ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِيَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ فِي مَا اخْتَلَفُوا فِيهِ وَمَا اخْتَلَفَ فِيهِ إِلَّا الَّذِينَ أُوتُوهُ مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ الْبَيِّنَاتُ بَغْيًا بَيْنَهُمْ فَهَدَى اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا لِمَا اخْتَلَفُوا فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِهِ وَاللَّهُ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“Njerëzit ishin një popull (të fesë së natyrshme islame) e (kur u përçanë) All-llahu dërgoi peygamberët përgëzues dhe qortues, dhe

atyre Ai u zbriti edhe librin me fakte të sakta për të gjykuar në atë që u kundërshtuan ndërmjet vete. Në atë (libër) kundërshtuan vetëm ata që kishin libër (ithtarët e librit). E përpos atyre që iu kishte dhënë ai (libri) dhe u kishin ardhur argumente të qarta, nuk kundërshtoi kush në të (në librin) po edhe atë (kundërshtimin e kanë) nga zilia ndërmjet tyre, mirëpo All-llahu me mëshirën e Tij urdhëroi ata që besuan tek e vërteta e asaj për çka ishin kundërshtuar. All-llahu e vë në në rrugë të drejtë atë që dëshiron.”

(El-Bekare, 213)

Kjo do të thotë se njerëzit ishin një shoqëri e udhëzuar me besimin në një Zot, të unifikuar dhe të bashkuar, mirëpo u përçanë dhe u kundërshtuan në mes vete dhe Zoti dërgoi pejgamberët që njerëzit të kthehen përsëri në një shoqëri dhe në një besim.

Këtë e dokumenton edhe ajeti tjetër kur'anor:

وَمَا كَانَ النَّاسُ إِلَّا أُمَّةً وَاحِدَةً فَاخْتَلَفُوا وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِنْ رَبِّكَ لَفُضِيَ بَيْنَهُمْ
فِيمَا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ

“Njerëzit nuk ishin tjetër pos të një feje, e u përçanë. E sikur të mos ishte caktimi i hershëm nga Zoti yt, do të përfundohej (me dënim) mes atyre, për atë që ishin të përçarë.”

(Junus, 19)

Këtij ajeti i shtojnë edhe atë se ligji i All-llahut është se njerëzit kanë të drejtë për të zgjedhur për veten e tyre pasi që Ai u sjell argumente të vërteta, dhe pasi që u zbret atyre ligje që sjellin dritë, dhe u ka dërguar atyre pejgamberë udhërrëfyes me qëllim që të kenë përgjegjësi dhe me qëllim që të dënohen nëse nuk veprojnë sipas tyre.

Zoti i Madhëruar thotë:

... وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ
إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ

“Sikur të donte All-llahu, do t’iu bënte një popull (në fe e sheriat), por deshi t’iu sprovtojë në atë që ju dha juve, andaj ju

(besimtarë) përpiquuni për punë të mira. Kthimi i të gjithëve ju është tek All-llahu, e Ai do t'iu njoftojë për atë që kundërshtoheshit.”

(El-Maide, 48)

Në Kur'anin Fisnik kjo është përsëritë shumë herë. Prej tyre:

وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ لَجَعَلَ النَّاسَ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَا يَزَالُونَ مُخْتَلِفِينَ. إِلَّا مَنْ رَحِمَ رَبُّكَ وَلِذَلِكَ خَلَقَهُمْ وَتَمَّتْ كَلِمَةُ رَبِّكَ لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ أَجْمَعِينَ

“Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete) përveç atij që mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata. Fjala e Zotit tënd: Gjithsesi do ta mbush xhehennemin me të gjithë exhinët dhe njerëzit. Ka marrë fund (është plotësuar)”.

(Hudë, 118,119)

وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ يُضِلُّ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ وَلَتَسْأَلُنَّ عَمَّا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

“Sikur të dëshironte All-llahu do t'iu bënte një popull (në një fe), por sipas dijes së vet ai e le të humbur atë që do, e patjetër do të përgjigjeni për atë që vepruat”.

(Nahl, 93)

وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَهُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ يُدْخِلُ مَنْ يَشَاءُ فِي رَحْمَتِهِ وَالظَّالِمُونَ مَا لَهُمْ مِنْ وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ

“Po sikur të kishte dashur All-llahu, do t'i bënte ata (njerëzit) një popull (të një feje), por Ai shtie në mëshirën e Vet atë që do (atë që me vullnetin e vet pranon rrugën e drejtë) e jobesimtarët nuk kanë as mbrojtës as ndihmës”.

(Esh Shura, 8)

Dëshira e All-llahut është dëshirë absolute dhe realizuese, pra sikur të dëshironte All-llahu do t'i detyronte që të jenë një popull dhe askush nuk do të mund t'i ikte dëshirës së Tij, por All-llahu ka dëshiruar që njerëzit të kenë liri të zgjedhin, por edhe ta bartin përgjegjësinë me qëllim që nëse ndëshkohen, të ndëshkohen me meritë, nëse shpërblehen, të shpërblehen me meritë...

Të gjithë dijetarët eminentë islamë janë pajtuar për pikat, veçoritë dhe lidhjen e shoqërisë e cila përbën shoqërinë islame e ato janë: besimi në një Zot, Kibla e njëjtë, një histori dhe një gjuhë fetare, duke ia shtuar këtyre edhe burimet kryesore të ekzistencës. E gjithë kjo dokumenton domosdoshmërinë e bashkëpunimit, bashkëveprimit dhe marrëdhënieve reciproke. Zoti i Madhëruar thotë:

إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ

“Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur), kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua.”

(El-Enbija, 92)

Uniteti i shoqërisë islame në besimin e pastër dhe përqendrimi në shpalljen e Zotit dhe praktikimi i ligjeve të All-llahut, të cilat i ka paraparë për njeriun në tokë në dritën e plotë me të cilën Zoti i Madhëruar ia ka mësuar dhe sqaruar Muhamedit a.s.

Unifikimi dhe përqendrimi i Umetit në këto parime ka bërë që të jetë Umeti (populli) më i dobishmi të cilin e njeh historia.

Zoti i Madhëruar thotë:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ
وَلَوْ آمَنَ أَهْلُ الْكِتَابِ لَكَانَ خَيْرًا لَهُمْ مِّنْهُمْ الْمُؤْمِنُونَ وَأَكْثَرُهُمُ الْفَاسِقُونَ

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë (për të ruajtur rendin), të ndaloni nga veprat e këqija (kriminaliteti) dhe të besoni All-llahun.”

(Ali Imran, 110)

Kjo është dëshmia në All-llahun, nuk ka dëshmi më të plotë, më të drejtë dhe nuk ka fjalë më të mirë dhe më të ëmbël.

Dobia dhe e mira e kësaj shoqërie nuk mbështetet në racë, ngjyrë apo lloj, por mbështetet në parime, karakter njerëzor në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohërat.

Nga logjika e besimit islam vendoset praktikimi i Sheriatit Islam në jetën e muslimanit. Islami përfshin jetën në këtë dhe në botën tjetër dhe qëndron në krye të çfarëdo feje tjetër apo ideologjie mbi sipërfaqen e tokës, për të udhëhequr jetën (botën) me emrin e All-llahut.

Dhe kur njerëzit, në përgjithësi, gjykohen me ligjin e All-llahut mbizotëron qetësia, siguria, drejtësia dhe paqja, shpërndahet dashuria dhe

respekti ndërnjerëzor dhe të gjithë njerëzit jetojnë të nënshtuar vetëm ndaj All-llahut dhe jetojnë si vëllezër, edhe pse kanë fe dhe ideologji të ndryshme. Jo muslimanët, në Islam, i gëzojnë të gjitha të drejtat, jetojnë të qetë në paqe, gëzojnë respekt, dashuri dhe mëshirë prej muslimanëve.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“E ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”

(El-Enbija, 107)

Zoti i Madhëruar thotë:

لَا يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُم مِّن دِيَارِكُمْ أَن تَبَرُّوهُمْ
وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ

“All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja, All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë”.

(El-Mumtehineti, 8)

Sheriati Islam bazohet në shumë mënyra dhe me shumë argumente. Argumentet e ligjeve të Sheriatit janë⁵:

1. Kur’ani
2. Sunneti
3. Ixhmai
4. Kijasi
5. Istihsan
6. Mesalihul mursal
7. Urfi i drejtë
8. Istis’habi

Me këto argumente duhet vepruar me angazhim tepër të madh, interesim dhe kujdes të jashtëzakonshëm, me mëshirë tepër të madhe, me

⁵ Për kuptimin e këtyre terminologjive mirë është për t’u konsultuar me literaturën e lëndës së USULUL FIKH-ut, siç është libri “Usulul Fikhu” i autorit Shejh Abdul Vehab Halaf.

precizitet tepër të madh, për të marrë vendimin e kërkuar prej Sheriatit Islam.

Nuk lejohet që në shoqërinë islame të ketë ligje të cilat janë në kundërshtim me Sheriatin Islam, apo që të gjykojnë njerëzit dhe të vendosen ligje, të cilat nuk kanë mbështetje në Fikhun Islam, për çdo kohë dhe vend.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَأَنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَاحْذَرْهُمْ أَنْ يَفْتِنُوكَ عَنْ بَعْضِ مَا
أَنزَلَ اللَّهُ إِلَيْكَ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَاعْلَمُ أَنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُصِيبَهُمْ بِبَعْضِ ذُنُوبِهِمْ وَإِنَّ كَثِيرًا
مِّنَ النَّاسِ لَفَاسِقُونَ. أَفَحُكْمَ الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِّقَوْمٍ
يُوقِنُونَ

“(Ta zbritëm Kur’anin) që edhe ti të gjykos me atë që të zbriti All-llahu, e mos ndiq dëshirat e tyre, që të mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All-llahu. Nëse ata refuzojnë (gjykimin tënd) ti dije se All-llahu ka për qëllim t’i ndëshkojë ata për disa mëkate të tyre. Në të vërtetë, një shumicë e njerëzve janë jashtë rrugës.

A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më të mirë se ai i All-llahut?”

(El-Maide, 49,50)

Çdo shoqëri, në mesin e saj ka hipokritë, njerëz të sëmurë dhe labilë, njerëz pa karakter, të cilët i prishin litarët e lidhjes shoqërore dhe dalin nga ixhmai i Ummetit (shoqërisë islame).

Duhet të jemi të kujdesshëm me ta, të mos i lejojmë të bëjnë shkatërrime dhe të mos biem në grackat e tyre.

Mbështetja e muslimanëve në Sheriatin Islam duhet të jetë mbështetje e fortë dhe e thellë, bindje e thellë me zemër dhe mendje, krenari me të cilën duhet të krenohesh dhe përmbajtje me mish e me shpirt.

FEDERALIZMI I SHTETEVE DHE UNIFIKIMI

NENI 2

Lejohet që në shoqërinë islame të ekzistojnë shumë shtete dhe format e qeverisjes të jenë të përbashkëta, por me projekte të ndryshme.

NENI 3

Lejohet që shteti të hyjë në federatë me një shtet islam apo me shumë shtete islame, në bazë të marrëveshjes dhe kushteve paraprake me të cilat pajtohen.

Koment:

Prej fillimit të Islamit, të gjithë muslimanët janë nën qeverisjen e Imamit një, e ai është Muhammedi a.s. Tek ai kthehen për çështjen e sigurisë dhe pasigurisë, duke u mbështetur në fjalën e All-llahut:

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ وَلَا تَكُنَ لِلْخَائِنِينَ خَصِيمًا

“Ne të zbritëm ty (Muhammed) librin (Kur’anin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi All-llahu.”

(En-Nisa, 105)

Po ashtu edhe ajeti tjetër:

... وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا ...

“Çka t’u japë (urdhërojë) Pejgamberi, atë merreni (pranojeni) e çka t’ju ndalojë, largohuni (dhe mos veproni)”.

(El-Hashr, 7)

Dhe kur i dërguari i All-llahut ka kaluar në botën e përhershme ka vazhduar hilafeti (udhëheqja) e drejtë me mësimet e të Dërguarit të All-llahut dhe si zëvendësim i Imamit në veprimin e Sheriatit në çështjet politike të kësaj bote, dhe fesë dhe po ashtu vendosjen e rendit, paqes, qetësisë dhe drejtësisë në mes njerëzve.

Më pas territori islam është zgjeruar në lindje dhe në perëndim dhe të gjithë muslimanët kanë qenë nën ombrellën e udhëheqësit islam (halifit), ndërsa kryeqyteti i qeverisjes ka qenë Medina, Damasku ose Bagdadi.

Me paraqitjen e faktorëve të tjerë, dhe me paraqitjen e brendshme dhe të jashtme, shteti amë islam është ndarë në shtete të vogla dhe janë paraqitur lëvizjet e ndarjes dhe përçarjes, e cila rezultoi në rënien e Hilafetit Abasit, me kryeqendër Bagdadin, në duar të tatarit Hulako në vitin 656 h.

Më pas hilafeti është rikthyer, por me forma të ndryshme. Hilafeti i fundit ka qenë në perandorin Osmane në Stamboll.

Pa marrë parasysh se çka thonë për Perandorinë Osmane, ajo perandori konsiderohet perandori me vlera të rëndësishme dhe qeveria e saj ka pasur rëndësi të posaçme.

Për këtë arsye jehuditë dhe të krishterët kanë vepruar së bashku për rrëzimin e Hilafetit Osman dhe Evropa e ka copëtuar botën islame.

Dhe vjen koha kur muslimanëve, një kohë të gjatë, iu kanos rreziku i mosekzistimit fizik dhe kapitullimit ekonomik, derisa përfundoi epoka e kolonializmit dhe okupimit ushtarak, pasi që muslimanët i ndanë, i copëzuan dhe i përçanë dhe formuan shtete të vogla, të paaftha.

Më pas revolucionarët bënë apel për domosdoshmërinë e bashkimit të forcave, unifikimin e fjalës dhe unifikimin e politikës për ta tejkaluar gjendjen e vështirë.

Vendimi ynë është që për ta tejkaluar gjendjen momentale, të formohen shtetet me qeveri të ndryshme, por të cilat duhet të kenë një politikë dhe një qëllim të përbashkët, gjë e cila do t'i ndihmonte në tejkalimin e kësaj gjendje, derisa bota rreth nesh angazhohet që për pasionet e tyre të lidhin litarët e shtëpisë së merimangës.

U formuan Shtetet e Bashkuara Socialiste Sovjetike BRSS, prej popujve dhe kombeve dhe gjuhëve të ndryshme nën një shtet, i cili ka qenë superfuqi e botës për një kohë që zgjati 70 vite.

Tani edhe Bashkimi Evropian angazhohet për një metodë të re të unifikimit të ri, që me vullnet të lirë t'i bashkojë shtetet e ndryshme me gjuhë të ndryshme, me popuj të ndryshëm, me histori të ndryshme dhe me zhvillime ekonomike të ndryshme.

Sa i përket muslimanëve, ata e kanë edhe më lehtë, edhe më mirë që të bashkohen të gjithë dhe të ndërlidhen në litarin e All-llahut dhe të formojnë unionin e përbashkët ekonomik dhe politik dhe forcën e përbashkët. Zoti i Madhëruar thotë:

وَاَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا وَاذْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنْتُمْ أَعْدَاءَ
فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُمْ بِنِعْمَتِهِ إِخْوَانًا وَكُنْتُمْ عَلَى شَفَا حُفْرَةٍ مِّنَ النَّارِ فَأَنْقَذَكُم
مِّنْهَا كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur’anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtojeni nimetin e All-llahut ndaj jush kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së Xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu All-llahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju të gjeni të vërtetën e lumtur”.

(Ali Imran, 103)

Unionet e vendeve të ndryshme, të cilat janë në botën islame, si p.sh. Liga Arabe, apo Kongresi Islam janë vetëm si pikënisje, për atë apelojmë, që të pajtohen dhe të vazhdojnë deri sa t’i japin frytet dhe të realizohet uniteti i plotë dhe të kthehet Hilafeti i drejtë.

Mirëpo pengesë në rrugën e Bashkimit islam janë:

- Sistemi mbretëror apo udhëheqja familjare;
- Marrja e pushteteve me forcë ushtarake.

Këto dy sisteme nuk mund të formojnë shtet me personalitet eminent të ndershëm dhe të zgjedhur prej popullit (*ehlul hal vel aqaf*). Sistemi mbretëror shtyn që të emërohen në pozita njerëz të paafte, edhe për veten e mos të flasim për shoqërinë. Sistemi ushtarak në shumicën e rasteve është diktatorial, nuk njeh rrugën e dialogut dhe konsultimeve dhe nuk i beson paqes dhe qetësisë shtetërore dhe jeton vetëm në ankth dhe mbijeton vetëm nëpërmjet dhunës.

Bashkimi islam është çështje e lehtë dhe e arritshme kur të ndodhë demokratizimi dhe kur popujt të mësojnë lirinë e zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre dhe kur të zgjedhurit ta kuptojnë se zgjedhja e tyre nuk është vetëm nder, por përgjegjësi dhe drejtësia të jetë mbi forcën dhe populli të jetë mbi qeverinë dhe interesi i përgjithshëm shoqëror të jetë mbi ambiciet individuale.

Më ka habitur sistemi qeverisës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kur për një kohë të shkurtër janë zgjedhur pesë kryetarë të

shtetit (Klintoni, Bushi, Karteri, Niksoni dhe Fordi) dhe secili prej tyre i ka takuar partisë opozitare në pushtet, ndërkohë që është zgjedhur me vota të lira dhe secili prej tyre ia ka dorëzuar tjetrit qeverinë me vullnet të lirë dhe me festim zyrtar dhe është tërhequr nga qeveria dhe ka vazhduar jetë normale.

Ah! Sikur udhëheqësit muslimanë të mendonin pak fenë e tyre dhe të punonin për fenë e tyre dhe të zhvisheshin nga udhëheqja e tyre e brishtë, dhe ambiciet e tyre.

Inspektues (kontrollues) i Imamit (kryetarit), ministrave dhe qeverisë është vet populli dhe ai kërkon përgjegjësi dhe llogari prej tyre në përputhshmëri me Sheriatin Islam.

Koment:

Ummeti islam është ummet parlamentar, këtë All-llahu e thotë në ajetin Kur'anor:

... وَأَمْرُهُمْ شُورَى بَيْنَهُمْ ...

“... ata konsultohen mes vete për punë të përbashkëta”.
(Esh-Shura, 38)

Ummeti islam është ummet i konsultimit gjithëpopullor, duke u bazuar edhe në hadithin e Muhamedit a.s.:

“Feja është këshillë dhe konsultim. E kanë pyetur Muhammedin a.s.: Për kë o i dërguari i All-llahut? Është përgjigjur: Për All-llahun e Lartmadhëruar, për librin e Tij, për të Dërguarin e Tij dhe për ummetin islam në përgjithësi.”

Nga këtu kuptohet se ummetin islam, nuk lejohet ta qeverisë diktatura. Kontrollin mbi udhëheqësinë dhe të gjithë qeveritarët e ka populli islam, i cili duhet të ushtrojë lirinë e mendimit, dhe zgjedhjes. Ky kontrollim i popullit nuk njihet ambicie individuale apo grupe e klanore dhe nuk njihet interesa personale. Secili duhet të angazhohet në kënaqësinë e All-llahut dhe në dobi të ummetit, ku zemrat bashkohen në një qëllim.

Imami (kryetari, Halifi) ka për obligim të kujdeset për shoqërinë (ummetin), të sigurojë popullin dhe duhet të jetë tepër i kujdesshëm për sigurinë e përgjithshme dhe çështjet shtetërore, të veprojë drejtë, me përpikëri dhe me sinqeritet.

Dijetarët kanë folur shumë për detyrat dhe përgjegjësitë (e imamit) p.sh. Kadiu Ebu Jeali el Fera, i ka përmendur dhjetë detyra, e ato janë⁶:

⁶ “Ahkam sultanije”, recenzues Muhamed Hamid Fekij, fq. 27, botues “Darul Kutub Ilmije”, Bejrut.

1. Ruajtja e fesë dhe bazave në të cilat është pajtuar ummeti (dijetarët më eminentë). Nëse ndodh ndonjë përplasje apo dyshim në shoqëri, ai i sqaron me argumente, i drejton çështjet me drejtësi, i shikon të drejtat, përgjegjësitë dhe obligimet e shoqërisë, me qëllim që feja të jetë zgjidhje, dhe që populli të mos lajthitë.
2. Gjykimi dhe ekzekutimi i ligjeve ndërmjet palëve dhe zgjedhja e konfrontimeve mes tyre deri sa të mbizotërojë paqja dhe qetësia, duke mos u dëmtuar askush.
3. Dënimi i kriminelëve në bazë të veprave të tyre, dhe në bazë të shkeljes së ligjit, ruajtja e pasurisë së qytetarëve nga keqpërdorimi dhe shkatërrimi.
4. Ruajtja e çështjeve më të imta të qytetarëve me qëllim që ata të janë të lirë në veprim dhe të lirë në qarkullim.
5. Formimi i forcës mbrojtëse për të ruajtur shoqërinë ndaj çdo sulmi nga jashtë.
6. Luftimi ndaj atyre, të cilët luftojnë shoqërinë deri sa të arrihet marrëveshje për paqe, apo deri sa të dorëzohen.
7. Destinimi i fondeve dhe i buxhetit në atë çka e parasheh Sheriati.
8. Ndarja e fondeve dhe shpenzimi prej arkës qendrore (bejtul-mal) pa e tepruar (duke mos lejuar as deficit, as suficit) dhe intervenimi me kohë në investime
9. Nëpunës të lartë administrativë dhe financiarë të emërohen njerëz të dëshmuar dhe të besueshëm, me qëllim që administrata të punojë me drejtësi, ndërsa mjetet financiare të jenë të ruajtura dhe të siguruara.
10. Që personalisht dhe drejtpërdrejtë të marrë pjesë në zgjedhjen e problemeve, që të përmbushë kërkesat politike dhe mbrojtjen e shoqërisë, dhe të mos autorizojë të tjerët në çështjet e rëndësishme, ndërsa vet të dëfrehet, ose ta kalojë kohën në adhurim, sepse mund të ndodhë që i autorizuari besnik të tradhtojë, ndërsa këshilltari i drejtë të devijojë. Zoti i Madhëruar, kur e tregon rastin e Davudit a.s. thotë:

يَا دَاوُودُ إِنَّا جَعَلْنَاكَ خَلِيفَةً فِي الْأَرْضِ فَاحْكُم بَيْنَ النَّاسِ بِالْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ الْهَوَى

“O Davud: Ne të kemi bërë sundimtar në tokë, e ti pra gjyko me drejtësi mes njerëzve e mos shko pas dëshirave”.

(Sad, 26)

Zoti i Madhëruar nuk i ka thënë Davudit a.s. që t'i autorizojë të tjerët, por e ka urdhëruar që t'i kryejë çështjet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Po ashtu, edhe Muhammedi a.s. ka thënë:

“Secili prej juve është bari (kujdestar) dhe secili do të jetë përgjegjës për pozitën e tij.”

Kur imami (Halifi-Kryetari) e merr përsipër zgjidhjen e çështjeve të shoqërisë islame (ummetit) duhet t'i ketë parasysh dy obligime:

- Dëgjueshmëria dhe përlulshmëria ndaj All-llahut
- Triumfi- të dalë fitimtar në zgjidhjen e problemit

Duhet që Imami (kryetari-Halifi) të mos ketë diçka çka e humb imunitetin e kryetarllëkut.

Imuniteti i hiqet Imamit (kryetarit) prej dy shkaqeve:

- Veprimi me padrejtësi;
- Pasja e të metave psikike⁷

Qeveritari duhet të shpalojë planprogramin e qeverisë dhe ta arsyetojë atë, ta mbrojë dhe të kërkojë këshilla dhe ndihmë për plotësimin e tij.

Nëse qeveritari i tejkalon kompetencat e tij, atëherë populli është ai, i cili kërkon llogari dhe përgjegjësi prej tij dhe prej kabinetit të tij, dhe merr vendimin e merituar kundër tyre.

Islami nuk njeh qeveritarë të pagabueshëm apo imam (kryetar), i cili nuk jep përgjegjësi për punën e tij, apo sqarim për mendimin e tij. Raportet mes qeveritarit dhe shoqërisë duhet të jenë raporte të sinqerta. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Më i miri udhëheqës (qeverisës) është ai të cilin e doni dhe ju do, luteni për të dhe lutet për ju. Ndërsa udhëheqësi (qeveritari) më i keq është ai të cilin nuk e doni dhe nuk ju do, e mallkoni dhe ju mallkon.”

Muhammedi a.s. është shembulli tipik për ne. Ai ka qenë peygamber, por në të njëjtën kohë ka qenë edhe udhëheqës për çështjen e muslimanëve dhe i ka përcjellë me kujdes të posaçëm të dy detyrat tek ne.

Sa i përket ligjit, Kur'ani tregon rastin e një gruaje e cila është ankuar për shkeljen e të drejtës së saj:

⁷ Si paraliza, çmenduria, verbëria etj.

قَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّتِي تُجَادِلُكَ فِي زَوْجِهَا وَتَشْتَكِي إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ يَسْمَعُ
تَحَاوَرَكُمَا إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ

“Vërtet All-llahu i dëgjoji fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te All-llahu, prandaj All-llahu dëgjon bisedën tuaj, All-llahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë”.

(El Muxhadele, 1)

Për këtë arsye, kur zbreti ajeti kur'anor, i cili tregon për “Dhiharin”, Muhammedi a.s. e ka përmirësuar Hilal bin Umeje-n me rastin e akuzimit të gruas së tij me dashnorin Ibn Sihanë. Muhammedi a.s. i ka thënë Hilalit: “**Ose më sill argument, ose do të dënohesh për shpifje**”. Hilali i thotë: Për Zotin i cili të ka zgjedhur pejgamber, flas të vërtetën, për këtë do të zbresë shpallja e cila do të më shpëtojë nga dënimi për shpifje. Dhe pastaj ka zbritur ajeti kur'anor:

وَالَّذِينَ يَرْمُونَ أَزْوَاجَهُمْ وَلَمْ يَكُنْ لَهُمْ شُهَدَاءُ إِلَّا أَنْفُسُهُمْ فَشَهَادَةُ أَحَدِهِمْ أَرْبَعُ
شَهَادَاتٍ بِاللَّهِ إِنَّهُ لَمِنَ الصَّادِقِينَ. وَالْخَامِسَةُ أَنَّ لَعْنَتَ اللَّهِ عَلَيْهِ إِنْ كَانَ مِنَ
الْكَاذِبِينَ . وَيَدْرَؤُا عَنْهَا الْعَذَابَ أَنْ تَشْهَدَ أَرْبَعَ شَهَادَاتٍ بِاللَّهِ إِنَّهُ لَمِنَ الْكَاذِبِينَ.
وَالْخَامِسَةَ أَنَّ غَضَبَ اللَّهِ عَلَيْهَا إِنْ كَانَ مِنَ الصَّادِقِينَ

“Ndërsa ata të cilët shpifin për gratë e veta dhe nuk kanë dëshmitarë tjetër përveç vetes, dëshmimi i çdo njërit prej tyre është: të betohet katër herë në All-llahun se ai e thotë të vërtetën. E pesta (herë e betimit) është: mallkimi i All-llahut është mbi të, nëse ai gënjen. E nga ajo (gruaja e shpifur) largohet dënimi, nëse katër herë betohet në All-llahun se ai (shpifësi) gënjen. E pesta herë e betimit të jetë që ta godasë hidhërimi i All-llahut, atë (gruan) nëse ai ka qenë i vërtetë.”

(En-Nur, 6-9)

Ligji i dënimit për akuzim shpifjeje (liani) është aprovuar si ligj i ri pas ankimit të Hilalit te i dërguari i All-llahut. Sa i përket politikës, kemi rastin e Marrëveshjes së Hudejbijes, kur Umeri r.a. i thotë të Dërguarit a.s.:

- O i dërguar i All-llahut, a nuk jemi ne të drejtë ndërsa ata në humbje?

Muhammedi a.s. i tha: Po, gjithsesi.

- Umeri prapë i thotë: Të vrarët tanë a nuk janë në xhennet ndërsa të vrarët e tyre në xhehennem.

Muhammedi a.s. prapë i thotë: Po, gjithsesi.

Umeri thotë: ne nuk do ta mënjanojmë fenë tonë, por le të shohim se si do të gjykojë All-llahu mes nesh.

Në ditën e fitores së Hunejnit, ensarët kundërshtuan ndarjen e pasurisë së mbetur nga lufta, të Muhammedit a.s. Ata u habitën se si i dërguari i All-llahut më shumë iu jepte pasuri atyre që më së voni e kishin pranuar Islamin dhe atë pas çlirimit të Mekkes. Ndërsa Muhammedi a.s. ua sqaroi filozofinë e ndarjes së pasurisë duke iu thënë:

“Unë ndonjërit i jap më shumë, ndërsa tjetrin e dua më shumë, vetëm për shkak se frikësohem që atë të cilin e dua më shumë mund të dënohet në xhehennem (për atë ndarje)”.

Por edhe më shumë, njëri prej hipokritëve proteston me zë të lartë dhe thotë: “O Muhammed vepro drejtë, se nuk je duke vepruar drejtë.”

Ndërkaq, Muhamedi a.s. thotë:

“Kjo është ajo që unë dua kënaqësinë vetëm prej All-llahut. Vetëm All-llahu le të jetë i pajtuar me gjykimin tim.”

Muhammedi a.s. u soll butë me këtë njeri, e përbiu hidhërimin e tij, e pastaj tha:

“Zoti e mëshiroftë Musain a.s. Ai është ofenduar edhe më shumë se kjo, dhe ka duruar”, e pastaj ka thënë: “Po kush mund të veprtojë me drejtësi nëse i dërguari i All-llahut nuk vepron drejtë”.

KAPITULLI I DYTË

BAZAT E SHOQËRISË ISLAME

Përbëhet prej 13 neneve:

Prej nenit 5

Deri në nenin 17

NDIHMA RECIPROKE

Neni 5

Ndihma reciproke dhe bashkëpunimi janë bazë e shoqërisë.

Koment:

Asnjë shoqëri nuk mund të ekzistojë pa ndihmë reciproke në mes vete. Kjo është ajo që disa filozofë e quajnë: “Pajtim gjithëkombëtar”. Njeriu vetë, as nevojat e tij personale nuk mund t’i kryejë. Jeta e tij varet prej marrëdhënieve me tjerët.

Ndihma shoqërore është domosdoshmëri, ndërsa në Islam, përpos që është domosdoshmëri, është edhe prej vlerave më të larta.

Zoti i Madhëruar thotë:

... وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ

اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ

“Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në punë të mbara, e mos u ndihmoni në mëkatim e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë”.

(El-Maide, 2)

Shteti nuk mund të funksionojë me një individ, por ka nevojë që e tërë shoqëria të veprojë së bashku. Këtë e tregon Kur’ani fisnik në rastin e Dhulkarnejnit, kur ai i thotë popullit të shtypur të “SEDEJNIT” (Kodrave):

آتُونِي زُبَرَ الْحَدِيدِ حَتَّىٰ إِذَا سَاوَىٰ بَيْنَ الصَّدَفَيْنِ قَالَ انْفُخُوا حَتَّىٰ إِذَا جَعَلَهُ نَارًا

قَالَ آتُونِي أَفْرَغْ عَلَيْهِ قَطْرًا

“Më sillni copa të hekurit! E kur e nivelizoi ai me dy anët e kodrave tha: “Ndizeni!” e kur e bëri atë (hekurin) zjarr (si zjarr nga të ndezurit) tha: “Më sillni bakër të shkrirë për t’ia hedhur atij!”.

(El Kehf, 96)

Kjo ka qenë përgjigjja e Dhulkarnejnit kur populli i thotë se ne do të të paguajmë nëse ndërton një pendë për t’u mbrojtur prej popullit zullumqar.

قَالُوا يَا ذَا الْقُرْنَيْنِ إِنَّ يَأْجُوجَ وَمَأْجُوجَ مُفْسِدُونَ فِي الْأَرْضِ فَهَلْ نَجْعَلُ لَكَ خَرْجًا
عَلَى أَنْ تَجْعَلَ بَيْنَنَا وَبَيْنَهُمْ سَدًّا

“Ata thanë: O Dhulkarnejn, vërtet Jexhuxhi dhe Mexhuxhi janë duke bërë shkatërrime në tokë, a bën që ne të japim ty një kontribut (në formë tagri a tatimi) e që të bësh një pendë mes nesh dhe mes tyre”.

(El Kehf, 94)

Dhulkarnejni ka refuzuar që t’ua ndërtojë pendën pa i angazhuar dhe pa vepruar edhe ata në punë. Ai i nxiti për punë dhe për ndihmë në ndërtimin e pendës. Ai nuk dëshiroi asgjë për vete, por tha:

قَالَ مَا مَكْنِيَ فِيهِ رَبِّي خَيْرٌ فَأَعِينُونِي بِقُوَّةٍ أَجْعَلْ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُمْ رَدْمًا

“Ajo që më ka dhënë Zoti është shumë më e mirë (nga ajo që më ofroni ju) por ju më ndihmoni me fuqi punëtore”.

(El Kehf, 95)

Nuk mjafton që ju të paguani dhe të flini nën hije, por patjetër duhet të derdhni djersë, të punoni punë të rëndë, dhe të ndihmoni me ndihmë frytdhënëse deri në arritjen e sukseseve më madhështore.

Dhulkarnejni u ka treguar disa çështje:

- Më sillni copa hekuri
- Ndizeni
- Më sillni bakër të shkrirë t’ia hedh atij.

Dhulkarnejni iu ka ndihmuar me ekspertizmin e tij dhe ka marrë pjesë edhe vet personalisht në ndërtimin e pendës së bashku me ata.

Kjo është një përvojë e mirë që populli apo shoqëria e cila bashkëvepron, bashkëpunon, bashkëndihmon arrin fuqi, zhvillim dhe i sjell vetes paqe dhe siguri.

Ka dallim mes ndihmës reciproke dhe ndihmës sociale në shtetin islam. Ndhimesa reciproke ka për qëllim angazhimin maksimal të dy palëve. Ndërsa ndihmë sociale është kur ata, të cilët janë më të fortë dhe më të fuqishëm i ndihmojnë atyre, të cilët janë më të dobët, vetëm për shkak të dashurisë dhe mëshirës që kanë ndaj tyre.

T'iu ndihmohet dhe t'iu kryhen nevojat të tjerëve është farz në Islam, ndërkohë që është edhe prej virtyteve më të larta të moralit. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush i mundëson muslimanit të tejkalojë një fatkeqësi të dunjasë, Zoti do t’ia tejkalojë një fatkeqësi në Ditën e Kijametit. Kush ia lehtëson gjendjen muslimanit në këtë dunja, Zoti do t’ia lehtësojë atij në Ditën e Kijametit. Kush i mbulon muslimanit një të metë, Zoti do t’ia mbulojë një të metë në botën tjetër. Zoti është në ndihmë dhe në përkrahje të robit, derisa ai i ndihmon dhe e përkrah vëllain e tij.”

Ndihma sociale në Islam përfshin ndihmën ndaj personave me aftësi të kufizuara, por edhe ndaj të tjerëve të cilët kanë nevojë materiale, por edhe ndaj atyre që kanë nevojë për përkrahje morale. Ndihma e prindërve në pleqëri. (sigurimi pensional).

Zoti i Madhëruar thotë:

إِمَّا يَبْلُغَنَّ عِنْدَكَ الْكِبَرَ أَحَدُهُمَا أَوْ كِلَاهُمَا فَلَا تَقُلْ لَهُمَا أَفْ وَلَا تَنْهَرُهُمَا وَقُلْ لَهُمَا قَوْلًا كَرِيمًا . وَاخْفِضْ لَهُمَا جَنَاحَ الذُّلِّ مِنَ الرَّحْمَةِ وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا .

“Nëse njërin prej tyre, ose që të dy i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of-oh” as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, por atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrihe ndaj tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”.

(El Israë, 23-24)

Pastaj ndihma dhe kujdesi ndaj farefisit, në përgjithësi. Muhammedi a.s. thotë:

“Zoti pasi i ka krijuar krijesat, e prej tyre njerëzit, dhe prej tyre e ka ndarë veç një pjesë të gjakut (farefisnisë), ka thënë: A nuk dëshiron që të respektohet, kush e respekton dhe e nderon farefisninë dhe të mos respektohet dhe të mos nderohet, kush nuk e respekton dhe nuk e nderon farefisninë? Farefisnia i thotë: po. Atëherë ashtu qoftë (i ka thënë Zoti). Pastaj i dërguari i All-llahut ka vazhduar duke thënë: lexoni ajetin kur’anor.

فَهَلْ عَسَيْتُمْ إِنْ تَوَلَّيْتُمْ أَنْ تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ وَتَقَطَّعُوا أَرْحَامَكُمْ . أُولَئِكَ الَّذِينَ لَعَنَهُمُ اللَّهُ فَأَصَمَّهُمْ وَأَعَمَّى أَبْصَارَهُمْ .

“A pritet prej jush që nëse merrni sundimin (ose zmbrapseni prej fesë islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërpreni lidhjet e farefisnisë. Të tillët janë që All-llahu i mallkoi, i bëri të shurdhët dhe ua verbëroi të parët e tyre”.

(Muhammed, 22-23)

- **Kujdesi ndaj fqinjëve**

Muhammedi a.s. thotë:

“Xhibrili më ka porositur vazhdimisht me u sjellë mirë ndaj fqinjëve, sa që kam menduar se do të më obligojë që t'i emëroj trashëgimtarë”.

Kujdesi ndaj familjeve të dëshmorëve dhe jetimëve

Muhammedi a.s. thotë:

“Ai, i cili i ndihmon gruas së dëshmorit dhe të varfrit, ka vlerën e muxhahidit në rrugën e All-llahut”.

Pastaj transmetuesi ka vazhduar (duke thënë) edhe sikurse agjëruesi i cili vazhdimisht agjëron ditën dhe vazhdimisht falet natën.

- **Kujdesi ndaj të paafetëve**

Kur muslimani e viziton vëllain e tij të sëmurë, ai gjendet në anën (krahët) e xhennetit deri sa të kthehet.

- **Kujdesi ndaj nevojtarëve në përgjithësi**

Zoti i Madhëruar thotë:

فَلَا اقْتَحَمَ الْعَقَبَةَ . وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْعَقَبَةُ . فَكُّ رَقَبَةٍ . أَوْ إِطْعَامٌ فِي يَوْمٍ ذِي مَسْغَبَةٍ . يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ . أَوْ مِسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ .

“E ai nuk u hodh në përpjetëzën (rrugë e vështirë-qafëmal). E ç’gjë të mësoi ty se ç’është Akabe (rrugë e vështirë)? Është lirimi i një skllavi. Ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria: Ndonjë jetimi që është i afërt ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria”.

(El Beled, 11-16)

- **Kujdesi arsimor**

Zoti i Madhëruar thotë:

وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنفِرُوا كَآفَّةً فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي
الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për të mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata në mënyrë që ata të kuptojnë (e të ruhen).”

(Et Tevbe, 122)

Nuk ka më mirë për ummetin se kur ndihmohen në mes vete dhe kur kujdesen për njëri-tjetrin dhe bashkëpunojnë në mes vete.

VENDOSJA E RENDIT (EL EMRU BIL MEARUF) DHE LUFTA KUNDËR KRIMIT (EN NEHJU ANIL MUNKER)

Neni 6

Vendosja, mbajtja e rendit dhe lufta kundër krimit është farz dhe bën mëkat ai i cili ka mundësi dhe nuk vepron në rastet e nevojshme.

Koment:

Vendosja, mbajtja e rendit dhe lufta kundër krimit janë veçori të shoqërisë islame. Zoti i Madhëruar thotë:

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ تَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَتَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ
وَتُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun.”

(Ali Imran, 110)

Superioriteti i shoqërisë islame (ummetit islam) është në parime dhe karakter dhe jo në raca, apo kombësi. Islami nuk njeh racizëm dhe nacionalizëm. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَى وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا
إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi tek ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat) e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.

(El Huxhuratë, 13)

Çështja e vendosjes, mbajtjes së rendit dhe luftës kundër krimit në terminologjinë bashkëkohore është “shërbimi policor” apo “rendi shoqëror” dhe të gjithë kanë të drejtë të japin mendime, propozime, për dobitë, përparësitë, përgjegjësitë të cilat i bëjnë dobi shoqërisë.

Ky “rend shoqëror” obligon që secili të kujdeset dhe secili të ketë përgjegjësi për vendin e vet. Muhammedi a.s. ka treguar në një hadith përgjegjësinë e secilit për vendin e vet, ku thotë:

“Secili prej juve është bari, dhe secili do të japë përgjigje për tufën e tij. Imami (kryetari) është bari dhe ai është përgjegjës për tufën e tij. Njeriu është kujdestar i shtëpisë së tij dhe jep përgjigje për tufën (familjen) e tij. Gruaja është kujdestare në shtëpinë e burrit të saj dhe ajo është përgjegjëse për tufën e saj. Shërbëtori është kujdestar i pasurisë së pronarit të tij dhe ai është përgjegjës për kujdestarin e tij. Secili është bari dhe secili do të përgjigjet për tufën e tij.”

Lufta kundër krimit dhe mbajtja e rendit shoqëror është çështje e cila kërkon urtësi, mençuri dhe kujdes të veçantë nga shoqëria.

Për të ndërtuar jetë të qetë nevojitet mund e angazhim, dashuri e mirësi, ndërsa burrimi është t’i dhurosh dhuratë ose t’i japësh sadaka njeriut, i cili ka nevojë. Më burrërore dhe më bujare do të ishte t’i japësh këshillë atij, e cila i bën dobi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, pra t’i japësh edukatë të mirë ose t’i mësosh një sjellje të mirë ose arsimim të mirë. Nëse është obligim për ta shpëtuar njeriun për të mos rënë në ndonjë humnerë ose greminë, ose për të mos i dalë përpara ndonjë automjeti, atëherë do të ishte anë obliguese për ta mbrojtur njeriun që të mos bie në mëkate, ose të mos bëjë krim, ose për ta larguar prej punëve të këqija dhe të neveritshme.

Ndërsa Muhammedi a.s. ka thënë:

“Nuk beson askush prej jush, deri sa mos të dojë për vëllain e tij, atë që e do për vete.”

Çështja nuk është ushqimi dhe veshmbathja, por ashtu siç dëshiroj për vete udhëzim dhe përqendrim në fe, ashtu duhet të dëshiroj edhe për të tjerët, dhe për këtë arsye i këshilloj dhe i urdhëroj në punë të mira dhe i ndaloj e i largoj nga punët e këqija. Thirrja në All-llahun është dashuri, ajo do urtësi, mençuri e maturi dhe muslimani duhet të veprojë ashtu si e kërkon vendi e momenti.

Muhammedi a.s. thotë:

“Kush e sheh një të keqe le ta largojë me dorën e tij, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij, nëse edhe atëherë nuk mundet, atëherë me zemrën e tij, por kjo është shkalla më e ulët e imanit (besimit).”

Këto tri shkallë dhe këto tri mënyra janë orientim për çdo kujdestar, i cili është përgjegjës për tufën e tij dhe çdo përgjegjës për pozitën e tij, nuk bie në kundërshtim me përgjegjësitë e të tjerëve në pozitat e tyre.

Njeriu në shtëpi ka mundësi ta largojë të keqen në familjen e tij me këto tri mënyra: me dorë, me gjuhë dhe me zemër. Muhammedi a.s. ka thënë:

Urdhëroni fëmijët tuaj për namaz kur t'i mbushin shtatë vjet, dhe përdorni rrahjen (e lehtë) kur t'i mbushin dhjetë vjet”.

Mirëpo, këtij njeriu, i cili i praktikon këto tri mënyra në shtëpinë e tij, nuk i lejohet sipas Sheriatin Islam t'i praktikojë në shtëpinë e vëllait të tij. Atij i mbeten në disponim në familjen e vëllait të tij gjuha dhe zemra, pra largimi me gjuhë dhe largimi me zemër. Ai ka mundësi, bile e ka edhe obligim ta këshillojë vëllain e tij, t'ia tregojë dhe t'ia sqarojë gabimet, pasi kështu e kryen obligimin ndaj All-llahut të Lartmadhëruar.

Sa i përket krimit të organizuar në shoqëri, këtë e ka obligim qeveria-imami (Halifi) ose kryetari. Ai është përgjegjës para All-llahut të Madhëruar për të paguar dhe për ta larguar të keqen. Imami (kryetari) i drejtë është njëri prej shtatë personave, i cili do të jetë nën hijen e Arshit në Ditën e Kijametit. Ai ka të drejtë dhe mundësi për t'i ekzekutuar dënimet, për mbajtjen e rendit dhe për formimin e organeve juridike për të siguruar shoqërinë nga krimet. Askush nuk ka të drejtë për ta emëruar apo për ta autorizuar veten si zëvendës të imamit (kryetarit) dhe për t'i ekzekutuar vetë dënimet, pasi kjo shpie në çrregullim, shkatërrim dhe në përhapjen akoma më shumë të krimit dhe i bën njerëzit të kacafyten dhe të luftojnë mes vete.

Dijetarët (intelektualët) kanë rol të veçantë në këshillimin e imamit (kryetarit) dhe orientimin e drejtë të shoqërisë. Dijetarët duhet ta ngrenë zërin kundër të pavërtetës dhe duhet të flasin dhe të kërkojnë haptazi drejtësi, dhe duhet të veprojnë me kohë dhe në mënyrën më të mirë.

Nëse, befasisht, paraqitet ndonjë e keqe si vrasja, uzurpimi, apo dhunimi në vende publike, atëherë e kanë obligim të gjithë anëtarët e shoqërisë që janë aty prezent, për ta larguar me dorë nëse kanë mundësi, nëse nuk paraqitet ndonjë ngatërresë më e madhe dhe pastaj pjesëtarët e shoqërisë duhet të kërkojnë prej organeve policore (përgjegjëse) deri sa t'i zgjidhin problemet ose të dënohet kriminel.

Natyrshmëria e urdhërimit në punë të mira, me fjalë të tjera vendosja e rendit dhe lufta kundër krimit, ka nevojë për mençuri dhe maturi të nivelit të lartë dhe duhet njohur mirë fikhu (kuptimi i ligjit dhe bazat e jurisprudence islame) dhe duhen ditur çështjet për të cilat janë pajtuar dhe për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët më eminentë. Pasi mendimet e ndryshme të dijetarëve, janë fusha të cilat duhen studiuar dhe hulumtuar, dhe muslimanit nuk lejohet që mendimin e njërit t'ia imponojë tjetrit.

Largimi i krimit (të keqes-munkerit) me tri mënyrat është farz për çdonjërin i cili është përgjegjës, ndërsa nëse largimi i të keqes është në kompetencën e tjetrit, atëherë nuk lejohet me dorë por nevojitet me mënyrën e këshillës dhe të udhëzimit, ta urresh me zemër dhe me zë të lartë duke thënë: O Zoti im! Ky krim dhe kjo e keqe nuk është në kënaqësinë Tënde, unë e gjykoj këtë çka veprojnë, por nuk kam mundësi për ta larguar. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا عَلَيْكُمْ أَنْفُسَكُمْ لَا يَضُرُّكُمْ مَنْ ضَلَّ إِذَا اهْتَدَيْتُمْ

إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيَنْبُتُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

“O ju që besuat, ruajeni veten tuaj! Ai që ka humbur nuk ju dëmton juve, kur jeni në rrugë të drejtë. Kthimi i të gjithëve ju është te All-llahu dhe ai ju njofton për atë që vepruat”.

(El Maide, 105)

Muslimani pafajësohet kur këshillon tjetrin me sineritet të plotë dhe angazhohet në largimin e të keqes. Nëse tjetri përdor shkopin e shpatën, ai mban personalisht përgjegjësinë e krimit para All-llahut të Madhërishëm, jo të tjerët.

Krimi haptazi në shoqëri dënohet për dy llojesh:

E para: Krimin e vepruar dhe

E dyta: Krimin haptazi

Kush e sheh krimin dhe nuk angazhohet për ta larguar me njërin prej tri mënyrave konsiderohet si bashkëpjesëmarrës i atij krimi dhe bën mëkat para All-llahut të Madhërishëm, sepse Islami kujdeset për sigurinë, qetësinë dhe pastrimin e shoqërisë.

FAMILJA BAZË E SHOQËRISË

NENI 7

Familja është bazë e shoqërisë, themel i fesë dhe i moralit dhe shteti duhet të kujdeset për krijimin e familjeve të shëndosha, për ruajtjen e nënave dhe të fëmijëve.

Koment:

Në Islam, familja, është obligim të krijohet, të ruhet dhe të sigurohet. Për këtë arsye martesë ka qenë sunnet i pejgamberëve. Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ وَجَعَلْنَا لَهُمُ أَزْوَاجًا وَذُرِّيَّةً

“Ne dërguam edhe para teje pejgamberë dhe atyre u mundësuam të kenë gra e fëmijë.”

(Err-Rra'd, 38)

Martesa është ligj i njeriut, ajo mbjell dashuri, simpati dhe mëshirë mes bashkëshortëve, thëllon bashkëpunimin, formon qetësinë shpirtërore dhe psikike, i jep femrës edhe mashkullit shëndet, përhap në shoqëri moralin e pastër si loti dhe ruan fortësinë e shoqërisë. Për këtë arsye, martesë është simbol dhe argument prej argumenteve të All-llahut. Zoti i Madhëruar thotë:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُم مِّنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً
وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

“Dhe nga argumentet (e madhërisë) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë”.

(Err-Rrum, 22)

Familja nuk është ndërmarrje tregtare apo ekonomike, apo klub nate, apo vend imoraliteti, por parim i familjes është feja dhe morali. Islami nuk njeh vetëm shfryrje të epshit, por takimi (lidhja) bashkëshortor bëhet për shkak të udhëzimit të librit të All-llahut dhe këshillave të Muhammedit a.s.

Njerëzit martohen për qëllime të ndryshme, disa martohen për pasuri, të tjerët për bukuri, ndërsa në Islam qëllimi është krejt tjetër.

Jeta është kalimtare, i riu plakët, shëndeti dobësohet, bukuria humbet, secila pra rritet, zhvillohet dhe dobësohet, ndërsa morali dhe feja mbeten vazhdimisht. Për këtë arsye, Muhammedi a.s. në një hadith sahih ka thënë:

“Femra martohet për katër gjëra: për pasurinë e saj, për bukurinë e saj, për fisin e saj dhe për fenë e saj, por më mirë martohu me atë e cila është fetare se përndryshe do të përplasesh për toke.”

Familja e shëndoshë është bazë e shoqërisë së shëndoshë, ajo është tulla e parë mbi të cilën ndërtohet banesa apo shoqëria. Shteti duhet të kujdeset për familjet, t’i përkrahë ato, ta mbrojë gjininë femërore, respektivisht nënën e shoqërisë, dhe edukuesen e fëmijëve, asaj duhet t’i ndihmohet me të gjitha mjetet.

Shpenzimi për familje dhe edukimin e pasardhësve është investimi më i miri, dhe më i vlefshmi në shoqërinë islame.

Transmeton Muslimi në Sahih, nga Ebu Hurejre r.a., se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Dinarin të cilin e shpenzon në rrugë të All-llahut, dinarin të cilin e shpenzon në lirim të robit, dinarin të cilin e shpenzon për të varfrin, ndërsa më i vlefshmi është dinari të cilin e shpenzon për familjen tënde.”

Qeveritari i mirë i kryen të gjitha nevojat e shoqërisë dhe ua lehtëson atyre rrugët e jetesës më të mirë. Familja është çështja e parë dhe çështja kryesore për të cilën duhet investuar.

Transmeton Muslimi në Sahih, nga Aishja r.a., se ka thënë: Në shtëpinë time e kam dëgjuar Muhammedin a.s. duke thënë:

“O Zoti im! Kush kujdeset dhe sillet mirë dhe butë me ummetin tim, sillu mirë dhe kujdesu për atë”.

RUAJTJA E FAMILJES

NENI 8

Shteti e ka për obligim krijimin e familjes dhe ruajtjen e saj, po ashtu e ka për obligim plotësimin e kushteve për jetesë si ato materiale (për vendbanim) ashtu edhe ato jo materiale (për edukim). Shteti e ka bërë obligim për ta nderuar dhe për ta respektuar jetën bashkëshortore dhe për të plotësuar kushtet për të çuar jetë bashkëshortore të lumtur dhe për të rritur pasardhës, duke u bazuar në atë, se familja është obligim i parë dhe kryesor i tij.

Koment:

Çdo urdhëresë dhe ndalesë jepet nga organet më të larta qendrore, në ato më të ulëta lokale. Organet qendrore janë si prindërit në familje - përballë organeve lokale.

Dihet në Fikh, se qeveritari është kujdestar (prind) për atë i cili nuk ka kujdestar (prind). Po ashtu, ai e zëvendëson qeveritarin lokal kur ai është i paaftë. Familjen, e cila nuk ka kujdestar (nuk ka kush të kujdeset), shteti islam e ka për obligim ta financojë prej arkës qendrore islame (bejtul mal). Ai (qeveritari) duhet të kujdeset për ruajtjen e jetës së qytetarëve të shoqërisë dhe për pasurinë e tyre.

Zoti i Madhëruar thotë:

النَّبِيُّ أَوْلَىٰ بِالْمُؤْمِنِينَ مِنْ أَنفُسِهِمْ

“Pejgamberi është më i ndjeshëm (Prioritar) ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetvetes së tyre”.

(El Ahzabë, 6)

Ky prioritet (ndjeshmëri) ka të bëjë me kujdesin prej Pejgamberit, ndërsa shoqëria islame (ummeti) duhet ta dëgjojë dhe ta respektojë. Në një hadith Sahih, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Për çdo besimtar unë jam më i ndjeshmi dhe më prioritari në këtë botë dhe në botën tjetër. Nëse dëshironi lexoni (ajetin kur'anor): “Pejgamberi është më i ndjeshëm ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetvetes së tyre”. Çdo besimtar, i cili vdes, le ta trashëgojnë

trashëgimtarët e tij, por nëse besimtari i vdekur, lë borxhe dhe është i bankrotuar, unë do t'ia marr përsipër për t'ia kryer”.

Kështu kanë vepruar edhe halifët e të Dërguarit s.a.v.s., pas tij me shoqërinë islame (ummetin).

Prej këtui, çdoi gjë që ka të bëjë me arsimin, edukimin, banimin, shëndetin dhe punësimin e shoqërisë duhet ta marrë përsipër shteti. Shteti duhet të angazhohet për lehtësimin dhe plotësimin e kushteve për të gjitha këto çështje. Ajeti kur'anor, thotë:

وَأَنْكَحُوا الْأَيَّامَى مِنْكُمْ وَالصَّالِحِينَ مِنْ عِبَادِكُمْ وَإِمَائِكُمْ
إِنْ يَكُونُوا فُقَرَاءَ يُغْنِهِمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ

“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit dhe robërshat tuaja, që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësitë e Tij. All-llahu është bujar, dhe i gjithëdijshtëm”.

(En Nur, 32)

Nuk ka të bëjë vetëm përkrashja morale dhe materiale. Urdhri në këtë ajet fisnik u drejtohet të gjithë kujdestarëve dhe përgjegjësve, duke filluar që nga pronari i familjes, e deri te kryetari.

Shoqëria duhet nxitur për martesë dhe për krijimin e familjes dhe duhet ndihmuar në krijimin e kushteve për banim, punësim dhe financim, në të gjitha mënyrat. Pastaj, duhet nderuar dhe respektuar familja dhe jeta e gjinisë femërore si nënë dhe vlera më e madhe e femrës është detyra e saj si nënë.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Femrat më të mira janë ato në deve, gratë e kurejshëve të cilat i rrisin, kujdesën për fëmijët e tyre deri sa të rriten dhe kujdesen për burrat e tyre.”

SHËNDETI (SHËNDETËSIA)

NENI 9

Shteti e ka për obligim ruajtjen e shëndetit të shoqërisë. E ka për obligim hapjen e objekteve shëndetësore (si ambulancat, spitalet etj.) dhe sistemin e shërbimit shëndetësor pa pagesë për pjesëtarët e shoqërisë, prej masave preventive, deri në shërimin e plotë.

Koment:

Islami është filozofi e mjekësisë. Urdhëron për shërim dhe kërkon preventivë prej sëmundjeve. Në një hadith Sahih, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Për çdo sëmundje Zoti ka lënë bar (ilaç) për shërim”.

Preventivën prej sëmundjeve ngjitëse, muslimanët e kanë mësuar nga Muhammedi a.s., kur ka thënë:

“Kur të dëgjoni për (sëmundjen ngjitëse) kolerën, në ndonjë vend, mos shkoni atje. Por, nëse gjendeni në vendin ku është përhapur (sëmundja ngjitëse), mos dilni prej aty”.

Përmbajtja e shkaqeve dhe rrethanave nuk është në kundërshtim me mbështetjen në All-llahun. Muslimani është i bindur me zemër, i qetë në mendim, zemërgjerë dhe përkujtues i All-llahut. I vështron dhe i mbështetet rrethanave dhe shkaqeve dhe e di se atë çka ka vepruar mirë në të kaluarën, s’ka qenë e mundur ta gabonte dhe atë çka e ka bërë gabim në të kaluarën, s’ka qenë e mundur ta vepronte drejtë.

Shteti e ka për obligim për të siguruar shërimin e shëndetit të shoqërisë pa pagesë, varësisht prej mundësive dhe të hyrave të përgjithshme, pasi pjesëtari i shëndoshë i shoqërisë është themel i shoqërisë aktive, punëtore dhe të fortë. Muhammedi a.s. në një hadith Sahih, ka thënë:

“Besimtari i shëndoshë dhe i fuqishëm është më i dashur te All-llahu se besimtari i sëmurë dhe i dobët. Angazhohu për çdo të mirë dhe çka është e dobishme. Mbështetu në All-llahun dhe mos u bë i paafët. Nëse të ndodh diçka mos thuaj: Ah sikur të kisha vepruar kështu, do të bëhej kështu, por thuaj: Caktimi i All-llahut. Çka ka dashtë All-llahu është bërë se fjala “sikur” hap dyert e veprimit të shejtanit.”

ARSIMI

NENI 10

Studimi dhe kërkimi i diturisë është farz. Shteti e ka për obligim që në bazë të ligjit të sigurojë të gjitha shkallët e arsimit (prej atij fillor, deri në atë superior)

Koment:

Specifika kryesore e Islamit është se Libri i Përgjithmonshëm ka filluar me urdhrin “lexo”:

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ . خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ . اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ . الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ . عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ .

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”.

(El Alak, 1-5)

Kjo është drita e parë e shpalljes së Kur'anit, te Muhammedi a.s., e cila e ndriçoi rrugën e arsimimit. Urdhri kur'anor “lexo” tregon arsimuesin dhe të arsimuarin. Entin arsimor dhe nevojën e shoqërisë për arsim.

Pastaj e ka sqaruar ligjin kryesor, i cili shpie në rrugën e arsimit e ajo rrugë, rruga me emrin e All-llahut, i cili jep qeveri dhe qeverisje, Krijues i qiejve dhe të tokës, dhe Krijues i tokës dhe gjallesave.

Pastaj i ka kushtuar vëmendje shkencës së krijimit, e cila ka filluar prej një lëngu të hedhur, e cila është faza e parë e embrionit në mitrën e nënës dhe pastaj e ka vazhduar me thënien “**çka nuk e di-nte**”, e cila përfshin ligjet e tokës dhe të qiellit.

Muslimanët e ndajnë arsimin në Farz Ajn (obligim individual) dhe Farz Kifaje (obligim shoqëror).

Obligimi individual është obligimi i cili përfshin besimin e singertë tek Zoti, adhurimin, dhe veprimin e çdo njeriu të moshës madhore, pa marrë parasysh a është mashkull apo femër, prej tij kërkohet të ketë besim të singertë tek All-llahu dhe të ketë bindje të plotë në shpalljet e të dërguarve, që prej njeriut dhe peygamberit të

parë - Ademiti a.s., e deri te pejgamberi i fundit - Muhammedi a.s. Njohjen e kryerjes së adhurimeve (ibadeve) në formën e duhur sipas Sheriatit Islam dhe veprimit me drejtësi që secili të marrë atë çka i takon.

Farzi kifaje (obligim shoqëror) është obligim, i cili nëse disa e kryejnë të tjerët lirohen prej atij obligimi dhe përfshin çdo gjë që ka të bëjë me rregullimin shoqëror në çështjet, si: jeta shoqërore, ekonomia dhe politika. Pastaj, prej këtu fillojnë të gjitha shkencat e tjera të artit, studimit, hulumtimit etj. Shoqëria islame, patjetër, duhet të ketë mjekë të specializuar, inxhinierë dhe specialistë të të gjitha çështjeve, si ato qytetare, ashtu edhe ushtarake.

Shteti e ka për detyrë t'i plotësojë kushtet, të caktojë atë që është e domosdoshme dhe atë që nuk është e domosdoshme apo në rend të dytë, të caktojë drejtimit të cilat janë falas dhe të cilat janë me shpenzime vetjake, dhe të caktojë vitet e studimit, mënyrat dhe fazat e arsimimit të ulët, të mesëm, të lartë dhe superior etj. etj.

EDUKIMI FETAR

NENI 11

Edukimi fetar është program elementar në të gjitha fazat e arsimimit.

Koment:

Patjetër, me arsim, duhet të ruhet identiteti i shoqërisë islame. Nuk mjafton vetëm mësimi i përgjithshëm, por patjetër duhet që edukimi fetar të jetë çelës i arsimit dhe veprimi në të gjitha fazat e arsimimit.

Shkollat e mesme dhe fakultetet nuk janë vetëm për profesione, por para shkollave të mesme dhe pas fakulteteve duhet edukata e qytetarit të mirë. Ndërsa përgatitja dhe afrimi, çka i bënë dobi në këtë botë dhe në botën e ardhshme, është e domosdoshme. Është e domosdoshme të ngrihet morali dhe edukata, të ruhet nderi njerëzor dhe të largohet epshi dhe imoraliteti.

Duhet ditur se çdo vepër që punon ta kontrollojë (inspekton) All-llahu dhe çdo vepër që ta punosh bëje me sinqeritet, vetëm për All-llah, të angazhuarit për të fituar kënaqësinë e All-llahut është bazë e moralit, e karakterit njerëzor dhe e të gjitha të mirave të tjera. Zoti i Madhëruar thotë:

لَنْ يَنَالَ اللَّهُ لُحُومَهَا وَلَا دِمَاؤُهَا وَلَكِنْ يَنَالُهُ التَّقْوَىٰ مِنْكُمْ

“Tek All-llahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por tek Ai arrin bindja e juaj”.

(EL Haxh, 37)

Muhammedi a.s. ka thënë në një hadith Sahih:

“Veprat shpërblehen sipas qëllimit, dhe çdo njeri do të shpërblehet për veprën se për çfarë qëllimi e ka bërë”.

Pasi që edukimi fetar kërkohet në arsimimin fillor si siguri e edukimit dhe formimit të shëndoshë, në fazën e arsimimit të mesëm dhe të lartë është më se i domosdoshëm. Rinia është faza kur takohet njeriu me probleme të natyrave të ndryshme dhe ato probleme nuk mund t'i zgjidhë vetëm se nëpërmjet fesë, nëpërmjet udhëzimeve të Kur'anit dhe sunnetit.

PLANPROGRAMI I EDUKIMIT DHE ARSIMIT ISLAM

NENI 12

Shteti e ka për obligim të përgatisë planprogramin për muslimanët, çka u përket çështjeve të farzeve, mësimin e biografisë së Muhammedit a.s., historinë e halifëve (kryetarëve) të drejtë, në të gjitha fazat arsimore.

NENI 13

Shteti e ka për obligim të përgatisë planprogramin për mësimin përmendësh të pjesëve të Kur'anit në vitet e arsimit varësisht prej orientimit shkollor. Gjithashtu duhet të themelojë institute të posaçme për mësimin përmendësh të Kur'anit. Të shtypë dhe të botojë mus-hafe dhe t'ua lehtësojë atyre.

Koment:

Planprogrami i edukimit islam përbëhet prej këtyre temave:

Mësimi i Kur'anit dhe Texhvidi

Mësimi i Kur'anit është bazë e jetës islame në përgjithësi. Prej Kur'anit fënisnik ujitet besimi në All-llah, ndërtohet edukata, me të përbëhen farzet, njihet historia e njeriut dhe e pejgamberëve dhe varet civilizimi islam dhe zhvillimi i tij.

Kjo anë e planprogramit të edukimit islam, nuk duhet të jetë vetëm në shkolla dhe fakultete, por duhet të përfshihet e tërë shoqëria islame (ummeti), meshkuj e femra. Shteti duhet të hapë shkolla (të posaçme) speciale për mësimin e Kur'anit, ligjet, shkencat e tij dhe duhet të botojë mus-hafe për të furnizuar shoqërinë.

Kur'ani famëllartë ruhet edhe në mendjet dhe zemrat e muslimanëve, por edhe i shkruar në faqe dhe leximi përcillet gjeneratë pas gjenerate, në mënyrë strikte, deri sa të ekzistojë kjo botë duke u bazuar në garantimin e Zotit të Madhëruar:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

“Ne me Madhërinë Tonë e shpallëm Kur’anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij”.

(El Hixhr, 9)

Kur Zoti dëshiron të ndodhë një çështje, i lehtëson të gjitha çështjet që ajo të ndodhë.

BAZAT E FESË DHE BESIMIT ISLAM

Besimi dhe bindja në Zotin është çelës i identitetit të muslimanit, me të kryen veprat dhe në bazë të besimit dallohen fetë.

Shteti e merr përgjegjësinë për përgatitjen e planprogramit për të mësuar thellësisht besimin islam, madhështinë e tij, tolerancën e tij dhe gjithëpërfshirjen e tij, në të gjitha fushat e jetës. Planprogrami duhet të jetë i përqendruar në besim në një Zot – All-llahun e Lartmadhëruar dhe në pejgamberllëkun e Muhammedit a.s., si pejgamber i fundit dhe vulë e shpalljeve prej Zotit. Çështjen e melaikëve, pejgamberëve, librave të tij, Ditës së fundit, llogarinë në Ditën e Kijametit, xhennetin, xhehennemin etj.

ADHURIMET DHE MORALI

Adhurimet (ibadetet) janë fryt i besimit islam dhe moralit, ato janë fryti më i çmueshëm, me to zgjerohen zemrat, shtohen shpresat, mbizotëron paqja dhe qetësia dhe njerëzit garojnë në punë të mira, të zellshme dhe ndihmohen në jetë për ngritjen e standardit jetësor dhe civilizimin kulturor.

HISTORIA E HALIFËVE (KRYETARËVE) TË DREJTË

Epoka e Halifëve të drejtë është epoka e Ebu Bekr Es Sidik-ut, Umer El Faruk-it, Uthman-it, të ndriturit të dyfishtë, (poseduesit të dy dritave) dhe Aliut, Zoti e nderoftë personalitetin e tij. Ajo epokë është epoka e shëmbëlltyrës tipike, se si duhet praktikuar Islami. Është epoka më e ndritshme, ata lanë vepra të shkëlqyeshme, virtyte shembullore, të cilat meritojnë të mbështeten.

Në hadithin, të cilin e transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu (hadith Hasen Sahih) nëpërmjet zinxhirit deri tek Ebu Nexhih El Arbat bin Sarijete r.a., i cili ka thënë:

“Na ligjëroi i Dërguari i All-llahut një ligjëratë të rëndësishme dhe tërheqëse, sa që na u dridhen zemrat dhe na lotuan sytë. Ne i thamë: O i Dërguar i All-llahut, mos është ligjërata e fundit? Muhammedi a.s. tha: ***Ju porosis të jeni të devotshëm ndaj All-llahut, të dëgjueshëm edhe nëse ju udhëheq rob, sepse kush prej jush do të jetojë më vonë, do të shohë mospajtime dhe kundërshtime të shumta. Përmbajuni sunnetit tim dhe sunnetit të halifëve (kryetarëve) të drejtë dhe të udhëzuar, pasoni ata dhe ruajuni prej risive, sepse çdo risi shpie në humbje***”.

VESSHJA ISLAME E FEMRËS

NENI 14

Lakuriqësia është e ndaluar. Siguria e saj (femrës) është obligim. Shteti sjell ligje dhe vendime për mbrojtjen e ndjenjave të përgjithshme, në përputhshmëri me Sheriatin Islam.

Koment:

Femra islame, nga brenda e nga jashtë, është besim dhe moral. Morali dhe karakteri i femrës është te pastrimi i zemrës dhe i trupit. Nuk mundet të ketë pastrim të zemrës nëse nuk ka sinqeritet në fjalë, sjellje të mira, veshje të mirë, mbulesë dhe edukatë të mirë. I Dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë:

“Vërtet All-llahu nuk shikon format dhe pasuritë tuaja, por shikon zemrat dhe veprat tuaja.”

Disa mendojnë se nuk llogaritet pamja e jashtme, por vetëm zemra le të jetë e mirë.

Rregullimi dhe sinqeriteti i zemrës është në brendësi, edhe pse reflekton ndryshe jashtë. Ky është iluzion dhe tradhti e shejtanit, pasi zemra e shëndoshë dhe e mirë reflekton sjellje dhe edukatë të mirë. Nijeti i mirë rezulton me vepra të mira. Pamja e jashtme ka rëndësi në Sheriatin Islam. Pastërtia e rrobave, vendit, mbulimi i trupit janë kushte për pranimin e namazit. All-llahu na ka urdhëruar ta ruajmë trupin dhe ta kemi të pastër si loti.

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا بَنِي آدَمَ خُذُوا زِينَتَكُمْ عِنْدَ كُلِّ مَسْجِدٍ

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz”.

(El A'rafë, 31)

Sa i përket veshjes së femrës muslimane, Zoti i Madhëruar, në Kur'anin fënisht, thotë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِّلزَّوْجِکَ وَبَنَاتِکَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِیْنَ یُذْنِیْنَ عَلَیْھِنَّ مِنْ جَلَابِیْھِنَّ
ذَٰلِکَ أَذْنٰی اَنْ یُعْرِضْنَ فَلَا یُؤْذِیْنَ وَكَانَ اللّٰهُ غَفُوْرًا رَّحِیْمًا

“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le të vejnë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues”.

(El Ahzabë, 59)

Ky është apel i përgjithshëm i All-llahut për të gjithë besimtarët, për t’iu përmbajtur rregullave të veshjes islame që të njihen tek njerëzit me modesti dhe pastërti dhe mos t’iu nënshtrohen ofendimeve gjatë veshjes në rrugë publike. Femra e devotshme dhe e cila i përmbahet rregullave islame, domosdo i detyron të tjerët ta respektojnë atë, saqë edhe mëkatar i turpërohet prej saj. Ndërkaq, femra lakuriqe shpie në ngatërresa, tollovi dhe i shtyn mëkatarët ta ofendojnë dhe t’i hedhin fjalë të këqija dhe të pamoralshme.

Shoqëria përbëhet prej femrave dhe meshkujve dhe të gjithë kanë nevojë t’iu përmbahen rregullave të moralit, për t’u ruajtur pastërtia e shoqërisë dhe të gjithë duhet të ndihmohen mes vete në mirësi dhe devotshmëri.

Nuk mund të thuhet se kjo është e drejtë dhe përgjegjësi e vet familjes, pasi e drejta dhe përgjegjësia është vetëm brenda rrethit të shtëpisë dhe të familjes, ndërsa sa i përket jetës jashtë familjes dhe jetës shoqërore, përgjegjës është shteti, dhe shteti e ka për obligim të vendosë ligje dhe rregulla për ta ruajtur shtetin.

Prej këtui, qeveritari merr urdhër dhe vendos ligje dhe vendime, të cilat i sigurojnë ndjenjat e përgjithshme të shoqërisë dhe e ruajnë moralin dhe nderin e shoqërisë.

Kjo arrihet nëpërmjet rregullave dhe vendimeve për mbulojë e femrës në shkollë, fabrika, në zyrë, nuk lejohet që femra të jetë e zbuluar në sallat qeveritare, nuk lejohet që ajo të dalë e zbuluar në televizion, ajo nuk duhet të kryejë punë që janë në kundërshtim me moralin si reklamat, po ashtu të jetë e zbuluar edhe në mjetet e tjera të informimit.

Kjo nuk është posaçërisht për femrën muslimane. Nuk lejohet për femrën, pa marrë parasysh a është e vendit apo e huaj, muslimane apo jomuslimane, të dalë e zbuluar në rrugë publike, se turpi është edukata dhe sjellja e lartë e njeriut.

Kam vërejtur se në Iran nuk mund të shohësh femër të zbuluar, as në sallat e delegacioneve të huajve. Të gjitha janë me mbulojë islame, gjë që nuk vërehet në Arabinë Saudite, ku mund të shohësh

femra të zbuluara në Xhide dhe në Riad, gjë që është në kundërshtim me mbulimin islame.

Ne nuk themi se vetëm mbulimi i femrës është morali dhe nderi i femrës, por është hapi i parë, pas së cilit duhet të pasojnë hapat e tjerë të besimit dhe edukatës.

Ka dallim të madh në mes të Iranit dhe Arabisë Saudite. Në Iran, ka përzierje të plotë të meshkujve dhe femrave, në të gjitha fushat e jetës, ndërsa në Arabinë Saudite ka ndarje të plotë në mes të meshkujve dhe femrave në arsim. Është e ndaluar që profesori (mashkull) t'i mësojë femrat në shkollën për femra. Sikurse kanë hapur edhe sektorë të veçantë të bankave për femra. Mirëpo, përzierje e meshkujve dhe femrave ka edhe në spitale, edhe në ndërmarrjet tregtare, ka edhe në Qabe.

Në Iran, në shumicën e rasteve, femra nuk e ka të mbuluar fytyrën, ndërsa në Arabinë Saudite e kanë të mbuluar edhe fytyrën. Sido që të jetë, këto janë çështje sekondare për të cilën mund të diskutohet lehtë. All-llahu e di qëllimin.

GJUHA ARABE DHE KALENDARI I HIXHRETIT

NENI 15

Gjuha arabe, është gjuhë zyrtare. Kalendari i Hixhretit është vaxhib të përdoret si kalendar zyrtar.

Koment:

Gjuha arabe është gjuhë e Kur'anit, vetëm të kënduarit e saj është adhurim dhe është mrekulli e Zotit, madje edhe të lexuarit e sures më të shkurtër. Pasi që Islami është fe ndërkombëtare, ai i tejkalon kufijtë e vendeve dhe të kohërave. Gjuha arabe është gjuhë e cila bën bashkimin e të gjitha vendeve dhe të gjitha kohërave.

Në epokën e artë të Islamit gjuha arabe ka qenë gjuhë e qeverisë dhe e politikës, gjuhë e shkencës dhe civilizimit, gjuhë e artit dhe letërsisë.

Është interesant se sot mund të gjesh një jomusliman, i cili e këndon Kur'anin në gjuhën arabe shumë kthjellët dhe rrjedhshëm, ndërsa nuk mund të flasë apo të bëjë dialog në gjuhën arabe.

Kjo ka nevojë për dyfishimin e angazhimit dhe përforcimit, deri sa gjuha arabe të bëhet gjuhë ndërkombëtare.

Derisa sa kolonizimi evropian, i cili ka sunduar dhe ende tenton që gjuhësisht t'i okupojë popujt e vendeve të pazhvilluara dhe derisa institucionet e bashkësisë ndërkombëtare flasin gjuhën angleze dhe franceze, atëherë pse shoqëria islame të mos bëjë që t'i bashkojë një gjuhë, kur i bashkon një besim, një kible, pra edhe gjuha arabe të jetë gjuhë zyrtare në shërbimet zyrtare.

Është gabim kur disa thërrasin për gjuhën popullore arabe dhe gjuhët lokale, mirëpo këto thirrje janë thirrje të kolonialistëve, të cilët dëshirojnë përçarjen e ummetit (shoqërisë islame), ndarjen e arabëve dhe vendosjen e dallimeve gjuhësore në mes të popullit arab mes vete, në njërën anë dhe ndërmjet arabëve dhe muslimanëve, në anën tjetër.

Kalendari hënor dhe i hixhretit është simbol i muslimanëve, ai simbolizon civilizimin madhështor, i cili e ndërlidh shoqërinë islame (ummetin) prej Umerit r.a. dhe prej aty duhet të fillojë numërimi kalendarik dhe të caktohen festat zyrtare.

Është e papranueshme kërkesa e disa shteteve islamike, të cilët dëshirojnë të bëjnë bashkimin, që me llogaritjen e kalendarit diellor dhe muajt diellor, të bëhet dhe të llogaritet hixhreti.

Po ashtu, është e papranueshme se si disa shtete arabe tentojnë të ndryshojnë kalendarin e hixhretit dhe të fillojnë kalendarin me ditën e vdekjes së Muhammedit a.s., i cili pakësohet menjëherë për 13 vite.

Kjo është largim nga ixhmai (unanimiteti) i shoqërisë dhe mohon 14 shekuj të tjerë, po ashtu hap derën e çrregullimeve dhe Zoti e mallkon atë, i cili hap dyert e fitneve (shpifjeve e çrregullimeve).

Kalendari i hixhretit përbëhet prej muajve arabë, në të cilin viti fillon me muajin Muharrem dhe përfundon me muajin Dhul Hixhe dhe bazohet në rrotullimin e hënës. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

إِنَّ عِدَّةَ الشُّهُورِ عِنْدَ اللَّهِ اثْنَا عَشَرَ شَهْرًا فِي كِتَابِ اللَّهِ يَوْمَ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ
وَالْأَرْضَ مِنْهَا أَرْبَعَةٌ حُرْمٌ ...

“Te All-llahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës) ashtu si është në librin e All-llahut, prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë”.

(Et Tevbe, 36)

Muajt e kalendarit hënor nuk kanë më shumë se 30 ditë dhe më pak se 29. Muslimanët duhet të vështrojnë hënën e re pas 29 ditëve të çdo muaji. Nëse e shohin, atë ditë fillon muaji, e nëse jo, atëherë e plotësojnë muajin 30 ditë.

Transmetohet në Sahihun e Muslimit, nga Ibn Umeri r.a., se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Muaji i ka 29 ditë. Nëse nuk e shihni hënën e re agjëroni ditën e 30, nëse e shihni atëherë bëni Bajram, mos agjëroni, por nëse është mjegull dhe errësirë atëherë plotësoni 30 ditë (të muajit Ramazan)”.

Hëna i ka shenjat dhe fazat me të cilat njerëzit mund të ndërlidhin veprimet e tyre, me të ndërlidhen shtyllat e Islamit dhe bazohen ligjet e Fikhut. Zoti i Madhëruar thotë:

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْأَهْلِ قُلْ هِيَ مَوَاقِيتُ لِلنَّاسِ وَالْحَجِّ ...

“Të pyesin ty për hënën e re (dhe fazat e saj) thua: Ato janë përcaktime të kohës për njerëz dhe për haxh”. (El Bekare, 189)

DETYRA E QEVERISË

NENI 16

Qeveria ka për obligim kujdesin e përgjithshëm të shoqërisë dhe posaçërisht ruajtjen e fesë, ruajtjen e mendjes, ruajtjen e individit në shoqëri, ruajtjen e pasurisë dhe ruajtjen e nderit..

NENI 17

Nuk mjafton që qëllimet vetëm të jenë të projektuara por duhet që në të gjitha rastet të jenë të bazuara në mënyrat e sheriatit islam.

Koment:

Pozitat qendrore nuk janë pozita të përfitimeve të pasurisë individuale, as të shfryrjes së epsheve, apo për të arritur reputacion, por është amanet dhe përgjegjësi. Çdo njeri përgjigjet për pozitën të cilën e merr, për mirë apo për të keq. Transmetohet në Sahihun e Muslimit, nga Ebu Dherri r.a., se ka thënë:

“I kam thënë të Dërguarit të All-llahut: Më jep një post shtetëror? Tha: E vendosi dorën e tij në kraharorin tim dhe pastaj më tha: “O Ebu Dherr: Ti je njeri i paaftë (i pakualifikuar për atë që kërkon). Pozita është amanet (në këtë botë) ndërsa në botën tjetër nënçmim dhe pendim, përpos ai i cili vepron me drejtësi.”

Filozofia e përgjithshme është se për emërtimin e kandidatëve duhet që ata të jenë shëmbëlltyrë, të aftë për të marrë përgjegjësi vizionare, guxim dhe angazhim të palodhur.

Musa El Eshariu, tregon, ashtu qysh është e regjistruar në Sahihun e Muslimit, se: Hyra unë dhe dy njerëz nga fisi Beni Umeje te Muhammedi a.s. dhe njeri prej tyre tha: O i Dërguar i All-llahut na emëro në ndonjë detyrë, në ato kompetenca të cilat t’i ka dhënë All-llahu i Lartmadhëruar. Po ashtu kërkoi edhe i dyti. Muhammedi a.s. tha:

“Ne nuk i emërojmë në pozita, ata të cilët i lakmojnë dhe i kërkojnë ato.”

Kjo për arsye se, ai i cili lakmon pozitën dhe e kërkon atë, për shkak se ka paraprakisht ndonjë interes individual, dhe për përfitim të tij dhe nuk e dëshiron si amanet dhe përgjegjësi.

Interesi i përgjithshëm është në pesë baza kryesore, të cilat mandatorët duhet t'i ruajnë dhe t'i forcojnë, e ato janë:

1. Ruajtja e fesë, sepse ajo është porosi dhe ndjenjë e lidhur në shpirtin e njeriut dhe pa të nuk mbetet asgjë tjetër, përpos e keqja dhe shkatërrimi. Feja është besimi në All-llah, në emrat e bukur të Tij, në melaiket fisnike, në librat e tij të cilat kanë zbritur për t'i udhëzuar njerëzit në të vërtetën dhe në rrugën e drejtë, besimi në pejgamberët e Tij, të cilët i ka zgjedhur prej gjithë njerëzimit dhe në Ditën e Gjykimit, ku secili do të gjejë atë çka e ka vepruar.

2. Ruajtja e identitetit (personalitetit) dhe e drejta për jetë, liri, arsimim dhe nder. Personi është pjesë e vogël, që përbën tërë shoqërinë. Çdo shkelje e të drejtës së tij do të thotë shkelje e qenies njerëzore në përgjithësi. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

مِنْ أَجْلِ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَٰئِيلَ أَنَّهُ مَن قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا ...

“Për këtë (shkak të atij krijimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush e mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pas mbytur ai ndonjë tjetër, dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur të gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai i gjallë), është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit”.
(El Maide, 32)

3. Ruajtja e pasurisë dhe posaçërisht pronësisë private, e cila është fituar hallall, është e shenjtë. Dhe orientimi në atë, çka i ndihmon privatisht për t'i kryer detyrat e tij ligjore, që në Sheriatin Islam quhet “mirësi”.

4. Ruajtja e mendjes. Mendja është nderi dhe krenaria e njeriut, boshti i besimit dhe ligj i jetës. Sheriati Islam e ruan nga çdo tronditje dhe plasaritje dhe e mban të kthjellët dhe të shëndoshë.

5. Ruajtja e pasardhësve, me martesë legjitime, dhe me ndalimin e prostitucionit dhe imoralitetit, haptazi apo fshehtazi..

Ruajtja e fesë, mendjes, identitetit, pasurisë dhe nderit bëhet nëpërmjet Qeverisë dhe vetëm me mjete legjitime dhe fisnike, se vetëm qëllimi fisnik arrin rezultate fisnike. Këto çështje nuk arrihen me armiqësi.

Islami nuk e pranon parimin: Qëllimi e justifikon mjetin.

KAPITULLI I TRETË

EKONOMIA ISLAME

Përbëhet prej 10 neneve:

Prej nenit 18

Deri në nenin 27

EKONOMIA ISLAME

NENI 18

Ekonomia duhet të zhvillohet në bazë të parimeve të Sheriatit Islam, parime të cilat respektojnë nderin njerëzor dhe drejtësinë shoqërore dhe obligon në angazhim për jetë të lumtur, lirinë e mendimit dhe të veprimit, dhe mbron fitimin hallall.

Koment:

Njeriu është halife (mëkëmbës) në tokën e All-llahut, e ndërton tokën, i mëson ligjet e tokës dhe të krijesave në të, që t'i shfrytëzojë, të përfitojë dhe të prodhojë prodhime të mira dhe të bekuara. Në Islam, puna, derdhja e djersës dhe prodhimi janë ibadetet me të cilat njeriu afrohet më së shumti tek All-llahu. Zoti i Madhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذَلُولًا فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِن رِّزْقِهِ
وَالِيهِ النُّشُورُ

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj, dhe shfrytëzoni begatitë e tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja.”

(El Mulk, 15)

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Nuk ka ushqim më të mirë se ushqimi të cilin njeriu e fiton me duart e tij. Vërtet, Davudi a.s. është ushqyer me duart e tij.”

Muslimanët nuk mund t'i arrijnë qëllimet e tyre pa i pasur ligjet e tokës në disponim për fenë e tyre. Feja islame nuk lejon që muslimanët të bëjnë tevekul (vetëm mbështetje formale te Zoti), ndërsa këtë botë t'ua lënë në disponim armiqve të tyre dhe t'i ikin kënaqësisë së kësaj bote. Këtë e bëjnë vetëm të paaftit, kjo është turp. Islami nuk njeh kallogjeri dhe nuk njeh ndarjen e kësaj bote prej fesë. Puna për All-llah përfshin tërë jetën, pa përjashtim, deri sa t'i kuptojmë vlerat e mira, t'i përmbahemi drejtësisë, të bëjmë dobi dhe ta lulëzojmë jetën.

Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë fitimin hallall, fillim dhe mbarim të punës, ndërsa në mes të punës e ka vendosur namazin e xhumasë, si orientim i mirë, se puna e njeriut ka nevojë për forcë shpirtërore, e cila e nxit të shtojë prodhimin, të zhvillohet dhe të bëjë punë të mira sa më shumë. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ . فَإِذَا قُضِيَتِ الصَّلَاةُ فَانْتَشِرُوا فِي الْأَرْضِ وَابْتَغُوا مِنْ فَضْلِ اللَّهِ وَاذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ .

“O ju që besuat, kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, ecni shpejt për aty ku përmendet All-llahu (dëgjojeni hutben, falni namazin), e lini shitblerjen, kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse jeni që e dini. E, kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkon begatitë e All-llahut, por edhe përmendeni shpeshherë All-llahun, ashtu që të gjeni shpëtim”.

(El Xhumu’a, 9-10)

Në Islam pasuria ka dy rregulla- ligje. Për ta fituar mallin hallall dhe për ta shpenzuar në investime të dobishme. Nëse angazhohemi në këto dy çështje, kemi realizuar drejtësi shoqërore, e kemi ruajtur fisnikërinë, vlerën e njeriut dhe pasurinë e All-llahut e kemi shpenzuar për të mirën e krijesave të All-llahut.

Në këto dy rregulla nënrenditen:

1. Nuk ka fitim haram. Çdo njeri, i cili rritet me haram, trupi i tij nuk ka vlerë. Kamata, vjedhja, mitoja, uzurpimi, etj. të gjitha janë të papranuara në ekonominë islame.

2. Lypja është mëkat. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush lyp prej njerëzve, vetëm për ta shtuar pasurinë, ai kërkon tubimin e gacave të zjarrit. Pra le të zgjedhë më mirë pak (e mirë) se shumë e pa dobi.”

3. Varfëria është mëkat nëse është për shkak të shpenzimit pa kontroll dhe për shkak të përtacisë. Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَا تَجْعَلْ يَدَكَ مَغْلُولَةً إِلَىٰ عُنُقِكَ وَلَا تَبْسُطْهَا كُلَّ الْبَسْطِ فَتَقْعُدَ مَلُومًا مَّحْسُورًا

“Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bë koprrac) e as mos e shtrij në tërësi, e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt)”.

(El Israë, 29)

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Dora e cila jep është më e mirë se dora e cila merr.”

4. Puna është farz, me kusht që mos i humbë edhe farzet e tjera të All-llahut. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تُلْهِكُمْ أَمْوَالُكُمْ وَلَا أَوْلَادُكُمْ عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ
وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ فَأُولَئِكَ هُمُ الْخَاسِرُونَ

“O ju që besuat, as pasuria juaj, e as fëmijët tuaj, të mos u shmangin prej adhurimit ndaj All-llahut, e kush bën ashtu, të tillët janë ata të humburit.”

(El Munafikunë, 9)

5. Puna është e domosdoshme, por duhet të jesh zemërgjerë, i kënaqur dhe duhet të jetosh pa brenga dhe presione. Për këtë arsye, Muhammedi a.s., ka thënë:

“Nuk është pasuri, pasuria e shumtë, por pasuri e vërtetë është pasuria e zemrës dhe e shpirtit”.

TREGTIA E LIRË, INDUSTRIA DHE BUJQËSIA

NENI 19

Tregtia e lirë, industria dhe bujqësia duhet të jenë brenda kufijve të Sheriatit Islam.

Koment:

Islami i kushton rëndësi të posaçme ekonomisë, tregtisë, industrisë dhe bujqësisë. Rëndësia e tyre paraqitet vazhdimisht në tekstet kur'anore dhe në hadithet e Muhammedit a.s., që është në përputhshmëri me ndikimin e tyre në jetën e njeriut. Zoti i Madhëruar na ka urdhëruar ta vështrojmë (hulumtojmë) ushqimin të cilin e hamë dhe ta kuptojmë fshehtësinë e fitimit të tij dhe rrugën e përfitimit. Zoti i Madhëruar thotë:

فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ . أَنَا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا . ثُمَّ شَقَقْنَا الْأَرْضَ شَقًّا .
فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا . وَعَبَبْنَا وَقَضْبًا . وَزَيْتُونًا وَنَخْلًا . وَفَاكِهَةً وَأَبًّا . مَتَاعًا لَّكُمْ
وَلِأَنْعَامِكُمْ .

“Njeriu le të shikojë ushqimin e vet. Ne lëshuam shi të mjaftueshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës. Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra. Edhe rrush e perime. Edhe ullinj e hurma. Edhe kopshte të dendura. Dhe pemë e kullosa. Si mjet gjallërimi për ju dhe bagëtinë tuaj”.

(Abese, 24-32)

Sa i përket dobisë dhe rëndësisë së pemëtarisë, Muhammedi a.s. thotë:

“Çdo musliman, i cili mbjell ndonjë pemë ose perime dhe prej aty ushqehet ndonjë shpend ose njeri, i shkruhet sadaka (lëmoshë).”

(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Muhammedi a.s. sigurimin e ujësjellësit e ka quajtur sadaka rrjedhëse, prej të cilës njeriu fiton shpërblime të shumta edhe në këtë jetë, edhe pas vdekjes. Transmetohet nga Sead bin Ubadete se ka thënë:

“E kemi pyetur Muhammedin a.s. se cila është sadakaja më e vlefshme. Është përgjigjur: “Sigurimi i ujit. Pastaj, Seadi e hapi një ujësjellës dhe tha: “Kjo është (sadaka) për nënën e Seadit”.

(Davudi, Ibn Habani, Haremi)

Në një hadith tjetër, Muhammedi a.s., ka thënë:

“Veprat për të cilat shpërblehet besimtari pas vdekjes së tij janë: Dituria të cilën e ka mësuar dhe e ka shpërndarë, djaln e mirë të cilin e ka lënë pas vete, një mus-haf (libër) të cilin e ka lënë pas vete, ose ndonjë shtëpi për kalimtarët e rastit, ose ka siguruar ndonjë ujësjellës ose ndonjë sadaka të cilën e ka dhënë, sa ka qenë i shëndoshë, prej pasurisë së tij.”

(Ibn Maxhe, ibn Huzejme)

Çështja e industrisë në Kur'an është e ndërlidhur me pejgamberët më eminentë. Ibrahim a.s. e ka ndërtuar shtëpinë (Qaben) me të birin Ismailin. Zoti, Davudit a.s., ia ka mundësuar përpunimin e hekurit. Kur'ani ka treguar për përpunimin e lëkurës, leshit dhe ndërtesave. Zoti i Madhëruar thotë:

وَاللّٰهُ جَعَلَ لَكُمْ مِّنْ بُيُوتِكُمْ سَكَنًا وَجَعَلَ لَكُمْ مِّنْ جُلُودِ
الْأَنْعَامِ بُيُوتًا تَسْتَخِفُّونَهَا يَوْمَ ظَعْنِكُمْ وَيَوْمَ إِقَامَتِكُمْ وَمِنْ أَصْوَابِهَا وَأَوْبَارِهَا
وَأَشْعَارِهَا أَثَاثًا وَمَتَاعًا إِلَىٰ حِينٍ . وَاللّٰهُ جَعَلَ لَكُمْ مِّمَّا خَلَقَ ظِلَالًا وَجَعَلَ لَكُمْ مِّنَ
الْجِبَالِ أَكْنَانًا وَجَعَلَ لَكُمْ سَرَابِيلَ تَقِيكُمُ الْحَرَّ وَسَرَابِيلَ تَقِيكُم بَأْسَكُمْ كَذَلِكَ يُتِمُّ نِعْمَتَهُ
عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تُسْلِمُونَ .

“All-llahu ju bëri shtëpitë tuaja vendbanim të qetë dhe nga lëkurat e kafshëve ju mundësoi që të keni shtëpi, që lehtë i bartni kur udhëtoni, e edhe kur vendoseni, ndërsa nga leshi i tyre, petka e shtroja dhe t'i shfrytëzoni për një kohë. All-llahu, nga ajo që krijoi Ai, ju bëri edhe hije, e në kodra vendstrehime, edhe petka që ju mbrojnë prej të nxehtit dhe petka që ju mbrojnë në luftë. Ashtu All-llahu plotëson të mirat e Tij ndaj jush, në mënyrë që të dorëzoheni.”

(En Nahl, 80-81)

Kur'ani ka treguar edhe për përpunimin e hekurit dhe të celikut, ku thotë:

... وَأَنْزَلْنَا الْحَدِيدَ فِيهِ بَأْسٌ شَدِيدٌ وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ وَلِيَعْلَمَ اللَّهُ مَن يَنْصُرُهُ وَرُسُلَهُ
بِالْغَيْبِ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ عَزِيزٌ

“Ne e kemi zbritur edhe hekurin, që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz, e edhe për t’u ditur tek All-llahu se kush ndihmon Atë (rrugën e tij) dhe të Dërguarit e Tij, duke i besuar në fshehtësi. S’ka dyshim se All-llahu është i fuqishëm, mbizotërues.”

(El Hadidë, 25)

I dërguari i All-llahut ka kërkuar që të mësohet industria, të zhvillohet dhe të përsoset. Industrinë e ka definuar prej punëve të vlefshme dhe të dobishme, dhe veprimtari prej veprimtarive më të mira. Në Sahihun e Buhariut është i regjistruar një hadith, ku Ebu Dherr El Gafari e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.:

“Cila është prej veprave më të mira?

- **Besimi në All-llahun dhe lufta në rrugën e Tij, - është përgjigjur.**

Cila është përkujdesja më e mira?

- **Ajo që është më e shtrenjta dhe më e çmueshmja.**

Po nëse atë nuk e kanë (atë përkujdesje)?

- **Të ndihmosh industrinë dhe t’u mësosh të tjerëve industrinë.**

Po nëse atë nuk mund ta bëj?

- **T’i largosh të tjerët prej të keqes pse ajo është sadaka, të cilën e jep për veten tënde”.**

Nëpërmjet bujqësisë, industrisë dhe sektorëve të tyre realizohet prodhimi dhe zhvillohet tregtia, e cila i plotëson nevojat dhe kërkesat e njerëzve. Kur’ani tregon për udhëtimet me qëllim tregtie dhe sigurimin e rrugës tregtare dhe e ka bërë prej begative kryesore të njerëzve. Zoti i Madhëruar thotë:

لَا يَلَفُ قَرِيشٌ . إِيْلَافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ . فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ . الَّذِي
أَطْعَمَهُمْ مِّنْ جُوعٍ وَأَمَّنَهُمْ مِّنْ خَوْفٍ .

“Për hir të garantimit që e gëzojnë kurejshët! Garantimin e udhëtimit të tyre të bërë dimrit dhe verës. Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie, i cili i ushqen pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike”.

(Kurejsh, 1-4)

Muhammedi a.s. e ka lavdëruar tregtarin besnik dhe e ka përgëzuar për shkallën më të lartë të xhenetit (E'ala-Firdevs). Siç transmeton Tirmidhiu:

“Tregtari i drejtë dhe besnik është me peygamberët, të drejtët dhe dëshmorët”.

Muhammedi a.s. ka kërkuar tolerancë në shitje po ashtu edhe tolerancë në blerje, kur ka thënë:

“Zoti e mëshiroftë njeriun i cili toleron kur shet, kur blenë dhe kur jep borxh”.

(Buhariu)

Tregtia, industria dhe bujqësia janë shtyllë e jetës shoqërore. Islami i ka caktuar parimet e Sheriatit për zhvillimin e këtyre sektorëve të ekonomisë. I ka caktuar obligimet, por edhe ndalesat siç janë: të mos ketë kamatë, tradhti, monopolizim, padrejtësi, mos të bëhet tregti me mallra haram, siç janë: droga, alkooli, mishi i derrit etj.

Muslimani, patjetër, duhet ta japë zekatin edhe për mallin tregtar, edhe për produktet bujqësore, edhe për pasurinë e arkëtuar dhe, me pasurinë e All-llahut, iu bën dobi krijesave të All-llahut.

Muslimani ka liri absolute të tregtisë, ashtu si dëshiron edhe siç e sheh se çfarë interesi dhe çfarë përfitimi ka, por jo të jetë në kundërshtim me dobinë e përgjithshme të shoqërisë. Tregtia duhet të jetë me mjete të pastra, dhe me rregulla të moralit dhe edukatës.

PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 20

Shteti e projekton programin e zhvillimit ekonomik në pajtim me Sheriatin Islam.

Koment:

Shteti është përgjegjës për ngritjen e standardit të popullit dhe plotësimin e nevojave të tyre, varësisht prej të ardhurave të përgjithshme dhe buxhetit. Derisa qytetari ka liri për zhvillimin ekonomik personal, shteti e ka për obligim ta orientojë politikën ekonomike në atë çka është në dobinë e përgjithshme. Zhvillimi ekonomik i përgjithshëm është përgjegjësi e qeverisë dhe e individit së bashku.

Shoqëritë tona, sot, ballafaqohen me ligje të padrejta, të cilat e pengojnë prodhimin. Ballafaqohemi me problemin se, ligjet e drejta të zhvillimit ekonomik, po vonohen shumë. Kjo është përgjegjësi e shtetit. Po ashtu, ballafaqohemi me shpenzime të pakontrolluara dhe të tepërta të tregtisë dhe eksportit, kjo është përgjegjësi e individit.

Me bashkëpunim të ndërsjellët të Qeverisë dhe individit, mund të plotësohen shërbime më të mira për popullin. Duhet t'i japim fund ligjeve që pengojnë zhvillimin ekonomik dhe të projektojmë programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë, program i cili sjell stabilitet ekonomik të përhershëm dhe zhvillim ekonomik të përhershëm.

Kur'ani na tregon shembullin e mrekullueshëm të programit ekonomik, tek rasti i Jusufit a.s. Jusufi a.s. ishte burgosur i pafajshëm dhe me padrejtësi. Aty u takua me dy djelmosha dhe aty shfrytëzoi rrugën e thirrjes në rrugën e All-llahut, duke iu thënë:

يَا صَاحِبِي السَّجْنِ أَرَبَابٌ مُتَّفَقُونَ خَيْرٌ أَمِ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ

“O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm apo All-llahu i vetmi ngadhënjimtar”.

(Jusuf, 39)

Të dy djelmoshat kishin parë nga një ëndërr, ndërsa Jusufi a.s. ua komentoj që të dyve ëndrrën:

يَا صَاحِبِي السَّجْنَ أَمَا أَحَدُكُمَا فَيَسْقِي رَبَّهُ خَمْرًا وَأَمَا الْآخَرُ فَيُصَلِّبُ فَتَأْكُلُ الطَّيْرُ
مِنْ رَأْسِهِ قُضِيَ الْأَمْرُ الَّذِي فِيهِ تَسْتَفْتِيَانِ

“O shokët e mi të burgut! Njëri prej juve dyve do t’i japë të pijë verë zotëriut të vet, e tjetri do të varet, kurse shpezët do ta hanë nga koka e tij”.

(Jusuf, 41)

Qëllimi ishte se njeri do të dilte nga burgu dhe prapë do t’i shërbejë mbretit pije ndërsa tjetri do të ekzekutohet dhe do të kryqëzohet.

Kalon një kohë dhe mbreti e sheh një ëndërr dhe kërkon prej komentatorëve të ëndrrave komentim.

وَقَالَ الْمَلِكُ إِنِّي أَرَى سَبْعَ بَقَرَاتٍ سِمَانٍ يَأْكُلُهُنَّ سَبْعٌ عِجَافٌ وَسَبْعَ سُنبُلَاتٍ خُضْرٍ
وَأُخَرَ يَابِسَاتٍ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ أَفْتُونِي فِي رُؤْيَايَ إِن كُنْتُمْ لِلرُّؤْيَا تَعْبُرُونَ . قَالُوا
أَضْغَاثُ أَحْلَامٍ وَمَا نَحْنُ بِتَأْوِيلِ الْأَحْلَامِ بِعَالَمِينَ .

“E (kur u afrua lirimi i Jusufit) mbreti tha: Kam parë në ëndërr shtatë lopë të majme dhe shtatë lopë të dobëta që i hanin ato (të dobëtat i gëlltitën ato të majmet) dhe shtatë kallinj të gjelbër (që kishin lidhur frytin) e (shtatë) të tjerë të tharë. O ju pari, nëse dini të interpretoni ëndrrën, më tregoni për ëndrrën time! Ata thanë: Ëndrra të përziera, e ne nuk dimë komentimin e ëndrrave të përziera”.

(Jusuf, 43-44)

Këtu, i kujtohet të burgosurit, i cili ishte liruar dhe i shërbente mbretit dhe mbreti e dërgon te shoku i tij në burg, tek Jusufi, për t’ia komentuar ëndrrën. Dhe menjëherë Jusufi a.s. sqaron programin afatgjatë ekonomik për 15 vite.

قَالَ تَزْرَعُونَ سَبْعَ سِنِينَ دَأْبًا فَمَا حَصَدْتُمْ فَذَرُوهُ فِي سُنْبُلِهِ إِلَّا قَلِيلًا مِّمَّا تَأْكُلُونَ .
ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ سَبْعٌ شِدَادٌ يَأْكُلْنَ مَا قَدَّمْتُمْ لَهُنَّ إِلَّا قَلِيلًا مِّمَّا تَحْصِنُونَ .
ثُمَّ يَأْتِي مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ عَامٌ فِيهِ يُغَاثُ النَّاسُ وَفِيهِ يَعْرِضُونَ .

“Ai (Jusufi) tha: Mbillni shtatë vjet vazhdimisht, e çka keni korrur lëreni në kallinj, përveç një pakice, nga e cila do të hani. Pastaj do të vijnë shtatë (vjet) të vështira (me skamje) që do ta hanë atë që e keni ruajtur për to, përveç një pakice, nga ajo që do ta ruani (në depo për farë). Mandej, pas asaj, vjen një vit (i begatshëm) në të cilin njerëzve u bie shi dhe në të cilin do të kenë të vjela (vit i begatshëm në përgjithësi)”.

(Jusuf, 47-49)

Dhe kështu planifikoi dhe komentoi Jusufi a.s. se me ‘lopët e majme dhe kallinjtë e gjelbër’ do të shtohet bereqeti dhe do të shtohen të mbjellat dhe i udhëzoi për t’i mbledhur dhe për t’i deponuar, pra d.m.th. ta lënë grurin në kallinj që të mos prishet. Kjo këshillë nuk ishte komentim i ëndrrës, por pjesë e planifikimit. Pastaj ka komentuar pjesën e dytë të ëndrrës, se me ‘lopët e dobëta dhe kallinjtë e thatë’ do të vijë kohë e thatësirës të tepërt dhe do të nevojitet shpenzimi prej depove. Pastaj i ka përgëzuar se pas shtatë viteve të thata, prapë do të vijë viti kur do të ketë begati dhe bereqet për të gjithë “viti në të cilin do të ketë të vjela” (pra viti kur do të ketë shi dhe pas shiut do të ketë të korrura dhe të vjela). Dhe ata do të shtrydhin ullirin dhe do të kenë vaj, do të kenë rrush etj. etj.

Atëherë mbreti (pasi që vërejti zgjuarsinë dhe planprojektin e Jusufit a.s.) e zgjodhi për vete, pasi e kuptoi aftësinë, mençurinë dhe besnikërinë. Këto cilësi janë cilësi të projektuesve dhe realizuesve të projekteve. Jusufi a.s. u bë ministër i ekonomisë, në Egjipt, për t’i sjellë shoqërisë ekonomi të qëndrueshme dhe stabile.

Zoti i Madhëruar tregon:

وَقَالَ الْمَلِكُ ائْتُونِي بِهِ اَسْتَخْلِصْهُ لِنَفْسِي فَلَمَّا كَلَّمَهُ قَالَ إِنَّكَ الْيَوْمَ لَدَيْنَا مَكِينٌ
أَمِينٌ . قَالَ اجْعَلْنِي عَلَى خَزَائِنِ الْأَرْضِ إِنِّي حَفِيظٌ عَلِيمٌ .

“Mbreti tha: Më sillni mua atë, thjesht ta veçoj për veten time! (ia sollën Jusufin) E pasi që bisedoi me të, tha: Tash ti ke tek ne pozitë dhe je i besueshëm. Ai (Jusufi) tha: Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit (ministër të ekonomisë dhe financave) unë jam besnik i dijshtëm”.

(Jusuf, 54, 55)

Imami Zamehsheriu, duke komentuar ajetin se si Jusufi a.s. ka kërkuar pozitë, thotë:

“Ai ka kërkuar pozitë për t’i vendosur në vend ligjet e All-llahut, për të vendosur drejtësi, për të vepruar me sinqeritet, për të ndarë me barazi. Për këtë arsye janë dërguar peygamberët tek njerëzit. Dhe duke e ditur se, atë detyrë, nuk e kryen dikush tjetër ashtu si nevojitet dhe kërkohet. Pra kërkimi i postit apo kandidimi për post duhet të bëhet për të fituar kënaqësinë e All-llahut, e jo vetëm të hipur në pozitë, për qëllime individuale të dunjasë”.

LUFTIMI I MONOPOLIT

NENI 21

Shteti e lufton monopolizimin mirëpo nuk ndërhyt në çmimin e mallrave përpos në raste të domosdoshme.

Koment:

Shoqëria Islame është shoqëri bashkëvepruese, (ku njerëzit) i ndihmojnë njëri-tjetrit. Muhamedi a.s. thotë:

“Kush ka shpinë (mjet transportues) le ta ndihmojë dhe le t’ia japë atij që nuk ka. Kush ka tepricë le t’i japë atij që nuk ka.”
Transmetuesi i hadithit, Ebu Seid el Hudriju, i ka përmendur llojet e mallrave sa që e kemi kuptuar se asnjëri prej neve nuk ka të drejtë në tepricë.

Tregtia është besnikëri. Patjetër duhet të sigurohet besnikëri në tregti. Për këtë arsye, Muhammedi a.s., thotë:

“Zoti e mëshiroftë atë, i cili është tolerant në shitblerje dhe kur jep borxh”.

Tregtari besnik ka vlerë të madhe në fe. Muhammedi a.s. ka thënë: Tregtari i drejtë dhe besnik është me pejgamberët, të vërtetët dhe dëshmorët.

Në Islam, tregtia është në kundërshtim me monopolizimin. Qeveritari e ka për obligim të luftojë çfarëdo lloji të kimit. Monopolizim do të thotë ta bllokosh mallin dhe të mos lejoresh të shitet, derisa të ndihet nevojë e madhe, e pastaj ta shesësh me çmim shumë të shtrenjtë dhe kur ka pakicë në treg. Me monopolizimin e mallit bëhet dëmtimi i njerëzve (blerësve) dhe, në të njëjtën kohë, përfitimi (është) jo i drejtë dhe jo legjitim. Monopolizimi është cilësi e njeriut pa karakter, cilësi e koprracit dhe cilësi e vrasësit të pamëshirshëm. Monopolizuesi kënaqet kur njerëzit vuajnë dhe pikëllohet kur kënaqen njerëzit.

Kjo nuk është edukatë e besimtarit. Muhammedi a.s., në një hadith, ka thënë:

“Shembulli i muslimanëve në mëshirë të ndërsjellë dhe dashuri të ndërsjellë është sikurse një trup, të cilit kur i lëngon një pjesë, i tërë trupi është jo i qetë.”

Monopolizimi ndikon në urrejtje mes njerëzve dhe i konfronton njerëzit në pasuri. Këtë, feja e pastër, nuk e pranon. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush monopolizon (mallin) për ta hipur çmimin tek muslimanët ai është mëkatar dhe Zoti e mallkon dhe e largon prej mëshirës së vet.”

Muhammedi a.s. ka garantuar furnizim të begatshëm dhe bereqet për çdo eksportues, i cili e ngjall tregun dhe sjell lehtësi në mallra. Ndërsa monopolizuesin e ka kërcënuar me të kundërtën, pra me bankrotim (të mëvonshëm), pasi të gjithë njerëzit do të ikin nga ai, sikurse ikin njerëzit nga luani. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Eksportuesi do të jetë i bekuar dhe i furnizuar, ndërsa monopolizuesi i penguar. Kush monopolizon (mallrat) e ushqimit të muslimanëve, Zoti do ta shpjerë në bankrotim.”

Është esenciale që shteti të mos hyjë në çështjet e brendshme të veprimeve ekonomike të qytetarëve. Ai i lë qytetarët të kenë liri në aktivitetin e tyre ekonomik, në kufi të karakterit dhe brenda kufijve të ligjeve ekonomike dhe rregullave të Sheriatit.

Nëse ndodh armiqësi dhe dallim nga konkurrenca e drejtë dhe ligjore, qeveritari ndërhyr për t'i rregulluar çështjet dhe për t'i vendosur në binarë.

Çmimet caktohen varësisht prej gjendjes shoqërore dhe varësisht prej ofertës dhe kërkesës. Ne nuk mund të lejojmë që të shkelet e drejta e qytetarit, në emër të lirisë së veprimt.

Në të njëjtën kohë, nuk dëshirojmë që të dëmtohet shoqëria. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Vërtet All-llahu është zgjerues i (gjendjes së shoqërisë), ngushtues (i gjendjes së shoqërisë), furnizues dhe caktues i çmimeve (të shoqërisë)”.

Po ashtu, ka thënë:

“Mos bëni ngrirjen e çmimeve, se caktimin e çmimeve e bën vetëm All-llahu.”

Nëse tregtarët nuk janë furnizues (të devotshëm) të shoqërisë, çka pengon në rritjen e çmimeve, atëherë Qeveria (Qeveritari) ka të drejtë të ndërhyjë në caktimin e çmimit, duke u bazuar në rregullin e Sheriatit Islam. *“Të mos dëmtohesh dhe të mos dëmtosh”.*

Prej shenjave të Ditës së Kijametit është humbja e besimit dhe mbajtjes së premtimit. Dhe njerëzit shiten ashtu qysh e përshkruan Pejgamberi fisnik:

“Asnjëri nuk do ta kryejë emanetin, do të thuhet se filani është i sinqertë dhe besnik, ndërsa ai është tradhtar e jo besnik, dhe më kriminel, ndërsa do të dënohen dhe do të gurëzohen tjerët (e pafajshëm) dhe për ta do të thuhet se ata në zemrën e tyre nuk kanë besim as sa kokrra e bizelës”.

Hudhejfe bin Jemame thotë: Do të vijë një kohë kur njerëzit nuk mërzhiten si, e çka shesin. Nëse është musliman do të dalë nga feja e tij, nëse është i krishterë apo jehudi, nuk do të veprojë sipas fesë së tij. Ndërsa sot nuk do të blija prej askujt, pos prej filanit dhe filanit.

Gjendja e shoqërisë nuk rregullohet ndryshe, pos besueshmërisë mes vete dhe Qeverisë (Imamit) së drejtë.

PUNIMI I TOKËS

NENI 22

Shteti stimulon dhe nxit punimin e tokës dhe shndërrimin e tokës së papëlleshme në tokë të pëlleshme.

Koment:

Ky nen është prej neneve të rëndësishme në Kushtetutë, pasi ndikon shumë në mirëqenien e muslimanëve. Bota islame sot ka krizë ekonomike, për shkak se muslimanët nuk e punojnë tokën bujqësore dhe nuk i shfrytëzojnë të mirat natyrore.

E vërteta është se shteti islam për zhvillimin e tyre ekonomik duhet të lejojë migrimin në vendet pjellore (bujqësore) ku zhvillohet bujqësia ose shndërrimin e tokave të papëlleshme në toka të pëlleshme. Me mijëra e mijëra hektarë të shteteve islame nuk mund t'u gjinden njerëz për t'i punuar ato toka, që kanë ujë dhe janë të pëlleshme. Po ashtu, me mijëra e mijëra hektarë tokë të papëlleshme mund të shndërrohen të pëlleshme, me investime të vogla dhe angazhim të vogël.

Islami i kushton rëndësi këtyre çështjeve. Në Sahihul Buhari në kapitullin

“Kush e ngjall tokën e vdekur” është thënia e Muhammedit a.s.: “Kush e bën të pëlleshme tokën e papëlleshme, e cila nuk është e askujt, ai ka të drejtë (pronësi) në të.”

Po ashtu, edhe në Muvetaun e Malikut është hadithi ku Muhammedi a.s. thotë:

“Kush e bën tokën e papëlleshme të pëlleshme, ajo tokë është e tij.”

Në librat e Fikhut është kapitull i veçantë: *Shndërrimi i tokave të papëlleshme në toka të pëlleshme.*

Ne do t'i përmendim disa ligje të cilat janë të shkruara në librin EL-IFSAN AN MEANIS-SUHAH të fikhut të 4 Medhhebeve të emrit Hebijrete el Hanbeli, i cili ka vdekur në vitin 560 h., citojmë: “Janë pajtuar për shndërrimin e tokës së papëlleshme në tokë të pëlleshme. Pastaj janë shfaqur mospajtime: A është kusht leja e qeverisë (Imamit) apo jo? Ebu Hanife thotë: Duhet leja e Imamit (Qeverisë-shtetit). Ndërsa Imam Maliku thotë: Nëse është pronë shoqërore (dhe tepër e egër) për të cilën nuk ndodhë konflikt mes njerëzve, nuk ka nevojë për lejen e Imamit (qeverisë-shtetit). Kurse nëse është tokë gjysmë e pëlleshme dhe njerëzit hynë në konflikt,

atëherë nevojitet leja e qeverisë (shtetit). Shafiu dhe Ahmedi thonë: Nevojitet leja e Qeverisë (shtetit).

Janë shfaqur mospajtime rreth pronësisë, e cila ka qenë e muslimanëve, mirëpo (ata) e kanë lënë pas dore, nuk janë interesuar dhe kanë shkuar gjetiu. A ka të drejtë tjetri ta shndërrojë në tokë të pëlleshme (dhe ta shfrytëzojë) apo jo? Ebu Hanife dhe Maliku thonë: Po. Shafiu thotë: Jo. Ndërsa Ahmedi ka dhënë dy mendime, por më shumë anon nga jo.

Pastaj janë shfaqur mospajtime si pronësohet toka dhe kur bëhet e pëlleshme.

Ebu Hanife thotë: “Kur ta kufizojë parcelën, edhe pse nuk e ujit. Ndërsa, për shtëpinë, kur ta murojë edhe pse nuk i vë kulm”.

Imam Maliku thotë: “Zakonisht konsiderohet se toka është e pëlleshme, kur ta mbjellë dhe kur të hapë bunar apo siguron ujësjellës”.

Imam Shafiu thotë: “Nëse është tokë për ta mbjellë, në momentin kur ta mbjellë dhe ta ujitë, ndërsa nëse është për banim kur ta ndërtojë shtëpinë dhe ta vendosë kulmin”.

Këtu është edhe një pikë e rëndësishme. Kur ndonjëri e përvetëson një pjesë të tokës, për ta bërë të pëlleshme, pastaj e mban peng dhe nuk e punon. Këtu i përmbahemi mendimit të Umer bin Hatabit r.a., kur ka ligjëruar në mimber: “Kush e bën tokën e papëlleshme të pëlleshme (ajo) është e tij, ndërsa ai, i cili e përvetëson dhe për tri vite nuk e bën të pëlleshme, nuk ka të drejtë pronësie në atë tokë. Në një transmetim tjetër: Kush e mban peng tokën (e papronësuar) tri vite dhe nuk e punon (nuk e bën të pëlleshme) dhe vjen tjetri dhe e punon dhe e bën të pëlleshme i takon këtij të fundit. Kjo për arsye se njerëzit vetëm përvetësonin toka për vete dhe nuk i punonin.

Umer bin Hatabi r.a. ka kërkuar nga Bilal bin El Harith El Mezeniju që të heqë dorë nga toka, të cilën e kishte përvetësuar dhe nuk kishte pasur mundësi ta bënte të pëlleshme. Bilali kishte refuzuar me arsyetimin se atë tokë ia kishte dhuruar Muhammedi a.s. Ndërsa Umeri i është përgjigjur:

“I Dërguari i All-llahut nuk ta ka dhuruar për ta mbajtur peng, pët të mos e punuar dhe për të mos i lënë njerëzit për ta punuar, por ta ka dhuruar për ta punuar. Merre atë që ke mundësi ta punosh dhe lëre atë që nuk ke mundësi ta punosh.”

NDALIMI I KAMATËS

NENI 23

Kamata është e ndaluar, është e ndaluar edhe të marrësh edhe të japësh, edhe ta fshehësh, edhe të veprosh me fitim të kamatës.

Koment:

Islami dëshiron që shoqëria të jetë shoqëri e mëshirshme mes vete, dhe pasuria e All-llahut të jetë në shërbim të krijesave të All-llahut në mënyrë të dobishme e të ndershme, frytdhënëse, të mirë dhe shoqëria të ndihmohet në mes vete në punë të mira dhe devotshmëri. Për këtë arsye, Islami e ka ndaluar kamatën, në formë të prerë. Të pasurit kanë të drejtë të plotë në pasurinë e tyre, ndërsa çka e fitojnë pjesën tjetër me kamatë, duhet t'u kthehet atyre të cilëve ua kanë marrë pasurinë me kamatë, përndryshe, nëse nuk dihen, atëherë iu kthehen muslimanëve, në përgjithësi. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا بَقِيَ مِنَ الرِّبَا إِن كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ . فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَإِن تُبْتُمْ فَلَكُمْ رُءُوسُ أَمْوَالِكُمْ لَا تَظْلُمُونَ
وَلَا تُظْلَمُونَ .

“O ju që besuat, kijeni frikë All-llahun dhe nëse jeni besimtarë të singertë, hiqni dorë prej asaj që ju ka mbetur nga kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata) atëherë binduni se jeni në konflikt me All-llahun dhe të Dërguarin e tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve ju takon kryet e mallit tuaj, askënd nuk e dëmtoni, e as vetë nuk dëmtoheni”.

(El-Bekare, 278, 279)

Porosia e fundit, të cilën e ka lënë Muhamedi a.s. për ummetin e tij, në Haxhin Lamtumirës, ka qenë: Kamata e kohës së injorancës është e papranueshme. I pari i cili ka hequr dorë nga kamata ka qenë Abas bin Abdul Mutahibi (ai e ka falur tërë kamatën).

Sot flitet shumë për punët bankiere, ndërsa harrojmë pikën kryesore: Vërtet nuk dëshirojmë ekonomi të shëndoshë?! Vërtet ne jemi seriozë që t'i rregullojmë çështjet në përputhshmëri me Sheriatin Islam!? Apo, ndoshta, çështja është se jemi të paarsyeshëm dhe falsifikatorë të ligjeve. Dhe aktivitetin tonë nuk e fillojmë me emrin e All-llahut dhe nuk dëshirojmë praktikimin e Sheriatit Islamik!?

Forma për të cilën themi është dëgjueshmëri, nuk është dëgjueshmëri. Ai i cili bën lëvizje të edukatës fizike, si qëndrimi në këmbë, përkulje (ruku), përlulje (sexhde) nuk konsiderohet se është duke falur namaz. Ai, i cili ha haptazi me arsye, në mes të ditës së Ramazanit, nuk quhet mëkatar. Çështja sillet te nijeti. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Veprat shpërblehen sipas qëllimit dhe secili njeri si e ka pasur qëllim për të vepruar, për atë edhe do të shpërblehet”.

Ne shohim se ka çështje të komunizmit, të cilat janë në përputhshmëri me Islamin, po ashtu ka çështje në kapitalizëm të cilat janë në përputhshmëri me Islamin, por përkundër kësaj, as komunizmi, as kapitalizmi nuk janë islamë.

Sot kemi dy sisteme të organizimit bankar në Egjipt:

- Sistemi bankar i përgjithshëm dhe
- Sistemi bankar i veçantë. Ky sistem ndryshe quhet sistem i organizimit bankar islam.

Organizimi i parë: Sistem bankar islam. Ky sistem i organizimit, nëse janë seriozë, duhet ta heqin vetinë dhe anën e përgjithshme të tyre, sepse nuk kemi çka të fshehim por mundemi të praktikojmë sistemin bankar islam. Por nëse nuk janë seriozë, por janë rrenacakë, ata janë të pabesueshëm, dhe nuk u besohet atyre për t'i mbajtur të hollat e popullit, ata janë mashtrues dhe tradhtarë të popullit dhe Ummetit.

U themi atyre, të cilët vetëm dëshirojnë ta rrisin namën e bankave të tyre, ndaluni! Se prej çështjeve elementare të muslimanit është që të mos keqpërdoret feja dhe nderi i tij. Është mendim unanim (Ixxhma) i të gjithë ekspertëve të jurisprudencës islame se ekzistojnë veprimtari të bankave, të cilat janë haram i kulluar dhe i qartë dhe nuk e kemi ndërmend t'i përmendim ato ndalesa, të cilat në Islam dihen botërisht, vetëm themi se duhet të ndalen veprimet e ndaluara bankare, *sepse mosveprimi i haramit është obligim, i cili ka përparësi kundrejt veprimit të lejuarës* (TERKIL HARAM VAXHIB MUK'ADEM ALA FI'ELIL VAXHIB).

Llogaris, nëse kanë qëllime të mira, sqarohet pikësynimi kryesor, do të tuboheshin fukahatë dhe ekspertët e ekonomisë së

përgjithshme islame në një fjalë, e ajo është *“kënaqësia e All-llahut të Lartmadhëruar dhe ruajtja e interesit të njeriut”*.

Drejtoni dhe rregulloni veprimtarinë e tanishme, ose formoni sisteme bankare të tjera, ose lejoni që të veprohet me ekonominë islame zyrtarisht.

Shoqëria Islame nuk dëshiron MUHALEL në ekonomi, ashtu si bëhet tradhti apo mashtrimi MUHALEL për lejim martese, por dëshiron vizion të qartë islam, me veprimtari të drejtë, të pastër dhe fisnike. Sepse Zoti i Madhëruar e ka mallkuar MUHALELIN dhe MUHALEL LEH⁸.

Vërtet All-llahu është i mirë dhe i pastër, dhe pranon vetëm të mirën dhe të pastrën.

⁸ Muhalel – në këtë rast mund të përkthehet keqpërdorimi i ligjit me fjalë tjera me legjitimuar një çështje jolegjitime me kombinim të ligjeve.

Shembull konkret:

Nëse një burrë e lëshon gruan tri herë, atëherë nuk ka të drejtë të martohet me atë grua për të katërtën herë, mirëpo nëse ajo grua është martuar me një burrë tjetër dhe ai burri tjetër e ka lëshuar, tani i lejohet të martohet me burrin e parë pasi ka qenë e ndaluar më herët. Pra lejimi i martesës me gruan e triherëshkurorëzuar bëhet pas shkurorëzimit me burrin tjetër. Kështu nëse burri i parë i thotë një burri tjetër martoje gruan time të triherëshkurorëzuar e pastaj shkurorzoje që të kem ligjitimitet kurorëzimi me te. Kjo është e ndaluar në shariat islam (kështu që burri i dytë quhet MUHALEL LEH, sepse bëjnë një marrëveshje paraprake për t’u lejuar një çështje e ndaluar).

PRONA SHTETËRORE DHE PASURITË NATYRORE

NENI 24

Shteti është pronar i pasurive natyrore si xehet, gazrat, lëndët djegëse etj.

NENI 25

Çdo pasuri e cila nuk ka pronar, pronari i saj është “Bejtul Mal” Arka (shtetërore) ndërkombëtare islame. Ligji rregullon mënyrën e pronësimit të qytetarëve.

Koment:

All-llahu i Lartmadhëruar ka vendosur, që toka të ketë pasuri natyrore të panumërta dhe të mëdha me qëllim që njerëzit të kenë të mira materiale dhe dobi prej tyre, për të jetuar jetë të lumtur dhe për t’u zhvilluar. Kur’ani famëlartë përmend lloje të ndryshme të pasurive natyrore.

وَجَعَلْنَا لَكُمْ فِيهَا مَعَايِشَ وَمَنْ لَسْتُمْ لَهُ بِرَازِقِينَ . وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا عِنْدَنَا خَزَائِنُهُ
وَمَا نُنَزِّلُهُ إِلَّا بِقَدَرٍ مَعْلُومٍ .

“E tokën e kemi shtruar dhe në të kemi vendosur kodra dhe kemi bërë që në të të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve. Dhe Ne ju krijuam juve në të jetesën (mjetet për jetë) e edhe atyre për të cilët ju nuk jeni furnizues. E nuk ka asnjë send që të mos ta ketë burimin te Ne, po Ne, nuk e japim atë ndryshe, vetëm sipas një mase të caktuar (të nevojshme).”

ُ(El-Hixhr, 20,21)

Po ashtu, në Kur’an është sureja e cila e ka emrin “Hekuri”, El Hadidë.

... وَأَنْزَلْنَا الْحَدِيدَ فِيهِ بَأْسٌ شَدِيدٌ وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ وَلِيَعْلَمَ اللَّهُ مَنْ يَتَصَدَّقُ وَرُسُلُهُ
بِالْغَيْبِ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ عَزِيزٌ

“Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëzit, e edhe për t’u ditur tek All-llahu se kush ndihmon Atë (rrugën e Tij) dhe të dërguarit e Tij, duke i besuar të fshehtës. S’ka dyshim se All-llahu është i fuqishëm, mbizotërues”.

(El Hadidë, 25)

Fukahatë kanë dhënë mendime të shumta sa i përket xeheve, pasurive natyrore dhe së drejtës së pronësisë së shtetit dhe të qytetarëve (individëve).

Në librin “El- Iknaë” të medhhebit shafij lexojmë⁹:

“Është e njohur se për “thesar” (rukaz) pasuri nëntokësore (ari, argjendi etj.) patjetër duhet të arrihet minimumi i sasisë (NISABI) për dhënien e zekatit dhe nuk është kusht për të kaluar një vit. Rukaz - quhet thesari i fshehur që nga e kaluara (koha e injorancës), do të thotë para Islamit. Pra, para dërgimit të Muhammedit a.s. peygamber. Këtë e ka pohuar edhe Shejh Ebu Ali.

Rukaz (thesar) i kohës së injorancës konsiderohet:

1. Të dihet se pronari i thesarit të fshehur nuk ka qenë musliman, ose ka qenë musliman, por e ka tradhtuar fenë dhe është gjetur në shtëpinë e tij, ose në vendin e tij. Ai thesar nuk konsiderohet **Rukaz**, por **Fie**¹⁰, ashtu siç është sqaruar në librin “Mexhmuë” ku e kanë sqaruar në mënyrë unanime.

2. Të jetë i fshehur në tokë, nëse nuk është i fshehur, por kuptohet (vërtetohet) se e ka bartur uji qarkullues, atëherë ai është Rukaz. Nëse nuk ka qenë i fshehur, por i ka rënë dikujt prej mjetit etj. etj., konsiderohet send i humbur¹¹.

Nëse vërtetohet se është thesar i fshehur prej muslimanëve p.sh. ka ajete të Kur’anit, ose është emër i udhëheqësve islamë. Nëse vërtetohet pronari, është i pronarit dhe i kthehet atij, pasi pasuria e muslimanëve nuk lejohet të pronësohet (të uzurpohet).

⁹ “El Iknaë fi Hal Elfadh”, Ebi Shugjaë li Shemsud-dini Muhamed bin Ahmed Esh-Sherbijni El-Hatib.

¹⁰ “El-Fie”, ka dispozitë të veçantë të cilën e potencon ajeti fisnik në suren El-Hashr: “Atë që Allahu nga ia dha të Dërguarit të Vet (Fie) nga pasuria e banorëve të vendeve pabesimtarëve, ajo i takon Allahut, të Dërguarit të afërmve, jetimëve dhe udhëtarëve pa mjete të mbijetimit gjatë rrugës”. *(El-Hashr, 7)*

¹¹ “Lukta”, sendi i hubur për të cilin pritet një vit e pastaj e pronëson gjetësi dhe ai e shfrytëzon., mirëpo nëse paraqitet pronari i sendit të humbur, atëherë sendi i gjetur i kthehet pronarit.

Nëse nuk dihet pronari, atëherë konsiderohet send i humbur¹² (i hedhur). Kështu veprohet edhe për monedhat¹³ (e arit), të cilat nuk dihet a janë islame, apo jo islame.

Thesari i gjetur i takon gjetësit dhe e ka për obligim të japë zekatin, nëse gjendet në tokë të papronësuar¹⁴ (pronë shoqërore). Po nëse thesari gjendet në xhami, apo në rrugë, konsiderohet send i humbur (i hedhur).

Nëse personi gjen thesar në pronësi të ndonjë individi, ose vakëfit, atëherë i takon individit nëse e kërkon, po nëse individi hesht ose nuk e kërkon, atëherë i takon gjetësit dhe kështu çështja përfundon te përpunuesi i tokës sepse ai veç e pronëson. Nëse për thesarin e gjetur konfrontohet shitësi dhe blerësi i ndonjë prone, ose huadhënësi dhe huamarrësi, atëherë përbetohet ai i cili e ka pronën në momentin e fundit-blerësi. Kështu veprohet edhe për orenditë e shtëpisë.

Në librin “Ahkamu Sultaniye” të medhhebit Hambeli lexojmë¹⁵:

“Ndërsa sa i përket pronës shoqërore¹⁶, e cila i jepet individit, pra kur është pronë me pasuri natyrore, atëherë pasuritë natyrore ndahen në dy lloje: Të papërziera dhe të lira në natyrë, dhe të përziera të cilat mund të nxirren vetëm pas përpunimit.

Sa i përket lëndëve të lira në natyrë si nafta, kripa, uji, pra të përziera nuk lejohet pronësimi. Të gjithë njerëzit janë bashkëpjesëmarrës dhe merr çka i takon dhe çka i vyen atij.

Kjo është treguar qartë në transmetimin e Harbit:

“Është pyetur Muhammedi a.s. për njeriun, i cili ka e lëndën e kripës. Është përgjigjur: Kripa është sikurse uji i cili lundron dhe ia ka kthyer tjetrit dhe ka thënë: Kripa nuk është lëndë e cila mund të pronësohet. E ka marrë njeriu, e ka pronësuar dhe i ka penguar njerëzit ta shfrytëzojnë”.

Muhammedi a.s. nuk e ka pëlqyer, por e ka ndarë në pjesë të barabarta edhe për të tjerët dhe ka thënë: Kjo është e muslimanëve.

¹² “Monedha”, para të shtypura si dinari, dirhemi etj.

¹³ “Tokë e Vdekur” konsiderohet toka e pa pronësuar dhe e cila nuk është e plleshme.

¹⁴ Pronarit të mëhershëm.

¹⁵ Autor Ebi Jeali Muhamed bin Husejn El Ferai-Korrektor Muhamed Hamid El-Fekij, fq. 235, botues Darul Kutubul Ilmije, Bejrut.

¹⁶ Do të thotë që shteti i jep (u dhuron) disa shtetasve të tij.

Nëse ndahen këto lëndë, apo pasuri natyrore, atëherë ato nuk e kanë vendin definitiv, por u ndahen edhe tjerëve dhe të gjithë marrin pjesë njësoj në atë pasuri natyrore. Nëse ai, i cili e ka pronësuar atë pronë shoqërore dhe e përvetëson vetëm për vete atë lëndë-pasuri natyrore, ai i ka shkelur të drejtat e të tjerëve. Pasi ai nuk e ka marrë në tërësi, por i ka penguar të tjerët për t'i shfrytëzuar, sepse ai as nuk e ndalon në tërësi¹⁷, por e shfrytëzon vetëm për vete në përgjithësi, vazhdimisht, për të mos lejuar që dikush tjetër ta shfrytëzojë vazhdimisht, që t'i bëhet besnik nëse pronësohet ajo pronë.

Ndërsa, për sa i përket xeheve të përziera (jo të lira në natyrë), të cilat nuk mund të nxirren, vetëm se me angazhim dhe punë, si: ari, argjendi, hekuri e të ngjashme, pa marrë parasysh a ka nevojë apo jo, nuk mund të pronësohet si pronë individuale, sikurse lëndët e lira në natyrë. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë në të.

Nëse e bën tokën të pëlleshme, pa marrë parasysh a e ka shndërruar në pronë private, apo jo, dhe paraqitet xehe e përzier ose e papërzier, ka të drejtë pronësie si pronë private, sikurse të hapësh bunar ... bunari i takon atij i cili e ka hapur.

Mund të përfundojmë në atë se, në çka kanë të drejtë të gjithë është pronë shtetërore dhe shteti e orienton ashtu çka është e dobishme për njerëzit.

Hapësira ajrore, satelitët, xehet dhe pasuria e personave të cilët kanë vdekur dhe nuk kanë lënë trashëgimtarë, kalon në arkën qendrore të muslimanëve dhe shteti e merr përsipër shfrytëzimin dhe shpenzimin e asaj pasurie për interesin e përgjithshëm të muslimanëve dhe për shërbime qytetare.

Kryetari i shtetit nuk ka të drejtë të pronësojë asgjë për vete nga pasuria shoqërore, as të ndajë ndonjë pjesë për familjen e tij dhe nuk ka dorë, as të drejtë të veprojë me ato mjete, veçse ashtu si është e paraparë në Sheriatin Islam dhe, në kufi, si parashihet me ligj. Nëse shihet qartë se është dobi e përgjithshme shoqërore, mund t'u jepen qytetarëve pjesë të pronave shoqërore, pas vendimit që merr shteti në bazë të ligjeve të caktuara.

¹⁷ Në këtë parcelë ka të drejtë të ncjerrë xehe e minerale sikurse të gjithë të tjerët dhe nuk ka drejtë ta ndalojë adkënd.

ROLI I ZEKATIT NË EKONOMIN ISLAME

NENI 26

Zekatin shteti e ndan në pjesën e shoqërisë, të cilën e ka parapa Sheriati Islam.

Koment:

Zekati është farz në Islam dhe shtyllë prej shtyllave të Islamit. Zoti i Madhëruar thotë:

خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا وَصَلَّ عَلَيْهِمْ إِنَّ صَلَاتَكَ سَكَنٌ لَهُمْ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ . أَلَمْ يَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ هُوَ يَقْبَلُ التَّوْبَةَ عَنْ عِبَادِهِ وَيَأْخُذُ الصَّدَقَاتِ وَأَنَّ اللَّهَ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ .

“Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’u shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta. All-llahu dëgjon e sheh. A nuk e ditën ata se All-llahu është ai që pranon pendimin e robërve të vet, pranon lëmoshat dhe se, vetëm All-llahu është Ai që shumë pranon pendimin dhe është mëshirues.”

(Et Tevbe, 103-104)

Në pasuri bën pjesë:

1. Bagëtia si devetë, lopët, delet
2. Ari dhe argjendi
3. Pemët dhe perimet
4. Malli tregtar

Për secilën prej këtyre llojeve kushtet janë të njëjta, e ato janë: Islami, liria, nisabi.

Nisabi (minimumi i numrit) te devetë është pesë deve dhe jepet një dele zekat.

Nisabi (minimumi i numrit) te lopët është tridhjetë dhe jepet një mëshjtjerrë e vitit të dytë.

Nisabi (minimumi i numrit) të bagëtisë është katërdhjetë dhe jepet një dele.

Nisabi i arit është 20 mithkal dhe jepet 2,5%.

Nisabi i argjendit është 200 dërhëm dhe jepet 2,5%¹⁸

Nisabi i pemëve, perimeve dhe të mbjellave është 5 evsek dhe jepet 10%, nëse ujitet (prej shiut) pa mund dhe 5%, nëse ujitet me mund dhe shpenzime.

Mallrat tregtarë, edhe nisabin, edhe përqindjen, për të dhënë zekat, e kanë si ari dhe argjendi. Bagëtitë kanë edhe një kusht tjetër, e ai është që bagëtia të jetë në kullosë, do të thotë që pronari (fermeri) nuk shpenzon shumë për t'i ushqyer, sepse ushqehen me kullosë, të lira në natyrë.

Kalimi i vitit është kusht për të gjitha pasuritë e tjera, përpos pemëve, perimeve dhe të mbjellave, ku jepet zekati në ditën e të mbledhurave, respektivisht të korrurave.

Sa i përket llojeve të të mbjellave, fukahatë kanë dhënë mendime:

1. Çka korret (mblidhet) dhe deponohet, si dhe hurmat e rrushi.
2. Çdo e mbjellë në tokë.

Në ar dhe argjend jepet zekati çka është e fërkuar dhe çka nuk është e fërkuar, dhe ende çka është e përzier (e papastruar).

Ari dhe argjendi i fërkuar konsiderohet: dërhemi, dinari etj. Pra kur të kalojë një vit jepet zekat 2,5%.

Xehet të cilat nxirren prej toke të pronësuar, apo jo, kur të arrihet nisabi dhe nuk është kusht të kalojë viti, pra është e ngjashme me të mbjellat, pemët dhe perimet. Sepse kalimi një vit është kushtëzuar për qarkullim, fitim dhe zhvillim, ndërsa xehet, të mbjellat, pemët dhe perimet, ato e kanë fitimin në momentin e mbledhjes (pemëve, perimeve), apo nxjerrjes së xehes.

Thesari (ari dhe argjendi) është pasuri, e cila është fshehur në kohën e injorancës dhe nëse e ka arritur nisabin është 20%.

Shteti është përgjegjës për tubimin e zekatit. Muhammedi a.s. i ka caktuar tubuesit e zekatit, po ashtu, pas tij edhe halifët e drejtë Ebu Bekër Es Sidiku i ka luftuar ata që kanë mohuar dhënien e zekatit

Shteti bën shpërndarjen e zekatit, ashtu siç është e paraparë në Sheriatin Islam. Zoti i Madhëruar thotë:

¹⁸ Mithkali tani është i barabartë me 4 ²/₇ e gramit. Dirhemi tani është i barabartë me 3 gr.

إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ وَالْعَامِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِي الرِّقَابِ
وَالْغَارِمِينَ وَفِي سَبِيلِ اللَّهِ وَابْنِ السَّبِيلِ فَرِيضَةً مِّنَ اللَّهِ
وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ

“All-llahu caktoi obligim që lëmoshat (zekati etj.) t’iu takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë). Atyre që u duhen përfituar zemrat (të dobëtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve) në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.”

(Et-Tevbe, 60)

Nuk lejohet që shteti t’ia bashkojë zekatin buxhetit shtetëror, pa i paraparë këto kategori të shpërndarjes së zekatit, por patjetër edhe prej buxhetit, duhet të veçojë pjesë për këto kategori prej të hyrave të tjera.

Në të vërtetë, zekati përfshin kategori të shumta të pjesës së shoqërisë, për të cilat shteti ndan mjete nga buxheti, që në kohën e sotme quhen ministria për çështje sociale, ministria e arsimit, ministria e shëndetësisë, ministria e punëve të brendshme dhe e sigurisë, ministria e mbrojtjes etj.

Kategoritë e zekatit janë tetë:

1. Të varfrit

Janë ata të cilët nuk kanë pasuri, nuk kanë fitim, nuk kanë të hyra, ata të cilët kanë nevojë elementare për jetë, për këtë arsye edhe i ka përmendur ajeti në rendin e parë.

Ebu Hanife mendon se gjendja e të ngratit (miskinit) është më e vështirë dhe më e rëndë se e të varfrit (fekir-it)

2. Të ngratit:

Janë ata të cilët kanë pak pasuri, mirëpo ajo nuk i mjafton as për nevojat elementare. Ibn Kethiri në tefsirin e tij thotë se Ikremete ka thënë: Mos u thoni të varfërve muslimanë të ngratë (mesakinë), por thoni Pasuesve të Librit (Ehlil-kitab)¹⁹.

¹⁹ Komentimi i Kur’anit Famëllartë, Vëll.II, fq. 364.

Pjesa dërmuese e dijetarëve më eminentë islamë janë të pajtimit se zekati i merret të pasurve muslimanë dhe u jepet të varfërve muslimanë, ndërsa nuk i jepet pabesimtarit, por pabesimtarit i jepet vetëm në cilësinë “për t’i përvetësuar zemrat e tyre” dhe mund t’u jepet edhe lëmoshë.

3. Punonjësit autorizohen prej imamit, marrin përgjegjësi e tubojnë zekatin, e shpërndajnë në vendet e caktuara. Punonjësve u takon zekati edhe nëse janë të pasur.

4. Atyre që u duhen përvetësuar zemrat

Janë ata të cilët shteti e parashih se është në dobi të Islamit dhe muslimanëve. Këta janë dy lloje: muslimanë dhe pabesimtarë. Muslimanit, i cili e ka pranuar Islamin në kohën e fundit dhe imani i tij është i dobët, i jepet zekati për t’iu forcuar imani, ose atij, i cili e ka pranuar Islamin dhe ka respekt në familjen dhe shoqërinë e tij, popullin (është lider) dhe ndihmon që edhe tjerët ta pranojnë Islamin.

Pabesimtarit, i cili bashkëpunon me muslimanët dhe mund t’i pengojë pabesimtarët për t’i dëmtuar muslimanët, i takon zekati. Pasi është më mirë t’i japësh zekat atij, se sa të dërgosh tek ata pabesimtarë ushtrinë islame.

Qëndrimet e Muhammedit a.s. për këtë çështje janë shëmbëlltyra më e mirë. Safvan bin Umeje tregon:

“Muhammedi a.s., në luftën e Hunejnit më ka dhënë (pasuri), ndërsa unë e urreja më së shumti dhe vazhdimisht më jepte (pasuri), derisa u bë më i dashuri tek unë”.

Muhammedi a.s. i ka dhënë një grupi të fisit Kurejshit, në ditën e Hunejnit, 100 deve, ndërsa Ensarëve që kishin marrë pjesë atë ditë (në atë betejë), Muhammedi a.s. u ka thënë:

“Unë i jap ndonjërit më shumë, ndërsa të tjerët i dua më shumë, se ata që i dua frikësohem mos do të digjen në xhehennem”.

A jepet zekati për përvetësimin e zemrave pas Muhammedit a.s.?

Ibn Kethiri thotë:

Dijetarët kanë dhënë dy mendime:

Umeri, Amiri, Sheabiju dhe një pjesë e dijetarëve mendojnë se nuk u takon, pasi All-llahu e ka forcuar Islamin, dhe e ka vendosur në shtete të shumta dhe të tjerët i ka dobësuar.

Dijetarë të tjerë mendojnë se u takon, për arsye se Muhammedi a.s. i ka dhënë fisit Havarin, edhe pas çlirimit të Mekkes. Ky është argument se u jepet atyre, dhe është një çështje për të cilën ka nevojë²⁰.

5. Lirimi i robërve

Islami angazhohet për lirimin e robërve prej prangave të robërisë. Lirimi i robërve bëhet në dy mënyra:

Mënyra e parë: Kur robi ka lidhur kontratë me zotëriun për t' u liruar prej robërisë, pasi të tubojë një shumë të caktuar të të hollave. Atëherë i jepet zekati robit, për ta paguar veten e tij dhe t' u liruar vetë.

Mënyra e dytë: Për të caktuar një fond prej zekatit dhe prej atij fondi të blihen robërit dhe menjëherë të lihen të lirë për të jetuar. Kjo duke u bazuar edhe në ajetin kur'anor: **“Lirimin e robit”**

(El Beled, 13)

6. Të mbyturit në borxhe

Borxhlinjtë janë dy lloje:

Lloji i parë: Kur borxhliu ka marrë borxh për interes të vetin personal, mirëpo i është vështirësuar gjendja dhe nuk ka mundësi për ta kthyer, atëherë i jepet zekati për ta larë atë borxh.

Lloji i dytë: Kur borxhliu ka marrë borxh për interes, apo për dobi të muslimanëve, atëherë i jepet zekati edhe pse është i pasur. Kjo nga arsyeja se Islami i ndihmon veprat e mira dhe njerëzore.

Në disa libra të Fikhut thuhet:

Borxhlinjtë janë tre lloje:

Lloji i parë: Kush merr borxh për vete, për kryerjen e nevojave të cilat janë të lejuara, mirëpo më vonë ato mjete i ka shpenzuar në çështje të palejuara. Ose ka marrë borxh për çështje të palejuara, si alkool p.sh., mirëpo është penduar ose e ka ndryshuar mendjen dhe mjetet i ka shpenzuar në gjëra të lejuara. Atëherë i jepet zekati për ta larë borxhin, nëse nuk ka mundësi për ta kryer. Ndërsa, nëse ka marrë borxh për gjëra të ndaluara dhe i ka shpenzuar për gjëra të ndaluara dhe nuk është penduar, nuk i jepet zekati.

²⁰ Komentim i Kur'anit Famëllartë Vëll.II, fq.365

Lloji i dytë: Kush merr borxh për pajtimin e njerëzve, ose fiseve p.sh. nëse e sheh se dy fise janë konfrontuar për vrasje dhe nuk dihet vrasësi. Atëherë e paguan gjakun (dijen) i jepet zekati edhe nëse është i pasur.

Lloji i tretë: Kush merr borxh për të paguar një dëm për të cilin është dënuar dhe nuk ka mundësi për ta larë²¹.

Tregon Kubejsete bin Meharik el Hilali: E mora një përgjegjësi për ta kryer dhe shkova te Muhammedi a.s. dhe kërkova për ta kryer atë (nuk kisha mjete) Muhammedi a.s. tha: Kryeje atë përgjegjësi (me borxh), e kur të tubohet zekati do të japim prej zekatit dhe do ta lash borxhin. Pastaj vazhdon Kubejsete duke treguar se çka i ka thënë Muhammedi a.s.:

“O Kubejsete, nuk lejohet (pra prej zekatit), përpos në këto tri raste:

- Për njeriun i cili ka marrë përgjegjësi për ta kryer një vepër dhe pasi e merr i vështirësohet gjendja, saqë pa borxh nuk mund ta kryejë atë obligim.

- Për njeriun të cilit i ka ndodhur ndonjë fatkeqësi, e cila ia ka zhdukur tërë pasurinë dhe merr borxh sa për të mbijetuar, apo për ta tejkaluar atë fatkeqësi.

- Për njeriun i cili ka arritur shkallën më të ulët të varfërisë dhe merr borxh sa për të mbijetuar. Përpos këtyre rasteve nuk lejohet”.

7. Në rrugën e All-llahut

Luftëtarët të cilët mbrojnë nderin dhe vendin. Këtë sektor e kanë zgjeruar fukahatë edhe për interesin e përgjithshëm shtetëror, si p.sh. ndërtimin e shkollave, spitaleve, xhamive. Ibn Kethiri thotë se imam Ahmedi, imam Hasani dhe Is-haku i konsiderojnë se edhe ata të cilët udhëtojnë për haxh, janë në rrugën e All-llahut dhe u takon zekati²².

²¹ “El Iknaë fi Hal Elfadh”, Ebi Shuxhaë Esherbijni El Hatib.

²² Komentimi i Kur’anit Famëllartë, vëll.II, fq. 266.

8. Udhëtari pa mjete udhëtimi (Ibni Sebil)

Janë udhëtarët të cilët nuk kanë mjete për të vazhduar rrugën ose për t'u kthyer në vendlindje.

Në medhhebin shafii është ai i cili e ka filluar udhëtimin dhe nuk ka mjete, por edhe ai i cili ka mbetur në mes të rrugës i jepet zekati, me kusht që ai udhëtim të mos jetë udhëtim për të bërë ndonjë mëkat.

Ndërsa medhhebi Hanbeli mendon se zekati i takon atij, i cili ka mbetur në mes të rrugës pa mjete, e jo ai i cili e fillon rrugën prej vendlindjes.

Sasia e zekatit jepet për aq sa i mbulojnë nevojat dhe aq sa tubohet shuma e zekatit.

Zekati nuk është fond shpenzues për kohë të caktuar ose për ditë të caktuar (fond vjetor apo mujor), përndryshe, po të ishte ashtu, do të shtoheshin nevojtarët dhe të papunët vit pas viti, ndërsa këtë e refuzon Islami, i cili e ka parim: ***“Dora e cila jep është më e vlefshme se dora e cila merr”***

Në disa libra të Fikhut kam lexuar thënien e cila nuk matet me ar.

Në shumicën e rasteve, të varfrit i jepet sa për jetesë, i blihet tokë me atë fond të zekatit për ta punuar dhe të sjellë përfitime për vete. Imami ia blen tokën ose inventarin.

Kjo për atë i cili nuk ka aftësi ose nuk ka ndonjë artizanat (profesion). Ndërsa ai i cili ka aftësi për artizanat i blihen mjete të artizanatit. Nëse ka aftësi tregtie i blihen mallra tregtarë për të filluar tregtinë dhe ai e merr përfitimin dhe e vazhdon tregtinë.

Të mbyturit në borxhe i jepet sa për të larë borxhin. Për lirimin e robit jepet sa për t'u liruar nga robëria.

Udhëtarit të rastit i jepet sa për të arritur deri në vendlindje, ose sa i nevojitet për të arritur qëllimin e udhëtimit.

Luftëtarit i jepet sa i nevojitet për të shkuar, për të qëndruar dhe për t'u kthyer dhe sa i nevojitet familjes së tij gjatë asaj kohe. Atij i përgatitet mjeti për udhëtim dhe çka i nevojitet si ushqim, veshmbathje, pra sikurse udhëtarit.

Personave, për përfitimin e zemrave të tyre, u jepet sa e parasheh imami.

Punonjësve u jepet zekati sipas punës dhe sipas angazhimit që bëjnë. Nëse ndonjëri i ka dy cilësitë e përmendura p.sh. edhe i varfër, edhe i mbytur në borxhe, i jepet për njëërën prej dy cilësive²³. Zekati është zhvillim i jetës ekonomike islame dhe këtë përgjegjësi e ka shteti. Nëse kjo përgjegjësi u lihet individëve do të humbte qëllimi, vlera, rëndësia dhe roli i tij. Individëve, sado që t’u jepet, prapë se prapë, ata bëhen edhe më shumë të pangopur dhe më shumë koprracë.

²³ “El Iknaë fi Hal Elfadh”, Ebi Shuxhaë Esherbijni El Hatib.

VAKËFET

NENI 27

Vakëfi në sende të mira është i lejuar. Ligji vendos organizimin në të gjitha format.

Koment:

Prej prioriteteve të Islamit është sistemi i vakëfit. Ai ka rëndësi të posaçme në jetën ekonomike. Ai organizohet në baza të modernizimit dhe civilizimit, si në arsim, shëndetësi dhe sociologji. Ministrinë e vakëfeve të muslimanëve, në të kaluarën kanë luajtur rol të rëndësishëm, ndërsa sot ka hyrë koprracia në zemra dhe shpirtra dhe është dobësuar shumë ky institucion dhe nuk lënë vakëfe.

Nëse i bëjmë një vështrim viteve të mëhershme, shohim se muslimanët e parë kanë pasur etje të madhe për të lënë vakëf, për të fituar kënaqësinë e All-llahut dhe ndërtimin e jetës shoqërore të muslimanëve. Dhe çdo pasuri, të vogël apo të madhe, e kanë lënë vakëf për të mirën e muslimanëve. Kanë lënë vakëf për të varfrit, për të sëmurët, për të paaftit, për kërkuesit e diturisë (studentët), për luftëtarët në rrugën e All-llahut, për udhëtarët, për kurbetçinjtë, për të shkurorëzuarat, për të vejat, për jetimët etj. etj.

Vakëf në etimologji do të thotë mbyllje.

Në terminologji vakëf do të thotë: Mbyllja (lënia) e pasurisë (inventarit), prej të cilës kanë dobi muslimanët dhe për ta shpronësuar nga vetvetja, dhe e është lejuar në Sheriat.

Vakëfi është prej Ibrahimit a.s., kur e ka ndërtuar Qaben, me të birin Ismailin, për ata që e vizitojnë, bëjnë tavaf Qaben, qëndrojnë dhe falen, bien në ruku, bien në sexhde, deri në Ditën e Kijametit.

Po ashtu, uji Zem-zem ka buruar prej dorës së Ismailit a.s., me shije të ëmbël, që shuan etjen dhe shëron deri në Ditën e Kijametit.

All-llahu na ka urdhëruar për ta pasuar Ibrahimit a.s:

ثُمَّ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ أَنْ اتَّبِعْ مِلَّةَ إِبْرَاهِيمَ حَنِيفًا وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ

“Pastaj, ty të shpallëm: Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët (as jehudi, as krishterë).”

(En-Nahl, 123)

Në hadithin Sahih, Muhammedi a.s. thotë:

“Kushdo që ndërton xhami sado e vogël që të jetë, All-llahu do t’i ndërtojë atij shtëpi në xhennet”.

Në një hadith tjetër Muhammedi a.s. thotë:

“Kur të vdes njeriu (biri i Ademit) i ndërpriten shpërblimet e të gjithë punëve, përpos tri veprave, e ato janë: lëmoshë rrjedhëse, dituria e dobishme dhe djali i mirë, i cili lutet për të”.

Lëmoshë rrjedhëse është vakëfi.

Sipas mendimeve më të sigurta, i pari në Islam i cili ka lënë vakëf është Umeri r.a., sipas dy burimet autentike (sahihajni). Në Hajber, Umerit i ka takuar një pjesë toke, ndërsa Muhammedi a.s. i ka thënë: ***“Nëse dëshiron leje vakëf, që të jetë lëmoshë”.*** Umeri r.a. e ka lënë vakëf-lëmoshë, me kusht që pastaj as të mos shitet, as të mos dhurohet, as të mos trashëgohet.

Fukahatë (dijetarët më eminentë të lëmisë së Sheriatit Islam) janë pajtuar se vakëfi kur ta arrijë destinimin, nuk mund ta rikthejë as vakëf-lënësi. Por mbet pronë shoqërore e përgjithshme dhe destinim për atë çka e ka lënë.

Pastaj, fukahatë kanë dhënë sqarime të thukta në këtë çështje që kanë të bëjnë me vakëf-lënësin, sendin e lënë vakëf, dhe për atë se për çfarë është lënë vakëf.

Ata kanë diskutuar çështje të thukta.

A lejohet shitja e vakëfit nëse shkatërrohet, ose dëmtohet, sa që nuk ka dobi prej saj, dhe me ato mjete të blihet një send tjetër për ta lënë vakëf? Maliku dhe Shafiu kanë thënë: Mbet ashtu dhe nuk lejohet të shitet.

Ahmedi ka thënë: Lejohet të shitet, me kusht që me ato mjete të blihet diçka tjetër për t’u lënë vakëf.

Fukahatë pastaj kanë dhënë mendime të mrekullueshme. Nëse e lën vakëf për mirësi, dhe shpërblim le ta lenë vakëf për farefisn, pastaj për kategoritë e zekatit, përpos punonjësve të zekatit, dhe për ata që u duhen përfituar zemrat e tyre.

Ose për të lënë vakëf vetëm për rrugën e All-llahut, luftëtarëve. Nëse dëshiron për tri kategori: për mirësi, për dobi të përgjithshme dhe në rrugë të All-llahut, atëherë: një e treta për luftëtarët, një e treta për farefisn, dhe një e treta për kategori të tjera.

Nuk lejohet vakëfi për ndërtimin e varreve, sepse të vdekurit kanë përgjegjësitë e tyre dhe nuk ndërtohen varret e tyre. Nuk lejohet

vakëfi për kafshët, sepse ato nuk kanë të drejtë pronësie. Nëse i lihet pronarit të kafshëve për kafshët, në këtë rast vakëfi është për njeriun dhe është i lejueshëm.

Bën përjashtim vakëfi për kafshët për luftë si p.sh. kuajt, devetë etj. Lejohet për të lënë tokë me bari, për ta. Imami Ebu Hamid El Gazali ka thënë: Lejohet vakëfi për zogjtë e Mekkes.

Lejohet (pranohet) vakëfi prej pabesimtarit edhe për xhami, pasi edhe ai ka të drejtë mirësie dhe përderisa vakëfi është për çështje të lejuara.

Lejohet vakëfi për Dhimijun (jo muslimani në shtetin islam) dhe për jo muslimanët (Muahid, Must'emin), pasi për ta lejohet edhe lëmosha²⁴.

Dhe në fund, shteti islam ka nevojë për vendosjen e ligjit për vakëfin, administratën apo ministrinë e vakëfeve, e cila kujdeset me përkushtim të madh për interesin e përgjithshëm shoqëror.

²⁴ Shiko librin “El-Ifsah an Meani Suhah”, autor Ibni Hebijrete El-Hanbeli, i cili ka vdekur në vitin 560 h. Botues shoqata Seideje në Rijad, vëll. II, fq. 52. Shiko librin “Revda Talibi fi Esna El-Metalibi”, nga autori Imam Ebi Jahja Zekeriju El-Ensariju Esh-Shafiiju, vëll.II, fq. 457.

KAPITULLI I KATËRT

TË DREJTAT DHE LIRITË QYTETARE

Përbëhet nga 16 nene:

Prej nenit nr. 28

Deri në nenin nr. 43

BAZË LIGJORE DREJTËSIA

NENI 28

Bazë ligjore është barazia dhe drejtësia. Mbrojtja e së drejtës është e shenjtë dhe e garantuar, e cila nuk lejohet të cenohet (preket).

Koment:

Drejtësi do të thotë që secilit t'i jepet ajo që i takon. Barazi është veprimi (sjellja) me njerëzit pa i dalluar për shkak të ngjyrës, llojit, apo fesë, ndërsa drejtësia dhe barazia janë bazë ligjore në shtetin islam: Kjo është e definuar shumë qartë në Kur'an.

Zoti i Madhëruar thotë:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ إِنَّ اللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُمْ بِهِ إِنَّ اللَّهَ كَانَ سَمِيعًا بَصِيرًا

“All-llahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni.”

(En-Nisa, 58)

Amanetet (porositë-testamentet) janë fjalë që përfshijnë të drejtat e All-llahut, të drejtat e njerëzve, si ato individuale, ashtu edhe shoqërore.

Gjykimi me drejtësi është urdhër prej All-llahut, pa marrë parasysh a është prej atyre që kanë pozita të ulëta (lokale), apo të larta (qendrore). Ky urdhër vlen për të gjithë, sepse është urdhër gjeneral dhe i përgjithshëm, edhe për gjykatësin, edhe për të gjykuarin. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ بِالْقِسْطِ شُهَدَاءَ لِلَّهِ وَلَوْ عَلَىٰ أَنْفُسِكُمْ أَوِ الْوَالِدِينَ وَالْأَقْرَبِينَ إِن يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَقِيرًا فَاللَّهُ أَوْلَىٰ بِهِمَا فَلَا تَتَّبِعُوا الْهَوَىٰ أَنْ تَعْدِلُوا وَإِنْ تَلَوُّوا أَوْ تَعْرِضُوا فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا

“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, pasi All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t’i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, All-llahu hollësisht di çka punoni”.

(En Nisa, 135)

Muslimani e ka për detyrë të veprojë me drejtësi dhe me dëshmi për të vërtetën për All-llah, edhe pse e vërteta për të është e hidhët, pasi hidhësia e të vërtetës është më e mirë se ëmbëlsira e të pavërtetës.

Edhe përkundër armiqësisë së jehudive ndaj Islamit, All-llahu e ka urdhëruar Muhammedin a.s. për të gjykuar drejtë në mes tyre edhe përkundër asaj se (ata) e kanë shtrembëruar librin e shpallur (Tevratin) ku thotë:

سَمَاعُونَ لِلْكَذِبِ أَكَّالُونَ لِلسُّحْتِ فَإِنْ جَاؤُوكَ فَاحْكُم بَيْنَهُمْ أَوْ أَعْرِضْ عَنْهُمْ وَإِنْ
تُعْرِضْ عَنْهُمْ فَلَنْ يَضُرُّوكَ شَيْئًا وَإِنْ حَكَمْتَ فَاحْكُم بَيْنَهُمْ بِالْقِسْطِ
إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ

“Janë ata që i përgjigjen të pavërtetës dhe e hanë shumë haramin (ryshfetin). Në qoftë se vijnë te ti (për ndonjë gjykim), gjyko mes tyre ose hiq tyre. Nëse prapsesh prej tyre (nuk gjykon), ata nuk mund të sjellin ty kurrfarë dëmi. Po nëse gjykon në mes tyre, gjyko drejtë; All-llahu i do të drejtë”.

(El Maide, 42)

Shpeshherë Kur’ani përsërit se gjykimi duhet të jetë gjithmonë me drejtësi, pa marrë parasysh armiqësinë fetare dhe pa marrë parasysh çka flasin për shkak të urrejtjes. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَا نُ قَوْمٍ عَلَى
أَلَّا تَعْدِلُوا اعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَى وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kijeni dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni”. (El Maide, 8)

Po ashtu Zoti i Madhëruar thotë:

فَذَلِكَ فَادْعُ وَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَقُلْ آمَنْتُ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنْ
كِتَابٍ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمُ اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ لَا حُجَّةَ بَيْنَنَا
وَبَيْنَكُمُ اللَّهُ يَجْمَعُ بَيْنَنَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ

“E për këtë shkak (të përçarjes së tyre) ti thirr dhe përqendrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tua e thuaj: Unë kam besuar në librat që i shpalli All-llahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, All-llahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj; Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh e jush; All-llahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm tek Ai është përfundimi!”

(Esh Shura, 15)

Në shtetin islam e drejta për t’u mbrojtur dhe për t’u gjykuar janë të garantuara dhe të pacenueshme. Çdo qytetar ka të drejtë për t’u ankuar te gjykatësi suprem (i autorizuar). Dhe secili ka të drejtë mbrojtjeje dhe secila palë duhet të sjellë fakte për atë që pretendon.

Sipas ligjit të Sheriatit nuk lejohet mbrojtja me tradhti, me falsifikime dhe rrena, sepse kjo konsiderohet krim dhe shpifje dhe prej mëkateve më të mëdha të All-llahu i Lartmadhëruar.

Shkaku i zbritjes së një ajeti kur’anor është ky: Njëri prej muslimanëve kishte vjedhur një mburojë dhe e kishte fshehur në shtëpinë e një jehudiu pa e ditur ai. Kur është zbuluar mburoja te jehudiu, vjedhësi e kishte akuzuar atë për vjedhje. Ai (jehudi) është përбетuar se nuk e ka vjedhur. Populli i tij (vjedhësit) kanë shkuar te Muhammedi a.s. për ta shpallur atë të pafajshëm, ndërsa jehudin për ta dënuar. Atëherë zbret ajeti kur’anor për të zbuluar çka fshehin në zemrat e tyre, për t’ia kthyer sendin e vjedhur pronarit, për ta hequr padrejtësinë prej jehudiut dhe vërteton domosdoshmërinë e vërtetimit të gjykimit dhe të argumenteve dhe bën thirrje për të mos polemizuar pa nevojë, po ashtu e ngriti vlerën e së vërtetës dhe drejtësisë, dhe për t’i bindur njerëzit se All-llahu sheh dhe kontrollon çdo veprim

fshehtazi apo haptazi, gjykon akuzimin e të pafajshmëve dhe mbrojtjen e kriminelëve dhe atë me metodologji të mrekullueshme të Zotit të Lartmadhëruar: Ja si e shpjegon Zoti i Madhëruar:

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ وَلَا تَكُنَ لِلْخَائِنِينَ خَصِيمًا . وَاسْتَغْفِرِ اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَحِيمًا . وَلَا تَجَادِلْ عَنِ الَّذِينَ يَخْتَانُونَ أَنْفُسَهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَنْ كَانَ خَوَّانًا أَثِيمًا . يَسْتَخْفُونَ مِنَ النَّاسِ وَلَا يَسْتَخْفُونَ مِنَ اللَّهِ وَهُوَ مَعَهُمْ إِذْ يُبَيِّتُونَ مَا لَا يَرْضَى مِنَ الْقَوْلِ وَكَانَ اللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطًا .

“Ne të zbritëm ty (Muhamed) librin (Kur'anin) me plot të vërteta, që të gjykosësh mes njerëzve me atë që të mësoi All-llahu. Mos u ngurro për tradhtarët (mos u dil në ndihmë). Kërkoj falje (për këtë) All-llahut. Vërtet, All-llahu fal, mëshiron. Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten. All-llahu nuk e do atë që është gënjeshtar e mëkatar. Ata fshihen (turpërohen) para njerëzve e nuk turpërohen para All-llahut, e Ai është me ta edhe kur planifikojnë fshehtas thënie me të cilat nuk është i kënaqur Ai. All-llahut nuk mundën t'i shpëtojnë veprimet e atyre.”

(En Nisa, 105-108)

Që të tre ajetet kanë paraqitur rregullat e përgjithshme sa u përket të drejtave dhe lirive qytetare e ato janë:

- All-llahu i Lartmadhëruar është falës dhe mëshirues, për t'i çelur dyert e atyre të cilët pendohen dhe vendosin për të punuar vepra të mira e që nuk e humbin shpresën te All-llahu.

- Dënimet janë individuale (personale), askush tjetër nuk mund të gjykohet për tjetrin.

- Të akuzosh të pafajshmit është prej mëkateve më të mëdha, dhe krimeve më të mëdha.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَمَنْ يَعْمَلْ سُوءًا أَوْ يَظْلِمْ نَفْسَهُ ثُمَّ يَسْتَغْفِرِ اللَّهَ يَجِدِ اللَّهَ غَفُورًا رَحِيمًا . وَمَنْ يَكْسِبْ إِثْمًا فَإِنَّمَا يَكْسِبُهُ عَلَى نَفْسِهِ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا . وَمَنْ يَكْسِبْ خَطِيئَةً أَوْ إِثْمًا ثُمَّ يَرْمِ بِهِ بَرِيئًا فَقَدِ احْتَمَلَ بُهْتَانًا وَإِثْمًا مُبِينًا .

“Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten, pastaj kërkon falje te All-llahu, ai e gjen All-llahun falës e mëshirues. Kush bën ndonjë mëkat, ai ka ngarkuar vetveten, All-llahu i di hollësitë, është gjykatës i drejtë. Kush bën ndonjë gabim ose mëkat, e pastaj atë ia hedh një të pafajshmi, ai ngarkohet me një shpifje e me një mëkat të hapët”.

(En Nisa, 110-112)

Muhamedi ka kërkuar që, para ligjit, të gjithë të jenë të barabartë pa bërë dallime dhe ka ndaluar ndërmjetësim për dënimet, të cilat i ka paraparë All-llahu, për të mos u dënuar.

Në Sahihun e Buhariut, nga Urvete tregohet se në kohën e Muhammedit a.s., saktësisht në betejën e çlirimit të Mekkes, një grua kishte vjedhur. Populli i saj kishte shkuar te Usame bin Zejd r.a. për të ndërmjetësuar te Muhammedi a.s., për mos ta dënuar.

Urvete thotë: Pasi Usame i kishte thënë Muhammedit a.s., që të mos ta dënonte, fytyra e Muhammedit a.s. menjëherë kishte ndryshuar dhe i kishte thënë: “Po më flet për dënimin, të cilin e ka paraparë All-llahu!?”.

Usame i kishte thënë: Kërkoj falje prej All-llahut. Por, pasi që ishte falur jacia, Muhammedi a.s. ishte ngritur dhe kishte ligjëruar. Në rend të parë e kishte falënderuar All-llahun e pastaj kishte thënë:

“Popujt para jush janë shkatërruar pse kur ka vjedhur i pasuri dhe në pozitë, nuk e kanë dënuar, ndërsa kur ka vjedhur i dobëti, e kanë dënuar. Pasha atë, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhammedit (a.s.), po të kishte vjedhur Fatimja, bija e Muhammedit (a.s.) do t’ia kisha prerë dorën.”

Pastaj Muhamedi a.s. kishte urdhëruar për t’iu prerë dora asaj gruaje, e ajo ishte penduar dhe më vonë ishte martuar.

Aishja r.a. ka thënë:

Pas këtij rasti, ajo grua ishte rregulluar dhe ishte përmirësuar, vinte vazhdimisht te Muhammedi a.s. dhe thoshte: All-llahu është më i madhi (All-llahu Ekber).

Dënimet në Sheriat janë pastrim i individit dhe mbrojtje e shoqërisë.

Ligji i All-llahut ekzekutohet te të gjithë papërgjashtim. Ai i cili ka pozitë (gjykatësi) për të qenë shëmbëlltyrë e mirë, e fillon prej vetes dhe prej familjes. Dhe kështu mbizotëron barazia dhe drejtësia.

LIRIA E BESIMIT, MENDIMIT DHE VEPRIMIT

NENI 29

Liria fetare, mendimit, veprimit, të shprehurit e lirë, themelimi i shoqatave, sindikatave dhe bashkëngjitja në to, liria individuale, liria e bashkimit në to, janë të drejta themelore dhe elementare, të cilat shteti i garanton në kuadër të Sheriatit Islam.

Koment:

Ky nen përfshin disa të drejta elementare, të cilat i garanton Sheriati Islam.

Qytetarët kanë të drejtën:

- e besimit
- e veprimit
- e mendimit
- e shprehjes
- për të themeluar shoqata dhe sindikata
- e kalimit në to dhe bashkimit me ta

Të gjitha këto liri i ka lejuar Kur'ani dhe i ka praktikuar i dërguari i Tij dhe shoqëria islame gjatë shekujve dhe gjatë historisë ka qenë shëmbëlltyrë për të gjitha këto.

- **Liria e besimit** nënkupton për të mos ta detyruar askënd me dhunë për të hyrë në fe, ose për t'u dëmtuar se i takon ndonjë feje apo religjioni tjetër. Zoti i Madhëruar ka thënë:

لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنَ بِاللَّهِ فَقَدْ
اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى لَا انْفِصَامَ لَهَا وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk beson të pavërtetat, e i beson All-llahut ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues, i dijshtëm”.

(El Bekare, 256)

- **Liria e mendimit** nënkupton hapjen e shtigjeve të mendjes për meditimin e ekzistencës dhe jetës shoqërore. Zoti i Madhëruar thotë:

قُلْ انظُرُوا مَاذَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ...

“Thuaj: Vështroni me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në tokë”.

(Junus, 101)

Po ashtu në një ajet tjetër, thotë:

قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِكُمْ سُنَنٌ فَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكَذِّبِينَ

“Përpara jush kanë kaluar popujt ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet, ndaj, udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni si qe përfundimi i atyre që përgënjeshtuan.”

(Ali Imran, 137)

- **Liria e veprimit** nënkupton angazhimin e njeriut për të fituar me ato mjete dhe mënyra që i përshtaten jetës së tij, për mos t’u detyruar për të punuar një punë të cilën nuk mundet ta punojë, ose nuk e dëshiron. Zoti i Madhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذُلُولًا فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِنْ رِزْقِهِ
وَالِيهِ النُّشُورُ

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj, dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja.”

(El Mulk, 15)

- **Liria e shprehjes** nënkupton që njeriu të thotë haptazi atë që e mendon se është e mirë dhe e qëlluar, dhe që është e dobishme.

Tubimi i njerëzve nëpër shoqata, apo sindikata, për të kërkuar një të drejtë të përgjithshme apo të veçantë, apo për të ruajtur interesin e organizatës, apo të ndonjë grupi, apo lloji e ngjyre, duke ndihmuar në punë të mira dhe devotshmëri.

Këto liri janë të mbrojtura në kuadër të Sheriatit Islam, në kuadër të natyrshmërisë dhe ndjenjave të shëndosha, të cilat nuk janë në kundërshtim me logjikën e shëndoshë.

Liria e besimit në kufijtë të cilat i ka paraparë All-llahu i Lartmadhëruar:

... حَتَّى لَا تَكُونَ فِتْنَةً ...

“Deri sa të mos ketë propagandim që sjell shkatërrim”.

Lexo: (El Bekare, 193)

Është e palogjikshme që shoqëria islame të lejojë që individët të bëjnë shkatërime në tokë dhe të sulmojnë themelet e besimit islam - pa i penguar dhe pa i ndaluar. Asnjë shtet në botë nuk i lejon individët për t’ia shkatërruar themelet, të cilat i ka ndërtuar për vete. Secili shtet ka sovranitetin, të cilin nuk guxon askush t’ia cenojë, përndryshe, çdo individ i cili tenton për t’i shkatërruar themelet e shtetit konsiderohet (se ka kryer) tradhti të madhe.

Liria e mendimit duhet të jetë brenda kufijve të fjalëve të All-llahut:

وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ
كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْئُولًا

“Mos iu qas asaj, për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi”.

(El Israë, 36)

Nuk është e logjikshme për të lejuar persona të cilët thurin legjenda, formojnë kulte, fantazojnë dhe sjellin iluzione në mes njerëzve, pa i ndërprerë iluzionet dhe lojërat e tyre.

Liria e mendimit duhet të jetë brenda kufijve të fjalës së All-llahut:

... وَاعْمَلُوا صَالِحًا ...

“Dhe bëni vepra të mira ...”.

(El Mu’minunë, 51)

Nuk është e logjikshme që trazirat dhe shkatërrimi në tokë të quhen liri. Nuk konsiderohet punë ajo çka është në kundërshtim me rregullat e fesë, të ahlakit (moralit) dhe nuk është në dobi të individit dhe të shoqërisë, por përkundrazi quhet shkatërrim (e kundërta e punës).

E drejta e të shprehurit duhet të jetë në kufi të fjalës së All-llahut:

... وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا ...

“dhe njerëzve u thuani fjalë të mira”.

(El Bekare, 83)

Dhe në kufi të fjalës së All-llahut:

... وَاجْتَنِبُوا قَوْلَ الزُّورِ ...

“Dhe largohuni fjalës shpifëse”.

(El Haxh, 30)

Nuk është e logjikshme që fjalët shkatërruese dhe dëmtuese të quhen liri e të shprehurit.

Liria është e drejtë e njeriut dhe kërkesë e Islamit deri sa nuk kalon në kufijtë e tjerëve, të karakterit, të fesë, të pastërtisë dhe të edukatës.

Në shoqëri me Muhammedin a.s. kanë jetuar jehuditë dhe idhujtarët, të gjithë së bashku, krah për krah me muslimanët. Në shtëpinë e Muhammedit a.s. ka pasur punëtorë jomuslimanë.

Në Sahihun e Buhariut thuhet se *një fëmijë jehudi i ka shërbyer Muhammedit a.s. dhe pasi që është sëmure Muhammedi a.s. ka shkuar dhe e ka vizituar, është ulur te koka e tij dhe i ka thënë: “Pranoje Islamin.” Djaloshi e ka shikuar prindin e vet, i cili ishte afër. Prindi i ka thënë: Dëgjoje babën e Kasimit (Muhamedin a.s.) dhe djaloshi e ka pranuar Islamin duke dëshmuar shehadetin “Eshhedu en La ilahe il-la-llah ve eshhedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu”. Muhammedi a.s. pasi ka dalë nga shtëpia e tij ka thënë: “E falënderoj All-llahun, që e shpëtoi prej zjarrit”.*

Muhammedi a.s. ka diskutuar dhe ka dialoguar me meshkuj e femra për çështjet e sheriatit dhe jetës, dhe për këtë kanë zbritur ajete, siç është rasti me ajetin kur'anor:

قَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّتِي تُجَادِلُكَ فِي زَوْجِهَا وَتَشْتَكِي إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ يَسْمَعُ
تَحَاوَرَكُمَا إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ

“Vërtet, All-llahu dëgjoi fjalët e asaj, e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te All-llahu; prandaj All-llahu e dëgjon bisedën tuaj, All-llahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë.”

(El Muxhadele, 1)

Kur’ani, Muhammedin a.s., e ka cilësuar të butë dhe të mëshirshëm, në të njëjtën kohë, e ka urdhëruar për konsultim dhe tolerancë. Zoti i Madhëruar thotë:

... وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ
وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ .

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falja atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta për të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që i mbështeten”.

(Ali Imran, 159)

Sa i përket tradhtisë së fesë ajo është shpifje. Nëse i përcjellim me vëmendje ajetet, sa i përket atij i cili e tradhton fenë, do të shohim se nuk është çështje vetëm besimi, por në të vërtetë (lënia e fesë) është kryengritje kundër shoqërisë, tradhti e fesë, largim prej radhëve të besimtarëve dhe bashkëngjitje radhëve të armiqve.

Zoti i Madhëruar thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَشْتَرُونَ بِعَهْدِ اللَّهِ وَأَيْمَانِهِمْ ثَمَنًا قَلِيلًا أُولَئِكَ لَا خَلَاقَ لَهُمْ فِي الْآخِرَةِ
وَلَا يُكَلِّمُهُمُ اللَّهُ وَلَا يَنْظُرُ إِلَيْهِمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَلَا يُزَكِّيهِمْ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“Ata që për një vlerë të paktë e shesin besën e dhënë All-llahut, ndryshojnë edhe zotimet e tyre, të tillët nuk kanë pjesë (mëshirë) në botën tjetër, dhe në Ditën e Kijametit All-llahu nuk u flet atyre, nuk i shikon ata dhe nuk i pastron (prej barrës së gabimeve), ata kanë një dënim të dhembshëm”.

(Ali Imran, 77)

Ata janë të cilët nuk e dinë vlerën e të vërtetës, dhe as të karakterit dhe shkojnë vetëm pas interesit material, pra janë

materialistë dhe mercenarë dhe nderin e tyre e shesin për mjete të përlyera. Zoti i Madhëruar thotë:

فَتَرَى الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ يُسَارِعُونَ فِيهِمْ يَقُولُونَ نَخْشَى أَنْ تُصِيبَنَا دَائِرَةٌ
فَعَسَى اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَ بِالْفَتْحِ أَوْ أَمْرٍ مِّنْ عِنْدِهِ فَيُصْبِحُوا عَلَى مَا أَسَرُّوا فِي
أَنْفُسِهِمْ نَادِمِينَ . وَيَقُولُ الَّذِينَ آمَنُوا أَهَؤُلَاءِ الَّذِينَ أَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ
أَنَّهُمْ لَمَعَكُمْ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فَأَصْبَحُوا خَاسِرِينَ .

“E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh si ngarendin te ta (për miqësi) duke thënë: Po frikësohemi se mos po na sillet ndonjë e keqe. Po All-llahu do të sjellë fitoren, ose diç tjetër nga ana e Tij, e atëherë do të pendohen për atë që e mbanin fshehtë në shpirtin e tyre. Ata që besuan ju thonë: A këta ishin që u betuan në Zotin me betimin më të fortë të tyre se ishin me ju? I shkatërruan veprat e veta dhe aguan të dëshpëruar”.

(El Maide, 52- 53)

Ata janë hipokritë, ata u sjellin besimtarëve vetëm fatkeqësi, kur (të jetë luftë) kanë nevojë besimtarët, ikin nuk mund t'i gjesh askund, kur të korrin fitore vrapojnë të parët për të treguar se kanë “kontribuar” më së shumti. Dhe vetëm shpifin dhe i zbulojnë të metat e muslimanëve.

Është më se evidente se dënimet e çdo ligji janë preventivë e të këqijave të hapëta apo të fshehta. Pra dënimi është për preventiv, për atë arsye nevojiten rregulla, argumente dhe dëshmi dhe përderisa mëkati është i fshehur dhe i pazbuluar dhe nuk gjinden fakte nuk mund të merret vendimi për dënim. Prandaj, vetëm All-llahu i di të fshehtat dhe jo të fshehtat.

Nuk është vërtetuar se Muhammedi a.s. e ka dënuar tradhtarin e fesë, vetëm pse ka kaluar në fenë tjetër. Në marrëveshjen e Hudejbijes, në vitin e 6-të të Hixhretit, prej kushteve kanë qenë:

- Që Muhammedi a.s. t'i kthejë te kurejshitët, nëse ndonjëri prej tyre e pranon Islamin dhe shkon te Muhammedi a.s. pa lejen e kujdestarit të tij.

- Kurejshitët nuk e kanë për detyrë që t'i kthejnë, nëse ndonjëri prej muslimanëve largohet nga feja dhe shkon te kurejshitët.

Kur muslimanët nuk deshën t'i pranonin këto dy kushte Muhammedi a.s. u sqaroi atyre urtësinë dhe mençurinë e këtyre kushteve, duke u thënë se nëse muslimani, i cili vjen prej kurejshitëve, kthehet prapë te ata, All-llahu do t'i bëjë zgjidhje dhe do t'i gjejë rrugëdalje, ndërsa kush shkon te kurejshitët e tradhton fenë. Allahu nuk e lejon që të kthehet më te muslimanët. Praktika ka treguar se në shumë ndodhi (beteja), në të cilat kanë luftuar tradhtarët e fesë, pa dyshim se i kanë sjellë fatkeqësitë dhe tragjedi të mëdha muslimanëve duke grabitur pasurinë e tyre.

Në Sahihun e Muslimit është i transmetuar hadithi nga Enes bin Maliku se ***kanë ardhur te Muhammedi a.s. disa njerëz për shkak se bagëtia e tyre kishte mbetur shterpë dhe nuk kishin qumësht.***

Muhammedi a.s. u tha: “Nëse dëshironi jepni sadakanë e deveve dhe pini qumësht prej saj.” Ata ashtu edhe vepruan e u pajtuan. Pastaj kanë shkuar deri në kullosa, dhe livadhe ku barinjtë ruanin bagëtinë, ata atje i kanë mbytur barinjtë, e tradhtuan Islamin dhe e verbuan devenë e Muhamedit a.s.. Kur kuptoi për këtë, Muhammedi a.s. dërgoi pas tyre një ekspeditë të cilët i zunë, kështu që ua prenë duart e tradhtarëve të fesë, këmbët e tyre dhe i verbuan, dhe i lanë në një vend derisa vdiqën.

Në një transmetim tjetër të Muslimit tregohet: *“Muhamedi a.s. i ka verbuar ata (ka urdhëruar të verbohen) se ata kanë verbuar barinjtë”.*

E DREJTA E PRONËS PRIVATE DHE NDERI JANË TË SHENJTA

NENI 30

Prona private dhe nderi janë të shenjta dhe të pacenuara. Shpifja është e ndaluar. Ligji cakton cilat veprime kundër shtetit konsiderohen tradhti e madhe, ose prishje e interesave shtetërore. Aktivitetet e tilla (shërbimi sekret - spiunimi) nuk guxojnë të veprojnë pa lejen e gjykatës supreme shtetërore.

Koment:

Çdo njeri ka pronën e tij e cila nuk guxon të cenohet. Veçoritë e tij nuk lejohet të zbulohen. P.sh. Shtëpia është vendbanim i njeriut, aty strehohet, aty qëndron. Zoti i Madhëruar e ka bërë të shenjtë dhe po ashtu ka vendosur ligjet se si duhet të sillesh para se të hysh në pronën e tjetrit:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتًا غَيْرَ بُيُوتِكُمْ حَتَّى تَسْتَأْذِنُوا وَتُسَلِّمُوا عَلَى أَهْلِهَا ذَلِكَ خَيْرٌ لَّكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ . فَإِنْ لَمْ تَجِدُوا فِيهَا أَحَدًا فَلَا تَدْخُلُوهَا حَتَّى يُؤْذَنَ لَكُمْ وَإِنْ قِيلَ لَكُمْ ارْجِعُوا فَارْجِعُوا هُوَ أَزْكَى لَكُمْ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ .

“O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim. Po nëse nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t’u jepet leje, e nëse u thuhet kthehuni, ju pra kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. All-llahu di çdo gjë që veproni ju”.

(En Nur, 27- 28)

Kërkimi i lejes për në pronë të huaj bëhet në shumë mënyra, si: trokitja në derë, thirrja tri herë rreshtazi.

E para: për ta ditur pronari se ka vizitorë;

E dyta: për t’u përgatitur; dhe

E treta: për t’i dhënë leje nëse dëshiron.

Nëse bëhet pyetja: Kush është? Përgjigjja duhet të jetë e qartë, me emër e mbiemër. Nuk lejohet të përgjigjesh jo qartë p.sh. Unë!

Muhammedi a.s. nuk e ka pëlqyer këtë. Pastaj përshëndetja e selamit para të folurit (fillimit të bisedës) Përshëndetja me selam (paqja, mëshira qoftë mbi ju) tregon simpatinë, dashurinë dhe dëshirën që keni ndaj asaj familjeje, për t'i siguruar paqe dhe qetësi gjatë atij takimi.

Esenciale është se spiunimi është i ndaluar. Veprimi i së keqes haptazi meriton ndëshkim dhe përgjegjësi për atë veprim. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë:

“Kush merret me këto veprime le t'i ndërpresë dhe le t'i fshehë çka ka parë, nëse dëshiron që All-llahu atij t'ia fshehë gabimet, sepse kush i zbulon të fshehtat e tjerëve do të jetë fatkeqësi për të.”

(Transmeton Maliku në Muveta)

Kadiu Ebu Jeali Ferai ka paraparë dy çështje, të cilat duhet të bëhet detektimi i tyre, nëse janë veprime të këqija. Ai vazhdon dhe thotë: Nëse peshon mendimi se bëhet ndonjë marrëveshje e fshehtë kundër interesave kombëtare, e ajo bëhet në dy mënyra:

1. P.sh., për të lajmëruar për ndonjë njeri besnik se ka ndërmend të vrasë ndonjë njeri ose të bëjë prostitucion, për këto çështje lejohet për të detektuar dhe pas zbulimit të fakteve për t'i paraqitur si dëshmi. Kjo është si preventivë për mosshkeljen e ligjit dhe mosveprimin e çështjeve të ndaluara. Për këtë arsye nëse ndonjë individ apo një pjesë e shoqërisë kryen detektimin edhe vullnetarisht pranohen faktet e tyre.

2. Nëse nuk është kështu, pra për çështje më të imta, nuk lejohet detektimi dhe nuk lejohet gjurmimi.

Tregohet se Umer bin Hatabi ka hyrë në një lokal, ku një grup njerëzish pinin alkool dhe i përgojonin të tjerët. Ai u tha atyre: Ua kam ndaluar alkoolin e ju po vazhdoni të pini, ua kam ndaluar përgojimin e ju përsëri përgojoni. Ata thanë: O udhëheqës (prijës) i besimtarëve: All-llahu e ka ndaluar përgjimin e ju keni përgjuar, e ka ndaluar hyrjen në shtëpi të huaj pa leje, e ju keni hyrë në këtë shtëpi pa leje. Atëherë Umeri tha: Dy me dy, dhe është larguar pa vazhduar më tutje për t'i dënuar.

Nëse në shtëpi nuk gjendet askush, ose nuk është pronari legjitim, ose gjendet fëmija ose gruaja me të cilën është e ndaluar ndeja me të, ose vizitorit i thuhet: kthehu se nuk është kohë e përshtatshme, në të gjitha këto raste, duhet të kthehet dhe të kërkojë falje prej familjarëve, sepse çdo shtëpi i ka fshehtësitë e veta.

Nuk lejohet hyrja nëpër shtëpi ndryshe, përpos nga dera. Zoti i Madhëruar thotë:

... وَأَتُوا الْبُيُوتَ مِنْ أَبْوَابِهَا ...

“... dhe hyni nëpër shtëpia nga dera”. (El Bekare, 189)

Islami ndaloi rreptësishtë zbulimin e të metave të njerëzve, në të gjitha format, si (p.sh) me vendos mjete elektronike të përgjimit ose kamera të fshehta. Kanë ardhur hadithe të cilat ndalojnë për përgjimin pas dera. E analog me këtë, (është) përgjimi me mjete elektronike.

Në një hadith Sahih, Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar shikimin për zbulimin e të metave, ku thotë:

“Sikur t’i ndërpritej të parit, nuk do bëhej mëkat.”

Përgjimi me çfarëdo mjeti është mëkat i madh dhe krim.

Zoti i Madhëruar në Kur’an thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ إِثْمٌ وَلَا تَجَسَّسُوا وَلَا يَغْتَبَ بَّعْضُكُم بَعْضًا أَيُحِبُّ أَحَدُكُمْ أَن يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا فَكَرِهْتُمُوهُ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ تَوَّابٌ رَّحِيمٌ

“O ju që besuat, largohuni nga paragjykimet dhe dyshimet e shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron ta hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë ju me siguri e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin”.

(El Huxhuratë, 12)

Këto ndalesa janë për të siguruar qetësi për qytetarët, t’i mbrojtë shteti dhe për të marrë masa ndëshkuese për ata të cilët nuk i nënshtrohen ligjeve të All-llahut.

Ndërsa sa i përket mbrojtjes së shtetit, për t’u siguruar nga tradhtarët, lejohet që shteti të ketë aparatën e kundërzbulimit ose për t’i zbuluar terroristët dhe shkatërrimtarët dhe ata të cilët nuk ia duan të mirën vendit.

Dëmi i madh largohet me dëmin më të vogël. Domosdoshmëria e lejon të ndaluarën. Paqja dhe qetësia e përgjithshme ka përparësi ndaj paqes dhe qetësisë individuale.

Shteti këto veprime të posaçme mund t’i praktikojë vetëm pas marrjes së vendimit prej gjykatës supreme.

E DREJTA E QARKULLIMIT TË LIRË KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

NENI 31

Qytetarët kanë të drejtë qarkullimi brenda dhe jashtë. Nuk lejohet të ndalohen qytetarët për të udhëtuar jashtë vendit, po ashtu nuk lejohet të detyrohen për të qëndruar në këtë apo në atë vend, vetëm se me vendimin e gjykatësit (suprem), i cili i sqaron arsyet dhe rrethanat. Pra është e ndaluar deportimi i qytetarëve.

Koment:

Prej të drejtave njerëzore është e drejta për qarkullim të lirë, qëndrim, udhëtim brendakombëtar (shtetëror) dhe ndërkombëtar (jashtështetëror). Nuk lejohet të ndalohen qytetarët për të udhëtuar, po ashtu, është e ndaluar të detyrohen për të qëndruar në vend, në kushte dhe rrethana të rëndomta.

All-llahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“Udhëtoni nëpër tokë” (Ali Imran, 137)

“Ecni nëpër pjesë të saj” (El Mulk, 5)

“Shpërndahuni në tokë” (El Xhuma, 10)

Kjo e drejtë nuk i shkelet askujt, përpos me vendim të ligjit me arsyetim.

Dihet se në Sheriat lejohet deportimi, prej një vendi në një vend tjetër, për prostitutin e pamartuar. Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme, sa i përket dënimit me deportim dhe dënimit me shkopinj. Ebu Hanife mendon dënimi i prostitutit të pamartuar bëhet vetëm me shkopinj (xhild). Maliku mendon se mashkulli i pamartuar, nëse bën prostitucion deportohet, ndërsa femra e pamartuar jo. Shafiu e parasheh se edhe femra edhe mashkulli deportohen për një vit në largësi udhëtimi një ditë e një natë, duke u bazuar në hadithin e Muhammedit a.s.:

“Përmbajuni këtij rregullit tim, përmbajuni këtij rregullit tim. All-llahu ju ka bërë zgjedhje (ka vendosur rregull). I pamartuari dhe e pamartuara dënohen me njëqind shkopinj dhe deportohen një vit, ndërsa i martuari dhe e martuara dënohen me njëqind shkopinj dhe gurëzohen - dënohen me vdekje.” (Transmeton Muslimi)

Medhhebin e Ahmed bin Hanbelit parashihet se femra dhe mashkulli deportohen nga vendi i tyre në largësi të shkurtimeve të namazit.

Urtësia e deportimit është preventivë për mospërhapjen e amoralitetit, dhe ndërprerjen e fjalëve, dhe përgatitjen e kushteve për mëkatarin për t'u penduar, për t'iu frikësuar All-llahut dhe për t'u bërë i devotshëm.

Ndërsa urtësia e deportimit të mashkullit dhe mos deportimit të femrës është se femra duhet të jetë në përkujdesje dhe nuk lejohet të udhëtojë pa kujdestarin, e nëse udhëton pa përkujdesje dhe pa kujdestar mund të mëkatojë më shumë, ndërsa nëse parashohim të shkojë me të ndonjë prej kujdestarëve, atëherë kemi dënuar (ndëshkuar) të pafajshmin për shkak të saj.

Nëse imami (qeveria) e parasheh interesin e individit, ose edhe interesin kombëtar, në deportimin e individit në një vend të caktuar, nuk është e ndaluar me Sheriat. Tregohet se Umer bin Hatabi një natë ishte duke kaluar nëpër rrugë të Medinës kur dëgjon zërin e një gruaje, duke recituar një vjershë.

A ka ndonjë rrugë e cila më shpie të pi alkool (të dehem)

Ose rrugë e cila më shpie te Naser bin Haxhaxhi

Djalë bujar, i cili depërton thellë në zemër!

Ma lehtëson jetën të cilën e dua shumë

Ndjenjat rriten kur dëgjoj për atë

Dhe të gjitha brengat m'i largon!

Umeri r.a. tha: Nuk e shoh të arsyeshme që në Medinë të jetë Naser bin Haxhaxhi, se sjell pengesa. Të nesërmen shkon te Naser bin Haxhaxhi, dhe sheh se ai ishte tepër i bukur.

Umeri i tha: Emiri i besimtarëve ka vendosur me t'i marrë flokët. I mori flokët e tij dhe sheh se flokët i shkëlqenin: Atëherë Umeri i tha: vishe një kapelë (shall), kur e veshi shallin të gjithë u mahnitën edhe më shumë me bukurinë e tij.

Umeri i tha atij: Për Zotin ti nuk do të jetosh në atë vend ku jetoj unë.

- O emiri i besimtarëve po çfarë faji kam unë për këtë.

- Unë kam vendos kështu.

Pastaj e dërgoi në Basra.

Kur e kishte kuptuar gruaje se Umeri e kishte dëgjuar duke e recituar vjershën, i kishte thurur edhe disa vargje të tjera:

“Thuaj imamit i cili i frikësohet

Çfarë faji kam unë, dhe alkooli ose Naser bin Haxhaxhi
Paragjykimin mos e bënë realitet
Rruga e frikacakut është e pasigurtë
Epshet pengohen dhe mbyllen me devotshmëri.

Umeri pastaj kishte qarë dhe kishte thënë: E falënderoj All-
llahun për atë që epshin e ka mbyllur dhe e ka penguar.

Naser bin Haxhaxhi ka qëndruar për një kohë në Basra. Në
mes të ezanit dhe ikametit, nëna e Naserit shkon te Umeri r.a. dhe i
thotë: O emir i besimtarëve. Për Zotin kemi për t'u gjykuar në Ditën e
Kijametit para Zotit ti dhe unë, dhe Zoti do të të marrë ty në llogari.
Abdullahu (djali yt) dhe Asimi qëndrojnë në prehrin tënd, ndërsa mua
dhe djalin tim na ndajnë kodrat.

Umeri i tha: Djali im nuk sjell pengesa dhe probleme kur është
para tyre (femrave).

Pasta Umeri e kishte dërguar me detyrë në Basra Utbete bin
Gazvanin. Pasi kishte qëndruar disa ditë kishte thirrur banorët e
Basrës dhe u kishte thënë: Kush dëshiron për t'i dërguar letër emirit
të muslimanëve le të shkruajë.

Naser bin Haxhaxhi e kishte shkruar letrën si vijon:

Bismil Lahirr Rrahmanirr Rrahim
Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ju o emir i besimtarëve!
Po t'i shkruaj këto vargje
Po më dëbove ose më izolove
Vallë, a mos të kam bërë ndonjë të keqe
Më dëbove pa kurrfarë faji
Nga dy vendet e shenjta, ku ishte vendlindja ime,
dhe kishte vend për mua
Për shkak të femrave që kishin pasion në mua
Ke menduar për mua
çka nuk ka qenë dashur për të menduar
Ti thua se po më nderon
Kur edhe prindërit i kam pasur të ndershëm
Edhe ata i mundon se thua se po i nderon
Ndërsa ata dhe familja të gjithë po agjërojnë
Këto dy çështje a mund edhe një herë t'i verifikosh
Pasi që jam lodhur dhe jam dobësuar.

Kur i lexoi Umeri këto vargje ka thënë: Shqyrtoni lëndën e tij. Pasi që i autorizuari e kishte shqyrtuar lëndën ia kishte ndërtuar një shtëpi në qendër të tregut në Basër. Kur kishte vdekur Umeri r.a., atëherë ai ishte kthyer në Medine.

Po ashtu, në rastet kur shfaqet kolera apo sëmundjet ngjitëse mund të bëhet izolim i plotë preventiv në vendin e përhapjes së kolerës, ku ndalohet edhe hyrja në atë vend edhe dalja prej atij vendi.

Për këtë kemi hadithin sahih:

“Kur në një vend përhapet kolera mos shkoni atje, po nëse përhapet në vendin kur jeni aty, mos ikni, por qëndroni aty”.

Umer bin Hatabi r.a. ka refuzuar të hyjë në Siri në kohën kur ishte përhapur sëmundja ngjitëse e kolerës. Ebu Abidete i thotë: “A po ikë prej K’aderit të All-llahut”!? Umeri i thotë: “A ti, o Eba Abidete, po thua!? Po, po iki prej K’aderit të All-llahut në K’aderin e All-llahut. Çka mendon nëse e ke devenë dhe je në mes të luginës ku janë dy kodra; njëra kodër është e thatë pa kullosa, ndërsa tjetra e mbushur plot me kullosë, a nuk do ta kishe dërguar devenë në kodrën me kullosë, për të kullotur me K’aderin e All-llahut. Po nëse e dërgon në kodrën e thatë pa kullosë, atëherë ti e ke kullotur në vend të thatë me K’aderin e All-llahut.”

E DREJTA PËR AZIL POLITIK

NENI 32

Dorëzimi i azilkërkuesve politik është i ndaluar ndërsa për kriminelët e rëndomtë lejohet dorëzimi në bazë të marrëveshjes së dy vendeve.

Koment:

Kërkim i azilit politik do të thotë kur ndonjëri i cili nuk është pajtuar me qeverisjen e një shteti, ndiqet politikisht dhe ai shkon në shtetin tjetër, për të kërkuar mbrojtje dhe siguri, pasi ka dështuar ndryshimi i qeverisë apo vendosja e qeverisë tjetër.

Kjo është e ngjashme me kohën e injorancës dhe Islamit, kur ka qenë sistemi i mbrojtjes dhe përkujdesjes, kur një njeri e ka marrë një njeri tjetër, familjen e tij ose farefisin e tij me garancion, e pastaj ka deklaruar dhe ka apeluar para popullit se ai, apo ajo familje është nën besën apo garancionin e tij, dhe mos ta dëmtojë askush, por të jetojnë në paqe dhe në besë.

Muhammedi a.s. ka qenë në mbrojtje të axhës së tij Ebu Talibit dhjetë vite të plota, deri sa Muhammedi a.s. ka thënë:

“Për Zotin, deri sa ka qenë gjallë Ebu Talibi (axha im) asnjë e keqe nuk më ka ndodhur prej kurejshitëve”.

Njësoj ka ndodhur edhe me Ebu Bekri Sidikin. Në Sahihun e Buhariut transmetohet nga Aishja r.a., se kur janë sprovuar muslimanët dhe janë torturuar pandërprerë, Ebu Bekër Es-Sidiku ka shkuar refugjat në drejtim të Etiopisë, deri sa ka mbërritur në vendin e quajtur Berekul Gamad - vend pesë milje larg Mekkes, në drejtim të Jemenit. Aty takon Ibn Degnete i cili ishte prijës i atij vendi dhe e pyet Ebu Bekrin:

- Ku po shkon?
- Populli im më ka dëbuar dhe po udhëtoj nëpër tokë që ta adhuroj Zotin tim.
- Po një njeri sikur ti, as nuk dëbohet, as nuk udhëton në vende të tjera. Ti vetëm sjell dobi dhe bën mirë, bën lidhjen farefisnore, i posedon të gjitha virtytet e mira, i ndihmon të dobët, ti je gjithmonë në anën e të vërtetës, unë jam mbrojtësi yt. Kthehu lirisht në vendin tënd dhe adhuroje Zotin tënd.

Ebu Bekër Es-Sidiku u kthye së bashku me Ibn Dagnete dhe pasi vizituan parinë e kurejshitëve ai u tha: Unë kërkoj ta siguroj dhe ta garantoj Ebu Bekër Es-Sidikin për të jetuar në Mekke. Ata i thanë: Thuaj Ebu Bekër Es-Sidikut le të kthehet në shtëpinë e tij i lirë dhe le ta adhuroje Zotin e Tij. Le të falet, le të lexojë çka të dojë, por mos të reklamohet shumë se frikësohemi se do të na sjellë probleme me fëmijët tanë dhe gratë tona.

Pastaj Ibn Dagnete i tregoi Ebu Bekrit.

Ebu Bekri vazhdoi të qëndrojë në shtëpinë e tij, e adhuronte Zotin, falte namazin, dhe këndonte Kur'an në shtëpinë e tij. Pas një kohe Ebu Bekër Es-Sidiku ndërtoi mbi kulmin e shtëpisë një vendfalje, ku falej dhe lexonte Kur'an. Gratë dhe fëmijët e idhujtarëve e shikonin me interesim të veçantë dhe e dëgjonin Ebu Bekër Sidikun kur e këndonte Kur'anin, e këndonte dhimbshëm dhe qante. Paria e idhujtarëve të Mekkes u frikësuan nga realiteti dhe shkuan te Ibn Dagnete dhe i thanë: Ne e kemi siguruar me kërkesën tënde që ta adhurojë Zotin e tij në shtëpinë e tij, mirëpo ai i ka tejkaluar kompetencat dhe ka ndërtuar xhami mbi kulmin e shtëpisë së tij dhe ne po frikësohemi se do të na sjellë telashe me gratë dhe fëmijët tanë. Më mirë do të ishte mos ta adhuronte fare Zotin në shtëpinë e tij. Nëse refuzon për të mos kënduar Kur'an haptazi atëherë marrëveshja nuk vlen. Ne nuk kemi dashur të të tradhetojmë ty, ndërsa ne nuk jemi afër me Ebu Bekrin për t'i thënë që të mos këndojë Kur'an haptazi. Ibn Dagnete shkoi te Ebu Bekër Es-Sidiku dhe ia tregoi mendimin e kurejshitëve. Ebu Bekri iu përgjigj deri sot kam qenë nën sigurimin tënd, mirëpo toka ime është nën sigurimin e All-llahut!

Kështu, në kohën e injorancës, ka qenë sigurimi i cili ka pasur rregulla dhe kushte dhe respektim të marrëveshjes. Arabët e kohës së injorancës kanë pasur marrëveshje të cilave iu janë përmbajtur, kanë pas garancione, sigurime dhe besë.

Tani do të tregojmë edhe një shembull, i cili (tregon si) ka ndodhur sigurimi në Islam. Pranë Umi Hanit, bijës së Ebu Talibit, kur ishte viti i çlirimit të Mekkes, kaluan dy njerëz të Beni Mahzumit dhe ajo i morri në mbrojtje për t'i siguruar. Pasi përfundoi lufta erdhi Ali bin Ebu Talibi dhe tha se do t'i vriste. Pastaj, tregon Umi Hani, shkova te Muhammedi a.s., i cili kur më pa u gëzua shumë dhe më pyeti: Çka dëshiron? I thashë: O i dërguari i All-llahut, kan qenë nën

sigurimin tim dy njerëz, mirëpo Alia (r.a.) dëshiron t'i mbyttë. Muhammedi a.s. tha:

“Do të jenë të siguruar ata që i ke siguruar ti, oj Umi Han”.

(Transmeton Muslimi)

Pra le ta dëshmojë e tërë bota: Në cilin vend respektohet dhe nderohet femra, apo mendimi i saj, ashtu qysh është respektuar mendimi i saj (Umi Hanit)!?

Femra siguron dy burra të farefisit, ndërsa burri i saj luftonte kundër idhujtarëve me muslimanët në anën tjetër. Dhe hyn vëllai i saj dhe dëshiron t'i mbyttë për shkak të idhujtarëve, ndërsa ajo e mbyll derën e shtëpisë së saj dhe ngre akt padi te Muhammedi a.s., i Dërguari besnik. Ai e priti me përshëndetje, i dha të drejtën politike në rrethana të jashtëzakonshme dhe atë në mes të fushëbetejës.

Ndërsa, ndryshon çështja përsa i përket azilkërkuesit i cili ka bërë krime. Dorëzimi i atij, i cili ka bë krime, tek shteti amtar, posaçërisht, është bashkëpunim në punë të mira dhe devotshmëri dhe në ndalim të veprave kriminale dhe përndjekje e krimit dhe kriminelëve.

Mirëpo kjo bëhet nëpërmjet marrëveshjes së shteteve, të cilat i caktojnë llojet e krimeve dhe ndërrimin e kriminelëve për ta ndaluar krimin, pasi fshehja e krimit është krim. Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَا تَرْكَنُوا إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا فَتَمَسَّكُمُ النَّارُ وَمَا لَكُم مِّنْ دُونِ اللَّهِ مِنْ أَوْلِيَاءَ ثُمَّ لَا تُنصَرُونَ

“Dhe mos anoni kah ata që bënë zullum, e për atë shkak t’iu kapë zjarri, sepse përveç All-llahut nuk keni ndonjë mbrojtës, e mbeteni të pa ndihmuar”.

(Hudë, 113)

KEQTRAJTIMI DHE TORTURIMI

NENI 33

Torturimi i qytetarit është krim, krimi apo dënimi për krim nuk vjetërsohet. Krimineli dhe bashkëvepruesi mbajnë përgjegjësi. Nëse i ndihmohet kriminelit për kryerjen e krimit duke heshtur dhe duke mos e treguar atë, (ai njeri) është pjesëmarrës i krimit dhe jep përgjegjësi. Qeveria e merr në përgjegjësi për bashkëveprim.

Koment:

Detyrë e qeverisë është që të jetë besnike ndaj qytetarëve të saj, i siguron ata, kujdeset për ta dhe garanton pasurinë dhe nderin e tyre, dhe sillet me qytetarët ashtu si sillet nëna me fëmijët e saj.

Qeveria nuk është asgjë tjetër, pos një grup prej personave (qytetarëve) të cilët marrin detyrë dhe përgjegjësi dhe i shërbejnë popullit me dashuri dhe sinqeritet. Nëse këta qeveritarë shndërrohen në ujqër, që thithin gjakun e shoqërisë (ummetit) dhe i shkelin të drejtat e bijve të vet, i dënojnë për aktivitetet e tyre, u shkatërrojnë shtëpitë e tyre, ajo është tragjedi prej tragjedive më të mëdha. Prej këtu torturimi i qytetarëve dhe nënçmimi i tyre llogaritet shkelje e kompetencave të tij dhe largim prej detyre tërë jetën. Përpos kësaj, Sheriati Islam ka paraparë që për padrejtësi individët kanë për t'u dënuar edhe në botën tjetër.

Në hadithin e Muslimit, Muhammedi a.s. ka thënë:

“A e dini kush është bankrotuesi (muflisi)?

- Bankrotues është ai i cili nuk ka dërrhem as pasuri - janë përgjigjur shokët e tij.

- Bankrotues (muflis i ummetit tim) quhet ai i cili falet, agjëron, jep zekat e pastaj këtë e shan, tjetrin e shpif, e ha pasurinë e tjetrit, e vret tjetrin, i bie tjetrit, atëhere (në Ditën e Kijametit) atyre do t'ia japë të mirat e veta dhe kur t'i shpenzohen të mirat, para se të pastrohet prej padrejtësive, i ngarkohen mëkatet e atyre dhe hidhet në zjarr.”

Më së shumti keqtrajtojnë dhe torturojnë nëpunësit e vegjël, pas shënjitimit apo sinjalizimit të eprorëve të tyre dhe kur të zbulohet çështja, dënimi bie në nëpunësit e vegjël dhe nuk bie te eprorët e tyre.

Është e domosdoshme për të vendosur ligje për përgjegjësi qytetare, dhe për çdo njërin, i cili përkrah ose hesht kur sheh se qytetari torturohet dhe keqtrajtohet, ashtu që të tillët të konsiderohen bashkëpjesëmarrës të krimit dhe të ndiqen penalisht dhe moralisht.

Qeveria patjetër duhet të sigurojë dhe të garantojë që qytetarët të jenë të lirë dhe që nuk do të keqtrajtohen. Pra detyra e qeverisë është që gjithmonë të jetë syçelë dhe të përkujdeset për detyrën që ka marrë, që qytetarët të mos keqtrajtohen, por përkundrazi të jetojnë të qetë.

Kur'ani tregon se si sundimtar faraoni, ka qenë prej shkatërrimtarëve dhe keqbërësve, prej hipokritëve dhe prej bashkëpunëtorëve të shejtanit.

Zoti i Madhëruar tregon për faraonin:

قَالَ لِلْمَلَإِ حَوْلَهُ إِنَّ هَذَا لَسَاحِرٌ عَلِيمٌ . يُرِيدُ أَنْ يُخْرِجَكُمْ مِنْ أَرْضِكُمْ بِسِحْرِهِ فَمَاذَا تَأْمُرُونَ . قَالُوا أَرْجِهْ وَأَخَاهُ وَأَبْعَثْ فِي الْمَدَائِنِ حَاشِرِينَ . يَأْتُوكَ بِكُلِّ سَحَّارٍ عَلِيمٍ . فَجَمَعَ السَّحَرَةَ لِمِيقَاتٍ يَوْمٍ مَعْلُومٍ . وَقِيلَ لِلنَّاسِ هَلْ أَنْتُمْ مُجْتَمِعُونَ . لَعَلَّنَا نَتَّبِعُ السَّحَرَةَ إِنْ كَانُوا هُمْ الْغَالِبِينَ . فَلَمَّا جَاءَ السَّحَرَةُ قَالُوا لِفِرْعَوْنَ أَإِنَّا لَنَا أَجْرًا إِنْ كُنَّا نَحْنُ الْغَالِبِينَ . قَالَ نَعَمْ وَإِنَّكُمْ إِذَا لَمِنَ الْمُقَرَّبِينَ .

“(faraoni) Parisë që e rrethonin u tha: “Vërtet, ky qenka magjistar shumë i aftë!” Që me magjinë e vet dëshiron t’iu dëbojë nga toka juaj, e ç’më propozoni mua. (Paria) shtyje atë dhe vëllain e tij (çështjen e tyre) për më vonë, e ti dërgo nëpër qytete tubues. Që të sjellin të gjithë magjistarët e dijshtëm këtu. Dhe, magjistarët u tubuan në kohën e ditës së caktuar. Edhe popullit iu tha: “Ejani e tubohuni. Ashtu që t’i përkrahim magjistarët, nëse ata triumfojnë. E kur erdhën magjistarët i thanë faraonit: A do të ketë shpërblim për ne, nëse ndalim ngadhënjimtarë?. Ai tha: Po, bile ju do të jeni atëherë prej më të afërmve!”

(Esh Shuara, 34-42)

Paria e faraonit ka qenë pjesëmarrëse në të keqe dhe aleat i kriminelit dhe shkatërruesit. Në një ajet tjetër, Zoti i Madhëruar thotë:

وَفِرْعَوْنَ ذِي الْأَوْتَادِ . الَّذِينَ طَعَوْا فِي الْبِلَادِ . فَأَكْثَرُوا فِيهَا الْفَسَادَ .

“Dhe me faraonin e fortifikuar me tenda (ushtarake) të cilët e tepruan me krime në tokë. Dhe në të shtuan shkatërrimin”.

(El Fexhr, 10-12)

Në tendat e faraonit kanë qenë ushtarët e faraonit, të cilët i torturonin dhe i mbytnin burrat, ndërsa gratë i dhunonin, kështu ata kanë qenë pjesëmarrës të krimit dhe torturimit.

Nëse gjatë torturimit, i torturuari vdes ose i dëmtohet një pjesë e trupit, atëherë dënimi do të jetë në të njëjtën masë. Zoti i Madhëruar thotë:

وَكَتَبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ وَالْأُذُنَ
بِالْأُذُنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ فَمَن تَصَدَّقَ بِهِ فَهُوَ كَفَّارَةٌ لَهُ وَمَن لَّمْ
يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“Ne u caktuam atyre në të (Tevrat) kundërmaset ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin. Por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e fal atë (hakmarrjen) ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti All-llahu, ata janë mizorë (të padrejtë)”.

(El-Maide, 45)

DËNIMI PËR MOSLAJMËRIMIN E RASTIT

NENI 34

Nëpunësi, i cili është në momentin e torturimit dhe keqtrajtimin e rastit dhe është përgjegjës i asaj detyre, nëse nuk e lajmëron rastin te organet ligjore, ai ndëshkohet me dënim të papërcaktuar.

Koment:

Muslimani mban përgjegjësi në mbajtjen e rendit (emër bil mearuf) dhe luftën kundër kriminalitetit (nehj anil munker) në tri mundësitë e mundshme dhe kjo duke u bazuar në hadithin e Muhammedit a.s.:

“Kush prej jush e sheh një të keqe le ta largojë me dorën e tij, nëse nuk mundet ashtu, atëherë me gjuhën e tij, nëse edhe me gojë nuk mundet, atëherë me zemrën e tij, por kjo është shkalla më e ulët e imanit.”

Kjo përgjegjësi bën që qytetarët të jenë më të kujdesshëm, se çka ndodh me shoqërinë e tyre, në mënyrë që të dominojë drejtësia, karakteri, e mira dhe morali.

Largimi nga përgjegjësitë do të thotë humbje e shoqërisë (ummetit), sëmundje e mendjes shoqërore dhe sulm ndaj nderit të tij.

Nëpunësi, i cili në vendpunën e tij fsheh torturimin dhe keqtrajtimin e qytetarit, dhe nuk lajmëron te organet përkatëse, ai ka bërë krim për të cilin duhet ndjekur moralisht dhe penalisht.

Moslargimi i vetive negative të shoqërisë (ummetit) dhe moslargimi i keqtrajtimit të qytetarëve e shpie shoqërinë (ummetin) në shkatërrim.

Prej bazave të Sheriatit Islam është mosdëgjimi i krijesës, nëse është në kundërshtim me urdhrin e Krijuesit. Në Sheriat, është e ndaluar keqtrajtimi i qytetarëve, po ashtu nuk lejohet dëgjimi i urdhrave të eprorëve, nëse ka të bëjë me keqtrajtimin. Nuk lejohet as heshtja, nëse ai e di se organet përkatëse kryejnë veprime të tilla.

Dënimi dhe masat përmirësuese në Sheriat i japin të drejtë gjykatësit, që varësisht prej personave, kushteve dhe rrethanave të ndëshkojë në masa përkatëse, duke filluar prej vërejtjes, mallkimit, të rrahurit, deri te deportimi. Dijetarët më eminentë të jurisprudencës

islame e kanë kushtëzuar që dënimi me të rëna të mos ta tejkalojë numrin katërdhjetë, ose tetëdhjetë të rëna.

Imami Maliku mendon se mundet edhe më shumë dhe mund të tejkalohet edhe maksimumi i numrit 100 (masë ndëshkuese e caktuar) saqë mund të arrijë (edhe deri) në ekzekutim.

Disa shtete veprojnë me këtë ligj (të fundit) dhe dënimin për trafikim droge - dënim me vdekje. Ky nuk është dënim i caktuar me Sheriat, por dënim me masë të pacaktuar. Ky dënim është paraparë për shkak të dëmit të madh, i cili shkaktohet prej këtij krimi.

PËRGJEGJËSIA E SHTETIT NDAJ TË AKUZUARIT

NENI 35

Në Islam gjaku nuk është ujë, shteti e kompenson gjakun e vrasjes nëse nuk dihet vrasësi, ose nuk ka mundësi për ta gjetur dorasin, ose e ndalon dorasin, mirëpo ai nuk ka pasuri për ta kompensuar vrasjen.

Koment:

Në Islam njeriu ka rëndësi të madhe, këtë e dokumenton ajeti kur'anor:

مِنْ أَجْلِ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنَّهُ مَن قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا ...

“Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush e mbyt një njeri (pa të drejtë) pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur të gjithë njerëzit.”

(El Maide, 32)

Po ashtu ka dënim të ashpër në ahiret. Zoti i Madhëruar thotë:

وَمَن يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُّتَعَمِّدًا فَجَزَاؤُهُ جَهَنَّمُ خَالِدًا فِيهَا وَغَضِبَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُ وَأَعَدَّ لَهُ عَذَابًا عَظِيمًا

“Kush e mbyt një besimtarë me qëllim, dënimi i tij është xhehennemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë, All-llahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh”.

(En Nisa, 93)

Në librat e Fikhut, janë sqaruar ligjet me përpikëri, sa i përket dënimit për vrasje dhe e kanë ndarë me tri lloje:

- Vrasja me qëllim
- Vrasja pa qëllim dhe
- Vrasja e dyshimtë

Vendimi i Sheriatit Islam për dënimin e vrasjes me qëllim është ekzekutimi me vrasje, përveçse nëse kujdestari i të vrarit ia fal ose kërkon shpagim (dije).

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِصَاصُ فِي الْقَتْلِ الْحُرُّ بِالْحُرِّ وَالْعَبْدُ بِالْعَبْدِ
وَالْأَنْثَى بِالْأُنْثَى فَمَنْ عُفِيَ لَهُ مِنْ أَخِيهِ شَيْءٌ فَاتَّبَاعْ بِالْمَعْرُوفِ وَأَدَاءٍ إِلَيْهِ
بِإِحْسَانٍ ذَلِكَ تَخْفِيفٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَرَحْمَةٌ فَمَنِ اعْتَدَىٰ بَعْدَ ذَلِكَ فَلَهُ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje: i liri për të lirin, rob për robin, femra për femrën. Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet (e atij që fal) kuptueshëm dhe shpagimi (nga dorasi) atij le t’i bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj. E kush tejkalon pas këtij (pajtimi), ai ka një dënim të hidhët”.

(El Bekare, 178)

Organi juridik dhe ekzekutiv (velijul emril-amë) është organi kompetent për ekzekutimin e vendimeve të All-llahut të Lartmadhëruar. Nëse dy palët pajtohen dhe merren vesh që të bëhet shpagimi i vrasjes (dija), atëherë nuk ka pengesë, pasi të dy palët janë vëllezër të njeri-tjetrit. Ndërsa falja e vëllezërve njëri tjetrit dhe pajtimi është prej veprave madhështore dhe fisnike.

Kujdestari i të vrarit e kërkon shpagimin (dijen) me afat të caktuar, me vlerë të caktuar, në bazë të rrethanave dhe kushteve sa më të volitshme, ndërsa dorasi e paguan sa më mirë, pa e vonuar afatin dhe pa e zvogëluar shumën e caktuar.

Në vrasjen pa qëllim nuk parashihet ekzekutimi me vdekje, por vetëm shpagimi i gjakut (dija).

Shpagimi (dija) në Sheriatin Islam është e paraparë 100 deve, ose 200 lopë, ose 1000 dele.

Nëse nuk gjenden këto kafshë, atëherë i jepet kundërvlera në kohë të caktuar, siç parashihet mes palëve. Ka mendime se vlera (e dijes) duhet të jetë 1000 dinarë, ose 12 000 dërhëm prej argjendi.

Ekzistojnë disa rrethana të cilat ndikojnë që shpagimi (dija) të jetë e domosdoshme dhe e rëndë, e ato janë:

- Vrasja me qëllim, ose vrasja pa qëllim
- Vrasja në Qabe ose në muajt e haxhit (el haram)
- Vrasja e farefisit

Shpagimit (dija) mund t'i rritet vlera, dhe atë:

1. Rritja për një të tretën e vlerës
 2. Zgjedhja e llojit të kafshëve me vlerë të madhe.
- P.sh. 100 deve të shpagimit të (dijes) lehtë është kështu:
- | | |
|------|----------------------------|
| 1-20 | (huka) ²⁵ |
| 2-20 | (xhudha) ²⁶ |
| 3-20 | (bint lebun) |
| 4-20 | (bint mehad) ²⁷ |
| 5-20 | (ibn lebun) ²⁸ |

Ndërsa për shpagimin e (dijen) e rëndë është kështu:

- | | |
|------|----------|
| 1-30 | (huka) |
| 2-30 | (gjudha) |
| 3-40 | (bars) |

Ndërsa shpagimi (dija mugaledha) e rëndë në vlerë të monedhave është plus shtesa e një të tretës të vlerës dhe do të ishte (133 dinarë) njëqind e tridhjetë e tre dinarë (të arit) dhe (16 000) gjashtëmbëdhjetë mijë të argjendit.

Shpagimin (e dijes) e bën familja e dorasit dhe atij i ndihmojnë me qëllim që të jetë përgjegjësi shoqërore dhe përkujdesje e prindërve ndaj fëmijëve dhe pasardhësve. Ndihma dhe mbrojtja e farefisit duhet të jetë në kohëra të mira dhe të vështira. Nuk ka pengesë që sindikata e punëtorëve të organizatës, në të cilën punon, të bëjë shpagimin (dijen).

Nëse gjendet i vrari dhe nuk dihet kush është dorasi atëherë ekzistojnë dy mënyra:

Mënyra e parë: Kur një popull e akuzon popullin tjetër me të cilin ka pasur armiqësi të mëhershme dhe nuk kanë fakte për t'u adresuar në vrasësin e drejtpërdrejtë, por anon mendimi (dyshohet) se akuzuesi ka të drejtë në bazë të kushteve dhe rrethanave. Vendimi i Sheriatit këtë e quan dënim kolektiv.

Dënimi kolektiv bëhet kur akuzuesi përbetohet pesëdhjetë herë dhe vendoset për ta bërë shpagimin (dijen), pa marrë parasysh akuzimi a bëhet për vrasje pa qëllim, apo me qëllim, pasi dënimi

²⁵ Deveja e cila i ka tri vjet dhe ka hyrë për vitin e katërt.

²⁶ Deveja e cila i ka katër vite dhe ka hyrë për vitin e pestë.

²⁷ Deveja e cila ka një vit dhe ka hyrë për vitine dytë.

²⁸ Deveja e cila i ka dy vite dhe ka hyrë për vitin e tretë.

kolektiv (Kasame) është argument i dobët dhe nuk mund të ketë dënim (me vdekje) për ekzekutim. Imam Shafiu (medhheb kadim) dhe Imam Ahmedi mendojnë se në dënimin kolektiv (Kasame) mund të ketë dënim kolektiv, nëse vrasja është me qëllim.

Nëse akuzuesi refuzon të përбетohet pesëdhjetë herë, atëherë i akuzuari përбетohet pesëdhjetë herë dhe lënda konsiderohet e mbyllur.

Mënyra e dytë: Kur gjendet i vrari, nuk dihet dorasi dhe nuk ngrihet padia ndaj askujt. Në këtë rast dhe siç ishte rasti i fundit të mënyrës së parë, lënda mbyllet, mirëpo gjaku i të vrarit nuk shkon kot, por kompensimin e gjakut e bën shteti (shpagimin-dijen).

Kompensimin e gjakut (dijen) e merr familja e të vrarit, me qëllim që t'i lehtësohet fatkeqësia, dhe vazhdimi i jetës për nevoja materiale.

Shteti përfaqëson familjen shtetërore ndërsa qeveritari është kujdestari i familjes. Muhammedi a.s. në shumë raste ka paguar borxhet e shokëve të tij.

Në një hadith Sahih Muhammedi a.s. ka thënë:

“Për çdo besimtar unë jam përgjegjës dhe kujdestar, edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, nëse dëshironi lexoni ajetin.

“Pejgamberi ka përparësi ndaj besimtarëve më shumë se vetja e tyre”.

Çdo besimtar i cili vdes e trashëgon familja e tij, kush ka borxh dhe ka vdekur dhe nuk ka pasuri, unë do të jem përgjegjës dhe do t'ia paguaj.”

Emiri i muslimanëve Umeri r.a. është përkujdesur shumë për muslimanët, ai para vdekjes ka thënë: Dhashtë Zoti të shpëtoj dhe të vejat (familjet) e Irakut do të kishin përkujdesje, sa që nuk do të kishin nevojë për askënd tjetër.

Ai po ashtu thotë: Çdo musliman në fytyrën e tokës, i cili nuk ka mjete materiale për të jetuar, ka të drejtë të vijë dhe të marrë prej arkës qendrore.

Po të kisha jetuar, edhe bariu i Jemenit do të vinte të merrte pa u skuqur fare.

Me këto vendime qiellore ruhet dhe sigurohet shoqëria dhe nuk ndodhin vrasje. Dënimi me vdekje siguron shoqërinë nga vrasjet e shumta dhe njerëzit jetojnë të qetë, largohen brengat dhe fatkeqësitë, hiqet vesvesja (dyshimi) i shejtanit dhe e keqja e injorancës. Njerëzit pajtohen me vendimin e Zotit

Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَا تَقْتُلُوا النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَمَنْ قُتِلَ مَظْلُومًا فَقَدْ جَعَلْنَا لَوْلِيهِ
سُلْطَانًا فَلَا يُسْرِفُ فِي الْقَتْلِ إِنَّهُ كَانَ مَنْصُورًا

“Dhe mos mbytni njeriun që All-llahu ka ndaluar (mbytjen e tij), veçse me drejtësi (që e kërkon Sheriati). E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij, Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos kalojë kufirin në mbytje deri sa ai është i ndihmuar (prej Zotit)”.

(El Israë, 33)

Tejkalimi i kufijve të dënimit me vdekje bëhet me njëren prej tri formave:

1. Duke ekzekutuar dënimin me vdekje kujdestari i të vrarit, pa lejen dhe pa vendimin e gjyqit (gjykatësit). Pasi kjo shpie në tollovi të mëdha, nuk plotësohen faktet, çështjet kalojnë me dyshime dhe të pasigurta. Lindin armiqësitë, derdhet gjaku dhe shoqërisë i kanoset rreziku i shkatërrimit.

2. Duke dënuar me vdekje jo dorasin, por ndonjë njeri më fisnik të familjes së tij p.sh. i vrari të jetë rob, ndërsa të kërkohet të ekzekutohet zotëriu, ose dorasi të jetë femër, e të kërkohet të dënohet mashkulli, ose të jetë vrarë një, e të kërkohet të vriten më shumë.

3. Duke u hakmarrë ndaj dorasit dhe familjarëve të tjerë. E gjithë kjo është tejkalim i ligjeve të Sheriatit, ndërkohë që praktimi i Sheriatit në shoqëri sjell paqe, siguri, e bllokon dhe e ndalon krimin.

E DREJTA PËR ANKESA

NENI 36

Çdo qytetar ka të drejtë ankese nga krimi, apo nga padrejtësia që i bëhet atij ose tjetërkujt, ose për keqpërdorimin e pasurisë së përgjithshme.

Koment:

Shoqëria islame dallohet se ajo është gjithmonë e zgjuar dhe e kujdesshme ndaj qytetarit, dhe garanton që shoqëria të jetë e qetë dhe e sigurtë, dhe siguron pasurinë shoqërore.

Dënimi bie vetëm mbi kriminelin, për ta parandaluar shkatërrimin e shoqërisë. Organizimi dhe siguria shoqërore është e garantuar nëpërmjet dy çështjeve:

- Devotshmëria ndaj All-llahut. Kjo nuk dëshiron inspektim nga jashtë, mjafton që në zemrën e muslimanit të jetë frika dhe dashuria ndaj Zotit. Aktiviteti dhe heshtja e tij janë dobi dhe bereqet, haptazi dhe fshehtazi.

- Respektimi i ligjit dhe i vendimit. Kjo detyrë ka të bëjë për organet juridike për mbajtjen e drejtësisë në mes njerëzve, ndjekjen e krimit dhe dënimin e shkatërrimtarëve.

Në Sahihun e Muslimit, Hudhejve bin el Jeman, thotë:

“Do të vjen koha kur njeriu nuk do të shikojë me cilin do të tregtojë, sepse nëse është musliman dëshiron (të jetë i sigurtë në fenë e tij) dhe t’i përvetësojë tjerët në fenë e tij. Nëse është i krishterë ose hebrej dëshiron (të jetë i sigurtë në shitblerje) që t’i përvetësojë për vete. Ndërsa sot nuk do të kisha blerë prej tjerëve, pos prej atyre të cilët i njoh se nuk mashtrojnë në shitblerje”.²⁹

Për të arritur te vendimi i gjyqit dhe respektimi i ligjit duhet patjetër që qytetari ta marrë përgjegjësinë e zbulimit të krimit, për t’iu ndihmuar organeve policore për të kryer detyrën e tyre. Kjo realizohet në atë mënyrë që qytetari ngre aktpadinë te përgjegjësit (organet kompetente) kundër krimit i cili bëhet ndaj pasurisë shoqërore.

Çdo njeri ka fushëveprimtarinë, në të cilën ka kompetencë dhe ka mundësi për ta larguar të keqen të cilën nuk mund ta largojnë të tjerët, nëse e keqja është jashtë fushëveprimtarisë së tij ose jashtë kompetencave të tij, nevojitet që çështjen ta ngrejë tek organet kompetente, t’u sqarojë atyre atë që e ka për obligim për t’ua treguar dhe t’u sjellë argumente dhe dëshmi.

²⁹ “Shihul Muslim bi Sherh Nevevij”, vëll. II, fq.170.

Ky kuptim i drejtë vjen nga thënia e Muhammedit a.s. kur thotë:

“Kush prej jush e sheh një të keqe le ta largojë me dorën e tij, nëse nuk mundet me dorë atëherë me gjuhën e tij, e nëse edhe kështu nuk mundet, atëherë me zemrën e tij, por kjo është shkalla më e dobët e imanit.”

Çështja, aktpadia ndaj krimit (lajmërimi), në asnjë çast, nuk do të thotë akuzim i të pafajshmëve, tentim për t’iu ulur reputacionin të ndershmëve dhe për të luajtur me nderin e njeriut.

Për veprimet e tilla, Zoti i Madhëruar thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يُحِبُّونَ أَنْ تَشِيعَ الْفَاحِشَةُ فِي الَّذِينَ آمَنُوا لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ فِي الدُّنْيَا
وَالْآخِرَةِ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënimi i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk i dini.”

(En Nur, 19)

وَالَّذِينَ يُؤْذُونَ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ بَغَيْرِ مَا اكْتَسَبُوا فَقَدْ احْتَمَلُوا بُهْتَانًا
وَإِنَّمَا مُبِينًا

“E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtare, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me shpifje dhe me një mëkat shumë të madh.”

(El Ahzabë, 58)

Organi përgjegjës, pas ngritjes së aktpadisë, nevojitet që menjëherë të marrë masat dhe ta hulumtojë rastin, për të gjetur fakte për veprën e kryer. Këtë e kuptojmë nga thënia e Zotit të Madhëruar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنْ جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَنْ تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ
فَتُصِيبُوا عَلَى مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos goditni ndonjë popull, pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë”.

(El Huxhuratë, 6)

E DREJTA E PUNËS DHE E PRONËSISË

NENI 37

E drejta për punë dhe fitim është e garantuar, nuk lejohet cenimi i tyre, vetëm nëse është çështja (në kundërshtim) me ndonjë vendim të sheriatit islam.

Koment:

Puna, fitimi dhe pronësia janë të drejta të ndërlidhura mes vete. Puna është e drejtë e qytetarit, por në të njëjtën kohë edhe obligim. Caktimi i Zotit është që jeta të ndërtohet nëpërmjet punës, pra për plotësimin e nevojave të ushqimit, veshmbathjes dhe strehimit. Zoti i Madhëruar ia ka treguar këtë realitet Ademit a.s., edhe derisa ishte në xhennet:

فَقُلْنَا يَا آدَمُ إِنَّ هَذَا عَدُوٌّ لَكَ وَلِزَوْجِكَ فَلَا يُخْرِجَنَّكَ مِنَ الْجَنَّةِ فَتَشْقَى . إِنَّ لَكَ
أَلَّا تَجُوعَ فِيهَا وَلَا تَعْرَى . وَأَنَّكَ لَا تَظْمَأُ فِيهَا وَلَا تَصْحَى .

“E Ne thamë: O Adem, ky është armik yt dhe i bashkëshortes tënde, pra mos t’iu nxjerrë kurrsesi nga xhenneti, e t’iu vërë në vështirësi (për të siguruar mjetet e jetesës). Ti aty (në xhennet) nuk ke për të qenë i uritur, e as nuk ke për të mbetur i zhveshur. Aty nuk ke për të pasur etje, e as nuk do të kesh vapë”.

(Ta Ha, 117-119)

Pasi Ademi doli prej xhennetit, për të marrë përgjegjësinë e udhëheqësit në tokë, atij iu nevojit që t’i plotësonte nevojat e tij.

Njeriu kur punon, fiton. Ky fitim mundet të jetë sa për t’i plotësuar nevojat elementare, por edhe më shumë. Në të dyja rastet, punëtori ka të drejtë dhe liri për punë, fitim dhe shpenzim.

Islami e kërkon fuqishëm punën dhe e ka bërë obligim të punohet, për të fituar dhe për të pronësuar. Zoti i Madhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذُلُولًا فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِن رِّزْقِهِ
وَالِيهِ النُّشُورُ

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja.”

(El Mulk, 15)

Në një hadith sherif, Muhammedi a.s. thotë:

“Dora e lartë (e cila jep) është më e mirë se dora e ulët (e cila lyp). Fillo të japësh në rend të parë ndaj atij që e ke në përkujdesje. Sadakaja (lëmosha) më e mirë është e të pasurit, kush përmbahet dhe nuk bëhet barrë e tjerëve Allahu do t’ia përmirësojë gjendjen e tij - VE MEN JESTEAFIF JEAFILAHU”.

Sead bin Ebi Vekasi shkon te Muhammedi a.s. dhe i thotë:
“O i dërguar i All-llahut, unë kam pasuri, dhe pas kam vetëm një vajzë trashëgimtare, a t’i jap sadaka 2/3 e pasurisë?”

- Muhammedi a.s. i tha: Jo.
- A të jap sadaka 1/2?- i tha Saidi.
- Muhammedi a.s. i tha: Jo.
- Saidi vazhdoi: A të japë sadaka 1/3 e pasurisë?
- Muhammedi a.s. i tha: Po, 1/3. Sepse të lësh trashëgimtarë të pasur është më mirë se sa ta lësh të kërkojë prej njerëzve”.

Kjo është e drejta për punë, për fitim dhe për pronësi, të cilat janë të garantuara sipas ligjeve të Sheriatit Islam. Mirëpo, është e ndaluar puna me sende të ndaluara si: me alkool, prostitucion, bixhoz. Është i ndaluar fitimi i fëlliqur si: me kamatë, vjedhje e mashtrim. Nuk ka pronësi me mall haram.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Vërtet All-llahu është i mirë dhe i pastër dhe e do vetëm të mirën, e të pastrën”. All-llahu i urdhëron besimtarët ashtu siç i ka urdhëruar pejgamberët. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الرُّسُلُ كُلُوا مِنَ الطَّيِّبَاتِ وَاعْمَلُوا صَالِحًا إِنِّي بِمَا تَعْمَلُونَ عَلِيمٌ

(Ne u patëm thënë): **“O ju të dërguar, hani atë që është e lejuar dhe e mirë dhe bëni vepra të mira se Unë e di atë që ju veproni”.**

(El Mu’minunë, 51)

Po ashtu, Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُلُوا مِن طَيِّبَاتِ مَا رَزَقْنَاكُمْ وَاشْكُرُوا لِلَّهِ

إِنْ كُنْتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ

“O ju që besuat, hani nga të mirat që u kemi dhënë dhe falënderoni All-llahun, nëse jeni që vetëm Atë e adhuron”.

(El Bekare, 172)

Në qoftë se njeriu niset në udhëtim, i vështirësohet gjendja, i rrezikohet jeta dhe ai i ngre duart në drejtim të qiellit e thotë: o Zot! - ndërsa ushqimi i tij ka qenë haram dhe është furnizuar me haram, atëherë si t'i përgjigjet All-llahu atij!?"

Kur'ani ka sqaruar se si duhet të pastrohet pasuria e fituar prej haramit, kur thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَذَرُوا مَا بَقِيَ مِنَ الرِّبَا إِن كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ . فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَإِن تُبْتِغُوا فَلََكُمْ رُؤُوسُ أَمْوَالِكُمْ لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ .

“O ju që besuat, kijeni frikë All-llahun dhe nëse jeni besimtarë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë, atëherë binduni se jeni në konflikt me All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. E nëse jeni penduar, juve ju takon kryet e mallit tuaj, askënd nuk e dëmtoni, as vetë nuk dëmtoheni”.

(El Bekare, 278- 279)

PUNA E FEMRËS

NENI 38

Femra duhet të punojë brenda kufijve të Sheriatit Islam.

Koment:

E drejta e femrës për punë është e garantuar në Sheriatin Islam. Në Islam është vërtetuar puna e femrës në shit-blerje, dhe e drejta e femrës për pronësi. Po ashtu, (femrës) i ka dhënë të drejtën për të pasur pasuri të veçantë, e cila mund t'i dhurohet si testament, dhuratë ose si trashëgimi. Zoti i Madhëruar thotë:

لِّلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ الْوَالِدَانِ وَالْأَقْرَبُونَ وَلِلنِّسَاءِ نَصِيبٌ مِّمَّا تَرَكَ الْوَالِدَانِ
وَالْأَقْرَبُونَ مِمَّا قَلَّ مِنْهُ أَوْ كَثُرَ نَصِيبًا مَّفْرُوضًا

“Meshkujve ju takon pjesë nga pasuria që lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti)”.

(En Nisa, 7)

Zoti i Madhëruar, po ashtu, thotë:

... لِّلرِّجَالِ نَصِيبٌ مِّمَّا اكْتَسَبُوا وَلِلنِّسَاءِ نَصِيبٌ مِّمَّا اكْتَسَبْنَ ...

“Burra ju takon hise nga ajo që fituan ata, dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato”.

(En Nisa, 32)

Gjatë historisë islame, femra ka punuar në të gjitha veprimtaritë e jetës. Ka qenë shit-blerëse, tregtare, udhëheqëse, e udhëhequr, zonjë e shërbëtore, juriste, luftëtare, thirrëse në rrugën e All-llahut, edukatore e arsimitare.

Prej shembujve tipik të gjeneratës së parë të islamit kemi nënat e besimtarëve. Zonja Hatixhe r.a., e bija e Huvejlidit, tërë pasurinë e saj dhe tërë mençurinë e saj e ka aktivizuar për Islamin. Urvete bin Zubejr tregon për Aishen r.a.: Nuk kam parë grua më të ditur në mjekësi, as në fikh, as në poezi se sa Aishja r.a. Shkonim te Aishja r.a. dhe ajo, gjithmonë, me diturinë e saj na i vërtetonte.

Po ashtu, është vërtetuar se Umi Selem, Umi Habibe dhe Sevdete bin Zumate kanë dhënë mund të madh në triumfin e fesë së All-llahut. Po ashtu edhe gratë të tjera të Muhammedit a.s. Historia ka regjistruar faqe të arta të xhihadit të femrës islame me Muhammedin a.s. Dëshmorja e parë në Islam është Sumejja, nëna e Umar bin Jasirit. Mushrikët e vranë vetëm sepse ajo refuzoi çdo fe tjetër, pos Islamit.

Po ashtu, edhe Esma bint Ebu Bekri, e cila i ka ndihmuar Muhammedit a.s. dhe babës së tij Ebu Bekrit, natën e hixhretit.

Femrat kanë marrë pjesë në shumë beteja, u sillnin ujë luftëtarëve, ua shëronin plagët, mbanin edhe armë në dorë, një prej tyre në luftën e Uhudit në mbrojtje të Muhammedit a.s. ka qenë Nesibete bin Keab. Historia islame është e mbushur me raste të veçanta të angazhimit të femrës.

Mirëpo nevojitet të kemi parasysh dy pika:

E para: Femra islame ka veshje të posaçme (mbulesën), para meshkujve të huaj. Këtë e tregon ajeti kur'anor:

وَقُلْ لِّلْمُؤْمِنَاتِ يَغْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ إِلَّا مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَلْيَضْرِبْنَ بِخُمُرِهِنَّ عَلَىٰ جُيُوبِهِنَّ ...

“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolit e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shamitë mbi kraharorin e tyre”.

(En Nur, 31)

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لِّلْأَزْوَاجِ وَبَنَاتِكَ وَنِسَاءِ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلَابِيبِهِنَّ
ذَلِكَ أَذْنَىٰ أَنْ يُعْرِفْنَ فَلَا يُؤْذِينَ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا

“O Ti pejgamber, thuaju grave tuaja, bijave tua dhe grave të besimtareve le të vejnë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër të njihen e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara, Ai është i mëshirshëm”.

(El Ahzabë, 59)

E dyta: Puna e femrës nuk do të thotë që ajo të mos përkujdeset për familjen, për shtëpinë dhe për t'i tejkaluar kufijtë, duke anashkaluar të drejtën dhe obligimin e saj që ka ndaj burrit dhe ndaj fëmijëve.

Puna e femrës në shtëpinë e saj ka përparësi ndaj punës jashtë shtëpisë së saj. Detyra e femrës për të qenë nënë ka përparësi ndaj çdo pune tjetër.

Muhammedi a.s. i ka lavdëruar gratë kurejshite duke thënë:

“Gratë më të mira që kanë hipur ndonjëherë në deve janë gratë kurejshite sepse ato i kanë mbajtur fëmijët e vegjël në krah e në prehër dhe janë përkujdesur ndaj tyre dhe po ashtu janë përkujdesur edhe ndaj burrave të tyre”.

Nëse e kërkon nevoja si p.sh. nevoja e femrës për të rritur jetimë, ose burri është i sëmurë dhe ka shumë fëmijë, dhe nëse e kërkon nevoja e përgjithshme kur shteti ka nevojë për fuqi punëtore, (punë) të cilat janë edhe në harmoni me natyrshmërinë e femrës, atëherë ligji e përkrah dhe e mbështet që ajo të punojë. Islami dëshiron që edhe femra edhe mashkulli të punojë për një jetë të ndershme dhe të lumtur.

Muhammedi a.s. thotë:

“Ushqimi më i mirë është ushqimi i fituar me duart e tua, se i Dërguari i All-llahut Davudi a.s. ushqehet me fitimin e duarve të tij.”

Në gramatikë është e njohur se trajta e pashquar përfshin në mënyrë gjenerale edhe mashkullin edhe femrën, edhe të madhin edhe të voglin, edhe pronarin edhe punëtorin.

E DREJTA PRONËSORE

NENI 39

Shteti garanton të drejtën pronësore, dhe lirinë e veprimit. Prona shoqërore në asnjë mënyrë nuk guxon të eksporporohet, ndërsa prona private mund të eksporporohet me vendim të veçantë gjyqësor.

Koment:

Pronësia është e drejtë natyrore të cilën Islami e garanton pa marrë parasysh a është pak apo shumë. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

... نَحْنُ قَسَمًا بَيْنَهُمْ مَعِيشَتَهُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَرَفَعْنَا بَعْضَهُمْ فَوْقَ بَعْضٍ دَرَجَاتٍ لِّيَتَّخِذَ بَعْضُهُمْ بَعْضًا سُلْخِيًّا وَرَحِمْتُ رَبِّكَ خَيْرٌ مِّمَّا يَجْمَعُونَ

“Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë; Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se sa të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri tjetrin për shërbime. E mëshira (caktimi për pejgamber) e Zoti tënd është shumë më e dobishme se ajo që ata e grumbullojnë.”

(Ez Zuhruf, 32)

Fjala “Tes-hir” ka për qëllim ndërrimin e vlerave dhe nevojave të njerëzve në mes vete, pa marrë parasysh gjendjen dhe pozitën që kanë. Kjo është për arsye se njeriu nga natyra është i krijuar si krijesë kolektive.

Burimet e pronës në Islam janë:

1. Puna, Zoti i Madhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذُلُولًا فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا مِن رِّزْقِهِ
وَالِيهِ النُّشُورُ

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj, dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja.”

(El Mulk, 15)

Po ashtu, edhe Muhammedi a.s. thotë:

“Të zgjohet ndonjëri prej jush në mëngjes dhe të bartë dru me krahun e tij dhe të japë sadaka prej së cilës njerëzit të kenë dobi, është më mirë se sa të presësh prej njerëzve të të japin apo mos të të japin. Dora e lartë (e cila jep) është më e vlefshme se dora e ultë (e cila lyp- merr)”

2. Trashëgimia, Zoti i Madhëruar thotë:

يُوصِيكُمُ اللَّهُ فِي أَوْلَادِكُمْ لِلذَّكَرِ مِثْلُ حَظِّ الْأُنثِيَيْنِ فَإِنْ كُنَّ نِسَاءً فَوْقَ اثْنَتَيْنِ فَلَهُنَّ ثُلُثَا مَا تَرَكَ وَإِنْ كَانَتْ وَاحِدَةً فَلَهَا النِّصْفُ وَلِأَبَوَيْهِ لِكُلِّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا السُّدُسُ مِمَّا تَرَكَ إِنْ كَانَ لَهُ وَلَدٌ فَإِنْ لَمْ يَكُنْ لَهُ وَلَدٌ وَوَرِثَهُ أَبَوَاهُ فَلِأُمِّهِ الثُّلُثُ فَإِنْ كَانَ لَهُ إِخْوَةٌ فَلِأُمِّهِ السُّدُسُ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا أَوْ دَيْنٍ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ لَا تَدْرُونَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ لَكُمْ نَفْعًا فَرِيضَةٌ مِّنَ اللَّهِ إِنْ أَلَّاهُ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا

“All-llahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra; nëse janë (trashëgimtare) vetëm femra, dy e më shumë, atyre ju takojnë dy të tretat e pasurisë që trashëgohet; nëse është një femër, asaj i takon gjysma; për prindërit, për secilin nga ata, ju takon e gjashta nga ajo që ka lënë (i vdekuri) nëse ka fëmijë; e në qoftë se (i vdekuri) nuk ka fëmijë e atë e trashëgojnë (vetëm) prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta; në qoftë se ai (i vdekuri) ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta (kjo e drejtë e trashëgimisë bëhet) pasi të kryhet testamenti (vasijet) që ka lënë dhe pasi të lahet borxhi; ju nuk e dini se kush është më afër dobisë suaj, prindërit tuaj ose fëmijët tuaj. (ky përcaktim është) urdhër nga All-llahu. Vërtet All-llahu është më i dijsmi, më i urti.”

(En Nisa, 11)

3. Testamenti të cilën e pronëson pas vdekjes së testamentuesit. Zoti i madhëruar në ajetet e trashëgimisë thotë:

- **pasi të kryhet testamenti (vasijeti)**
- **pas testamentit të porositur**
- **pas kryerjes së testamentit**

(En Nisa, 11-12)

4. Sadakaja, pa marrë parasysh a ka qenë ajo sadaka obliguese apo jo, ajo është e drejtë e nevojtarëve:

وَالَّذِينَ فِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ مَّعْلُومٌ . لِّلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ .

“Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp”.

(El Mearixh, 24-25)

وَفِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ لِّلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ

“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë, por nuk lyp).”

(Edh Dharijatë, 19)

Kur të vërtetohet posedimi dhe pronësia, në asnjë mënyrë nuk lejohet keqpërdorimi i tij, as të shndërrohet në pronësi të përgjithshme, pa marrë parasysh rrethanat apo shkaqet.

Zoti i Madhëruar, në ajetet e trashëgimisë, thotë:

وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ مُّهِينٌ

“Kush e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, dhe i shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në zjarr të përjetshëm. E për të është një dënim i rëndë”.

(En-Nisa, 14)

Sistemet, të cilat nuk lejojnë që trashëgimia të jetë shkak pronësie, apo nuk e pranojnë pronën private, janë sisteme të brishta dhe në kundërshtim me natyrshmërinë, e paralizojnë zhvillimin, dhe e shpien Ummetin në varfëri, keqpërdorime dhe imoralitet.

Keqpërdorimi i pronave është prej padrejtësive më të shëmtuara. Në Sahihun e Muslimit, Ebi Umamete r.a transmeton. se i dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë:

“Kush ia merr të drejtën tjetrit me përбетim të rrejshëm, All-llahu ja ndalon atij xhennetin dhe e shpie në xhehennem. Një njeri i tha: Po, edhe nëse është send me vlerë të vogël?”

“Po, edhe nëse është send me vlerë shumë të vogël”, (u përgjigj Muhammedi a.s.)”.

Muhammedi a.s. ka thënë, gjithashtu:

“Kush uzurpon apo me padrejtësi merr një pëllëmbë të tokës, do të jetë i rënduar për shtatë tokë”.

Nuk lejohet bartja e pronës të ndonjë personi, veçse me vendim të gjyqit i bazuar në ligjet e Sheriatit. P.sh. nuk lejohet t'i legjitimohet prona, nëse ai ka i tubuar mjetet në haram dhe me mjete të fëlliqura siç janë: droga, kamata, prostitucioni, vjedhja. Për sendin haram nuk ka legjitimitet në pronësi, nëse dihet personi paraprak (të cilit i është marrë pasuria me padrejtësi) i kthehet, po nëse nuk dihet, ajo pasuri kalon në investim të interesit të përgjithshëm, si p.sh.: ndërtim të xhamive, shkollave, spitaleve, rrugëve etj. etj.

Ndërsa sa i përket thënies së të dërguarit të All-llahut s.a.v.s.:

“Vërtet All-llahu është i mirë dhe e pranon vetëm të mirën”, ka për qëllim shpërblimin te Zoti. Pra Zoti i Madhëruar çdo sadakë që e pranon dhe e shpërblen, e shpërblen nëse është me pasuri të lejuar, të mirë dhe hallall. Për sadakanë me pasuri haram, sadakadhënësi nuk shpërblehet, por ajo vetëm mbetet si interes apo dobi e përgjithshme e muslimanëve.

KUSHTET E SHPRONËSIMIT (EKSPORPURIMI)

NENI 40

Askujt nuk mund t'i merret prona përpos nëse është në pyetje interesi kombëtar dhe atëherë duhet t'i kompensohet në përputhshmëri me vendimet të cilat rregullohen me ligj.

Koment:

Pasuria private është e garantuar dhe e pacenueshme, dhe shteti e mbron atë. Mirëpo kur ndeshen dy të drejta (interesa):

E drejta (interesi) individual dhe e drejta (interesi) shoqëror. P.sh. Shteti ka nevojë për ujësjellës, ose ndërtimin e shkollës ose të spitalit, atëherë mund të bëhet shpronësimi prej pasurisë private me kompensim të drejtë, të cilin e rregullon ligji, pasi sipas bazave të Sheriatit e drejta (interesi) shoqërore ka përparësi ndaj të drejtës (interesit) individual.

Kështu ka vepruar Muhammedi a.s. kur e ka ndërtuar xhaminë e tij në Medine. Është vërtetuar në Sahihun e Buhariut se vendi (prona) i xhamisë ka qenë i dy fëmijëve jetimë dhe Muhammedi a.s. i ka pyetur për t'i blerë. Por ata kanë thënë: Jo, nuk do ta shesim, por do ta dhurojmë, o i Dërguar i All-llahut. Mirëpo, i Dërguari i All-llahut ka refuzuar deri sa janë pajtuar që ta shesin dhe, pasi e ka blerë, aty është ndërtuar xhamia.

Kështu kanë vepruar edhe halifët e drejtë, kur e kanë zgjeruar projektin e Mesxhidi Haramit (Qaben) në Mekke dhe të Xhamisë së Muhammedit a.s. në Medine, kur bënë shpronësimin e pronave përreth xhamive, ndërkohë që ua kompensojnë atyre me kushte shumë të përshtatshme dhe të volitshme.

Në shumicën e rasteve, shteti nuk ka ndërhyrë dhe nuk ka pasur nevojë për të ndërhyrë, mirëpo muslimanët kanë garuar mes vete se kush do të bëjë më shumë të mira, duke ndërtuar shkolla, xhamia, spitale, duke i zgjeruar rrugët etj. etj. Kështu, nga bamirësit e shumtë, janë plotësuar interesat e përgjithshme të shoqërisë.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Në Islam, kush lë një punë të mirë (rrugë të hajrit) ai do të shpërblehet, por do të shpërblehet edhe me punën të cilën e vazhdojnë të tjerët pas tij, duke mos iu humbur shpërblimi të tjerëve. Ndërsa kush e lë një punë të keqe do të ngarkohet, edhe për punën e keqe të tjerëve që e vazhdojnë pas tij, duke mos iu lehtësuar atyre fare.”

LIRIA E GAZETARISË

NENI 41

Themelimi i shtëpive të gazetarisë është i lejuar, gazetat janë të lejuara, mirëpo të gjitha këto brenda kufijve të Sheriatit Islam.

Koment:

Liria e gazetarisë dhe shpërndarja e informatave është liria e të shprehurit dhe të mendimit, sipas rregullave të dobisë së përgjithshme dhe sipas bazave të moralit.

Në Islam fjalët të kërkuara janë:

- Fjala “All-llah”

Fjala për të Lartëmadhëruarin është shkenca për ekzistimin e Tij, dhe (Atij) i takojnë të gjitha cilësitë e mira, të gjitha përshëndetjet dhe të gjitha lavdërimet. Zoti i Madhëruar, në Kur'an, thotë:

وَكَلِمَةُ اللَّهِ هِيَ الْعُلْيَا

“Dhe fjala e All-llahut është më e larta”

(Et Tevbe, 40)

“Fjala e All-llahut” është feja e Tij, shpallja e Tij. Nëse fjala e njeriut kalon mbi fjalën e All-llahut, fillojnë shtrembërimet, ngatërresat dhe shkatërrimet.

- Fjala e vërtetë

Mbi të vërtetën janë ndërtuar dhe qëndrojnë qiejt dhe toka, mbi të vërtetën rregullohen çështjet e dunjasë dhe të ahiretit, mbi të vërtetën qëndron lumturia, siguria dhe qetësia njerëzore.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَاللَّهُ يَقُولُ الْحَقَّ وَهُوَ يَهْدِي السَّبِيلَ

“E All-llahu thotë atë që është realitet (fjalë të vërteta) dhe Ai udhëzon në rrugë të drejtë”.

(El Ahzabë, 4)

- Fjala e “devotshmërisë”

Devotshmëria është preventiv për mosshkatërrim, nxitje, dëshirë dhe angazhim për punë të dobishme dhe të mira.

Zoti i Madhëruar thotë:

... وَالزَّمَهُمْ كَلِمَةَ التَّقْوَى وَكَانُوا أَحَقَّ بِهَا وَأَهْلَهَا ...

“Dhe për ata zgjodhi besimin e drejtë (të devotshmërisë me fjalën La ilahe il-lall-llah), pse ata ishin më meritore për të dhe më të zotët e saj”.

(El Fet-h, 26)

- Fjala e mirë

E mirë është ajo çka e konsideron të mirë ligji i Sheriatit, është në harmoni me logjikën, me natyrshmërinë, dhe ajo çka është e mirë për jetën dhe për ekzistencën.

Zoti i Madhëruar thotë:

... وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا ...

“... dhe njerëzve thuani fjalë të mira”.

(El Bekare, 83)

- Fjala e dobishme

Fjala e dobishme konsiderohet çdo fjalë e cila i bën dobi fesë dhe jetës. Muhammedi a.s. thotë:

“Kush beson All-llahun dhe në Ditën e Gjykimit ose le të flasë fjalë të dobishme, ose le të heshtë.)

- Fjala e bukur

Fjala e bukur është ajo çka sjell të mira dhe dobi dhe ndikon te njerëzit për të qenë të mirë dhe i nxit ata që të bëjnë punë të dobishme.

Zoti i Madhëruar thotë:

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ . تُؤْتِي أُكْلَهَا كُلَّ حِينٍ بِإِذْنِ رَبِّهَا وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ .

“A nuk e ke kuptuar se si All-llahu bëri shembull: fjalën e mirë (të bukur) si pema e mirë, që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart. E që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frytin e vet në çdo kohë. All-llahu, pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë.”

(Ibrahim, 24-25)

Nuk ka dyshim se fjala me cilësitë të cilat i përmendëm prezanton Islamin në besim (akide) dhe veprim (shariat) dhe buron prej Kur'anit dhe sunnetit dhe e ushqen logjikën njerëzore, dhe është mostër për njerëzimin dhe rregull i shoqërisë. Çështjet dhe mjetet bashkëkohore duhet të jenë në dobi të muslimanëve dhe ardhmërisë së tyre.

Liria e gazetarisë bazohet në kryerjen e amanetit për përcjelljen e lajmit, për sinjeritet në ide, angazhim në punë të mira dhe qëllime të drejta.

Mirëpo ka lloje të revistave të cilat Islami nuk i lejon të shpërndahen në ummetin e tij, e ato janë:

- **Revistat e përgojimit, shpifjes dhe gënjeshtreve.**

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَن تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْبِحُوا عَلَىٰ مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë”.

(El Huxhuratë, 6)

- **Revista e krimeve dhe imoralitetit**

Zoti i madhëruar thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يُحِبُّونَ أَن تَشِيعَ الْفَاحِشَةُ فِي الَّذِينَ آمَنُوا لَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ

“Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk dini”.

(En Nur, 19)

- **Revistat e luftës psikologjike**

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الَّذِينَ اتَّخَذُوا دِينَكُمْ هُزُوءًا وَلَعِبًا مِّنَ الَّذِينَ أُوتُوا
الْكِتَابَ مِن قَبْلِكُمْ وَالْكَفَّارَ أَوْلِيَاءَ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ . وَإِذَا نَادَيْتُمْ إِلَى
الصَّلَاةِ اتَّخَذُوهَا هُزُوءًا وَلَعِبًا ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَعْقِلُونَ .

“O ju që besuat! Mos i merrni për miq ata të cilëve u është dhënë libri para jush edhe as jobesimtarët që me fenë tuaj tallen e luajnë. Kijeni dro All-llahun po që se jeni besimtarë. Edhe thirrjen (ezanin) tuaj për namaz ata e marrin për tallje e lojë. Me këtë vërtetojnë se janë popull që nuk kupton”.

(El Maide, 57,58)

- **Revistat që sjellin lajme hipokrite dhe që tregojnë për interesa dhe përfitime duke e shtrembëruar të vërtetën**

Zoti i Madhëruar thotë:

وَمِنْهُمْ مَّن يَلْمِزُكَ فِي الصَّدَقَاتِ فَإِنْ أُعْطُوا مِنْهَا رِضْوَانًا
وَإِنْ لَّمْ يُعْطُوا مِنْهَا إِذَا هُمْ يَسْنَخُونَ

“Ka prej tyre që do të bëjnë vërejtje në ndarjen e lëmoshës, nëse u jepet nga ajo, ata mbesin të kënaqur e nëse nuk u jepet, ata hidhërohen”.

(Et Tevbe, 58)

SHOQATAT DHE SINDIKATAT

NENI 42

Qytetari ka të drejtë të themelojë dhe t'u bashkëngjitet shoqatave dhe sindikatave të cilat veprojnë haptazi dhe qartë sipas ligjit, ndërsa ndalohet nëse ato veprojnë kundër rregullimit shoqëror, ose të cilat veprojnë si grupe të armatosura, ose në njëfarë mënyre veprojnë kundër ligjeve të Sheriatit Islam.

Koment:

Islami e lejon themelimin e shoqatave dhe formimin e sindikatave për të arritur qëllime të caktuara, të cilat janë në shërbim të një grupi të qytetarëve, mbrojtjen e të drejtave të tyre, garantimin e tyre, dhe mbrojtjen e të vërtetës dhe angazhimin (xhihadin) për dobi dhe që sjellin të mira në shoqëri.

Nëse shoqatat dhe sindikatat nuk i kryejnë këto punë, i tejkalojnë kompetencat dhe mashtrojnë shoqërinë dhe tradhtojnë vlerat e tyre, kundërshtojnë dhe luftojnë shoqërinë dhe rrugën e saj të pastër dhe veprojnë ilegalisht, çka e dëmton paqen dhe rendin e shoqërisë, dhe shpie në ngatërresa të mjegullta, (atëherë) këto shoqata dhe sindikata nuk duhen respektuar, por ato mbyllen dhe ndalohet veprimtaria e tyre dhe veprimtarët e këtyre organizatave mbajnë përgjegjësi për veprimtarinë e tyre, e cila ka qenë në kundërshtim me rregullimin shoqëror dhe me ligjet e Sheriatit Islam.

Në Kur'an kemi ajete të cilat tregojnë për çështjen e shoqatave dhe sindikatave, ku Zoti i Madhëruar, thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا تَنَاجَيْتُمْ فَلَا تَتَنَاجَوْا بِالْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَمَعْصِيَةِ الرَّسُولِ
وَتَنَاجَوْا بِالْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ . إِنَّمَا النَّجْوَىٰ مِنَ
الشَّيْطَانِ لِيَحْزَنَ الَّذِينَ آمَنُوا وَلَيْسَ بِضَارِّهِمْ شَيْئًا إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ وَعَلَى اللَّهِ
فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ .

“O ju që keni besuar, kur bisedoni mes vete fshehurazi, mos bisedoni për çka është mëkat, armiqësi dhe kundërshti ndaj Pejgamberit, por bisedoni për punë të nderhme e të matura dhe kijani frikën All-llahut, te i Cili do të tuboheni! Bisedën e fshehtë e nxit vetëm djalli për t’i shqetësuar ata që besuan, ndonëse ajo nuk mund t’i dëmtojë ata fare pa dëshirën e All-llahut, andaj vetëm All-llahut le t’i mbështeten besimtarët”!

(El Muxhadele, 9-10)

Nexhva quhet pëshpëritja apo biseda e fshehtë. TENAXHEV është bashkëbisedim i fshehtë dhe sekret. Aktiviteti i shoqatave dhe sindikatave dhe mbledhjet e tyre janë një lloj bashkëbisedimi dhe bashkëveprimi i posaçëm i tyre, ku marrin vendime, ku anëtarët e tyre marrin detyra dhe përgjegjësi dhe ku udhëheqësit e tyre (Kryetari e kryesia) japin përgjegjësi për punën e tyre.

Ajeti fisnik ka ndaluar që të bashkëbisedohet dhe të bashkëveprohet në mëkate dhe armiqësi dhe në kundërshtim ndaj të dërguarit, në tubimet dhe manifestimet e tyre, por ka përcaktuar që ato të jenë në sferën e punëve të mira dhe të devotshmërisë. Po ashtu, ajeti ka tërhequr vërejtjen se ata të cilët bashkëbisedojnë dhe bashkëveprojnë në atë çka është në kundërshtim me fenë e All-llahut dhe çka është në dëm të shoqërisë, shejtani bëhet bashkëveprimtar i tyre dhe i mashtron me dinakërinë e tij.

Ndonjëherë vetë shejtani i sundon ambiciet dhe epshet e tyre dhe i nxit armiqtë e ummetit, edhe të brendshëm edhe të jashtëm, që të veprojnë kundër ummetit.

Deri sa shoqëria është besnike ndaj fesë së Tij dhe i përmbahet parimeve dhe karakterit dhe është shoqëri e një mendjeje, atëherë planet e tradhtarëve janë të gjykuar për të dështuar dhe për të mos pasur sukses.

Nuk lejohet, në asnjë formë, të jesh anëtar i këtyre shoqatave, por edhe nuk duhet të heshtet ndaj planeve të tyre armiqësore dhe shkatërrimtare.

Në hadithin e Ebu Davudit, të cilin e transmeton nga senedi i Xhabir bin Abdullahut, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Lejohen vendkuvendimet e ummetit përpos në tre kuvendime, e ato janë: Vendkuvendimet ku bëhet marrëveshje për gjakderdhje e cila është haram, apo për imoralitet (prostitucion) e cila është haram, apo për uzurpimin apo marrjen e pasurisë së të tjerëve pa të drejtë”.

REALIZIMI I TË DREJTAVE NË PËRPUTHSHMËRI ME QËLLIMET E SHERIATIT

NENI 43

Plotësimi i të drejtave duhet të jetë në përputhshmëri me qëllimet e Sheriatit.

Koment:

Të drejtat dhe liritë në Islam duhet të jenë në përputhshmëri me qëllimet e Sheriatit Islam.

Qëllimi kryesor i Sheriatit është dobia e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër. Kjo shihet shumë qartë edhe në bazat e Sheriatit, por edhe në degët tjera. Qëllimi i krijimit të jetës është:

- sprovimi për t'i kryer obligimet. Zoti i Madhëruar thotë:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ الْعَزِيزُ الْغَفُورُ

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkatfalësi”.

(El Mulk, 2)

- po ashtu, edhe për të adhuruar All-llahun. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, veçse që të më adhurojnë.”

(Edh Dharijatë, 56)

Pejgamberët janë dërguar një pas një dhe shpalljet kanë zbritur vazhdimisht për t’iu sjellë argumente robërve (njerëzve) dhe t’ua sqaruar rrugën e drejtë. Zoti i Madhëruar thotë:

رُسُلًا مُبَشِّرِينَ وَمُنْذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ

وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا

“Të dërguar që ishin lajmëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para All-llahut. All-llahu është i pavarur në sundimin e vet dhe di si të veprojë”.

(En Nisa, 165)

Dhe peygamberi i fundit, Muhammedi a.s. është dërguar mëshirë për të gjithë. Zoti i Madhëruar thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“E ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”

(El Enbija, 107)

Nëse përcjellim qëllimin e vendimeve në ibadete (adhurim) dhe veprim do të shohim se dobitë janë të pashmangshme nga ato ligje dhe vendime.

Pastërtia ndërlidhet me abdestin, guslin dhe tejemumin. Zoti i Madhëruar thotë:

... مَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيَجْعَلَ عَلَيْكُمْ مِّنْ حَرَجٍ وَلَكِنْ يُرِيدُ لِيُطَهِّرَكُمْ وَلِيُتِمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكُمْ
لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ .

“All-llahu nuk dëshiron (me obligim për abdest e larje) t’u sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’iu pastrojë, t’iu plotësojë të mirën e Tij ndaj jush e që t’i falënderoheni”.

(El-Maide, 6)

Bazat e moralit ndërlidhen me namazin. Zoti i Madhëruar thotë:

اَتْلُ مَا أُوحِيَ إِلَيْكَ مِنَ الْكِتَابِ وَأَقِمِ الصَّلَاةَ إِنَّ الصَّلَاةَ تَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ
وَالْمُنْكَرِ وَلَذِكْرُ اللَّهِ أَكْبَرُ وَاللَّهُ يَعْلَمُ مَا تَصْنَعُونَ

“Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur’ani), fal namazin. Vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, e përmendja e All-llahut është më e madhja (e adhurimeve); All-llahu e di ç’punoni ju”.

(El-Ankebutë, 45)

Devotshmëria e cila i përmbledh të gjitha të mirat është e ndërlidhur me agjërimin. Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”

(El-Bekare, 183)

Dobitë e muslimanëve në aspektin politik, ekonomik dhe shoqëror ndërliiden me haxhin. Zoti i Madhëruar thotë:

وَأَذِّن فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَى كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ .
لِيَشْهَدُوا مَنَافِعَ لَهُمْ وَيَذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ فِي أَيَّامٍ مَّعْلُومَاتٍ عَلَى مَا رَزَقَهُمْ مِّنْ
بَهِيمَةِ الْأَنْعَامِ فَكُلُوا مِنْهَا وَأَطْعِمُوا الْبَائِسَ الْفَقِيرَ . ثُمَّ لِيَقْضُوا تَفَثَهُمْ وَلِيُوفُوا
نُدُورَهُمْ وَلِيَطَّوَّفُوا بِالْبَيْتِ الْعَتِيقِ .

“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta. Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin All-llahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) për atë që i ka furnizuar me kafshë. Hani pra, prej tyre (kurbaneve) dhe ushqeni të ngushtuarin e të varfrin. Pastaj le të heqin papastërtinë e tyre, le të zbatojnë premtimet e veta dhe le të sillen (bëjnë tavaf) rreth shtëpisë së lashtë.”

(El Haxh, 27-29)

Triumfi i së vërtetës, mbrojtja e të dëmtuarit, asgjësimi i ngatërresave dhe largimi i shkatërrimit, të gjitha këto janë të ndërliidhura me xhihadin në rrugën e All-llahut. Zoti i Madhëruar thotë:

وَالْوِلْدَانَ الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا أَخْرِجْنَا مِنْ هَذِهِ الْقَرْيَةِ الظَّالِمِ أَهْلُهَا وَاجْعَل لَّنَا مِن
لَّدُنكَ وَلِيًّا وَاجْعَل لَّنَا مِن لَّدُنكَ نَصِيرًا

“Ç’keni që nuk luftoni për Zotin dhe për (t’i shpëtuar) të paafitit, burrat, gratë dhe fëmijët, të cilët u lutën: ‘Zoti ynë! Nxirrna nga ky fshat (Mekka) banorët e të cilit janë mizorë. Na jep nga ana jote shpëtim e ndihmë’.”

(En Nisa, 75)

Fikhu islam (jurisprudenca islame) përfshin të gjitha çështjet për të cilat ka nevojë njeriu në këtë botë dhe në botën tjetër. Për këtë arsye janë zhvilluar shkencat të detajuara në të gjitha çështjet, si në: martesë, trashëgimi, testament, xhihad, pasurinë e frontit, robërit e luftës etj.

Të gjitha këto në sferën e qëllimeve të Sheriatit, të cilat dijetarët i kanë përmbledhur në pesë çështje parësore e ato janë:

- Mbrojtja e fesë
- Mbrojtja e jetës së njeriut
- Mbrojtja e pasurisë
- Mbrojtja e mendjes dhe
- Mbrojtja e nderit

KAPITULLI I PESTË

IMAMI (KRYETARI)

Përbëhet prej 17 neneve:

Prej nenit nr. 44

Deri në nenin nr. 60

DËGJUESHMËRIA NDAJ IMAMIT (Kryetarit)

Neni 44

Shteti ka Imamin (kryetarin) i cili duhet (është vaxhib) të dëgjohet edhe pse ndryshon në ide dhe mendime.

Koment:

Emërimi i kryetarit të shtetit mund të quhet Imam, Qeveritar ose Mbret. Kjo është një prej obligimeve për të cilën duhet të angazhohet (ummeti) bashkësia familjare islame për të vendosur rend, paqe e siguri, (në mënyrë) që qytetarët t'i gëzojnë të drejtat e tyre, dhe mbrohet feja.

Imami (Kryetari) i drejtë është njëri prej 7 personave të cilët All-llahu do t'i nderojë në botën tjetër me nder dhe respekt të veçantë. Në një hadith autentik (Buhari dhe Muslimi)i, transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Shtatë persona All-llahu do t'i vendosë nën hijen e Tij, në Ditën kur nuk ka hije tjetër pos hijes së Tij, e ato janë:

- ***Imami (kryetari) i drejtë;***
- ***I riu i cili e ka çuar rininë me adhurim***
- ***Njeriu, zemra e të cilit është e ndërlidhur me xhaminë***
- ***Dy njerëz të cilët e duan njëri-tjetrin për All-llah, bashkohen për All-llah dhe ndahen për All-llah.***
- ***Njeriun, të cilin e ka ftuar një grua e hijshme dhe me famë e ai i thotë: Unë i frikësohem All-llahut.***
- ***Njeriu, i cili jep sadaka aq fshehtë, sa që dora e majtë nuk e di çka ka dhënë dora e djathtë.***
- ***Njeriu i cili kur e kujton All-llahun i pikojnë lotët prej syve”.***

Raportet dhe ndërlidhjet qeveritare dhe qytetarit islam i ka bërë që të jenë lidhje të ndihmës mes vete.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kryetarët (udhëheqësit) më të mirë tuaj janë ata të cilët i doni dhe ju duan, luteni për ta dhe luten për ju. Ndërsa kryetarët (udhëheqësit) më të këqij tuaj janë ata të cilët i urreni dhe ju urrejnë, i mallkoni dhe ju mallkojnë.”

Nëse Imami (kryetari) konsultohet me dijetarët (deputetët) dhe në fund merr vendim të drejtë dhe nxjerr ligje, vendime dhe urdhra të cilat nuk janë në kundërshtim me Sheriatin Islam është obligim dëgjimi i tij.

Është e pamundur që gjithmonë të ketë konsensus të plotë mirëpo, pas konsultimeve dhe rrahjeve të problemeve dhe tematikave, ndodhin polemika, mospajtime dhe mendime të ndryshme, mirëpo imami (kryetari) i mbyll (të gjitha ato) kur ta marrë në fund vendimin. Kur Imami (kryetari) merr vendimin është obligim për t'iu përmbajtur të gjithë, e edhe ata të cilët nuk janë pajtuar me atë vendim. Dëshirat e të gjithëve kurrë nuk mund të plotësohen. Ixhmai (Konsensusi) i tërësishëm është i rrallë, prandaj për bazë merret mendimi i shumicës dhe është urtësia ajo që prin.

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ ...

“O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju.”

(En Nisa, 59)

Në sahihun e Muslimit transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se ka thënë:

E kam dëgjuar Muhammedin a.s. duke thënë:

“Kush heq dorë nga dëgjueshmëria, në Ditën e Kijametit do ta takojë All-llahun i paarsyeshëm dhe pa argumente. Kush vdes, pa e pranuar imamin (kryetarin), do të vdesë si injorant.”

Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush më dëgjon mua, e ka dëgjuar All-llahun, kush më kundërshton mua e ka kundërshtuar All-llahun. Kush e dëgjon prijësin (emirin) më ka dëgjuar mua dhe kush e kundërshton prijësin (emirin) më ka kundërshtuar mua.”

Në një rivajet tjetër:

“Kush e dëgjon prijësin (emirin) më ka dëgjuar mua dhe kush e kundërshton prijësin (emirin) më ka kundërshtuar mua”.

Islami e parasheh dëgjimin ndaj prijësve të zgjedhur si mbyllje të dyerve të ngatërresave, dhe mbyllje të dritareve të sherrit (të keqes) dhe thyerje të epsheve dhe pengim të trillimeve të shejtanit për të mos depërtuar në mesin e muslimanëve.

Dijetarët kanë regjistruar fjalë të mençura dhe të urta përsa i përket emërimit të Imamit (kryetarit) dhe obligimit të dëgjimit ndaj tij. Këtu po përkujtojmë fjalën e imamit El-Amidi: Duke u mbështetur në thëniet e dijetarëve, të cilat janë përcjellë në mënyrë të pakontestueshme prej “ixhamit” të muslimanëve, në gjeneratën e parë menjëherë pas vdekjes së Muhammedit a.s. për të mos mbetur pa Imam (kryetar) ose Halif as për një kohë të shkurtër. Ebu Bekër Es-Sidiku ka thënë fjalën e urtë të njohur pas ndërrimit të jetës së Muhammedit a.s.: *“Muhammedi a.s. ka ndërruar jetë. Patjetër nevojitet ta zëvendësojë dikush sa më shpejt për t’u kujdesur për çështjet e kësaj feje”*. Të gjithë e dëgjuan, e pranuan dhe e përkrahën këtë thënie dhe asnjëri prej muslimanëve nuk e ka kundërshtuar, por i janë bindur plotësisht. Ndërsa ngritja e Havarixhëve kundër Imamit (Halifit) nuk ka qenë për ta kundërshtuar si Imam (halif), por (ata) kanë kundërshtuar dhe nuk janë pajtuar me emërimin dhe mënyrën e emërimit, por ata prapë se prapë kanë vazhduar dhe kanë qenë këmbëngulës për forcimin e fesë dhe të akides (besimit) dhe nuk janë larguar nga feja, por kanë luftuar familjen e farefisin vetëm e vetëm për t’i ndihmuar fesë dhe muslimanëve.

Natyrisht logjika ndonjëherë e paramendon se është obligim ajo çka nuk është obligim. Kur’ani dhe sunneti i Muhammedit a.s. ka treguar se ata kanë gabuar në veprim por nuk kanë gabuar në qëllim.

Pas tyre Tabi’inët kanë vazhduar po të njëjtën mënyrë dhe kështu, gjeneratë pas gjenerate, është përcjellë emërimi i Imamit (kryetarit) deri tek ne.

Urtësia e kësaj është se ne e dimë se kjo është dituri, e cila është e përafërt me dituritë e domosdoshme dhe se qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet urdhëresave, ndalesave dhe të gjitha mjeteve të tjera të cilat i ka ligjësuar, si dënimet e caktuara (hudud), dënimet e tjera penale (Kisas), aktet kontraktuese, statusin personal (martesa, aktet kontraktuese, trashëgimia), ligjet e luftës, manifestimi i simboleve islame në ditët e festive (Xhumaja dhe Bajrami), të gjithë këto janë në interes të qëllimeve të tyre për të pasur një jetë sa më të mirë dhe më të lumtur.

Kjo nuk mund të arrihet pa Imamin (Kryetarin) e respektuar dhe të qytetarëve të dëgjueshëm, e kjo arrihet nëpërmjet ligjvënësit (Sharië) dhe për çdo vështirësi apo problem i drejtohen atij dhe i mbështeten atij në zgjedhjen e atyre problemeve.

Ngase ata vetë (shoqëria) për shkak të dëshirave të shumta të tyre, mendimeve të shumta dhe kundërshtimeve të shumta dhe për shkak të armiqësisë dhe konfrontimeve në mes vete, mund të shkojnë në shkatërrim të përgjithshëm, për këtë arsye udhëheqësia është e domosdoshme. Këtë e shohim vazhdimisht pasi kur (ndodh që) vdes udhëheqësi i ndonjë shoqërie, fillojnë ngatërresat, trazirat, tollovitë dhe mospajtimet e shumta, derisa të emërohet Imami (kryetari) i ri, sepse për shkak të trazirave të shumta, mospajtimeve të shumta secili angazhohet për të ruajtur kokën e vet, pasurinë e vet, me armë në dorë, e kjo shpie në mosrespektimin e fesë dhe shkatërrimin e të gjithëve. Për këtë është thënë: Feja është hapësira, udhëheqësi është ruajtësi i fesë. Feja dhe mbreti janë si dy binjak. Nuk ka më mirë se Imami (kryetari) që punon për interes të muslimanëve dhe qëllimet e tyre i ka prioritare. (kjo është fjalë e urtë popullore)³⁰

³⁰ “El-Imametu min Ebkarul Efkar fi Usuli Dijne. Nga autori Sejfud-din El-Amedin, i cili ka vdekur në vitin 631 h. Korrektoi Muhamed Ez_Zebedij. Botoi “Kitabul Arabij”, viti 1412 h.

NUK DËGJOHET NË MËKATE

NENI 45

Krijesa nuk dëgjohe për të bërë mëkat ndaj Krijuesit, po ashtu edhe Imami (Kryetari), në çfarëdo çështje e cila është në kundërshtim me Sheriatin.

Koment:

Të gjithë dijetarët janë pajtuar se Imami (Kryetari) dëgjohe në atë çka është e mirë, e dobishme dhe e drejtë, ndërsa nuk dëgjohe në çështjet të cilat janë në kundërshtim me ligjet e fesë. Dëgjueshmëria ndaj tyre është e kushtëzuar që mos të jetë në kundërshtim me urdhrat e All-llahut.

Imam Neveviu tregon se të gjithë ekspertët e jurisprudencës islame janë pajtuar (ixhmai) për këtë. Ai thotë: Dijetarët janë pajtuar unanimisht (ixhmai) në dëgjimin e Imamit (kryetarit) jo në mëkate, ndërsa e kanë ndaluar unanimisht për ta dëgjuar në mëkate³¹.

Po ashtu, edhe Kadi Ijad dhe të tjerët, kanë thënë po ashtu se të gjithë dijetarët unanimisht (ixhmai) janë pajtuar në këtë. Po shpjegojmë thënien e Muhammedit a.s. që thotë:

“Dëgjo dhe bindju (Imamit) në rrezik, vështirësinë tënde, apo në lehtësi, në atë që të pëlqen, apo nuk të pëlqen, në atë që të le mbresa (brenga).”

Pasi vështirësia, rreziku, e papëlqyera dhe ajo që le mbresa kanë të bëjnë në atë, që nuk pajtohes me mendimin e Imamit (kryetarit) dhe idetë e tij.

Shtetasi ndonjëherë nuk mund të arrijë pozitën të cilën e meriton, ose pengohet në detyrën për të cilën ka aftësi, kjo nuk mund të ndikojë që Kryetari (Imami) të mos dëgjohe, dhe të mos i bindet.

Për këtë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka marrë vendim të prerë dhe këtë në rastin e mirënjohur, të cilën e tregon Ali bin Ebi Talibi r.a.:

³¹ “Sahih Muslim bi sherh En-Neveviju”, vëll.XI, fq.222, botoi “Darul Fikri li Suneti”, viti 1403 h.

*“Muhamedi a.s. ka dërguar një ekip (togë) për një detyrë, ndërsa udhëheqës të tyre ka caktuar njërin prej ensarëve dhe i ka urdhëruar për ta dëgjuar dhe për t’iu bindur urdhrave të tij. Ata e kanë hidhëruar udhëheqësin, ndërsa ai u ka thënë: tuboni dru, ata kanë tubuar, pastaj u ka thënë: ndizini drutë, ata i kanë ndezur dhe është formuar flakë e madhe, pastaj u ka thënë: A nuk ju ka thënë i Dërguari s.a.v.s. që të më dëgjoni dhe të më bindeni? Ata i thanë: Gjithsesi po. Ai u tha: Hyni në zjarr! Ata shikuan njëri tjetrin dhe thanë: Ne prej zjarrit (xhehennemit) kemi ikur te i dërguari i Allahut dhe nuk e dëgjuan. Ai u qetësua nga mllefi dhe e fiku zjarrin. Kur janë kthyer te Muhammedi a.s. i kanë treguar për këtë ndodhi, ndërsa Muhammedi a.s. ka thënë: **“Po të hynin në zjarr nuk do të dilnin, pasi bindshmëria është në çështje të lejuara dhe logjike (jo në çështje të ndaluara dhe të palogjikshme)”**.*

Nga një transmetim tjetër, rasti ka qenë kështu: Disa kanë dashur të hyjnë në zjarr, ndërsa të tjerët kanë thënë: po ne prej zjarrit kemi ikur.

Kur ia kanë përmendur këtë ngjarje Muhammedit a.s. ai u ka thënë atyre që kishin dashur të hyjnë në zjarr: **“Sikur të kishit hyrë në zjarr, do të ishit aty deri në Ditën e Kijametit”**. Ndërsa të tjerëve u ka thënë: **“Nuk duhet të bindesh (ndaj udhëheqësit) në mëkat ndaj All-llahut, por të bindesh në çështjet e logjikshme dhe të lejuara”**.

Largimi, ndarja, veçimi nga udhëheqësi dhe ngritja e armës kundër tij, sjell shkatërrim në shoqëri, ndërsa shkatërrimi sjell urrejtje të vazhdueshme, kështu që shoqërinë e ndanë në grupacione dhe parti. Për këtë arsye është thënë: *Është më mirë të jetë udhëheqësi i keq, sesa të ketë shpartallim të përgjithshëm.*

Historia dhe praktika ka vërtetuar se ngritja e armëve kundër udhëheqësit e than të njomën, dhe e zhduk të thatën dhe shkatërron çdo gjë.

Mjetet paqësore dhe kushtetuese janë mjete për reformuesit, pasi kushtetuta jep të drejtë për lirinë e fjalës dhe të mendimit, lirinë e kërkimit të të drejtave. Shpata dhe kryengritja sjell shkatërrim, ndërsa urtësia dhe durimi janë çelësi i zgjidhjeve të problemeve. Për këtë ka këshilluar edhe Muhammedi a.s.:

“Kthejani dhe jepjani të drejtën secilit prej jush dhe luteni All-llahun për t’iu kthyer e drejta të cilën e meritoni”.

Ekzistojnë hadithe, të cilat tregojnë për mosbindje ndaj Imamëve (kryetarëve), nëse vërtetohet haptazi se ata kanë kaluar në pabesim. Muslimi transmeton nga Ibadete bin Samed se, Muhammedi a.s. na ka thirrur: Ne e kemi uruar dhe e kemi pranuar dhe kemi premtuar se do ta dëgjojmë dhe do t'i bindemi në atë çka na pëlqen, e çka nuk na pëlqen, në kohë të mira dhe në kohë të vështira, por nëse është edhe në dëmin individual (e në dobinë e përgjithshme) dhe nuk do ta kthejmë urdhrin. Muhammedi a.s. na ka thënë prapë: ***“Nëse shihni pabesim të qartë, ju keni argument te All-llahu (për mosbindje)”***.

Ka dallim të qartë në mes të mëkatit dhe pabesimit.

Mëkati mundet të jetë dëmtim individual, ku e keqja dhe nënçmimi shkon drejtpërsëdrejti në veten e tij, por mund të dëmtojë edhe të drejtat e qytetarëve, por ka shpresë për t'u përmirësuar ose mundet për t'u tejkaluar, ndërsa sa i përket pabesimit, ai del prej të gjitha normave të karakterit të ummetit, çka nuk mund të pranohet kurrsesi, sepse ai e ka poshtëruar ummetin dhe e ka nënçmuar atë, i ka poshtëruar vlerat më të larta dhe më të shenjta të tij.

Pasi që udhëheqësia (Imami-Kryetari) e ka për detyrë për ta ruajtur fenë dhe për ta udhëhequr politikën e kësaj bote, si mund ta kryejë këtë detyrë pabesimtari, si mund ta mbrojë heretiku i fesë, si mund ta sigurojë atë idhujtari, si mund ta mbrojë ai i cili nuk ka fe dhe nuk e pranon shenjtërinë e saj?

MËNYRA E EMËRIMIT TË IMAMIT

NENI 46

Mënyra e emërimit të Imamit (kryetarit) dhe zgjedhjes së tij sqarohet me ligj. Emërimi bëhet nën përkujdesjen e gjyqit dhe emërohet pas votimit të shumicës së votuesve.

Koment:

Mënyra e emërimit (votimit) të Imamit (kryetarit) është prej çështjeve të ixhtihadit, gjë që do të thotë se nuk është e përcaktuar saktësisht, për të qenë ajo një mënyrë obliguese.

Nga sahabët r.a. kemi disa mënyra të emërimit (votimit). Muhammedi a.s., kur ka ndërruar jetë, ka lënë opsionin konsultativ për shumë çështje në mesin e muslimanëve.

Nuk ka argument të prerë rreth obligimit të përcaktimit të Imamit (kryetarit) të muslimanëve. Ndërsa, disa argumente, të cilat tregojnë se disa sahabë janë më të vlefshëm se tjerët, nuk do të thotë se është e domosdoshme që ata të jenë Imam (kryetar) të muslimanëve. Udhëheqësi apo prijësi, në çdo vend dhe në çdo kohë, asnjëherë nuk është as më i dituri, as më i mençuri dhe as më i devotshmi ndaj All-llahut të Lartmadhëruar. Kjo është çështje normale, pasi ka dallime të llojllojshme të njerëzve, por edhe (sepse) pas peygamberëve nuk ka njerëz të pagabueshëm.

Ensarët janë tubuar në Sahife për të zgjedhur Imamin (kryetarin) prej mesit të tyre, për muslimanët. Aty janë propozuar Ebu Bekri, Umeri dhe Ebu Ubejdete r.a. Aty janë bërë diskutime të nxehta për sa i përket zgjedhjes së Imamit (kryetarit): ose vetëm prej ensarëve, ose vetëm prej muhaxhirëve, ose të zgjedhin dy imamë (kryetarë) prej të dy palëve. Tubimi ka përfunduar me emërimin e Ebu Bekrit Halif (kryetar) të muslimanëve.

Imam Ahmediju thotë:

Të gjitha kushtet e parapara për kryetar (imam) kanë qenë në favor të tij: Ai ka qenë mashkull, i lirë, kurejshit, me familje të dëshmuar, i moshës madhore, i mençur, musliman, i drejtë, i besueshëm, ndihmëtar dhe mbrojtës i islamit, përmbajtës i ligjeve, dëshmues i shehadetit, mbrojtës i çështjeve të fesë, nuk ka bërë mëkate të mëdha, po ashtu nuk i ka përsëritur shumë gabimet e vogla. Të gjitha këto janë cilësi të muslimanit të drejtë dhe të besueshëm.

Ka qenë prej të zgjedhurve “ehlil hal vel akd” dhe muxhtehid, rreth çështjeve të ixhtihadit dhe çështjeve të tjera. Ka pasur mendime të drejta dhe ide të mira në zgjidhjen e çështjeve të Sheriatit, të cilat janë të njohura si në çështje të trashëgimisë ashtu edhe në çështje të tjera. Ia shtojmë edhe atë se ai ka pasur njohuri për gjendjen e arabëve të mëhershëm dhe mendimet e tyre. Ka pasur njohuri në çështje të politikës, ka qenë mendjemprehtë dhe orator, ka qenë strateg ushtarak, organizues i ushtrisë, diplomat, gjatë udhëheqjes së tij nuk dihet të ketë bërë ndonjë lëshim apo gabim, ka qenë trim, i fuqishëm, i vendosur, i durueshëm, sidomos në çastet më të vështira me Muhammedin a.s., kur është strehuar në shpellë prej ndjekjes së idhujtarëve. Gjatë qëndrimit në shpellë e ka mbyllur vrimën e gjarprit me thembrën e këmbës së tij, dhe pasi që e ka kafshuar gjarpri nuk ka lëshuar asnjë ofshamë, vetëm e vetëm për të mos e zgjuar Muhammedin a.s., derisa ai ishte duke fjetur. Është i njohur edhe veprimi me heretikët, kur ai ka thënë se: do t’i luftoj ata, nëse është në pyetje edhe vetëm me dy vajzat e mia. Ka marrë pjesë në të gjitha betejat me Muhammedin a.s. Në çdo rast ai ka qenë i pari dhe i ka ndihmuar më së shumti fesë dhe muslimanëve, ka qenë i dëgjueshëm, ekzekutues i urdhrave dhe vizionar. Kur ka ndërruar jetë Muhammedi a.s. sahabët shpresën e kanë pasur te Ebu Bekri, po ashtu edhe kur kanë vendosur për mënyrën dhe vendin e varrimit të tij, por edhe për çështjet e tjera e kanë pyetur dhe kanë pasur mbështetje të fortë te ai për çdo problem³².

Kjo ka qenë forma apo mënyra e parë e angazhimit të sahabëve në zgjedhjen apo emërimin e kryetarit (halifes).

Pastaj vjen forma e dytë, apo mënyra e dytë, pas vdekjes së Ebu Bekër Es-Sidikut. Sahabët janë konsultuar, janë angazhuar dhe pas ixhtihadit kanë marrë vendim të emërohet Umer bin Hatabi r.a. dhe emërimin e kanë bërë prej minberit të xhamisë, duke e lexuar letrën e Ebu Bekër Es-Sidikut:

³² “El-Imametu min Ebkarul Efkar fi usuli dijnë”, fq.243

BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

“Ky është vendim, të cilin e ka marrë Ebu Bekër bin Ebi Kuhafe, në frymën e fundit të kësaj bote dhe të parën e botës tjetër, të cilin duhet ta pranojë edhe çdo kriminel e çdo pabesimtar: Unë e emëroj Halif (Kryetar) Umer bin Hatabin. Nëse ka biografi të mirë ky është mendimi im, unë dëshiroj çdo gjë të mirë, nëse është ndryshe atëherë ata që bëjnë mizori do ta kuptojnë se në çfarë drejtimi janë duke shkuar”³³.

Për këtë letër është regjistruar edhe teksti me variant tjetër:

BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

“Ky është propozimi (vendimi) i Ebu Bekër Es-Sidikut, zëvendësit të Muhammedit a.s. të dërguarit të All-llahut, i fundit në këtë botë dhe i pari pas shkuarjes në botën tjetër, të cilin duhet ta besojë çdo kriminel e çdo pabesimtar. Unë e emëroj Umer bin Hatabin. Nëse është i mirë dhe i drejtë, ky është mendimi im, nëse është mizor dhe kriminel unë të fshehtëm nuk e di. Unë kam dëshiruar çka është më së miri, çdo njeri shpërblehet për punën e tij dhe ata që bëjnë mizori do ta kuptojnë se në çfarë drejtimi janë duke shkuar”.

Ekziston edhe forma e tretë apo mënyra e tretë e emërimit të Uthman bin Afanit r.a. Kur është therë Umer bin Hatabi nga mexhusiu Ebi Lului, ka propozuar për kryetar (halif) 6 sahabë: por ka refuzuar që në mesin e tyre të jetë djali i tij, dhe po ashtu ka thënë fjalën e njohur: Prej familjes së Hatabit (mjafton) është propozuar një për kryetar (halif) të ummetit Muhammed s.a.v.s.

Gjashtë të propozuarit kanë qenë:

Ali Ibn Ebu Talibi, Uthman bin Afani, Sead bin Ebi Vekasi, Abdurrahman bin Aufi, Zubejn bin El-Avami dhe Talhatu bin Abdullah.

Me këta të gjashtë, Muhammedi a.s., ka qenë gjithmonë i kënaqur, derisa ka ndërruar jetë – ka thënë Umer bin Hatabi.

Pastaj i ka thënë Suhejbit: Tri ditë bëhu Imam në Xhami dhe fale namazin me xhemat. Nëse në Xhami hyn ndonjëri: ose Uthmani, ose Zubejri, ose Seadi, ose Abdurrahman bin Aufi, ose Talha jepi përparësi atyre për të dalë Imam (sepse asnjëri prej tyre nuk ka qenë prezent). Nëse hyn Abdullah bin Umejri (djali im) ai nuk ka çka të kërkojë, ti bëhu Imam.

³³ “Raxhin Rivajat fi Esedil Gajat”, nga Ibni Ethiri dhe Tarihu Taberiju dhe po ashtu Imametü ve Sijasetu nga Ibni Kutejbetu.

Nëse pesë (5) pajtohen, njeri refuzon, atëherë refuzuesin dënojeni me vdekje.

Nëse (4) pajtohen dy refuzojnë, ata të dy dënojeni me vdekje.

Nëse tre pajtohen për njërin, ndërsa tre të tjerë për tjetrin atëherë vjen në ndihmë votimi i Abdullah bin Umerit, dhe cili prej atij grupi fiton, ai e emëron Halifin (kryetarin).

Nëse nuk pajtohen me votimin (vendimin) e Abdullah bin Umerit, atëherë bëhuni në anën e Abdurrahman bin Aufit dhe nëse pajtohet populli dhe ata nuk pajtohen kurrsesi, atëherë ekzekutojini ata që nuk lejojnë që të formohet kurrsesi pushteti.

Kështu Umeri r.a. ka qenë rigoroz në mendim, i mençur dhe i ka ditur pasojat e mosekzistimit të kryetarit në shoqëri dhe e ka ditur se karrierizmi sjell ngatërresa, ndarje dhe shkatërrime dhe nuk ka dashur që në asnjë moment të ndodhë një gjë e tillë.

Pasi, Umeri r.a., ra dëshmor porosia e tij u krye me përpikëri. Janë tubuar të kandiduarit dhe e kanë zgjedhur Uthmanin r.a. Ka ndodhur ngatërresë e madhe, është vrarë halifi (kryetari) dhe është ndarë dhe përçarë ummeti (shoqëria familjare muslimane).

Nga kjo rezulton se cilado mënyrë e zgjedhjes dhe emërimit të halifit (kryetarit) është e pranuar, nëse pajtohet shoqëria islame. Pasi me sheriat lejohet apo pranohet mendimi i shumicës absolute, nëse kandidati për halif (kryetar) i plotëson kushtet e parapara me Sheriat, pa marrë parasysh nëse zgjedhja e kryetarit bëhet me referendum, apo me vendimin e Kuvendit, apo me votimin e parlamentit, apo me votimin e kuvendit dhe parlamentit, dhe pa marrë parasysh a e fiton kandidati shumicën absolute 2/3, apo shumicën e votave të votuesve.

Ajo çka është e kërkuar me Sheriat është uniteti i shoqërisë dhe siguria e tyre. Islami nuk i refuzon rregullat të cilat i parashohin të mençurit dhe të urtit e shoqërisë.

KUSHTET E IMAMIT (KRYETARIT)

NENI 47

Kandidati i propozuar për kryetar shteti duhet t'i plotësojë këto kushte: të jetë musliman; mashkull; i moshës madhore; i mençur; i shëndoshë, pa të meta; dhe i specializuar (i ditur) në ligjet e Sheriatit Islam.

Koment:

Emiri i besimtarëve ose halifi i muslimanëve ose Imami i përgjithshëm, ose kryetari i shtetit duhet të plotësojë një sërë kushtesh, për të qenë i aftë për të organizuar çështjet shtetërore, organizimin e mbajtjes së rendit dhe për të siguruar zhvillimin dhe progresivitetin e shoqërisë.

Kushtet ndahen në:

- Kushte në të cilat janë pajtuar të gjithë dijetarët dhe
- Kushtet në të cilat nuk janë pajtuar të gjithë dijetarët.

Në këtë nen janë përfshirë vetëm kushtet për të cilat janë pajtuar dijetarët dhe ekspertët e Fikhut islam, e ato janë:

E para: Islami

Shoqëria islame ka specifikat e veta për të vendosur në tokën e All-llahut, të bazuar në Kur'an dhe sunnet. Për këtë arsye nuk është e logjikshme që udhëheqësi apo kryetari të jetë jomusliman, pasi ai nuk do të ishte besnik ndaj rregullave të fesë dhe ndaj bazave të Sheriatit.

Shoqëritë muslimane janë sprovuar pas kolonializmit bashkëkohor, ku në vendet e kolonializuara të vendeve islame (si kryetar) janë emëruar priftërinj, si prifti Sengur është emëruar kryetar në Senegal dhe Julios Nijriu në Tanzani.

E dyta: Të jetë mashkull. Natyrshmëria dhe pozita e Imamit (kryetarit) është që të ballafaqohet drejtpërdrejtë me çështjet e shtetit, ndërsa kjo është vështirë për femrën, si p.sh. komandimi ushtarak në përgatitjen e çështjeve të luftës, ku nevoja e kërkon të jesh e vetmuar me të huajin, udhëtimi zyrtar në shoqëri me të huajt, pastaj natyrshmëria e grave është se atyre u vijnë menstruacionet, lehonja, gjendje në të cilat femra nuk mund të qëndrojnë në tubime dhe mbledhje.

Ata të cilët argumentojnë për barazinë e mashkullit dhe femrës, duke sjellë shembuj se në disa vende femra ka udhëhequr shtetin, ata e teprojnë sepse rastet e rralla nuk llogariten si rregull. Ata sprovojnë karakterin dhe i shkelin parimet e saj të rëndësishme, si shenjtërinë e saj në fenë islame, të cilën jomuslimanët nuk e njohin.

E treta: Mosha madhore.

Derisa fëmija nuk mund të ketë të drejtë për çështjet e vetes së tij dhe nevojitet për të pasur prindin apo kujdestarin për kontratat e rëndomta dhe prindi kujdeset për edukimin e tij, atëherë si mund të bëhet fëmija udhëheqës i tërë shoqërisë islame (ummetit), komandant i ushtrisë?!

Duke u nisur nga kjo, trashëgimia e fronit të fëmijës së mbretit nuk ka asgjë të përbashkët me Islamin.

E katërta: Mençuria

Mendja e shëndoshë është domosdoshmëri për udhëheqjen e ummetit (shoqërisë islame). Derisa mendjelehti nuk ka të drejtë të kujdeset për familjen e tij dhe derisa mendimi i tij nuk merret për bazë për çështje të thjeshta, ashtu nuk mund të merret për bazë për udhëheqjen e ummetit (shoqërisë islame).

Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَا تُؤْتُوا السُّفَهَاءَ أَمْوَالَكُمُ الَّتِي جَعَلَ اللَّهُ لَكُمْ قِيَامًا وَارْزُقُوهُمْ فِيهَا
وَاكْسُوهُمْ وَقُولُوا لَهُمْ قَوْلًا مَعْرُوفًا

“Mendjelehtëve (të papjekurve) mos u jepni pasurinë tuaj që All-llahu e bëri për ju mëkëmbje, por ata ushqejini nga ajo, vishini dhe thuajuni fjalë të mira”.

(En-Nisa, 5)

E pesta: Vendosmëria, sinjeriteti, karakteri janë prej veçorive të Kryetarit të drejtë (Imamit).

Të pamoralshmit janë shkatërrimtarë të tokës, ndërsa Zoti nuk iu ndihmon shkatërrimtarëve. Përpos kësaj Imami apo Kryetari është shëmbëlltyrë për të tjerët, dhe derisa është i pamoralshëm ai e humbet besimin te të tjerët dhe interesi kombëtar luhetet dhe e merr era.

Në hadithin sahih, Ebi Jeali Muakil bin Jesari r.a., transmeton se e ka dëgjuar Muhammedin a.s. duke thënë:

“Çdo udhëheqës, i cili e udhëheq një popull dhe e tradhton popullin e tij, Zoti atij ia ndalon të hyjë në xhennet.”

E gjashta: Të ketë njohuri për ligjet e Sheriatit.

Udhëheqja e ummetit (shoqërisë islame) ka nevojë për vizion në çështjet e fesë dhe njohjen e ligjeve të All-llahut dhe ixhtihadin për çështjet në të cilat ka dobi shoqëria në sferat e lejuara me Sheriat.

Ata, të cilët nuk e njohin fenë, nuk mund t'i bëjnë dobi vetes së tyre, e si mund ta udhëheqin Ummetin (shoqërinë islame) dhe ta gjykojnë popullin!?

Është normale, çdo kushtetutë e çdo populli duhet të ketë të specializuarit, të cilët e ruajnë dhe e praktikojnë. Kushtetuta e muslimanëve është Kur'ani dhe sunneti dhe është obligim apo urdhër i prerë që Kryetari (Imami) të ketë njohuri për ligjet e Sheriatit.

Këto janë kushtet për të cilat janë pajtuar dijetarët, dhe secili kandidat i propozuar për kryetar shteti duhet t'i plotësojë, ndërsa “ehlil hal vel akd”, komisioni i veçantë duhet të jetë ai i cili, para se të zgjidhet kryetari, duhet t'i shqyrtojë a i plotëson këto kushte.

Përsa i përket kushteve për të cilat nuk janë pajtuar të gjithë juristët islamë janë:

- Të jetë kurejshit
- Të jetë i pagabueshëm

Ne mendojmë, sikurse mendon shumica e dijetarëve, se nuk është kusht i domosdoshëm që kryetari (imami) të jetë kurejsh. Këtë e tregojnë qartë tekstet fetare, të cilat shpjegojnë për çështjen e Imamit, se këtë amanet mund ta kryejë çdokush, me emrin e All-llahut.

Në Sahihun e Muslimit, Umi Husejn ka thënë: E kam kryer haxhin së bashku me Muhammedin a.s. në haxhin e lamtumurës. Muhammedi a.s. ka mbajtur një fjalim ku, në mes tjerash, ka thënë:

“Nëse ju udhëheq robi i zi i Mexhdid-it dhe vepron me librin e All-llahut dëgjojeni dhe bindjuni.”

Në fe nuk lejohet fanatizmi dhe në sheriatin islam është i papranuar. Kur ka zbritur ajeti kur'anor: **“Thirr (në fe) dhe tërhiqja vërejtjen familjes dhe të afërmeve”.** (Esh-Shuaraë, 214)

Muhammedi a.s. i ka thirrur kurejshitët, i ka tubuar dhe e ka emëruar secilin veç e veç:

- “O bijtë e Keab bin Luit, shpëtojeni veten tuaj nga zjarri.***
- O bijtë e Murreh bin Keabit, shpëtojeni veten tuaj nga zjarri.***
- O bijtë e Abdu Shemsit, shpëtojeni veten tuaj nga zjarri.***
- O bijtë e Abdu Menafit, shpëtojeni veten tuaj nga zjarri.***
- O bijtë e Hashimit, shpëtojeni veten tuaj nga zjarri.***

***O bijtë e Abdul Mutalibit, shpëtojeni veten tuaj nga zjarri.
Oj Fatime, shpëtoje veten tënde nga zjarri se unë nga All-
llahu nuk kam asgjë, vetëm se jam i mëshirshëm ndaj jush”.***

Dashuria ndaj familjes së Muhammedit a.s. është vetëm respekt, nder dhe simpati, por nuk është adhurim, ne dërgojmë salavate për ta, lutemi për ta dhe nuk i marrim për zota përpos All-llahut. Udhëheqja e popullit nuk varet nga gjaku, lloji apo ngjyra.

Porosia e fundit e Muhammedit a.s. ka qenë: *Shpëtojeni Usamen*, ndërsa Usamja nuk ka qenë kurejshit, por vetëm një djalosh i cili e ka dashur All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe ka pasur aftësi për udhëheqjen dhe komandimin e ushtrisë, ndërkohë që nën komandën e tij ka pasur kurejsh, muhaxhirë dhe ensarë. Ai ka qenë saktësisht Usamete bin Zejd bin Harithi, rob i Muhammedit a.s.

Disa dijetarë mendojnë se Imami (kryetari) duhet të jetë kurejsh, duke u bazuar në dy pika:

E para: Se çështja e Imamit (kryetarit) është çështje me rëndësi dhe duhet të pranohet dhe respektohet nga të gjithë njerëzit. Kjo është më e sigurt për ruajtjen e reputacionit të shtetit, ndërsa hadithet për këtë janë më shumë këshilluese se sa obliguese.

E dyta: Çështja e Imamit (kryetarit) është çështje e diturisë për fenë islame dhe kurejshitët janë më prioritarë për t'i ditur vendimet e All-llahut dhe fikhun (e jurisprudencës) e sheriatit islam.

Çështja e pagabueshmërisë është e papranuar, sepse pas pejgamberëve nuk ka (njeri) të pagabueshëm. Nuk mund të ketë kryetar (imam) të pagabuar, por duhet të jetë kryetar (imam) muxhtehid aktiv, i ditur, i cili diskuton dhe konsultohet me të urtit dhe të mençurit dhe i cili merr vendim të shëndoshë në kohën e duhur.

Nuk do të thotë që udhëheqësi të jetë patjetër më i dituri, më i urti dhe më i afërti te All-llahu, por çështja është që të zgjidhet i afti, që ka mundësi ta kryejë amanetin dhe i cili korr suksese dhe nuk dështon.

Ebu Bekër Es-Sidiku, pasi është emëruar Halif (kryetar) ka thënë: Edhe pse jam emëruar, unë nuk jam më i miri, më dëgjoni në çështjet të cilat janë në përputhshmëri me ligjet e All-llahut.

PJESËMARRJA GJITHËPOPULLORE (E UMMETIT) NË ZGJEDHJEN E KRYETARIT (IMAMIT)

NENI 48

Emërimi i Imamit (kryetarit) bëhet me votim gjithëpopullor nga të gjitha shtresat e ummetit, sipas rregullores.

Edhe femra ka të drejtë pjesëmarrjeje në votim, nëse i plotëson kushtet.

Koment:

Ky nen përbëhet prej dy pjesëve:

- Zgjedhja e Imamit (kryetarit) bëhet me votim gjithëpopullor ku marrin pjesë të gjitha shtresat e ummetit.
- Femra ka të drejtë të kërkojë të marrë pjesë në zgjedhje, nëse i plotëson kushtet.

Ne mendojmë se pjesa e parë e nenit duhet të hiqet dhe të thuhet kështu:

Ligji e sqaron mënyrën e votimit në zgjedhjen e Imamit (kryetarit) në mbikëqyrjen e organit juridik. Emërimi bëhet me shumicën e kërkuar nga numri i votuesve.

Sa i përket pjesës së dytë, për pjesëmarrjen e femrës në zgjedhje, komisioni për vendosjene kushtetutës mendon se projektuesit e kushtetutës vendosin për këtë çështje pas një analize të thellë.

Pasi ky projekt nuk është shqyrtuar në Institutin për Hulumtime Islame ne mendojmë se femra ka të drejtë të kandidohet dhe të marrë pjesë në zgjedhje dhe kjo në bazë të rregullave islame, mirëpo kur themi “*nëse i plotëson kushtet*” kemi për qëllim që kandidati t’i plotësojë kushtet pa marrë parasysh a është femër apo mashkull.

Kur’ani famëlartë ka regjistruar shumë raste kur femra ka pasur mendime të përkryera, ka pas mendime të drejta, (ka raste) ku dhe Muhammedi a.s. është pajtuar apo e ka marrë mendim të drejtë të femrës, të cilat janë të njohura në historinë islame.

“DHIHARI” në jurisprudencën islame është i ndërlidhur me rastin kur femra është ankuar te Muhammedi a.s. dhe ka zbritur Kur’ani dhe e ka përkrahur atë.

Zoti i Madhëruar thotë:

قَدْ سَمِعَ اللَّهُ قَوْلَ الَّتِي تُجَادِلُكَ فِي زَوْجِهَا وَتَشْتَكِي إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ يَسْمَعُ
تَحَاوَرَكُمَا إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ بَصِيرٌ

“Vërtet, All-llahu dëgjoi fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te All-llahu; prandaj All-llahu e dëgjon bisedën tuaj, All-llahu e dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë”.

(El-Muxhadele, 1)

Gjatë marrëveshjes së “HUDEJBIJES” Umi Selemete ka dhënë mendim, të cilin e ka pranuar Muhammedi a.s., kështu që ai mendim i ka shpëtuar edhe sahabët që të mos vepronin në kundërshtim me Sheriatin.

Pasi e ka nënshkruar, i dërguari i All-llahut s.a.v.s. u ka thënë sahabëve: **“Ngrihuni, prejini kurbanët, dhe rruani kokat tuaja.”** Pra, i ka urdhëruar që me këto dy veprime ta përfundojnë “Umren” për të cilën ishin nisur për të shkuar në Mekke.

Transmetuesi tregon: Për Zotin, nuk është ngritur asnjëri prej vendit, derisa u ka thënë tri herë dhe prapë kur e ka pa se asnjëri nuk ka lëvizur prej vendit, ka hyrë te Umi Seleme dhe i ka treguar se nuk e ka dëgjuar asnjëri.

Umi Seleme i ka thënë Muhammedit a.s.: O i Dërguari i All-llahut, a dëshiron që të të dëgjojnë. Dil ti i pari, mos i fol askujt asnjë fjalë, shko dhe preje devenë tënde kurban dhe rruaje kokën.

Muhamedi a.s. ka dalë, nuk i ka folur askujt deri sa ka vepruar ashtu. E ka prerë devenë kurban dhe është rruar. Kur e kanë parë të tjerët, janë ngritur, i kanë prerë kurbanet, dhe janë rruar.

Gjatë tërë historisë islame femra ka qenë aktive në institucione shkencore, në shkencën e fikhut, ka pasur mendime politike dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore.

KRITIKA NDAJ TË KANDIDUARVE PËR IMAM (KRYETAR)

NENI 49

Nuk është gabim për të dhënë mendim kundër të kandiduarit për Imam (kryetar) para se të votohet.

Koment:

Është e sigurt se zgjedhja e Imamit (kryetarit) duhet të kalojë nëpër disa faza të cilat i hulumton komisioni zgjedhor (EHLUL AKD VEL HAL), për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për të qenë Imam (kryetar) dhe e meritojnë për t'u kujdesur për ummetin. Gjatë hulumtimit, të kandiduarit duhet t'i nënshtrohen rregullit të kritikës, pra të shikohen anët pozitive dhe negative.

Kjo tolerohet në zgjedhje dhe kritikuesi nuk dënohet, nëse ka qëllim të mirë, për t'u zgjedhur më i merituari, ai i cili e meriton dhe është në kënaqësinë e All-llahut të Lartmadhëruar. Dijetarët kanë përmendur edhe çështjet kur është e lejuar përfolja apo përgojimi (gibeti). Imami Neveviu përmend shtatë shkaqe:

E para: Përfolja për të padrejtin apo zullumqarin. Lejohet për padrejtësinë e mbretit, gjykatësit, apo funksionarit për të thënë se më ka bërë padrejtësi në këtë çështje, apo në atë çështje.

E dyta: Lejohet përgojimi për largimin e kriminelit nga krimi, p.sh. për të thënë filani është duke vepruar kështu dhe largoje nga ajo udhë e keqe, pra qëllimi është për ta larguar atë nga e keqja, nëse nuk është ai qëllimi, përgojimi është i ndaluar.

E treta: Për të kërkuar fetva: p.sh. për t'i thënë Muftisë: Babai im, ose vëllai im, ose burri im, më ka bërë këtë padrejtësi, a lejohet që të veprojmë në këtë, apo në atë mënyrë, apo cila është rruga për ta kthyer të drejtën time, apo për ta penguar që të mos më bëhet padrejtësi. Pra kjo lejohet pse e kërkon nevoja. Mirëpo, më së miri, është me thënë: çka mendon për njeriun, apo personin, apo për burrin, nëse vepron kështu, pra për t'ia arritur qëllimit pa e treguar personin, mirëpo përkundër kësaj, është e lejuar edhe të tregohet personi (për ta përgojuar) siç tregohet me rastin e Hindit, e cila i tregon të dërguarit të All-llahut s.a.v.s.: Vërtet Ebu Sufjani, burri im, është njeri koprrac

dhe nuk më jep çka më nevojitet mua dhe fëmijëve të mi, vetëm se unë i marr atij pa e pyetur dhe pa e ditur ai. Muhammedi a.s. i ka thënë:

“Merr çka të nevojitet ty dhe aq sa është më së miri”.

(Buhari dhe Muslimi)

E katërta: të këshilluarit e muslimanëve dhe të bërit vërejtje atyre për të mos vepruar keq.

Kjo bëhet në dy mënyra:

Mënyra e parë: Duke shpjeguar dobësitë dhe të metat e transmetuesve të haditheve, po ashtu duke treguar dobësitë dhe të metat e trashëgimtarit. Kjo është e lejuar me mendimin unanimit të dijetarëve (ixhma) muslimanë, bile është obligim nëse e kërkon nevoja.

Mënyra e dytë: Për të marrë informata nga familjarët, shokët, bashkëpunëtorët e tij etj. etj. Pas informatave nuk lejohet të fshehet asgjë, por të tregohet realiteti i tij saktësisht.

Me hadithin Sahih, Fatime bint Kajs r.a., ka thënë: E kanë kërkuar dorën time për fejesë edhe Eba Xhehmi, edhe Muavijju. Muhammedi a.s. i ka thënë:

“Sa i përket Muavijës ai është njeri i cili nuk ka pasuri, ndërsa Ebu Xhehmi është i vështirë nuk e heq shkopin prej dorës.”

(Muslimi)

Pra Ebu Xhehmi është rrahës (keqtrajtues) i grave, ky është komentimi i fjalës “nuk e heq shkopin prej dorës”.

Nëse eksperti jurist mendon për tjetrin (udhëheqësin) se është kriminel apo bid’atxhi (rasisjellës) merr dituri prej tij, mirëpo frikësohet se dëmtohet, atëherë ai (eksperti) këshillon, mirëpo këshilla duhet të jetë e kujdesshme, sepse tjerët mendojnë se ajo këshillë apo vërejtje është për shkak të gjelozisë, kështu që shejtani ndërhyrë dhe bën ngatërresa dhe përçarje në mes tyre.

Nëse ka marrë një detyrë me përgjegjësi dhe nuk e kryen atë, e ai mund të jetë: ose i mirë, ose shkatërrimtar, ose injorant, (prandaj) nevojitet që ai të përgojohet dhe të përgjohet, ose të detyrohet që ta kryejë përgjegjësinë, ose të shkarkohet nga detyra e atë detyrë ta marrë ndokush tjetër.

E pesta: Nëse është i njohur për mëkatar, ose për bid’ate (risi) si p.sh. pin haptazi alkool, ose ua merr haptazi të tjerëve pasurinë në mënyrë të palejuar, ose kryen punë të pamoralshme, atëherë lejohet

për ta përfolur dhe për ta përgojuar për atë çka ka vepruar, por është e ndaluar të përmenden të metat e tjera të tij, vetëm nëse këtë e kërkon nevoja, sipas rasteve të Sheriatit të cilat i kemi përmendur më parë.

E gjashta: Përcaktimi apo identifikimi i personit. Nëse një njeri është i njohur në bazë të pseudonimit si p.sh. “Qorri”, “Shurdhi” “Memeci” etj. etj. lejohet që të përmenden apo të identifikohen në bazë të pseudonimeve, por është e ndaluar të përmenden si të meta apo mangësi të tij. Nëse ekziston ndonjë mënyrë tjetër e identifikimit, do të kishte qenë më mirë.

Çka do të thuhet gjatë fushatës zgjedhore, votimi apo emërimi bëhet me shumicën e votuesve.

Pas emërimit paraqiten dy probleme:

E para: Që pjesa opozitare të vazhdojë aktivitetin e vet kundër Imamit (kryetarit) për të shkaktuar ngatërresa, mospajtime dhe mosdëgjueshmëri ndaj Imamit (kryetarit)

E dyta: Që udhëheqësi të mos hakmerret për të kaluarën dhe të jetë armik i opozitës.

Këto dy probleme duhet të eliminohen në atë mënyrë që Imami (kryetari) i emëruar të dëgjohet, dhe opozita t’i nënshtrohet vendimeve të tij, pasi ai ka fituar shumicën e votave. Ndërsa Imami (kryetari) duhet të sillet korrekt, duhet të jetë i drejtë edhe ndaj të afërmeve edhe ndaj të largëve, dhe ndaj pozitës edhe ndaj opozitës, me një fjalë, të jetë i drejtë për të gjithë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰ
أَلَّا تَعْدِلُوا اعْدِلُوا هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke vepruar dhe dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kijeni droje All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni”.

(El Maide, 8)

SHKARKIMI I IMAMIT (KRYETARIT)

NENI 50

Ata të cilët kanë pasur të drejtën e emërimit (të votimit) kanë edhe të drejtën e shkarkimit, nëse ekzistojnë shkaqet dhe arsyet, dhe sipas mënyrës së rregullave të ligjit.

Koment:

Në kushtet e zakonshme dhe të paqes bëhet votimi, respektivisht, emërimi i Imamit (kryetarit) i personit adekuat, dhe nuk emërohet personi (kandidati) tjetër, pasi nuk ka fituar sipas rregullave kushtetuese, pa i bërë padrejtësi, pa e nënçmuar dhe pa e diskriminuar.

Personi i emëruar e pranon përgjegjësinë, duke iu mbështetur dhe duke kërkuar mbrojtje prej All-llahut, dhe kur të tërhiqet e lë përgjegjësinë për tjerët pas tij, pa pasur zili dhe pa pasur lajkatime dhe tradhti.

Ai (ata) i cili ka të drejtë emërimin e Imamit (kryetarit) ai (ata) ka të drejtë shkarkimin e tij, nëse ekzistojnë arsyet dhe faktet. Shkaqet e mosemërimit i kemi shpjeguar më herët, tek votimi i imamit (kryetarit) e ato janë: *Islami; të jetë mashkull; të jetë i moshës madhore; të jetë i mençur; të ketë aftësi profesionale; dhe ta njohë Sheriatin.*

Këto kushte, pra, kanë qenë te kandidimi, apo para emërimit, ndërkaq, lëshimi apo mangësia e ndonjë kushti të cilin e vërteton komisioni zgjedhor (Ehlul Hali vel Akdi), atëherë Komisioni Zgjedhor shikon a i mungon kushti prej të cilit shkarkohet menjëherë, apo i mungon kushti me të cilën mungesë mund ta vazhdojë detyrën. Shembull mund të marrim *pabesimin*. Nëse kalon në pabesim, nuk ka të drejtë ta vazhdojë detyrën, por patjetër duhet të shkarkohet. Populli (ummeti) bënë mëkat nëse nuk e shkarkon.

Përveç pabesimit, fisku (krimi), nuk mund të jetë shkak i domosdoshëm shkarkimi, por mund ta vazhdojë detyrën.

Kadiu Ebi Jeali el Hanbeliu thotë:

“Pa marrë parasysh krimin apo mëkatin që ka të bëjë me çështjet trupore, siç janë përdorimi i çështjeve të ndaluara; apo që ka të bëjë me çështjet e besimit, por të cilat janë të dyshimta, jo të sigurta”.

Ebu Jeali argumenton me faktin se Imami Ahmed bin Hanbeli e ka quajtur Mu'tesimin emir të besimtarëve, edhe pse e ka dhënë mendimin se Kur'ani është i krijuar.

Juristët (fukahatë) e Bagdatit kanë shkuar te Imam Ahmedi dhe i kanë thanë: Kjo çështje është e paskrupullt (mendimi për krijimin e Kur'anit në kohën e qeverisë së Vathikut) dhe ne nuk pajtohemi që ai të jetë udhëheqës dhe të na prijë.

Ai u ka thënë ruajuni nga emocionet e juaja, mos hiqni dorë nga bindshmëria ndaj Imamit (kryetarit), mos e ndani trupin e muslimanëve³⁴.

Nëse te Imami (kryetari) paraqitet diçka që e dobëson ummetin (bashkësinë familjare islame) dhe interesin gjithëpopullor, siç janë: verbëria, çmenduria, sëmundja e rëndë, atëherë shkarkohet nga detyra, me procedurë të rregulluar sipas ligjit.

Nëse ata të cilët kanë pasur të drejtë votimi dëshirojnë shkarkimin e Imamit (kryetarit), për çfarëdo shkaku tjetër, atëherë ummeti (bashkësia familjare islame) ka të drejtë referendumi dhe vendimi i tyre ekzekutohet.

Prej asaj dite, qeveritari e kupton amanetin dhe përgjegjësinë, dhe i frikësohet All-llahut e ruhet prej Tij, dhe veten e konsideron shërbyes të ummetit, dhe nuk krenohet kur të emërohet, dhe nuk brengoset kur të shkarkohet. Marrjen e postit e merr duke iu lutur All-llahut dhe duke kërkuar ndihmë prej Tij, ndërsa për shkarkimin nga posti e falënderon All-llahun, pasi e ka shpëtuar.

Mirëpo epshi, karrierizmi bën që disa të këmbëngulin për postin, t'i diskreditojnë ata që kërkojnë shkarkimin e tij, (të tillët) e çnderojnë veten e tyre, fenë e tyre, shkatërrojnë e dëmtojnë vetëm e vetëm për ta mbajtur karrigen.

³⁴ “El-Ahkam Sultaniye”, nga Ebi Jeali El-Ferai, korrektioi Muhamed Hamid El-Fekiju.

Në Sahihun e Buhariut, nga transmetimi i Ebu Hurejres r.a., Muhammedi a.s. ka thënë:

“Ju do të dëshironi postin dhe karriken, por nuk e dini se do të pendoheni për këtë në Ditën e Kijametit.”

Në Sahihun e Muslimit, nga Ebu Dherri r.a., transmetohet se ka thënë: *I kam thënë të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.: Më cakto një post! Muhammedi a.s. e vendosi dorën e tij mbi supet e mija dhe më tha: “O Ebu Dherr, ti je i dobët, nuk ke aftësi për pozitë, pasi pozita është amanet dhe përgjegjësi (në këtë botë), ndërsa në botën tjetër nënçmim dhe pendim, përveçse nëse ndonjëri e kryen me përgjegjësi, me sinqeritet dhe drejtësi”.*

Nëse ndonjëri bën puç ushtarak dhe uzurpon pozitën e kryetarit, ndërsa ummeti nuk mund ta shkarkojë dhe ta largojë nga pozita, nuk është mëkat për ta dëgjuar dhe për t’iu bindur në çështjet të cilat janë të lejuara sipas Sheriatit islam, si në mirësi. Kjo si shkak i përtypjes së dëmit më të vogël.

Kadiu Ebu Jeali e pranon marrjen e pushtetit me dhunë, edhe pse nuk është e lejuar, ndërsa Imam Ahmedi, nga rivajeti i Abdu bin Malik el Asarit, ka thënë:

Kush e merr pushtetin me tehun e shpatës (me dhunë) dhe bëhet Halif, dhe e shpall veten emir të besimtarëve, nuk lejohet për askënd i cili i beson All-llahut dhe Ditës së Kijametit ta konsiderojë Imam, pa marrë parasysh a është i mirë apo i keq.

Në rivajetin e Ebi Harithit, përsa i përket (çështjes se) a është i pranueshëm Imami nëse e kërkon sundimin, ndërsa populli ndahet në dysh, thuhet: Atëherë namazi i xhumasë është me grupin i cili fiton. Argument për këtë merr veprimin e Ibn Umerit, i cili është falur me banorët e Medinës në kohën e “HIRRES” dhe ka thënë: Ne jemi me ata që kanë fituar³⁵.

Vërtet, largimi i Imamit nga qëllimet e Sheriatit, ose shkarkimi i Imamit me kundërrevolucion, ummetit i sjell shkatërrim dhe shpie në shfarosje, zhduken të mirat dhe humbet qetësia, armiqtë krekosen dhe e sulmojnë shtetin për t’i pasur muslimanët nën kontroll dhe nën okupim. Tek ne ka ndodhi të vërteta, që intelektualit i vjen turp edhe t’i përmendë, sepse prezanton faqen e zezë të historisë bashkëkohore të ummetit islam.

³⁵ “El-Ahkam Sultaniye”, nga Ebi Jeali El-Ferai, korrektioi Muhamed Hamid El-Fekiju.

Në Afganistan populli ka luftuar kundër okupimit komunist, heronjtë janë ngritur kundër një superfuqie botërore - pra kundër Bashkimit Sovjetik dhe pas një periudhe ia kanë arritur t'i mposhtin dhe t'i largojnë atë kokulur dhe të nënçmuar, por brenda natës liderët e luftës filluan të grinden mes vete për pushtet, filluan grindjet klanore të injorancës, grindje të cilat shkatërruan shtëpi dhe dogjën tokën për përfitime individuale dhe për marrjen e pushtetit.

Njësoj ka ndodhur në Somali, pas largimit të pushtetit të Muhamed Sidarit, i cili ka vrarë dijetarë dhe e ka torturuar popullin tej mase, ndërsa udhëheqësit e grupeve (partive) nuk janë pajtuar mes vete, se cili lider do ta udhëheq shtetin dhe si pasojë e asaj çështje janë përçarë, dhe prapë kanë filluar të luftojnë mes vete, duke vrarë gra, duke lënë jetimë dhe duke varrosur të rinjtë. Një pjesë e madhe e popullatës vdiq urie, ndërsa pjesa tjetër mbeti pa kulm mbi kokë, pa veshmbathje e pa barna, ndërsa liderët vazhduan prapë me injorancën dhe me kokëfortësinë e tyre, me vrasje e gjakderdhje.

Umer Ibn Hatabi ka qenë i urtë, vizionar dhe i përpiktë, dallues i së mirës ndaj të keqes, kur ka urdhëruar që, nëse nuk bëhet pajtimi, të ekzekutohet kandidati i propozuar për hilafet, pasi po të lihet ashtu shpërthen lufta qytetare, fillojnë trazirat dhe lëkundet shteti. Hilafeti nuk është pjesë e trashëguar personale dhe ummeti mund të vazhdojë edhe pa ata karrieristë, sepse ka qenë para tyre, e do të jetë edhe pas tyre.

Nëse shikojmë Algjerinë, shteti i cili ka dhënë një milion dëshmorë për t'u çliruar nga kolonializmi francez, vërejmë se, në fund, udhëheqësit ushtarak dëshiruan ta mbajnë në gjendje lufte dhe nën udhëheqjen ushtarake, mirëpo si kompromis lejuan që të zgjidhen çështjet me zgjedhje të lira demokratike, kur papritmas partia islame arriti të fitojë shumicën e vendeve në Parlament, mirëpo karrieristët, pushtetarët dëshironin demokraci, e cila u shërbente interesave të tyre dhe që e forconte pozitën e tyre, ashtu siç kishte dëshiruar Naseri në Egjipt, që i kishte mjaftuar demokracia false dhe në zgjedhje fitonte 99.999% të votave!

Pasi fitoi partia islame, pushtetarët në Algjeri i shpallën zgjedhjet të pavlefshme, dhe prapë e shndërruan shtetin në vend të trazirave, dhe e detyruan forcën islame të kalonte në ilegalitet dhe në luftë të armatosur kundër partisë në pushtet, kështu që të dy palët

kanë dalë prej binarëve dhe qëllimeve të Sheriatit dhe nuk i kanë shërbyer Islamit.

Ja çka shkruan Historiani algjerian Muhamed Tahir Udvaniju në gazetën El Ahram, të datës 30-12-1994: ‘Sot, pas tri vitesh lufte Algjeria është e shkatërruar, e dobësuar ekonomikisht, e dobësuar moralisht por edhe në aspektin edukativo arsimor, sepse në luftë vritet posaçërisht një pjesë e madhe e intelektualëve.’

Kjo luftë nuk ka kurrfarë arsyetimi dhe as që ka fitore islame në zgjedhje, mirëpo nuk mund të arsyetohet që të vihet në pushtet me dhunë, vetëm pse është shpallur i pavlefshëm raundi i parë i zgjedhjeve të lira. Secilën arsye prej këtyre arsyetimeve nuk mund ta pranojë logjika, pasi për tejkalimin e ndonjë krize shtetërore nuk lejohet të ngrihen armët dhe të luftohet kundër vëllezërve dhe me vëllezërit.

Edhe pse zgjidhja e krizës politike mund të zgjasë shumë, prapë se prapë, është një mijë herë më mirë se sa lufta vëllavrasëse.

Pasi të gjithë e pamë se çfarë mund të ndodhë, sa mund të kushtojë, atëherë del se këto veprime kanë qenë të gabuara, nuk na mbetet asgjë tjetër, veçse t’i kthehemi së kaluarës dhe të shohim se sa ka kushtuar lufta, e cila zgjati tri vite:

- tre miliardë dollarë
- tridhjetëmijë të vrarë
- pesëmbëdhjetëmijë të plagosur
- pesëmbëdhjetëmijë të burgosur
- pesëmbëdhjetëmijë të ikur nga vdekja, pjesa ma e madhe e tyre profesorë të universiteteve.

Sot, në dritën e ditës, e kuptojmë se sa kanë gabuar ata, të cilët kanë menduar vazhdimisht se lufta do të marrë fund së shpejti.

Duhet të kuptojmë dhe të mësojmë mirë nga praktika e popujve të mëhershëm, se zgjidhja e problemit nuk arrihet as pas dhjetë viteve, por edhe lufta nuk munda ta rrëzonte qeverinë në pushtet, sepse aty është një përqindje e barabartë në mes të anës së forcës dhe anës së frikës. Përfundimi nuk është në fushë të betejës, por në tavolinën e bisedimeve.

ORGANI JURIDIK MBI IMAMIN (KRYETARIN)

NENI 51

Imami (kryetari) i nënshtrohet ligjit, dhe del para gjykatës me mbrojtësin e tij

Koment:

Gjyqi është zgjedhës i problemeve të qytetarëve të konfrontuar mes vete. Imami (kryetari) është person në dy forma:

- Ai është qytetar dhe si qytetar i ka raportet dhe marrëdhëniet shoqërore.
- Ai është udhëheqës dhe ka përgjegjësi për atë çka është emëruar.

Në të dyja rastet, ai nuk mundet të jetë edhe udhëheqës edhe palë, në të njëjtën kohë. Nëse është palë e gjyqit për një çështje dhe në anën tjetër pala tjetër, atëherë procedura është e njëjtë sikurse në mes të dy qytetarëve të rëndomtë. Ai del para gjyqit personalisht me mbrojtësin e tij, e mbron të drejtën e tij dhe i paraqet faktet mbrojtëse, dhe gjyqi ka fjalën përfundimtare. Pra, askush nuk është mbi gjyqin.

Muhammedi a.s. na ka mësuar se njerëzit janë të barabartë para gjyqit dhe ligji i All-llahut nuk bën dallim në mes të funksionarit (sheri) dhe të qytetarit (vedie), as në mes të pasurit dhe të varfrit dhe as në mes të ziut dhe të bardhit.

Buhariu ka regjistruar me senedin Sahih nga Urvete, se në kohën e Muhammedit a.s., një grua ka vjedhur dhe kjo saktësisht (ka ndodhur) në luftën e çlirimit. Populli i saj ka shkuar te Usame bin Zejdi r.a. për të ndërmjetësuar te Muhammedi a.s., për mos ta dënuar. Urvete thotë: *Kur ka kërkuar Usame bin Zejdi te Muhammedi a.s. Muhamedit a.s. i është ndryshuar fytyra në të kuqe dhe ka thënë:*

“Po më flet për vendimin e prerë, të cilin e ka vendosur All-llahu?”
Usame ka thënë: Pendohem te All-llahu për këtë, o i Dërguari i All-llahut.

Pasi është falur namazi i jacisë Muhammedi a.s. ka mbajtur një ligjëratë, (në fillim) ka falënderuar All-llahun dhe ka vazhduar:

“Vërtet, popujt janë shkatërruar për faktin se kur ka vjedhur i ndershmi (prej parisë ose funksionari) nuk e kanë ekzekutuar dënimin, ndërsa kur ka vjedhë i dobëti e kanë ekzekutuar dënimin menjëherë. Pasha Zotin, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhammedit a.s., sikur të kishte vjedhur Fatimja, bija e Muhammedit (a.s.), dënimi do të ekzekutohej dhe do t’i pritej dora.”

Pastaj Muhammedi a.s. ka urdhëruar të ekzekutohet dënimi për vjedhje i asaj gruaje. Pastaj ajo është penduar, dhe më vonë ka dashur Zoti dhe ajo është martuar.

Aishja r.a. ka thënë:

Ajo pastaj vinte te i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. dhe i tregonte për gjendjen e saj dhe se ishte e lumtur në jetë.

Muhammedi a.s. na ka mësuar se është e domosdoshme ekzekutimi i vendimeve dhe të kthyerit e të drejtës pronarëve të saj, dhe për të patur tolerancë njerëzore.

Është vërtetuar në një hadith Sahih, se Muhammedi a.s. kur kishte dhembje të lehtë të kokës, pak ditë para vdekjes ka hyrë në xhami, është ulur në minber, ka mbajtur një ligjëratë dhe në fund ka thënë:

“Cilit i kam mëshuar në shpinë, cilin e kam ofenduar jam i gatshëm të ofendohem në të njëjtën masë prej tij.”

Pastaj ka zbritur prej minberit, është falur dhe prapë ka hipur në minber dhe prapë ka kërkuar prej të pranishmëve se mos i kishte borxh ndokujt. Njëri prej të pranishmëve ka thënë: Mi ke borxh tre derhem, ndërsa Muhammedi a.s. ka thënë: ***“Jepjani borxhin.”***

TË DREJTAT E KRYETARIT TË BARABARTA ME TË DREJTAT E QYTETARIT

NENI 52

Kryetari i shtetit i ka të gjitha të drejtat që i ka qytetari dhe i realizon si i realizojnë të tjerët. Ai ka të drejtë në realizimin e të ardhurave ashtu siç e parasheh ligji.

Koment:

Kryetari i shtetit ka të drejtat e qytetarit në të gjitha sferat e jetës, ai blen, shet, martohet, shkurorëzohet, merr pjesë në gëzime, ka të drejtën e qarkullimit, të drejtën e shoqërimit, ai bën përjashtim vetëm në çështjet të cilat janë të domosdoshme për kryetarin, pra në detyrat dhe obligimet e kryetarit.

Muhammedi a.s. ka qenë i dërguar i All-llahut, por në të njëjtën kohë ka qenë njeri modest, i thjeshtë, ka qenë i lumtur, i hidhëruar, është martuar, ka bërë shaka por shakaja e tij ka qenë reale, i është bashkuar sahabëve në kuvendime, është përmalluar për ndonjërin kur ka munguar, ka vizituar të sëmurët, iu ka ndihmuar të tjerëve, dhe ka ecur i lirë në rrugë.

Kur'ani e ka refuzuar logjikën e pabesimtarëve të cilët kanë dëshiruar që i dërguari të jetë engjull, pra jashtë qenies njerëzore dhe thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَا قَبْلَكَ إِلَّا رَجَالًا نُوحِي إِلَيْهِمْ فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ .
وَمَا جَعَلْنَاهُمْ جَسَدًا لَا يَأْكُلُونَ الطَّعَامَ وَمَا كَانُوا خَالِدِينَ .

“Edhe para teje kemi dërguar vetëm njerëz (pejgamberë) të cilëve u kemi zbritur shpalljen, pra pyetni njerëzit e dijshtëm nëse ju nuk dini! Ne nuk i kemi bërë ata (pejgamberët) trupa që nuk hanë ushqim e as nuk ishin të përjetshëm (të pavdekshëm)”.

(El Enbija, 7-8)

Kur'ani shpesh e ka vërtetuar se i dërguari është vetëm rob, njeri të cilin e ka zgjedhur All-llahu dhe e ka frymëzuar, ashtu siç thotë Zoti i Madhëruar:

قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ يُوحَىٰ إِلَيَّ أَنَّمَا إِلَهُكُمُ إِلَهٌ وَاحِدٌ فَمَن كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ
فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا

“Thuaj (o Muhammed): Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm Zoti Një është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet le të bëjë vepër të mirë e në adhurimin në Zotin e Tij të mos e përziejë askë”.

(El Kehf, 110)

Ligji islam nuk njeh njeri të pagabuar, ose të shenjtë, ose sistem mbretëror të cilët pretendojnë se kanë të drejtë mbretërie, apo të drejtë sundimi prej Zotit (teokraci), ose të veçuar për qeverisje prej të tjerëve.

Duke u nisur nga ky rregull i kushtetutës islame, i cili i bën të barabartë qeveritarin dhe të qeverisurin në të drejta, detyra dhe obligime, ajo çka veprojnë disa, duke paraqitur fjalë boshe, duke e ngritur veten në liderizëm bosh, me mashtrime e tradhti, të gjitha këto janë të ndaluara me Sheriat dhe fetarisht. Kjo trajtohet veçse hipokrizi ndaj qytetarëve.

Imam Neveviju në librin “Rijadus Salihin” thotë: Ndalohet, pretendimi “Shahimshah” (mbreti i mbretërve) etj. etj. sepse me këtë cilësi emërohet vetëm All-llahu i Lartmadhëruar. Ai citon hadithin e Ebu Hurejres r.a., se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Emrin të cilin më së shumti nuk e pranon Zoti i Madhëruar është “Malikul Mulk” (mbreti mbretërve)”.

(Buhari dhe Muslimi)

Sufjan bin Ijnetu thotë: Mbret i mbretërve është sikurse me thënë: “Shahinshah”.

TEMA: Ndalimi i thirrjes së kriminelit dhe atij i cili sjell risi e të ngjashme: “O zotëriu im”.

Nga Berurete r.a. transmetohet se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Hipokritit mos i thoni zotëri, sepse edhe nëse është zotëriu juaj, ju e keni hidhëruar All-llahun e Larmadhëruar”.

(Ebu Davudi me isnad sahih)

Ne të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. e kemi shëmbëlltyrën më të mirë, kur thotë:

“Mos më konsideroni të shenjtë sikurse e konsiderojnë të krishterët djalin e Merjemes, se në të vërtetë unë jam rob (njeri), por thoni “Abdullah ve resuluhu” (Rob i Zotit dhe i dërguar i Tij).”

Muhamedi a.s. ka hyrë në një vend dhe aty një njeri ka filluar të dridhet dhe të frikësohet. Muhammedi a.s. i ka thënë:

“Qetësohu se unë nuk jam mbret (Zot), por vërtet unë jam djalë i një nëne kurejshite, i cili han ushqim sikurse të gjithë të tjerët.”

I dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka shkuar te sahabët dhe ata i janë ngritur në këmbë. Muhammedi a.s. u ka thënë:

“Mos u ngritni në këmbë sikurse të tjerët i ngrihen njëri tjetrit në këmbë duke e madhëruar.”

TË ARDHURAT E IMAMIT (KRYETARIT)

NENI 53

Nuk lejohet të lihet testament për Imamin (kryetarin), as vakëf, as të afërmve të tij, deri në lozen e katërt, përpos testamentit prej të cilit ka të drejtë trashëgimie. Po ashtu, Imami (kryetari) nuk ka të drejtë të blejë ose të marrë me qira diçka që është pronë shtetërore, ashtu siç nuk lejohet ta shesë pronën shtetërore.

Koment:

E para: Të vepruarit e Imamit në familje dhe në farefis posaçërisht qysh parashihet me Sheriat.

Imami i nënshtrohet veprimeve ashtu siç i nënshtrohen të gjithë qytetarët si p.sh. e drejta e bashkëshortes ndaj bashkëshortit, të drejtat e fëmijës, trashëgimia, shit-blerja. Ligji është i barabartë për të gjithë.

E dyta: Të vepruarit e Imamit (kryetarit) në postin dhe detyrën të cilën e kryen. Për këtë nevojitet imtësi dhe precizitet, me qëllim, që të mos e shfrytëzojë pozitën e tij për gjëra të ndaluara, të përfitojë prej pozitës dhe të mos lejojë që tjetri të realizojë të drejtën e tij.

Nuk lejohet për Imamin (kryetarin) të lejë testament, as vakëf, as për të, as për farefisin e tij deri në shkallën e katërt, sepse kështu keqpërdoren qëllimet e Sheriatit dhe nijetet mund të jenë të këqija. Imami (kryetari) nuk ka të drejtë të ketë lidhje me testament, as vakëf, pasi testamenti dhe vakëfi, në Sheriatin Islam, janë caktuar për të përfutur kënaqësinë e All-llahut dhe është e paraparë për të varfrit, nevojtarët, të paaftit dhe për interesin e përgjithshëm të muslimanëve.

Po ashtu, Imami (kryetari) nuk mundet të jetë palë (blerëse) tregtare me shtetin, me qëllim që të mos keqpërdoret pozita dhe të përfitojë atë që nuk e meriton. Imami (kryetari) nuk ka të drejtë të blejë ose të marrë me qira pasurinë e shtetit.

Të gjitha këto janë të ndaluara për pastërtinë e postit, për sigurimin dhe mbrojtjen e pasurisë shtetërore, për mbrojtjen e të drejtave të qytetarit dhe për t'u ikur thashethemeve. Ligji për këto çështje është bazuar për heqjen e dyshimeve, ruajtjen e postit të Imamit (kryetarit) dhe ruajtjen e fesë.

Në një hadith Sahih, transmetohet nga Nu'man bin Beshir r.a., se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Vërtet, hallalli është i sqaruar, po ashtu edhe harami është i sqaruar, në mes tyre ka gjëra të dyshimta të cilat shumica e njerëzve nuk i dinë, kush ruhet nga çështjet e dyshimta ai është pastruar në fenë dhe nderin e tij, e kush bie në gjërat e dyshimta ai ka rënë në haram. Sikurse bariu i cili ruan bagëtinë buzë (rreth) një greminë dhe shumë lehtë mund t'i bierë bagëtia në të. Pra, çdo post, ka greminë, ndërsa gremina e All-llahut është veprimi i haramëve, po ashtu, në trup është një pjesë mishi me gjak, nëse ajo është e mirë, i tërë trupi është i mirë, nëse ajo pjesë mishi me gjak është i prishur, i tërë trupi është i prishur, e ajo pjesë mishi me gjak është zemra.”

Nëse çështjet janë stabile dhe të qëndrueshme, dhe zemrat janë të mbushura me iman dhe njerëzit i frikësohen All-llahut, atëherë nuk do të kishte qenë e ndaluar për Imamin (kryetarin) për të blerë prej pasurisë shtetërore, sepse ai është pjesë e shoqërisë, me fjalë të tjera qytetar dhe njësi e popullit, i cili i gëzon të gjitha të drejtat sikurse të tjerët.

KRYETARI NUK KA TË DREJTË TË PRANOJË DHURATA

NENI 54

Imami (kryetari) nuk ka të drejtë dhurate, çka i dhurohet atij është mashtrim, për këtë arsye derdhet në fondin e arkës shtetërore (bejtul-mal)

Koment:

Gulul do të thotë tradhti.

Në terminologjinë e Sheriatit është tradhti e pasurisë së luftës, të cilën muslimanët e fitojnë me betejë kundër armikut.

Kjo fjalë ka ardhur në ajetin kur'anor:

وَمَا كَانَ لِنَبِيٍّ أَنْ يَغُلَّ وَمَنْ يَغُلَّ يَأْتِ بِمَا غَلَّ يَوْمَ الْقِيَامَةِ
ثُمَّ تَوَفَّى كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ

“Është e pamundur për ndonjë pejgamber të bëjë mashtrim e të keqpërdorë (pasurinë e luftës-shtetërore) e kushdo që bën mashtrim e keqpërdorë do të vijë i ngarkuar (me mëkat) në Ditën e Kijametit, e pastaj do t'i jepet çdo kujt ajo që ka punuar dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi”.

(Ali Imran, 161)

Ajeti ndalon që muslimanët ta keqpërdorin pasurinë e luftës (Ganimah).

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

وَاعْلَمُوا أَنَّمَا غَنِمْتُمْ مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ لِلَّهِ خُمُسَهُ وَلِلرَّسُولِ وَلِذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ
وَالْمَسَاكِينِ وَابْنِ السَّبِيلِ إِن كُنْتُمْ آمَنْتُمْ بِاللَّهِ وَمَا أَنْزَلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا يَوْمَ الْفُرْقَانِ
يَوْمَ التَّقَىٰ الْجَمْعَانِ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“Ta dini se nga ajo që fituat (prej pasurisë së luftës), një e pesta i takon Allahut (në rrugën e Tij), të dërguarit të Tij, të afërmve (të dërguarit) të Tij, jetimëve, nevojtarëve dhe udhëtarëve në rrugë të drejtë të cilët nuk kanë mjete (për të mbijetuar), nëse keni besuar Allahun dhe atë (Kur'anin) që ia zbritëm robit tonë (Muhamedit) ditën e Furkanit (dita e fitores së Bedrit kur u menjanua e pavërteta nga e vërteta) e cila ishte ditë e konfrontimit të dy grupeve. Allahu është i fuqishëm për çdo gjë”.

(El Enfal, 41)

I dërguari i All-llahut e ka ndaluar rreptësisht këtë lloj të keqpërdorimit (gulul)

Në sahihun e Muslimit, transmetohet nga Umer bin Hatabi r.a., se kur ka ndodhur beteja e Hajberit, një grup i sahabëve kanë shkuar te Muhammedi a.s. dhe i kanë thënë:

Filani është shehid, edhe filani është shehid, deri sa kanë kaluar pranë njërit dhe kanë thënë: edhe ky është shehid. Muhammedi a.s. u ka thënë: “Jo! Ky nuk është shehid, unë këtë e kam parë duke u djegur në xhehennem.”

Imami (kryetari) e ka përgjegjësinë më të madhe për ruajtjen e pasurisë shtetërore dhe është më prioritar për qeverisje të singertë e të pastër dhe për përgjegjësi, për këtë arsye nuk lejohet të pranojë dhurata nga populli, ose prej atij i cili ka interes. Nëse i dhurohet diçka, ajo dhuratë derdhet, apo kalon në arkën qendrore të muslimanëve (Bejtul-mal). Është e ndaluar për çdo njeri, me pozitë të lartë shtetërore, të pranojë dhurata prej qytetarëve, ose prej atij të cilit i ka kryer ndonjë nevojë.

Muhammedi a.s. i ka ndaluar rreptësisht të gjitha format e mashtrimit dhe të keqpërdorimit dhe i ka mbyllur të gjitha dyert që të shpien aty. Në sahihun e Muslimit, Adij bin Amirete r.a. transmeton se e ka dëgjuar Muhammedin a.s. duke thënë:

“Cilin e emërojmë në ndonjë post dhe fsheh diçka ose mashtron, në Ditën e Kijametit do të vijë me atë keqpërdorim.”

Kam parë se si një njeri i zi, prej ensarëve, i tha Muhammedit a.s.:

- ***O i dërguar i All-llahut më cakto në ndonjë post.***
- ***“Po çfarë posti?”***
- ***Të kam dëgjuar se si ke thënë kështu, e ashtu.***
- ***Muhammedi a.s. tha: “Unë prapë po e them: cilin e caktojmë në ndonjë detyrë me përgjegjësi, le të sjellë pak apo shumë, çfarëdo që i jepet dhuratë merret prej tij dhe i ndalohet atij.”***

Ne kemi edhe një rast tjetër shembullor: Muhammedi a.s. ka emëruar në detyrë për të tubuar zekatin, njërin prej fisit Esed, të quajtur Ibnu Letijbete. Pasi ka ardhur nga terreni ka thënë kjo është tubuar dhe mbetet në administratat, ndërsa kjo më është dhuruar mua. Muhammedi a.s. ka hipur në minber e ka falënderuar All-llahun dhe ka thënë:

“Si është puna me punëtorin, i cili thotë kjo është për administratën, ndërsa kjo më është dhuruar mua, e pse nuk është ulur në shtëpinë e babës së tij, apo nënës së tij dhe të kishte shikuar a do t’i jepnin dhuratë apo jo? Pasha Zotin, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhammedit a.s., çdo njeri i cili keqpërdor, ose përfiton diçka nga posti, në Ditën e Kijametit do ta ketë të varur për qafe, qoftë deve, lopë apo dele.”

Pastaj i ka ngritur duart lart, sa që i janë parë shpatullat dhe nënsqetullat dhe është lutur:

“O Zot, a e kreu kumtesën?

O Zot, a e kreu kumtesën?”

(Transmeton Muslimi)

PËRGJEGJËSIA E IMAMIT (KRYETARIT) PARA UMMETIT ISLAM

NENI 55

Imami (kryetari) duhet të jetë shëmbëlltyrë për qytetarët në drejtësi, mirësi dhe vepra të mira. Ai i bashkëngjitet muslimanëve në të gjitha çështjet e shoqërisë islame, sikurse të dërguarit e delegacioneve për haxh për çdo vjet, të marrurit pjesë në kongreset islame zyrtare dhe jo zyrtare.

Koment:

Është obligative për imamin (kryetarin) të jetë shembull i mirë në praktikimin e ligjit dhe kryerjes së detyrave fetare, të jetë i drejtë me qytetarët, i butë ndaj ummetit, dhe të angazhohet maksimalisht për të sjellë paqe dhe siguri.

Imami (kryetari) i prin popullit në punë të mira. Çdo urdhër në Kur'an i është drejtuar, në rend të parë, të dërguarit të All-llahut s.a.v.s., e pastaj iu është drejtuar të gjithë besimtarëve, përpos që ka pasur raste të veçanta vetëm për Muhammedin a.s.

Imami (kryetari) shkon pas hapave të Muhammedit a.s. Ai është Halif në politikën e kësaj jete dhe të fesë. Imami (kryetari) duhet të jetë më i devotshmi, ai duhet t'i frikësohet më së shumti All-llahut, dhe ai duhet t'i mbështetet më së shumti All-llahut, dhe ta ketë (gjithmonë) parasysh se All-llahu e përcjell në çdo moment, dhe t'i përulet dhe t'i bindet Atij.

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ اتَّقِ اللَّهَ وَلَا تُطِعِ الْكَافِرِينَ وَالْمُنَافِقِينَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا .
وَاتَّبِعْ مَا يُوحَىٰ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا . وَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ
وَكَفَىٰ بِاللَّهِ وَكِيلًا .

“O pejgamber! Frikësoju All-llahut dhe mos i përfill mosbesimtarët dhe hipokritët, All-llahu me të vërtet i di të gjitha dhe është i Urtë. Dhe paso atë, që të shpallet nga Zoti yt! All-llahu pa dyshim është i informuar për atë çka punoni. Dhe mbështetu në All-llahun. All-llahu të mjafton për mbështetje”.

(El Ahzab, 1-3)

Imami (kryetari) duhet të prijë në drejtësi, ai duhet t'iu përmbahet më së shumti ligjeve të All-llahut.

Zoti i Madhëruar thotë:

فَلَذَلِكَ فَادْعُ وَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَقُلْ آمَنْتُ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ مِنْ
كِتَابٍ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمُ اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ لَنَا أَعْمَالُنَا وَلَكُمْ أَعْمَالُكُمْ لَا حُجَّةَ بَيْنَنَا
وَبَيْنَكُمُ اللَّهُ يَجْمَعُ بَيْنَنَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ

“Andaj ti thirri dhe bëhu i vendosur, ashtu siç je urdhëruar,

e mos i ndiq epshet e tyre dhe thua:

Unë besoj çdo libër që ka shpallur All-llahu

Dhe më është urdhëruar që të gjykoj drejtë.

Ne kemi përgjegjësi për veprat tona, ju keni përgjegjësi për veprat tuaja: Në mes nesh dhe jush nuk duhet të ketë kurrfarë mosmarrëveshje. All-llahu do të na tubojë të gjithëve dhe tek Ai do të kthehemi të gjithë”

(Esh Shura, 15)

Imami (kryetari) duhet të jetë më i buti, më i mëshirshmi, më bamirësi se të gjithë të tjerët, më fisniku dhe më bujari.

Zoti i Madhëruar thotë:

لَا تَمْدَنَّ عَيْنَيْكَ إِلَى مَا مَتَّعْنَا بِهِ أَزْوَاجًا مِنْهُمْ وَلَا تَحْزَنْ عَلَيْهِمْ
وَاخْفِضْ جَنَاحَكَ لِلْمُؤْمِنِينَ

“E ty të mos të shkojnë kurrsesi sytë në atë me çka Ne i pajisëm disa prej tyre, as mos u brengos për ta, kurse ndaj besimtarëve jij i përlur dhe i butë”.

(El Hixhr, 88)

Imami (kryetari) i drejtë është i pari prej shtatë personave të cilët do ta kenë fatin të jenë të sigurtë, të qetë dhe të ndiejnë aromën e Rejhanit.

Në hadithin (Buhari dhe Muslimi)i, nga Ebu Hurejre transmetohet se Muhammedi a.s., ka thënë:

“Shtatë persona do të hyjnë nën hijen e All-llahut, Ditën kur nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së Tij, e ata janë:

Imami (kryetari) i drejtë

I riu i cili kalon jetën në adhurim ndaj All-llahut

Njeriu i cili e ka zemrën të lidhur me xhaminë

Dy shokë të cilët e duan njeri tjetrin vetëm për All-llah, por edhe ndahen për All-llah

Njeriun të cilin e kërkon dhe e thërret një femër me famë dhe e bukur, ndërsa i përgjigjet (refuzon) se i frikësohet All-llahut

Njeriu i cili jep sadaka dhe e fsheh aq shumë, sa që dora e majtë nuk e di se çka ka dhënë dora e djathtë

Njeriu i cili kur e kujton All-llahun i skuqen dhe i lotojnë sytë.”

Imami (kryetari) i drejtë është njëri prej tre të parëve të cilët do të hyjnë në xhennet. Në sahihun e Muslimit, Ijadi transmeton se e ka dëgjuar të dërguarin e All-llahut duke thënë:

“Banorët e xhennetit janë tre:

- Udhëheqësi i drejtë;

- Njeriu i mëshirshëm, zemër butë për të gjithë, për të afërmit dhe për muslimanët;

- Ai i cili shpenzon për familjen e tij”.

Imamët (halifët) muslimanë, në çdo kohë dhe në çdo vend, gjithmonë, qëllim kryesor kanë pasur për t’i shërbyer Islamit, për t’ua lehtësuar gjendjen muslimanëve, ndërtimin e shoqërisë në besim në Zot Një dhe në një bashkësi familjare të vetme, duke iu përmbajtur ajetit kur’anor:

إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ

“Me të vërtetë, ky është besimi juaj – besimi i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuronit Mua!”

(El Enbija, 92)

Kurrë muslimanët nuk kanë pasur nevojë më shumë se sot për mëshirë mes vete, ndihmë mes vete, mbështetje mes vete, në kohën kur popujt e tjerë i kanë shpërndarë, i kanë përçarë, i kanë shkelur parimet e muslimanëve dhe ndjenjat e tyre dhe dëshirojnë ta fundosin ummetin islam.

Është bërë obligim i domosdoshëm që të bëhet unifikimi i sistemit të arsimit në botën islame, të përsosën ligjet ekonomike, të kihet një politikë e përbashkët, me qëllim që muslimanët të ballafaqohen me sistemin e ashtuquajtur rendi i ri botëror, i cili ka filluar pas fundosjes apo pas dështimit dhe shpartallimit të Bashkimit Sovjetik më 1991 dhe është paraqitur dhuna e kryqëzatave, dhe terrori botëror me të ashtuquajturat shtete perëndimore krishtere.

Sezoni i Haxhit konsiderohet takim ndërkombëtar islam, i cili i bashkon zemrat, qëllimet dhe i zgjeron kraharorët. Muslimanët, gjatë sezonit të haxhit, duhet të përgatisin vendet për t'i kryer farzet, të përfitojnë prej haxhit teorikisht dhe praktikisht në sjellje, edukatë, në ekonomi, politikë, në organizimin shoqëror dhe ushtarak, për të realizuar thënien e Zotit të Madhëruar:

وَأَذِّنْ فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَى كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ .
 لِيَشْهَدُوا مَنَافِعَ لَهُمْ وَيَذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ فِي أَيَّامٍ مَّعْلُومَاتٍ عَلَى مَا رَزَقَهُمْ مِّنْ بَهِيمَةِ
 الْأَنْعَامِ فَكُلُوا مِنْهَا وَأَطْعِمُوا الْبَائِسَ الْفَقِيرَ . ثُمَّ لِيَقْضُوا تَفَثَهُمْ وَلْيُوفُوا نُذُورَهُمْ
 وَلْيَطَّوَّفُوا بِالْبَيْتِ الْعَتِيقِ .

“Dhe ftoi njerëzit në haxhillëk; do të vijnë ata ty – në këmbë dhe (duke shaluar) në deve të rraskapitura; duke ardhur prej të gjitha viseve të largëta.

Që të prezantojnë në dobritë e tyre dhe të përmendin emrin e All-llahut në ditët e caktuara dhe nga që i ka furnizuar me kafshë. E, hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër!

Pastaj, le të heqin ndyrësitat nga trupi i tyre dhe le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le të bëjnë tavaf shtëpinë e lashtë (Qaben e nderuar)”.

(El Haxh, 27-29)

DETYRA DHE PËRGJEGJËSIA E IMAMIT (KRYETARIT) NË MBROJTJE TË POPULLIT DHE SHTETIT

NENI 56

Imami (kryetari) ka për detyrë të udhëheqë ushtrinë në rast lufte kundër armikut, (ka për detyrë) mbrojtjen territoriale dhe mbrojtjen e sovranitetit të vendit, të bëjë marrëveshje dhe të bashkëpunojë me shtetet e tjera.

Koment:

Në këtë nen janë përmendur përgjegjësitë kryesore të Imamit (kryetarit) e ato janë:

- Përgatitja dhe udhëheqja e forcës ushtarake
- Ekzekutimi i vendimeve
- Bërja e marrëveshjeve dhe bashkëpunimi me shtetet e tjera

Prej përgjegjëseve më të mëdha dhe më të rëndësishme që ka Imami (kryetari) është që të përgatitë, të përforcojë dhe të strukturojë ushtrinë, ta profesionalizojë atë, të krijojë kuadro dhe të përforcojë mbrojtjen e plotë të tokës së muslimanëve, nga çdo okupator dhe kolonizator.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ حَرِّضِ الْمُؤْمِنِينَ عَلَى الْقِتَالِ ...

“O i dërguar! Inkurajo besimtarët në luftë”.

(El, Enfal, 65)

Muhammedi a.s. ka marrë pjesë në vijën e parë të frontit, ka caktuar udhëheqësit e betejave, ka shpallur fitoret, ka ndarë pasurinë e luftës, ka bërë apel për përgatitjen e luftëtarëve, ka bërë apel për ta ndihmuar luftën si në aspektin material, ashtu edhe në atë ushtarak, për të mbrojtur Islamin dhe tokat e muslimanëve.

Kur'ani na ka mësuar edukatën e udhëheqjes së ushtrisë, rregullat e lëvizjes së ushtarëve, ligjet e frontit. Sa për ilustrim, po përmendim fjalën e Zotit të Madhëruar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا لَقِيتُمْ فِئَةً فَاثْبُتُوا وَاذْكُرُوا اللَّهَ كَثِيرًا لَّعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ .
وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَا تَنَازَعُوا فَتَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ وَاصْبِرُوا إِنَّ اللَّهَ مَعَ
الصَّابِرِينَ . وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ خَرَجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بَطَرًا وَرِئَاءَ النَّاسِ وَيَصُدُّونَ عَنِ
سَبِيلِ اللَّهِ وَاللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطٌ .

“O ju që besuat, kur të konfrontoheni me ndonjë grup, përqendrohuni dhe përmendni çdo herë All-llahun që të arrini fitoren e dëshiruar. Dhe respektojeni All-llahun e të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm se All-llahu është me të durueshmit. Mos u bëni si ata që dolën prej shtëpive të tyre sa për krenari e për t’i parë njerëzit, e që pengonin nga rruga e All-llahut. All-llahut nuk mund t’i shpëtojnë me atë veprim të tyre”.

(El Enfal, 45-47)

Luftëtari musliman është guximtar dhe i pari në front, nuk bën padrejtësi, nuk sulmon askënd dhe nuk i tejkalon kufijtë, mirëpo nëse i obligohet lufta për të mbrojtur vendin ai përforcohet si hero, lufton i patrembur dhe sakrifikon veten dhe pasurinë e tij në rrugën e All-llahut.

Luftëtari është i lidhur me zemër te All-llahu. Atë nuk mund ta mashtrojë dhe nuk mund ta tradhtojë kënaqësia e kësaj bote, ai nuk angazhohet për të okupuar, as për të kolonizuar, as për të nënçmuar dhe as për të poshtëruar popujt. Qëllimi i tij është feja e All-llahut ndërsa njerëzit kanë nderin dhe krenarinë e tyre, të drejtën për të jetuar të qetë, të sigurtë dhe në paqe.

Ushtarët janë të ndërgjegjshëm dhe janë të një mendimi e të një fjale, ata nuk njohin konflikt dhe përçarje, nuk njohin pushtet e karrierizëm.

Sa i përket ekzekutimit të vendimeve dhe praktikimit të Sheriatit, kjo është detyrë me rëndësi e cila ndikon në mirëqenien, në stabilitetin dhe sigurinë e ummetit. Imami (kryetari) e ka për obligim të veprojë sipas Sheriatin të All-llahut dhe për t’iu përmbajtur vendimeve të All-llahut, për të bërë ekzekutimin e tyre dhe për të mos lejuar që në vend të tij të vendosen (të zëvendësohet me) ligje dhe

vendime njerëzore, të cilat janë në kundërshtim me ligjet e All-llahut dhe në kundërshtim me drejtësinë, pasi All-llahu është Ai i cili e ka krijuar njeriun dhe Ai e di më së miri atë që është më e mira dhe më e dobishmja për të. Çdo vendim, apo ligj, i cili është larg fesë së All-llahut është injorancë, padrejtësi dhe krim.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَأَنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَاحْذَرْهُمْ أَنْ يَفْتِنُوكَ عَنْ بَعْضِ
مَا أَنزَلَ اللَّهُ إِلَيْكَ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَاعْلَمُوا أَنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُصِيبَهُمْ بِبَعْضِ ذُنُوبِهِمْ وَإِنْ
كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ لَفَاسِقُونَ . أَفَحُكْمَ الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا
لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ .

“Që të gjykosh me atë që të zbriti All-llahu, e mos paso epshet e tyre dhe ruaju rrezikut që të mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti All-llahu. Nëse ata nuk pranojnë gjykimin tënd, ti dije se All-llahu ka për qëllim t’i ndëshkojë ata për disa mëkate të tyre. Vërtet shumica e njerëzve janë mëkatarë. A gjykimin siç ka qenë në injorancë e kërkojnë? Po ku mund të gjendet gjykim më i mirë se gjykimi i All-llahut për një popull që i bindet urdhrave të Tij?”

(El Maide, 49-50)

- Sa i përket marrëdhënieve dhe kontratave me shtetet e tjera Imami (kryetari) i përcjell me vëmendje, i formulon nenet dhe vërteton interesin e ummetit dhe realizimin e qëllimeve të tij.

Nuk pranohet marrëveshja për ndarjen e ndonjë pjese toke të tokës së muslimanëve, ose ndonjë marrëveshje e cila e humb pasurinë shtetërore, ose e humb dinjitetin kombëtar, ose dinjitetin fetar.

Imami (kryetari) i nënshkruan vetëm ato kontrata të cilat janë në përputhje me vendimet e kushtetutës, të cilat janë të parapara me ligj.

Zoti i Madhëruar na ka urdhëruar për t'i kryer premtimet dhe për t'i realizuar kontratat.

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَوْفُوا بِالْعُقُودِ

“O besimtarë! Plotësojini obligimet dhe kryejini premtimet (marrëveshjet)”.

(El Maide, 1)

وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ بَعْدَ تَوْكِيدِهَا

“Dhe, zbatoni obligimet e All-llahut, të cilat i keni marrë përsipër dhe mos e thyeni betimin pasi që e keni forcuar”.

(En Nahl, 91)

وَلَا تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيمِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ حَتَّى يَبْلُغَ أَشُدَّهُ وَأَوْفُوا بِالْعَهْدِ إِنَّ الْعَهْدَ
كَانَ مَسْئُولًا

“Mos iu qasni pasurisë së bonjakut, përpos në mënyrën më të mirë, për derisa të mos arrijë moshën e pjekurisë. Dhe kryeni obligimet. Me të vërtetë për obligime jeni përgjegjës”.

(El Isra, 34)

PËRGJEGJËSIA MORALE E IMAMIT

NENI 57

Imami (kryetari) ka përgjegjësi për t'iu mundësuar personave dhe grupeve për të urdhëruar në punë të mira dhe për të ndaluar nga punët e këqija, po ashtu edhe për kryerjen e obligimeve.

Koment:

Prej përgjegjësive të Imamit (kryetarit) është që t'iu mundësojë bamirësve të ndalojnë nga punët e këqija dhe të urdhërojnë në punë të mira. Nuk mjafton për qeveritarin që, ummetit dhe popullit, t'iu mundësojë vetëm plotësimin e nevojave elementare të jetës, siç janë ushqimi, veshmbathja dhe banimi. Vetëm këto çështje nuk e ndërtojnë civilizimin dhe nuk i zhvillojnë popujt dhe nuk i mundëson njerëzve të kalojnë jetë të nderhme.

Këto gjëra (ushqimi, veshmbathja dhe vendstrehimi) janë të mjaftueshme vetëm për kafshët shtëpiake, kafshët e egra dhe shpendët, ndërsa njeriu përbëhet prej trupit dhe shpirtit, ai ka mendje dhe trup, zemër dhe trup, ai ka ndjenja dhe emocione, ai ka nevojë për moral dhe karakter.

Edukimi i njeriut është më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm se ndërtimi i fabrikave, rrugëve e urave. Ky edukim ka nevojë për burra të cilët i zbatojnë ligjet e All-llahut, i përmbahen vendimeve të All-llahut dhe praktikojnë Sheriatin e All-llahut, i cili siguron dhe garanton fenë e Allahut.

Këta burra duhet të nderohen dhe respektohen prej qytetarëve, prej Imamit (kryetarit) dhe prej funksionarëve, për ta kryer punën e tyre të nderhme, largimin nga punët e këqija dhe urdhërimin në punë të mira.

Këta burra mund të jenë dijetarë të cilët e sqarojnë të vërtetën, e nxjerrin në shesh të mirën, i lartësojnë vlerat dhe pengojnë të keqen, mëkatin, krimin, fitnen dhe ngatërresat, por mund të jenë edhe prej njerëzve të rëndomtë, të cilët iu tregojnë përgjegjësve se si është gjendja me qytetarët, çfarë padrejtësie bëhet, çfarë imoraliteti, çfarë krimi dhe çfarë shkatërrimi. Mund të jenë edhe inspektorë dhe kontrollues në fushat e arsimit, kulturës, shëndetësisë ose

bujqësisë. Mund të jenë oficerë të policisë, ose inspektorë, të cilët janë të obliguar për mbajtjen e rendit dhe sigurisë së popullit, dhe për përcjelljen e organeve apo individëve, të cilët nuk e zbatojnë ligjin e All-llahut.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

وَلْتَكُنْ مِنْكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى الْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ
وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

“Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron në punë të mira dhe parandalon krimin. Të tillë janë ata të shpëtuarit”.

(Ali Imran, 104)

Në hadithin, të cilin e transmeton Muslimi nga Ibn Mesudi, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Çdo pejgamber, të cilin All-llahu e ka dërguar para meje, ka pasur Havarijunë (ndihmëtarë faqebardhë) ose shokë të cilët e kanë pasuar rrugën e tij dhe i janë përmbajtur urdhrave të tij, ndërsa pas tyre kanë ardhur të padëgjueshmit të cilët kanë thënë diçka tjetër dhe kanë vepruar krejt diçka tjetër, kanë vepruar çka nuk janë urdhëruar. Kush i lufton ata është besimtar, kush i lufton ata me gjuhën e tij është besimtar, kush i lufton me zemrën e tij është besimtar, përndryshe, ai i cili nuk është prej këtyre kategorive e ka imanin sa kokrra e bizeles”.

Prej detyrave parësore të ummetit (familjes ndërkombëtare islame) është kryerja e farzeve, manifestimi (përdorimi) i simboleve islame, praktikimi i fesë dhe përforcimi i besimit. Udhëheqësi duhet të përkujdeset për së tepërmi për këtë çështje, ndërsa neglizhentët, dhe shkatërrimtarët duhet t'i izolojë dhe t'i pengojë. Njësoj duhet të veprojë edhe me ata të cilët tallen me fenë, me qëllim që ta pastrojë shoqërinë prej ndyrësirave.

Pas shehadetit, shtyllat kryesore të Islamit janë: Namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi.

Përkujdes të veçantë duhet pasur në politikën shtetërore, ndërtimin e xhamive dhe caktimin e ligjëruesve, ndërtimin e qendrave për mësimin e Kur'anit përmendësh, publikimin e kulturës islame në mjetet e informimit, themelimin e bankave të zekatit për tubimin dhe shpërndarjen e tij, po ashtu edhe në lehtësimin e shërbimeve për haxh.

Këto shtylla të jetës islame nuk lejohet të anashkalohen për asnjë çast, për këtë arsye, udhëheqësit të cilët nuk i kryejnë këto obligime fetare duhet të largohen nga detyra.

Në sahihun e Muslimit, Auf bin Malik r.a. transmeton se e ka dëgjuar Muhammedin a.s. duke thënë:

“Më të mirët prej udhëheqësve tuaj janë ata të cilët i doni dhe ju duan, ju luteni për ta dhe ata lutën për ju, ndërsa më të këqijtë janë ata udhëheqës që i urreni dhe ju urrejnë, i mallkoni dhe ju mallkojnë.” I thamë: O i dërguari i All-llahut, a t’i shkarkojmë prej detyre? Muhammedi a.s. ka thënë:

“Jo, deri sa e falin namazin.

Jo, deri sa e falin namazin.”

PËRGJEGJËSIA E IMAMIT (KRYETARIT) NË SISTEMIN ORGANIZATIV

NENI 58

Imami (kryetari) emëron nëpunësit shtetërorë (formon kabinetin). Lejohet që, sipas ligjit apo sipas rregullores, të emërojë nëpunësit e tjerë shtetëror (krahas posteve të larta-kabinetin).

Koment:

Prej përgjegjësive të Imamit (kryetarit) është se ai personalisht formon kabinetin e tij, pra i cakton ministrat me qëllim që të jetë lidhja e drejtpërdrejtë dhe konsultimi i vazhdueshëm. Ai, në rend të parë, konsultohet me personin para emërimit të tij dhe pas emërimit, të gjitha punët të cilat ai nuk i kryen në mënyrë të drejtpërdrejtë i kryen nëpërmjet tyre (ministrave).

Lejohet që Imami (kryetari) të emërojë zëvendësit (ministrat) që ata vetë, pastaj, të emërojnë nëpunësit shtetërorë. Me ligj, apo rregullore, caktohen kushtet e secilit nëpunës, për të qenë profesional, i sinqertë, me karakter, sakrifikues për kryerjen e detyrave shtetërore.

Le të përkujtojmë hadithin e të dërguarit të All-llahut i cili transmetohet nga Ajshja r.a., e cila ka thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut, në shtëpinë time, duke u lutur:

“O Zoti im, kush emërohet në post të ummetit tim dhe u vështirëson diçka, vështirësoja atij jetën dhe kush emërohet në post të umetit tim dhe sillet me butësi, mëshiroje dhe sillu butë ndaj tij”.

(Muslimi)

Po ashtu, edhe Jeali Muakal bin Jesari r.a., transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. duke thënë:

“Çdo udhëheqës i cili caktohet për t’u kujdesur për ummetin ndërsa ai i mashtron, kur të ringjallet në Ditën e Kijametit, Zoti i Madhëruar do t’ia ndalojë të hyjë në xhennet.”

(Buhari dhe Muslimi)

Në një hadith tjetër, Pejgamberi a.s. thotë:

“Çdo udhëheqës i cili i merr përsipër çështjet e muslimanëve dhe nuk e kryen me përgjegjësi dhe nuk angazhohet për ta, ai nuk do të hyjë në xhennet me ta.”

E DREJTA E IMAMIT (KRYETARIT) PËR TË FALUR GABIMIN DHE RREGULLAT E FALJES SË GABIMIT

NENI 59

Falja për thyerje të ligjeve, me përjashtim të vendimeve të prera dhe të përcaktuara (Hudud), rregullohet vetëm me ligj. Imami (kryetari) ka të drejtë faljeje për krime në raste të posaçme, përpos në vendimet e prera dhe të përcaktuara (HUDUD) dhe të tradhtisë shtetërore.

Koment:

Krimet janë dy lloje:

- Krimet të cilat ndëshkohen me ndëshkim (Ta'zir) ashtu siç e parasheh Imami (kryetari) në dobi të interesit individual dhe të përgjithshëm, siç janë: sjellja e ashpër ndaj prindërve; veprimi me kamatë, nënçmimi i fqinjit, keqpërdorimi i pasurisë shoqërore etj.

- Krimet të cilat ndëshkohen me ndëshkim, siç e ka përcaktuar All-llahu i Lartmadhëruar dhe nuk lejohet që të mos ndëshkohet nëse për atë krim janë plotësuar kushtet siç janë, hakmarrja për vrasje (kisasi), dënimi për shpifje të prostitucionit, dënimi për vjedhje etj.

Të drejtat janë dy lloje, njashtu edhe mëkatet të cilat meritojnë ndëshkim janë dy llojesh:

- Të drejtat dhe detyrat ndaj njeriut të cilat shkaktohen në konflikte, dëme materiale e fizike dhe të cilave patjetër duhet t'u rikthehet e drejta ose t'u kompensohet dëmi.

- E drejta dhe obligimi ndaj All-llahut që mund të zgjidhen me tolerancë dhe falje, pasi vërtet All-llahu është i mirë dhe i mëshirshëm.

Nëse ndodh krimi, atëherë jemi para dy gjendjeve apo mënyrave:

- Të bëhurit në mënyrë të fshehtë dhe që nuk e di askush.
- Të bëhurit haptazi sa që e sheh dhe e dëgjon çdokush.

Për të dy rastet, ekzistojnë dy mënyra të veprimit:

- Ose të zgjidhet problemi dhe të ndreqet rasti, pa hyrë në procedurë gjyqësore dhe administrative

- Ose të ngrihet çështja në gjykatë, për ta shqyrtuar çështjen dhe për ta ekzekutuar vendimin, pa marrë parasysh a e ka ngritur vetë aktpadinë kundër vetes, apo e kanë ngritur të tjerët duke sjellë fakte, dëshmi dhe dëshmitarë.

Muslimani këshillohet të falë, për të arritur shkallën e lartë të moralit dhe të fituar shpërblim prej All-llahut. Zoti i Madhëruar thotë:

خُذِ الْعَفْوَ وَأْمُرْ بِالْعُرْفِ وَأَعْرِضْ عَنِ الْجَاهِلِينَ

“Bëhu i matur (dhe sillu me kujdes ndaj tyre), urdhëro vepra të mira dhe largohu nga injorantët”.

(El A'raf, 199)

Zoti i Madhëruar, në një ajet tjetër, thotë:

وَلَمَنْ صَبَرَ وَغَفَرَ إِنَّ ذَلِكَ لَمِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ

“E ai që duron dhe fal, këto, në të vërtetë janë virtyte të larta”.

(Esh Shura, 43)

Muhammedi a.s. në një hadith, të cilin e transmeton Ebu Hurejrete r.a. thotë:

“Nuk është trim, trimi në konfrontim dhe dyluftim, por trim është ai i cili e sundon veten e tij kur është i hidhëruar.”

(Buhari dhe Muslimi)

Kur'an i ka treguar mundësinë e faljes në rast të vrasjes me qëllim:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِصَاصُ فِي الْقَتْلِ الْحُرُّ بِالْحُرِّ وَالْعَبْدُ بِالْعَبْدِ
وَالْأَنْثَى بِالْأُنْثَى فَمَنْ عُفِيَ لَهُ مِنْ أَخِيهِ شَيْءٌ فَاتَّبِعْ بِالْمَعْرُوفِ وَأَدَاءٌ إِلَيْهِ
بِإِحْسَانٍ ذَلِكَ تَخْفِيفٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَرَحْمَةٌ فَمَنِ اعْتَدَىٰ بَعْدَ ذَلِكَ فَلَهُ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“O besimtarë, është vendosur ligji për ju për sa i përket vrasjes: I liri për të lirin, rob për robin dhe femra për femrën; e atij që ia fal familja e të vrarit, duhet të sillet njerëzishëm (për dëmshpërblim) dhe le të zbatohet dëmshpërblimi me të mirë. Kjo falje është një lehtësi dhe mëshirë nga ana e Zotit. E Kushdo që pas kësaj (faljeje) e tejkalon kufirin, për atë ka dënim të rreptë”.

(El-Bekare, 178)

Kjo për arsye se shoqëria e muslimanëve është shoqëri e mëshirës, (ata) përforcohen dhe ndërlidhen mes vete, ndërsa rastet patetike janë të rralla. Thyerja e ndonjë ligji, nuk paraqet shoqërinë islame në përgjithësi.

Nëse vjen puna deri në gjyq dhe pala e cila ka të drejtë dëshiron ta tërheqë aktpadinë, atëherë kushtetuta i propozon dhe i jep të drejtë të falë për krimet e papërcaktuara (T'azir), të cilat mund të rregullohen me ligj dhe rregullore dhe me kusht që falja të mos keqpërdoret dhe të mos shfrytëzohet për t'u rritur krimet, e keqja dhe shkatërrimi dhe që shteti ta humbë vlerën e vet.

Lejohet që Imami (kryetari) të falë dënimet e papërcaktuara të Sheriatit Islam (T'azir), në raste të veçanta, ku shkak mund të jetë bashkimi i shoqërisë dhe uniteti i fjalës.

Përsa i përket dënimeve të prera dhe të përcaktuara (Hudud) të cilat ngrihen në procedurën gjyqësore, Imami (kryetari) nuk ka të drejtë t'i falë, sepse atëherë do të ndodhte mosekzekutimi i ligjeve të All-llahut, dhe vazhdimi i krimeve, gjë që kërcënon qetësinë dhe sigurinë e vendit.

Imam Neveviu sqaron hadithin sahih të koleksionit të Muslimit:

Janë të njohura transmetimet e haditheve në rastin e femrës Mahzumije, e cila kishte vjedhur. Ndërsa Usame bin Zejd ka ndërmjetësuar te i dërguari i All-llahut s.a.v.s., Muhammedi a.s. është hidhëruar dhe nuk i është përgjigjur, por përkundrazi i ka thënë:

“A po ndërmjetëson në dënimet e prera dhe të përcaktuara të All-llahut?!”

Muslimi përmend hadithin i cili ndalon ndërmjetësimin në dënimet e prera dhe të përcaktuara dhe ai ka qenë shkak i shkatërrimit të Beni Israilëve. Është ixhma (mendim unanim i të gjithë dijetarëve islamë) se ndërmjetësimi i Imamit (kryetarit) në dënimet e prera dhe të përcaktuara (Hudud) është i ndaluar dhe ai nuk ka të drejtë t'i falë, ndërsa para se të ngrihet aktpadia në gjyq, Imami (kryetari) ka të drejtë të falë. Këtë mendim e përkrahin shumica e dijetarëve, nëse ai (delikuenti) nuk është i njohur për krime, dhe nënçmues i vazhdueshëm i të tjerëve.

Në krimet, për të cilat nuk është i paraparë dënimi i prerë dhe i përcaktuar (T'azit), lejohet falja dhe ndërmjetësimi, pa marrë parasysh a ka arritur lënda në gjyq apo jo, sepse dënimet janë më të

lehta. Në këto raste falja dhe ndërmjetësimi është e pëlqyeshme (mustehab) nëse pala nuk është dëmtues. Ndoshta bazë për ndërmjetësim është fjala e Zotit të Madhëruar:

مَنْ يَشْفَعُ شَفَاعَةً حَسَنَةً يَكُنْ لَهُ نَصِيبٌ مِنْهَا وَمَنْ يَشْفَعُ شَفَاعَةً سَيِّئَةً يَكُنْ لَهُ كِفْلٌ مِنْهَا وَكَانَ اللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ مُقِيتًا

“Kush ofron ndihmë të mirë do të ketë pjesë nga ajo, dhe kush ofron ndihmë për ndonjë të keqe do të ngarkohet me të. All-llahu është i plotfuqishëm ndaj çdo sendi”.

(En Nisa, 85)

Po ashtu, edhe hadithi i Muhammedit a.s.

“Ndërmjetësoni dhe falni, do të shpërbleheni, ndërsa All-llahu nëpërmjet fjalës së të Dërguarit të Tij cakton çka dëshiron”.

(Sahih)

LIGJET E JASHTËZAKONSHME

NENI 60

Imami (kryetari) patjetër duhet t'i marrë parasysh rastet e jashtëzakonshme, të cilat parashihen me ligj. Nëse paraqitet rreziku i tronditjeve shtetërore, ose parashihet se ndodh kërcënim i shkatërrimit të shtetit, ose luftës qytetare, ose rreziku prej sulmit të ndonjë shteti, (atëherë Imami) merr vendime të shpejta dhe të jashtëzakonshme, me kusht që t'i paraqesë në parlament brenda një jave prej marrjes së vendimit. Nëse parlamenti nuk është formuar ende, atëherë thërret ish-parlamentin. Ligji i përcakton këto ngjarje të jashtëzakonshme dhe pasojat të cilat mund të ndodhin, po të mos merren vendime të tilla, specifikat dhe veçoritë dhe (përcakton) mënyrën e marrjes së vendimit.

Koment:

Ky nen i gjatë mund të përkufizohet kështu: Në raste të domosdoshme, Imami (kryetari) merr vendime të jashtëzakonshme të cilat i parasheh ligji, sikurse i parasheh rastet për marrjen e vendimit dhe mosmarrjen e vendimit, brenda një jave nga marrja apo mosmarrja e vendimit.

Sa i përket këtij neni sqarojmë si vijon:

“Domosdoshmëria i lejon të ndaluarat”

“Domosdoshmëria i lejon të ndaluarat aq kohë sa zgjat domosdoshmëria”

Bazë për këtë është ajeti kur'anor:

إِنَّمَا حَرَّمَ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةَ وَالدَّمَ وَلَحْمَ الْخِنْزِيرِ وَمَا أُهْلَ بِهِ لِغَيْرِ اللَّهِ فَمَنْ اضْطُرَّ
غَيْرَ بَاغٍ وَلَا عَادٍ فَلَا إِثْمَ عَلَيْهِ إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“(All-llahu) Ua ndaloi juve vetëm cofëtinën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që therret jo në emër të All-llahut. E kush detyrohet (të hajë nga këto) duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është mëkat. Vërtet All-llahu fal, është mëshirues”.

(El Bekare, 173)

Domosdoshmëria e shpëtimit të jetës e lejon ushqimin e ndaluar si cofëtinën, gjakun, mishin e derrit, mirëpo kjo leje vazhdon aq sa shpëtohet jeta, e jo për t'u ushqyer për së tepërmi me ushqimet e ndaluara. Duhet që ky lejim të caktohet deri sa të tejkalohet rreziku i jetës dhe menjëherë ato ushqime ndalohen. Nga kjo, nëse shtetit i kërcënohet rreziku për të ndodhur trazira brenda natës, ose ndonjë shtet e sulmon vendin, atëherë Imami (kryetari) merr vendime aty për aty, për ta përballuar gjendjen, për ta evituar rrezikun dhe për ta mbrojtur ummetin nga e keqja.

Situata nuk jep rast për të pritur, ajo çka kërkon një situatë e tillë është intervenimi i shpejtë.

Kushtetuta e kushtëzon Imamin (kryetarin) që brenda javës të sqarojë arsyen përse e ka marrë një vendim të tillë, me qëllim që dijetarët, të urtit, ekspertët dhe juristët të konsultohen për vazhdimin e mëtutjeshëm të situatës.

Këto situata të jashtëzakonshme dhe mënyrat e tejkallimit të tyre, fillim e mbarim, përcaktohen dhe sqarohen me ligj.

E gjithë kjo (bëhet) për të ruajtur unitetin e ummetit, ndalimin e ambicieve personale e grupe, ruajtjen e konsultimeve dhe të parlamentit.

Për këtë kemi shembull të shkëlqyeshëm te i dërguari i All-llahut s.a.v.s., se si ka vepruar ai në situatat e paqes dhe të luftës, të shpresës dhe të frikës. Ai ka qenë shëmbëlltyrë e udhëheqësit të drejtë, i afërt me sahabët, ka dhënë mendim, por edhe ka pranuar mendimin e tjerëve. Ka qenë me mish e me shpirt i angazhuar për të mirën e ummetit. Zoti i Madhëruar thotë:

فِيمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لَنتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانْفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ
فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ
إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ

“Në saje të mëshirës së All-llahut, (o Muhammed) u solle butësisht me ta, e sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Falua gabimin atyre dhe kërko falje te Allahu për ta, e konsultohu për çështje të mira të jetesës me ta. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu te All-llahu, se All-llahu me të vërtetë i do ata që mbështeten tek Ai”. (Ali Imran, 159)

KAPITULLI I GJASHTË

GJYKATA

**Përbëhet prej 22 neneve:
Prej nenit 61 deri në nenin 82.**

DREJTËSIA DHE BARAZIA

NENI 61

Gjyqi duhet të veprojë me drejtësi dhe në përputhshmëri me Sheriatin Islam.

Koment:

Kthehu në nenin 28 të kësaj kushtetute.

NENI 62

Njerëzit janë të barabartë para gjyqit. Nuk lejohet të dallohet askush, as prej personave, as prej grupeve të posaçme.

Koment:

All-llahu i Lartmadhëruar ka vendosurur të mos ketë dallim në mes të njerëzve; të atij me pozitë të lartë apo të ulët, në mes të të pasurit apo të varfrit, të arabit prej joarabit, të muslimanit prej jomuslimanit.

Drejtësia është absolute, nuk mund të ndahet, e drejta patjetër duhet të veprohet.

Zoti i Madhëruar thotë:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ إِنَّ اللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُمْ بِهِ إِنَّ اللَّهَ كَانَ سَمِيعًا بَصِيرًا

“All-llahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni”.

(En Nisa, 58)

Në një ajet tjetër, Zoti i Madhëruar thotë:

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ وَلَا تَكُنَ لِلْخَائِنِينَ خَصِيمًا

“Ne të zbritëm ty (Muhammed) librin (Kur’anin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi All-llahu. Mos u ngatërro për tradhtarët (mos u dil në ndihmë)”.

(En Nisa, 105)

Fjal “njerëz” përfshin të gjithë njerëzit, pa dallim pozite, reputacioni, pasurie, race apo feje.

Është e ndaluar të ketë gjyqe për të pasurit, ndërsa të ketë gjyqe të tjera për të varfrit, apo gjyqe për arabët, dhe të tjera për joarabët, e kështu me radhë.

Sa i përket jomuslimanëve, të cilët jetojnë në shtetin islam, ata nuk detyrohen të veprojnë atë që është në kundërshtim me ligjin e fesë së tyre. Derisa ata kanë ligje të veçanta të bazuara në fenë e tyre, ata gjykohen sipas ligjeve të fesë së tyre. Ndërsa, ajo që nuk është në kundërshtim me fenë e tyre i nënshtrohet ligjeve të muslimanëve.

Zoti i Madhëruar thotë:

سَمَاعُونَ لِلْكَذِبِ أَكْأَلُونَ لِلسُّخْتِ فَإِنْ جَاؤُوكَ فَاحْكُم بَيْنَهُمْ أَوْ أَعْرِضْ عَنْهُمْ وَإِنْ تُعْرِضْ عَنْهُمْ فَلَنْ يَضُرُّوكَ شَيْئًا وَإِنْ حَكَمْتَ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِالْقِسْطِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ

“Në qoftë se vijnë te ti (për ndonjë gjykim), gjyko mes tyre ose hiq ty. Nëse prapsesh prej tyre (nuk gjykon), ata nuk mund të sjellin ty kurrfarë dëmi. Po nëse gjykon në mes tyre, gjyko drejtë; All-llahu i do të drejtë”.

(El-Maide, 42)

Shkak i zbritjes së këtij ajeti ka qenë rasti *kur jehuditë erdhën te Muhammedi a.s. dhe i thanë se një grua dhe një burrë prej tyre kanë bërë prostitucion.*

Muhammedi a.s. u ka thënë: Po si është puna (gjykimi) në Tevrat për dënimin me vdekje? Ata i thanë: Është vetëm për t’ dënuar me shkopinj (jo me vdekje).

Abdullah bin Selame (njëri prej priftërinjve jehudë), i cili e kishte pranuar Islamin, u tha: Po gënjeni! Dënimi është me vdekje, nëse doni, bjereni Tevratin ta shohim.

E sollën Tevratin dhe e vendosën pranë, dhe njëri e shikoi, e vendosi dorën mbi ajetin e (gurëzimit) dënimit me vdekje, dhe e lexoi vetëm çka ishte para atij ajeti dhe pas atij ajeti.

Abdullah bin Selame i tha: Hiqe dorën. Pasi e hoqi dorën jehudiu, ata panë në Tevrat ajetin e dënimit me vdekje.

Jehuditë thanë: Muhammedi flet të vërtetën, sepse me të vërtetë, dënimi është me vdekje.

Muhammedi a.s. i urdhëroi dhe i dënuan me vdekje.

Transmetuesi i hadithit thotë: E kam parë se si njeriu i binte me gurë gruas (dhe i dënuan me vdekje).

Dijetarët islamë e kanë ligjësuar se jomuslimani (në shtetin islam) nuk gjykohet për atë çka nuk e ka në fenë e tij.

Nëse beson se në fenë e tij i lejohet alkooli, atij nuk i ndalohet (të pijë alkool). Nëse beson se është e ndaluar të martohet me më shumë se një grua, nuk obligohet të martohet me shumë gra.

Nëse beson se në fenë e tij nuk ka shkurorëzim, nuk obligohet t'i nënshtrohet ligjeve të shkurorëzimit.

* * *

LIGJET PUBLIKE

NENI 63

Nuk lejohet të ketë kuvende gjyqësore të fshehta, ose të pengohet pala për t'u mbrojtur për çështje të zakonshme.

Koment:

Gjyq suprem (publik) do të thotë se gjykatësi i cili sjell vendimin për dënim penal ose për kundërvajtje, nuk ka të drejtë që me një palë të veprojë ndryshe, ndërsa me një palë tjetër ndryshe, ose të bëjë dallime racore, por çdo kuvend gjyqësor duhet të jetë i njëjtë, pa përjashtim. Çdo çështje që i përket gjykatësit, ai duhet të marrë vendim të njëjtë pa dallim.

Gjykatësi është muxhtehid, i cili ka për detyrë zgjidhjen e problemeve, për këtë arsye nuk ka kurrfarë të drejte ta pengojë palën për t'u mbrojtur, por pala akuzuese ka të drejtë të sjellë dëshmi, dëshmitarë, por edhe të dalë vetë para kuvendit gjyqësor, ashtu siç kanë vepruar të parët tanë.

Nuk lejohet të themelohen kuvende gjyqësore të posaçme për persona të veçantë, që do të thotë gjyq i kurdisur, dhe gjykatësi nuk merr vendim, por urdhërohet të marrë vendim.

Kjo ndryshon në ndarjen e gjykatave në sektorë.

Lejohet që për pasuri të ketë gjykatës dhe gjyq të veçantë, po ashtu për dënime, gjykatës dhe gjyq të veçantë, po ashtu edhe për familje, gjykatës dhe gjyq të veçantë.

Pra, kjo është specializim në gjykim, dhe jo themelim i gjykatave të veçanta.

E keqja e themelimit të gjyqeve të veçanta është se ai i nënshtrohet kryetarit të shtetit, del prej sferës së drejtësisë, i revoltton palët e konfrontuara, prej gjyqit kërkohet procedurë e shpejtë dhe nuk mund të mbizotërojë drejtësia pa mbledhjen e fakteve dhe angazhimin maksimal për zgjidhjen e çështjes.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Nëse u lejohet njerëzve që të akuzojnë dhe t’iu realizohet menjëherë ajo për çka akuzojnë, atëherë njerëzit do të kërkonin (akuzonin) pa fakte pasurinë e të tjerëve dhe ekzekutimin e të tjerëve, por përbetimi është për të akuzuarin”.

Imam Neveviu thotë:

‘Në këtë hadith është një rregull shumë e rëndësishme e Sheriatit Islam: nuk pranohet akuzimi i njeriut pa fakte, por nevojitet të akuzohet me fakte ose (nevojitet) pranimi i të akuzuarit. Nëse i kërkohet përbetimi, ai duhet të përбетohet’.

Muhammedi a.s. ka sqaruar se nuk pranohet akuzimi pa fakte, sepse, po të ishte kështu, atëherë njerëzit vetëm do të akuzonin të tjerët dhe ata nuk do të mund të mbroheshin. Ndërsa akuzuesi duhet t’i sigurojë faktet.

GJYKIMI NË BAZË TË SHERIATIT ISLAM

NENI 64

Nuk lejohet të bëhet gjykimi me dyer të mbyllura, as i kryetarit, as i qeveritarit.

Koment:

Shih nenin 51 të kësaj kushtetute.

NENI 65

Vendimet e gjykatës bëhen me “Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim”, dhe Gjykatësit nuk i lejohet të vendosë diçka çka është në kundërshtim me Sheriatin Islam.

Koment:

Vendimet e gjykatës bëhen me “Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim”, sepse ato vendime kanë bazë Kur’anin dhe Sunnetin dhe që të dyja janë shpallje (vahjun) dhe inspirim prej Zotit. Vetëm se Kur’ani është shpallje (vahjun) si në fjalë, ashtu edhe në kuptim, ndërsa sunneti është shpallje (vahjun) vetëm në kuptim.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Ti (Muhammed) mos e shqipto atë (Kur’anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë! Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij. E kur ta lexojmë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij. Dhe pastaj është obligimi Ynë ta shkoqisim atë”.

(El Kijame, 16-19)

Zoti i Madhëruar e ka marrë përsipër tubimin e Kur’anit, shpjegimin dhe sqarimin e tij, e kjo bëhet edhe nëpërmjet sunnetit.

Zoti i Madhëruar ka thënë:

... وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“Ty ta zbritëm Kur’anin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre me shpresë se do ta studiojnë (Kur’anin)”.

(En Nahl, 44)

All-llahu i Lartmadhëruar me sheriatin dhe ligjet e Tij është i mëshirshëm ndaj robërve të Tij. Ashtu siç thotë Zoti i Madhëruar:

يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذَيِّبَنَّ لَكُمْ وَيَهْدِيَكُمْ سُنْنَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَيَتُوبَ عَلَيْكُمْ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ
. وَاللَّهُ يُرِيدُ أَنْ يَتُوبَ عَلَيْكُمْ وَيُرِيدُ الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الشَّهَوَاتِ أَنْ تَمِيلُوا مِيلًا عَظِيمًا
. يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُخَفِّفَ عَنْكُمْ وَخَلَقَ الْإِنْسَانَ ضَعِيفًا .

“All-llahu dëshiron t’iu sqarojë çështjet e t’iu drejtojë në rrugën e atyre që ishin para jush (pejgamberët) dhe t’iu pranojë pendimin. All-llahu e di më së miri. All-llahu dëshiron t’iu pranojë pendimin, e ata që ndjekin dëshirat e epsheve, dëshirojnë që ju të shmangeni në tërësi (nga rruga e drejtë). All-llahu dëshiron t’iu lehtësojë (dispozitat), e megjithatë njeriu është i paafte (për t’i përballuar epshtet)”.

(En Nisa, 26-28)

Për këtë arsye fjalia “*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*” (Në emër të All-llahut, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit), është çelës i të gjitha veprimtarive të njeriut.

Kjo fjali është çelës i leximit të çdo sureje të Kur’anit, përpos sures Et Tevbe. Mirëpo për mosvendosjen e saj aty, ka urtësi të veçantë. Ky ajet është përsëritur në suren En-Neml, ku Sulejmani a.s. e shkroi në fillim të letrës, të cilën ia dërgoi mbretëreshës së Sebes. Zoti i Madhëruar thotë:

قَالَتْ يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ إِنِّي أُلْقِيَ إِلَيَّ كِتَابٌ كَرِيمٌ . إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ
الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ . أَلَّا تَعْلَمُونَ عَلَيَّ وَأَتُونِي مُسْلِمِينَ .

“Ajo (gruaja-Belkisa) tha: O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore! (e lexova) Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit (Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim)!” (në vazhdim shkruan) Të mos u mbani në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (dhe besimtarë)!”.

(En Neml, 29-31)

Marrja e vendimeve dhe ekzekutimi i tyre me “BISMILAH” ka domethënie të thellë.

Gjykatësi nuk guxon t'i nënshtrohet ndonjë ligji tjetër veçse Sheriatit Islam, me parimet e tij, me rregullat e tij dhe me bazat e tij.

Ai është ligj-sheriat i mëshirës, ndërsa ligjet e tjera nuk janë ashtu. Zoti i Madhëruar thotë:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat”.

(El Enbija, 107)

Ai është ligj (sheriat) i të vërtetës, ndërsa të tjerat të jo të vërtetës. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

وَبِالْحَقِّ أَنْزَلْنَاهُ وَبِالْحَقِّ نَزَلَ ...

“Ne me urtësi (për të drejtë) e zbritëm atë (Kur'anin) dhe me urtësi është zbritur”.

(El Isra, 105)

Ai është ligj (sheriat) i të drejtës, ndërsa të tjerat të padrejtës. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

... وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمُ ...

“Jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush”.

(Esh Shura, 15)

Është ligj i plotë dhe i përkryer, ndërsa ligjet e tjera (janë) të mangëta.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

... الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا ...

“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova dhuntinë Time ndaj jush, zgjedha për ju islamin fe”.

(El Maide, 3)

Kur gjykatësi ta ndiejë në zemër kuptimin e “Bismil-lahirrrahmanirr-rahim”, ai jep maksimumin e energjisë për të arritur te e vërteta dhe te e drejta. Ai nuk është neglizhent për të mos gjetur argumente dhe për t'i sqaruar ato.

Muhammedi a.s thotë:

“Janë tre lloje gjykatësish: një në xhennet, dy në xhehennem.

Gjykatësi i cili e di të vërtetën dhe gjykon drejt është në xhennet.

Gjykatësi i cili e di të vërtetën, por gjykon me qëllim për të pavërtetën është në xhehennem.

Gjykatësi i cili gjykon pa dije ai është në xhehennem”.

* * * * *

PËRGJEGJËSIA E SHTETIT NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE (LIGJEVE)

NENI 66

Përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve (ligjeve) është shteti. Vonimi i ekzekutimit të vendimeve apo pengimi i tyre për t'u mos ekzekutuar është krim, dhe për ta merren masa ndëshkuese.

Koment:

Pas dëgjimit të dëshmive dhe analizave të argumenteve, dhe pas angazhimit maksimal, gjykatësi merr vendim, i cili është në përputhshmëri me Sheriatin, dhe menjëherë ia dorëzon organit ekzekutiv (të autorizuarit) për ekzekutimin e vendimit.

Zoti i Madhëruar thotë:

... وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ

“E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues”.

(El Maide, 44)

... وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ .

“E kush nuk vendos sipas asaj që zbrit All-llahu, ata janë mizorë (të padrejtë).”

(El Maide, 45)

... وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ .

“E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit”.

(El Maide, 47)

Të refuzohet vendimi apo gjykimi i All-llahut, ose ekzekutimi i vendimit apo i gjykimit të Tij, është mosbesim dhe dalje nga feja, ndërsa imami (kryetari) duhet të japë dorëheqje të parevokueshme

dhe të largohet nga qeveria. Kjo është prej krimeve më të mëdha, sepse është tejkalim i të drejtës së All-llahut në përkujdesjen ndaj robërve të tij, në atë çka është e mirë dhe e dobishme për ta. Është krim prej krimeve më të mëdha të mos gjykosh me drejtësi për të vërtetën dhe realitetin.

Ndërsa të mos i anashkalosh ligjet e fesë në tërësi, por të arsyetohesh se do t'i praktikojmë, por për shkak të rrethanave do ta praktikojmë më vonë, nuk konsiderohet pabesim por mëkat, i cili e shpie shtetin në rrezik, dhe i shkakton shoqërisë islame (ummetit) tollovi dhe ngatërresa. Zoti i Madhëruar thotë:

... فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ .

“Le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e Tij (të të dërguarit) se ata do t'i zërë ndonjë telashe ose do t'i godasë dënimi i hidhët”.

(En Nur, 63)

Mund të vendosen ligje për dënimin e atyre që janë neglizhentë dhe nuk i ekzekutojnë vendimet.

Ligjet për dënimin e mosekzekutimit të lëndëve apo vendimeve, janë ligje me dënim të papërcaktuar (TEAZIRË) dhe përcaktohen në bazë të peshës dhe rëndësisë së vendimit.

* * * * *

PAVARËSIA E GJYQIT

NENI 67

Shteti garanton pavarësinë e gjyqit. Cenimi i pavarësisë së gjyqit është mëkat.

Koment:

Pasi që vendimet dhe gjykimet fillojnë dhe burojnë prej fjalës Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim, atëherë mbikëqyrës i vetëm i gjykatës është feja, frika e All-llahut, duhet të ketë kujdes në vendimet që sjellë dhe në amanetin e ixhtihadit.

Shteti nuk ka të drejtë të ndërhyjë në vendimet e gjykatës, apo të përkrahë ndonjërin palë, apo të pengojë që të mos zbulohet e vërteta. Ky është krim moral dhe krim i cili sjell ngatërresa dhe shkatërrime të mëdha.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ وَتُدْلُوا بِهَا إِلَى الْحُكَّامِ لِتَأْكُلُوا فَرِيقًا مِّنْ أَمْوَالِ النَّاسِ
بِالْإِثْمِ وَأَنتُمْ تَعْلَمُونَ

“Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, e as mos u paraqitni me të (ryshfet) te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve, kur ju e dini (se pa të drejtë e hani atë)”.

(El-Bekare, 188)

Cenimi i pavarësisë së gjyqit çon drejt shkeljes së njerëzve pa të drejtë dhe humbjes së të drejtës së tyre.

Duke u nisur nga ajo se gjykatat janë të pavarura, dhe nga frika e të mos gjykuarit drejtë, Muhammedi a.s. e ka refuzuar Abdurr-Rahman bin Semreten të marrë detyrën e gjykatësit, duke i thënë:

“O Abdurr-Rrahman, mos e kërko atë post (gjykatës), pasi nëse emërohesh në atë post do të kesh përgjegjësi të madhe, ndërsa nëse emërohesh pa e kërkuar atë do të marrësh me seriozitet.”

Ebu Musa El Eshariu ka hyrë së bashku me dy djemtë e axhës së tij te i dërguari i All-llahut. Njëri prej tyre i tha: o i Dërguar i All-llahut më emëro në një pozitë qeveritare, pastaj edhe tjetri i tha po ashtu. Muhamedi a.s. iu përgjigj atyre:

“Për Zotin ne nuk i emërojmë në poste ata të cilët kanë lakmi (janë karrieristë) dhe i kërkojnë ato.”

Lakmia për post dhe kërkimi i tij janë shenja dhe argumente se ai është karrierist, dëshiron të krenohet, ndërkohë që të dyja këto cilësi janë të nënçmuara dhe bëjnë që gjykatësi të jetë larg nga drejtësia në gjykim.

Nuk është kundërgargument thënia e Jusufit a.s.:

قَالَ اجْعَلْنِي عَلَى خَزَائِنِ الْأَرْضِ إِنِّي حَفِيظٌ عَلَيْمِ

“Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm” (Jusuf, 55), sepse Jusufi a.s. ka qenë pejgamber, ndërsa pejgamberët janë të mbrojtur prej gabimeve dhe janë në përkrahje të All-llahut, ata e bartin shpalljen e Zotit dhe e praktikojnë atë. Për këtë arsye, Zoti ua ka lehtësuar çështjet dhe ua ka realizuar qëllimet. Pasi Jusufi a.s. arriti te pallati i mbretit, Zoti i Madhëruar tha:

وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ وَلِنُعَلِّمَهُ مِن تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ
وَاللَّهُ غَالِبٌ عَلَى أَمْرِهِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

“Ja kështu, Ne i bëmë vend Jusufit në tokë (në Egjipt) e që t’ia mësojmë atij shpjegimin për disa ëndrra. All-llahu është mbizotëruar i punës së vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve)”.

(Jusuf, 21)

Po ashtu, pasi Jusufi a.s. ka kërkuar të bëhet ministër i depove dhe financave, Zoti i Madhëruar thotë:

وَكَذَلِكَ مَكَّنَّا لِيُوسُفَ فِي الْأَرْضِ يَتَّبِعُوا مِنْهَا حَيْثُ يَشَاءُ نُصِيبُ بِرَحْمَتِنَا
مَنْ نَشَاءُ وَلَا نُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ

“Dhe kështu Ne Jusufit i dhamë pozitë në vend (në Egjipt) zinte vend aty ku dëshironte. Ne e pajisim me të mirat Tona atë që duam, e Ne nuk ua humbim shpërblimin punëmirëve”.

(Jusuf, 56)

Çështja, pra, ka qenë planifikim dhe rregullim prej Zotit.

Është e ndaluar dhënia e mjeteve për të arritur postin e gjykatësit, po ashtu, është e ndaluar që të marrë dhurata vetë gjykatësi, (pasi) që të dyja janë mito (ryshfet).

Në hadithin, të cilin e transmeton Davudi dhe Tirmidhiu nga ibn Amri r.a., Muhammedi a.s. ka thënë:

“E ka mallkuar Zoti atë i cili jep mito (ryshfet) dhe atë i cili merr (pranon mito-ryshfet).”

Po ashtu, dijetarët kanë theksuar se është mekruh (e papëlqyeshme) për gjykatësin të gjykojë atëherë kur ai është në gjendje jo të zakonshme dhe kur nuk mund ta gjykojë lëndën me përpikëri, p.sh. i hidhëruar, i gëzuar për së tepërmi etj.

Në Sahihun e Muslimit, transmetuar nga Abdurr-Rahman bin Ebi Bekrete, transmetohet se ka thënë: Më ka dërguar një letër prindi im dhe unë ia kam dërguar atë Abdul bin Ebi Bekrete, derisa ishte gjykatës në Sixhistan, duke i shkruar: “Mos gjyko mes palëve derisa je i hidhëruar, sepse e kam dëgjuar Muhammedin a.s. duke thënë: ***“Askush të mos gjykojë ndërkohë që ai është i hidhëruar.”***

Ndërhyrja e (Qeverisë) qeveritarit të (Gjykata) gjykatësi me kërcënime apo me benificione për të gjykuar diçka në favor të qeveritarit, është prej krimeve më të mëdha. Gjykatësi duhet t'i nënshtrohet vetëm fesë dhe ligjit të All-llahut dhe nuk guxon t'i nënshtrohet individëve të tjerë. Zoti i Madhëruar ka thënë:

وَلَا تَرْكَنُوا إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُوا فَتَمَسَّكُمُ النَّارُ وَمَا لَكُم مِّنْ دُونِ اللَّهِ
مِنْ أَوْلِيَاءٍ تُمْ لَا تَنْصُرُونَ

“Dhe mos anoni kah ata që bëjnë zullum, e për atë shkak t’iu kapë zjarri, sepse përveç All-llahut nuk keni ndonjë mbrojtës, e mbeteni të pandihmuar”.

(Hud, 113)

Në Sahihun e Muslimit transmetohet nga Ebi Hurejre se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Në Ditën e Kijametit secili do t’ia lajë të drejtën pronarit, derisa edhe delja me brirë do t’ia lajë hakun deles pa brirë”.

Po ashtu edhe në Sahihun, të cilin e transmeton Ebi Musa El Eshariu r.a., transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Vërtet All-llahu e lejon kriminelin deri në një afat (sa dëshiron Ai), mirëpo kur ta dënojë nuk mundet t’i shpëtojë dënimit.” Pastaj ka lexuar ajetin kur’anor:

وَكَذَلِكَ أَخْذُ رَبِّكَ إِذَا أَخَذَ الْقُرَىٰ وَهِيَ ظَالِمَةٌ إِنَّ أَخْذَهُ أَلِيمٌ شَدِيدٌ

“Ja kështu është ndëshkimi i Zotit tënd, kur dënon vendet që janë zullumqare, ndëshkimi i Tij është i dhimbshëm dhe i ashpër”.

(Hud, 102)

Prej këshillave më të mira është këshilla e Umer ibn Hatabit, kur i shkroi letër Ebi Musa El-Eshariut, (të cilit) i ka thënë:

“Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim. Prej robit të All-llahut, Umerit – Prijësit të muslimanëve, deri te rob i Zotit, bin Kajsi: Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ju:

Gjykimi është farz dhe sunnet i Muhammedit a.s., i cili duhet të pasohet. Nëse akuzuesi vjen te ti për ta akuzuar dikë, akuzimi i tij nuk merret parasysh pa dëshmi.

Krijë bindje tek njerëzit që kur të gjykosh ose kur të jen para teje në kuvend gjyqësor, nuk do të anosh kah pasaniku e i forti në dëm të të dobëtit dhe të varfërit, por do ta mbash në dorë peshojën e drejtësisë dhe neutralitetit.

Faktet kërkojnë prej akuzuesit, ndërsa përbetimi nga i akuzuari.

Pajtimi në mes të muslimanëve është i lejuar me kusht që e lejuara të mos bëhet e ndaluar dhe e ndaluara (të bëhet) e lejuar.

Kush akuzon pa fakte dhe argumente, bëja me dije që kurrë të mos veprojë ashtu. Nëse ka argumente gjyko me drejtësi. Nëse nuk ka fakte dhe argumente, konsideroje lëndën të zgjidhur, ky është arsyetimi më i miri dhe veprimi i dijetarëve.

Nëse sot e ke gjykuar dhe nesër kërkon ta shqyrtosh, mos të të pengojë asgjë, dhe paso rrugën e hulumtimit dhe shqyrtimit të së vërtetës. E vërteta i ka rrënjët e thella, nuk mund ta humb (ta shkulë) asgjë. Të hulumtosh të vërtetën është më mirë se të lejosh të pavërtetën.

Muslimanët janë të drejtë mes vete, përpos atij i cili dëshmon rrejshëm, ose ai i cili është dënuar për shkak të shpifjes, ose atij i cili

anon ndaj të afërmve. Zoti ka caktuar që nëpërmjet robërve të zbulohen të fshehtat, ndërsa për dënimet ka paraparë vetëm argumentet e shëndosha.

Mos u hidhëro, mos u brengos, mos u zemëro, mos u krekos, mos i nënçmo njerëzit.

Gjykimi i drejtë meriton shpërblim në ahiret dhe meriton të përmendet. Kush ka qëllim të drejtë për ta gjetur të vërtetën, mjafton që All-llahu është dëshmitar për atë që bën për njerëzit.

Zoti e pranon prej robërve të Tij vetëm sinqeritetin dhe nijetin e pastër.

Çka mendon për shpërblimin e All-llahut, mëshirën e Tij dhe furnizimin e Tij të pandërprerë?

Paqa, shpëtimi dhe mëshira e Zotit qoftë mbi ju."

Ibn Kajimi thotë:

“Kjo është këshillë (letër) e mirë, të cilën është mirë ta marrin dijetarët si bazë për gjykim, qeverisje dhe dëshmi”.

* * * * *

KUSHTET E GJYKATËSIT

NENI 68

Shteti zgjedh për gjykatës njerëzit më të mirë dhe më të ndërgjegjshëm, dhe siguron kushtet më të volitshme për punë dhe veprim.

Koment:

Fukahatë (dijetarët e shkencës së jurisprudencës) i kanë përmendur kushtet e gjykatësit, e ato janë: Të jetë

- **Mashkull**
- **I moshës madhore**
- **I mençur**
- **I lirë**
- **Musliman**
- **I ditur**
- **I drejtë**
- **T'i ketë shqisat e të dëgjuarit dhe të shikuarit.**

Tash do t'i tregojmë veç e veç, ashtu siç i ka përshkruar Ebu Jeali el-Firau, në librin e tij të korrektuar nga profesori Muhamed Hamid el-Fekiju.

- Sa i përket gjinisë: Femra ka mangësi për të qenë gjykatëse dhe për dëshmi.

Ebu Hanife e ka lejuar të jetë gjykatëse për gjërat për të cilat ka të drejtë dëshmie.

Ibn Xherir et-Taberiu thotë se ka të drejtë të gjykojë për të gjitha çështjet. Thënia e tij nuk llogaritet, pasi që ixhmai e ka dhënë mendimin dhe e ka kundërshtuar me thënien e Zotit të Madhëruar:

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ ...

“Meshkujt (burrat) janë përgjegjës për gratë, nga se Allahu ka graduar disa mbi disa të tjerë”.

(En-Nisa, 34)

dhe me thënien e Muhammedit a.s.:

“Nuk shpëton një popull që e udhëheq femra”.

(Buhari dhe Muslimi)

Sa i përket moshës madhore dhe mençurisë – fëmija dhe i çmenduri nuk kanë të drejtë për veten e tyre të vendosin, e si mund të vendosin (të gjykojnë) për tjerët?!

Po ashtu ixhtihadi dhe dëshmia e tyre nuk pranohet.

Shpjeguesi tregon edhe thënien e Mavrudit:

“Në kushtin ‘i mençur’ nuk mjafton që gjykatësi t’i dijë vetëm çështjet e natyrshme dhe të domosdoshme, por të ketë intelekt të zhvilluar, të mos harrojë lehtë, të jetë mendjemprehtë që t’i sqarojë çështjet e dyshimta dhe t’i zgjidhë çështjet”.

Sa i përket “lirisë”, kjo për shkakun se robi nuk ka kompetencë për të dëshmuar.

Autori Mavrudi shpjegon se:

“Po ashtu, edhe gjykimi i atij i cili nuk ka liri të plotë (mudebiri, mukatibi). Robëria nuk është pengesë për të dhënë fetva, as për të transmetuar hadithe.

Kur të lirohet prej robërisë ka të drejtë të jetë gjykatës.

Sa i përket kushtit “të jetë musliman”, kjo për arsye se kriminelin nuk mund ta ketë nën mbikëqyrje muslimanin, e mos të flasim për pabesimtarin.

Autori vazhdon e thotë:

Zoti i Madhëruar thotë:

... وَلَنْ يَجْعَلَ اللَّهُ لِلْكَافِرِينَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ سَبِيلًا .

“... All-llahu kurrësi nuk iu mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët”.

(En-Nisa, 141)

Mavrudi ka thënë se nuk lejohet që gjykatësi pabesimtar të jetë gjykatës i pabesimtarëve, ndërsa Ebu Hanife ka thënë se lejohet që gjykatësi të gjykojë në mes palëve të fesë së vet.

Pabesimtari mundet të jetë edhe prijës, dhe kryetar i pabesimtarëve, por sa i përket gjykimit, nuk mundet të jetë gjykatës i tyre.

Vendimi i gjykatësit të tyre është i fuqishëm për ta (pabesimtarët)

Imami (kryetari) nuk e pranon gjykimin e tij, nëse ka gjykuar në mes pabesimtarëve; dhe derisa është e ndaluar të gjykojë në mes tyre pabesimtari, atëherë gjykatësi i tyre apo vendimmarrës duhet të jetë gjykatës musliman.

Sa i përket drejtësisë, nga shkakun se kriminelin apo i padrejti është vetë i dyshimtë, ndërsa gjykimi është rrugë e amaneteve, autori citon thëniet e Mavrudit:

“Drejtësia ka të bëjë me atë se: flet të vërtetën, e kryen premtimin, nuk bën mëkate të mëdha, nuk bën veprime të dyshimta, është i qetë; edhe në kohë të mira (gëzimi) edhe në kohë të vështira (të hidhërimit) është shëmbëlltyrë për çështjet e kësaj bote dhe botës tjetër.

Sa i përket dëgjimit dhe shikimit të gjykatësit, është paraparë si kusht, për arsye se nevojitet: të dijë, të shohë dhe të dëgjojë, për ta dalluar saktësisht të mirën prej të keqes dhe që të mos ta dëmtojë askënd.

Ndërsa sa i përket aftësive të tjera të kufizuara nuk është kusht, sepse nuk mund të ndikojnë në moszgjidhjen e problemit dhe marrjen e vendimit.

Autori sqaron nga Mavrudi:

“Maliku e ka lejuar emërimin e gjykatësit të verbër, ndërsa sa i përket të shurdhëtit ka pasur mospajtime, të cilat i kemi përmendur te emërimi i imamatit (kryetarit).

Sa i përket “diturisë” (aftësisë profesionale) duhet t’i dijë patjetër ligjet e Sheriatit dhe duhet t’i dijë patjetër 4 bazat kryesore të Sheriatit, e ato janë:

E para:

Të ketë njohuri të thukët ndaj librit të All-llahut (Kur’anit), pra t’i kuptojë vendimet e Kur’anit; çka është urdhër i prerë, çka është jo i prerë; çka është i përgjithshëm (gjeneral) dhe çka nuk është i përgjithshëm por i posaçëm; çka është verbale dhe çka është i sqaruar; çka është ajet i qartë (Muhkem) dhe çka i paqartë (Muteshabih).

E dyta:

Të ketë njohuri mbi sunnetin e Muhammedit a.s. si: veprat, fjalët, rrugët apo mënyrën e kuptimit të haditheve; çka është hadith “Mutevatir” e çka është “Ahad”; çka është hadith “Sahih” (i vërtetë) dhe “Fasid” (jo i vërtetë); dhe të kuptojë shkakun e hadithit, nëse ka qenë vetëm për atë shkak, apo hadithi ka qenë i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës.

E treta:

Të ketë njohuri për vendimet e dijetarëve të parë (selef), për çështjet për të cilat ata janë pajtuar, dhe për të cilat nuk janë pajtuar, me qëllim që të marrë vendimin e “Ixhmait”, nëse është çështja për të cilën duhet marrë vendim, ose të angazhohet vetë dhe të marrë vendim siç e parasheh vetë, në çështjet për të cilat nuk janë pajtuar “Ixhmai”.

E katërta:

Të ketë njohuri për “Kijasin” (analogjinë), me qëllim që vendimi degëzor (sekondar) të jetë në përputhshmëri të plotë me vendimin bazor (kryesor).

Nëse ka njohuri për këto katër baza, ai është kompetent dhe ka aftësi të ixhtihadit dhe ka të drejtë të gjykojë dhe të japë fetva. Kush nuk i di këto katër baza nuk ka të drejtë dhe nuk ka aftësi të ixhtihadit, pra nuk ka të drejtë të japë fetva, as të gjykojë. Nëse jep vendim (gjykon), vendimi (gjykimi) i tij është i pavlefshëm, edhe nëse ka marrë vendim të drejtë (ia ka qëlluar), për arsye se nuk i ka plotësuar kushtet.

Nëse dihet se personi ka aftësi profesionale, nuk është e domosdoshme të intervistohet, sepse Muhammedi a.s. e ka emëruar Aliun r.a., gjykatës të Jemenit dhe nuk e ka intervistuar, sepse e ka ditur aftësinë e tij, mirëpo i ka këshilluar dhe ia ka tërhequr vërejtjen:

“Nëse dy palë gjykohen para teje, mos gjyko (mos merr vendim) vetëm me dëgjimin e njëres palë, por pasi ta dëgjosh edhe palën tjetër”.

Më vonë, Aliu r.a. ka deklaruar se pas kësaj thënie, kurrë nuk kam pasur problem në zgjidhjen e çështjeve.

Muhammedi a.s. e ka dërguar Muadhin në Jemen, por e ka intervistuar, duke i thënë:

“Me çka do të gjykossh?”

- Me Librin e All-llahut (u përgjigj Muadhi).

Po nëse nuk e gjen në librin e All-llahut?

- Me Sunnetin e të dërguarit të All-llahut.

Po nëse as aty nuk e gjen?

- Do të angazhohem në maksimum deri sa ta gjej të vërtetën (exhte hidu).

Autori pastaj vazhdon dhe thotë:
Ebu Hanife ka lejuar të emërohet gjykatës personi i cili nuk ka aftësi të ixhtihadit me kusht që të japë fetva dhe gjykimin e të parëve (për raste të njëjta).

Mirëpo pjesa dërmuese nuk e pranojnë, dhe emërimi i gjykatësit në mënyrë të tillë është i pavlefshëm dhe vendimet e tij janë të papranuara.

Ebu Davudi në Sunenin e tij transmeton se kur e ka emëruar Muhammedi a.s., Aliun r.a gjykatës në Jemen., Aliu i ka thënë:

“O i dërguar i All-llahut, po më emëron gjykatës, ndërsa unë jam i ri dhe nuk kam njohuri për gjykatës”.

Muhammedi a.s. i ka thënë: “Vërtet All-llahu do ta udhëzojë zemrën (mendjen) tënde, dhe do ta përforcojë gjuhën tënde, nëse para teje qëndrojnë dy palë të konfrontuara mos gjyko pa i dëgjuar të dy palët e konfrontuara, sepse kjo ndihmon në zgjedhjen e problemeve më së shumti”.

Aliu më vonë ka thënë: Sa kam qenë gjykatës, gjithmonë i kam zgjidhur problemet.

Në librin “Aunil Meabud” (vëll.III, fq.327) Mundhiri thotë:
“Këtë hadith e ka regjistruar Tirmidhiu në librin “Muhtesar” dhe është Hadith Hasen (i mirë)”.

Në hadithin, me rastin e Muadhrit, të cilin e ka transmetuar Ebu Davudi, në fund të tekstit thuhet: ***“Dhe nuk e lë çështjen të pazgjidhur”.*** Muhammedi a.s. e ka vendosur dorën e tij në gjoksin e Muadhrit dhe ka thënë:

“Falenderimi i takon All-llahut i cili të dërguarin e Pejgamberit e udhëzoi në atë mënyrë e cila i pëlqen pejgamberit të All-llahut.”

Në librin “Avnil Meabud” thuhet se, këtë hadith, Xhuzkani e ka konsideruar prej haditheve “Mevduë” (të pavërtetë), dhe ky hadith është i pavlefshëm (e kanë transmetuar një grup transmetuesish nga Shu’be). Kam shfletuar libra të transmetimeve që janë shumë të njohura dhe që nuk janë të njohura (Mesanid el Kubar ve Sugar) dhe kam pyetur edhe dijetarë, por nuk e kam gjetur tjetërkund, pos këtu, në këtë mënyrë siç është cekur më parë.

Njëri prej transmetuesve është Harith bin Amri - djali i vëllait të Mugire bin Shu’bes - ky është i panjohur dhe shokët e Muadhrit nga Humsi nuk e njohin atë, kështu që mbështetja në këtë zinxhir (person) nuk ka baza për t’u argumentuar në Sheriatin Islam.

Po nëse thuhet: Vërtet, fukahatë (dijetarët e Jurisprudencës islame) e kanë përdorur në librat e tyre dhe janë bazuar në këtë hadith, atëherë përgjigja do të ishte: Kjo ka qenë një rrugë, të cilën më pas e kanë pasuar deri sa ka ardhur rruga tjetër, e cila ka vërtetuar të kundërtën prej transmetuesve; duhet pasuar rruga e dytë, jo e para.

Në hadithin të cilin e transmeton Tirmidhiu ekziston citati: “Nuk dimë për këtë (hadith) vetëm këtë rrugë të transmetimit, ndërsa zinxhiri i transmetuesve është i këputur”.

Imami dhe Hafizi i njohur Xhemaludin el Meziju thotë: “Harith bin Amri nuk njihet (përmendet) askund tjetër përpos në këtë hadith. Po ashtu edhe Buhariu ka thënë: Nuk pranohet, nuk është i vërtetë, pasi transmetuesi është i panjohur”.

Imam Dhehebiu në librin “Mizan” thotë: “Është veçuar Ebu Aun Muhamed bin Abdullah Eth Thekafiju dhe ka thënë: Çdo hadith i cili vjen nga Harithi, por jo nga ebi Avni është i panjohur (i papranuar), ndërsa nga Harith bin Avni është i njohur (i pranuar).

Mirëpo hadithi ka shenja të mira, i cili te Umer bin Hatabi, dhe Ibni Mes’udi, Zejd bin Thabiti dhe Ibni Abasi është “Mevkuf”. Bejhekiju e ka regjistruar këtë hadith në “Sunenin” e tij dhe e ka ngritur në shkallë më të lartë³⁶.

* * * * *

³⁶ “El-Ahkam Sultaniye”, nga Ebi Jeali El-Ferai, korrektioi Muhamed Hamid El-Fekiju.

GJYKIMI NË PREZENCË TË AKUZUARIT

NENI 69

Kushtëzohet që në dënimet për krime i akuzuari të dënohet në prezencë të tij; në prezencë të mbrojtësit (avokatit) të tij, të cilin e zgjedh ai ose të cilin, nëse ai nuk e zgjedh, e zgjedh shteti.

Koment:

Dënimi në etimologji do të thotë pengim.

Në terminologji do të thotë ndëshkim në masë të caktuar me ligj (të Sheriatit Islam).

Dënimet e përcaktuara janë:

- Ekzekutimi me vdekje;
- Dënimi për prostitucion;
- Dënimi për vjedhje;
- Dënimi për kryengritje;
- Dënimi për alkool;
- Dënimi për tradhti.

Ai i cili dënohet me dënim të përcaktuar (prej Kur'anit dhe hadithit) patjetër duhet të jetë prezent para gjyqit. Ai ka të drejtë të ketë avokat-mbrojtës, ndërsa gjykatësi i ndihmon për kuptimin e terminologjive, paraqitjen e argumenteve dhe sqarimin e tyre. Nëse nuk zgjedh vetë avokat-mbrojtës, atëherë shteti i cakton atij avokat për ta mbrojtur.

Neveviu e ka lejuar gjykimin në mungesë të të akuzuarit me vrasje, duke e argumentuar me hadithin:

“Kishin shkuar në një udhëtim Abdullah bin Zejdi dhe Mehisete bin Mes’ud bin Zejdi deri në Hajber, mirëpo aty ishin ndarë, pastaj Abdullah bin Sehl in e gjen të vranë dhe e varrosin. Pasi e varrosin shkojnë te Muhammedi a.s. Huvejsete bin Mes’ud dhe Abdurrahman bin Sehl, i cili ishte më i riu. Abdurrahmani kishte shkuar të bisedojë para dy të parëve me Muhammedin a.s.

*Muhammedi a.s. kishte pyetur: **cili është më i vjetri prej juve?***

*- Pasi që bisedoi me të tre për vrasjen e Abdullah bin Sehlit. Muhammedi a.s. u tha: **“Le të përбетohen pesëdhjetë prej jush”**.*

- *Po si të përbetohemi kur asnjëri prej nesh nuk ka qenë dëshmitar, - iu përgjigjën .*

- *Atëherë do të përbetohen Jehuditë (e Hajberit) pesëdhjetë herë.*

- *Po si të pranojmë përbetimin e pabesimtarëve.*

Kur kuptoi Muhammedi a.s., se si është puna, atëherë bëri kompensimin e gjakut (pagimin e dijes). Në një transmetim tjetër Muhamedi a.s., mendoj ta zgjidhë lëndën dhe dha prej vetes së tij njëqind deve sadaka (pagim gjaku)”.

Mirëpo kjo mund të replikohet se Muhammedi a.s. nuk ka gjykuar në mungesë, por ia ka paraqitur familjes së të vrarit mënyrën e procedurës së akuzimit. Mirëpo pasi që kanë refuzuar procedurën, atëherë Muhammedi a.s., u ka dhënë (u ka paguar dijen) prej vetes së tij trashëgimtarëve për t'i ndërprerë konfrontimet dhe gjakderdhjen, dhe për të bërë pajtim të përgjithshëm (mes fiseve). Për këtë arsye, Muhammedi a.s., ose ka paguar prej vetes së tij, ose prej arkës qëndrore të muslimanëve (bejtul mal).

Prezantimi i të akuzuarit para gjykatës është çështje me rëndësi për plotësimin e drejtësisë, po ashtu, është me rëndësi të jetë edhe avokati (mbrojtësi) për të mos lejuar dyshim.

Detyra e avokatit (mbrojtësit) është të flasë të vërtetën dhe të mbrojtë të drejtën.

Në Sahihun e Muslimit, nga Umi Selemete-bashkëshortja e Muhammedit a.s., transmetohet se Muhammedi a.s. pasi ka dëgjuar palën akuzuese, ka dalë para popullit dhe ka mbajtur këtë fjalim:

“Vërtet unë jam njeri sikurse ju. Vjen akuzuesi dhe akuzon (dëshmon për veprën e tjetrit), mirëpo ndoshta ju jeni më afër ndodhisë dhe realitetit. Unë konsideroj se e flet të vërtetën dhe gjykoj (në bazë të asaj dëshmie). Kush dëshiron të shkelë të drejtën e muslimani, ta dijë se ai ka në dorë pjesën e xhehennemit”.

Vendimet e gjyqit merren në bazë të fakteve dhe në bazë të asaj që gjykatësi, pas shqyrtimit dhe analizave, e sheh më së miri, ndërsa All-llahu i di të fshehtat.

Gjykatësi mund të jetë i drejtë, por ndonjëherë vendimi i tij mund të jetë i gabuar kur atij i vijnë fakte apo dëshmi të rreme dhe të falsifikuara, ose kur mbrojtësi (avokati) nuk i frikësohet Zotit dhe sjell fakte të falsifikuara, ndërsa gjykatësi nuk e di se janë të falsifikuara dhe merr vendim të padrejtë.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

وَلَا تُجَادِلْ عَنِ الَّذِينَ يَخْتَانُونَ أَنْفُسَهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ مَنْ كَانَ خَوَانًا أَثِيمًا .
يَسْتَخْفُونَ مِنَ النَّاسِ وَلَا يَسْتَخْفُونَ مِنَ اللَّهِ وَهُوَ مَعَهُمْ إِذْ يُبَيِّتُونَ مَا لَا يَرْضَى
مِنَ الْقَوْلِ وَكَانَ اللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطًا . هَآأَنْتُمْ هَؤُلَاءِ جَادَلْتُمْ عَنْهُمْ فِي الْحَيَاةِ
الدُّنْيَا فَمَنْ يُجَادِلِ اللَّهَ عَنْهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَمْ مَنْ يَكُونُ عَلَيْهِمْ وَكِيلًا .

“Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten. All-llahu nuk e do atë që është gënjeshtar. Ata fshihen (turpërohen) prej njerëzve, e nuk turpërohen prej All-llahut, e Ai është me ta edhe kur planifikojnë fshehtas thënie me të cilat nuk është i kënaqur Ai. All-llahut nuk mund t’i shpëtojnë veprimet e tyre. Ja, ju jeni ata që i mbrojtët (gënjeshtarët) në jetën e kësaj bote, kush do të polemizojë me All-llahun për ta Ditën e Gjykimit, apo kush do t’i marrë në mbrojtje?”

(En Nisa, 107-109)

Dënimet e krimit të cilat i ka paraparë All-llahu të ngjashme me dënimin për vrasje, gurëzimin (ekzekutimi deri në vdekje) ose gozhdimi për plaçkitësin e rrugëve, ose prerjen e një pjese të trupit, ose goditjen me shkopnj, para masës së besimtarëve, të gjitha këto obligojnë zgjuarsin të plotë në ekzekutimin e këtyre ligjeve, në plotësimin e procedurës dhe në plotësimin e të gjitha kushteve për t’u mbrojtur i akuzuari.

Kjo nuk mund të arrihet pa prezencën e të akuzuarit, pa avokatin (mbrojtësin) e tij, i cili e kupton ligjin, i di qëllimet e ligjit të Sheriatit Islam dhe angazhohet për drejtësi.

Është vërtetuar se Muhammedi a.s. para ekzekutimit të dënimeve i ka vërtetuar argumentet. Ka pyetur për aftësinë mendore të të akuzuarit, i ka hulumtuar shkaqet dhe rrethanat e të akuzuarit, pastaj mënyrën e krimit. Ia ka shpjeguar të akuzuarit çka është krim dhe çka nuk është, pastaj prej të akuzuarit ka kërkuar ta pranojë gabimin, të kërkojë falje dhe të pendohet, po ashtu ka kërkuar që të heqë dorë nga deklarata.

Ja disa transmetime:

Në Sahihun e Muslimit, transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se një njeri prej muslimanëve shkoi te i dërguari i All-llahut, ndërkohë që ai ishte në xhami dhe i tha:

“O i dërguar i All-llahut kam bërë prostitucion”, ndërsa Muhammedi a.s. është kthyer prej tij (është larguar nga ai). Ai prapë i është afruar Muhammedit a.s. dhe i ka thënë: “O i dërguar i All-llahut kam bërë prostitucion”. Kështu ka vepruar katër herë. Pasi që dëshmoi për veten e tij (ka deklaruar) katër herë, i dërguari i Allahut i ka thënë: “A jeni i çmendur? Iu përgjigj - Jo! A jeni i martuar? Është përgjigjur - Po. Pastaj Muhamedi a.s. ka thënë: “Merreni dhe gurëzoheni (ekzekutojeni me vdekje)”.

Në transmetimin tjetër, nëpërmjet Xhabir bin Semrete r.a., thuhet:

“E kam parë Maiz bin Malikun, i cili ishte i shkurtër, nuk kishte këmishë, kur ka shkuar te Muhammedi a.s. dhe ka dëshmuar katër herë për veten e tij se ka bërë prostitucion. Ndërsa Muhammedi a.s. i ka thënë: Mos ndoshta vetëm e ke puthur, e ke lëmuar ose e ke prekur. Ndërsa ai është përgjigjur: Jo për Zotin, unë kam bërë prostitucion. Atëherë Muhammedi a.s. gjykoi që ai të gurëzohet (ekzekutohet)”.

Në transmetimin e Sulejman bin Beridetes nga babai i tij:

“Erdhi Maiz bin Maliku te Muhammedi a.s. dhe i tha: O i dërguar i All-llahut më pastro! Muhammedi a.s. iu përgjigj: Mjerë për ty, kërko falje prej All-llahut dhe pendohu. Pastaj nuk shkoi shumë larg dhe prapë është kthyer: O i dërguar i All-llahut më pastro!

Muhammedi a.s. prapë i tha: Mjerë për ty, kërko falje prej All-llahut dhe pendohu. Pastaj nuk shkoi shumë larg dhe prapë është kthyer dhe i ka thënë: O i dërguar i All-llahut më pastro!

Muhammedi a.s. i përsëriti prapë të njëjtat fjale deri në herën e katërt dhe e pyeti: Nga çka të të pastroj?

- Nga prostitucioni.

Muhammedi a.s. e pyeti: Mos je i çmendur?

- Iu përgjigj se nuk është i çmendur.

I dërguari s.a.v.s. i tha: ke bërë prostitucion?

- Iu përgjigj - Po!

Dhe urdhëroi të gurëzohet (ekzekutohet me vdekje)”.

Në transmetimin e Abdullah bin Burejde, nga babai i tij, thuhet:

“Maiz bin Malik el Eslemiu ka shkuar te Muhammedi a.s. dhe i a thënë: O i dërguar i All-llahut unë i kam bërë krim vetes sime, ngase kam bërë prostitucion dhe dëshiroj të më pastrosh. Muhammedi a.s. e ktheu prapë. Të nesërmen përsëri i shkoi dhe i tha: O i dërguar i All-llahut kam bërë prostitucion. Përsëri e ktheu prapë. Muhammedi a.s. dërgoi një njeri te farefisi i tij të pyesë se mos është i sëmurë psikik. Ata i kishin treguar se ai është i shëndoshë psikikisht dhe nuk ka ndonjë të metë. Kur i vjen herën e tretë prapë pyet për logjikën e tij, dhe prapë i tregojnë se ai është i shëndoshë psikikisht. Kur i vjen herën e katërt, atëherë Muhammedi a.s. urdhëroi ta hapin një varr, ta fusin aty dhe ta gurëzojnë (ekzekutojnë me vdekje)”.

* * * * *

GJYKIMI ME DYER TË HAPURA

NENI 70

Kuvendi i gjykimit duhet të jetë i hapur dhe me prezencën e masës. Nuk lejohet të jetë me dyer të mbyllura, përpos në raste kur është e domosdoshme në Sheriatin Islam.

Koment:

Gjykimi bëhet për ndërprerjen e konfrontimeve dhe mosmarrëveshjeve. Çështja, pra, është për çështjet e hapura dhe për veprimet, për të cilat nevojiten dëshmi, sqarime dhe argumente.

Kur dalin dy palë para gjykatës ata prezantojnë një veprimtari, një ndodhi prej ndodhive të shoqërisë dhe paraqesin shembullin se çka ndodh në mes të njerëzve.

Kuvendi i gjykatës me dyer të hapura është shumë me rëndësi. Prezantimi i qytetarëve në kuvend është i dobishëm se para tyre sqarohet e vërteta dhe e pavërteta, gjykohet kriminelin, tradhtari dhe njerëzit e llogaritin (e mendojnë) gjykimin në këtë botë, para gjykimit në botën tjetër.

Praktikimi i gjykimit me dyer të hapura ka bazë në Sheriat dhe argumente të forta.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

الرَّانِيَةُ وَالرَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِئَةً جَلْدَةً وَلَا تَأْخُذْكُمْ بِهِمَا رَأْفَةٌ فِي دِينِ

اللَّهِ إِن كُنْتُمْ تَوْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

وَلَيْشَهِدَ عَذَابُهُمَا طَائِفَةٌ مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ

“(Dispozitë obliguese është që) Laviren dhe lavirin t’i rrihni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që i besoni All-llahut dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh”.

(En Nur, 2)

Kuvendi i gjykatës ka qenë në xhaminë e Muhammedit a.s. ku ka prezantuar secili që ka dëshiruar. Ndërsa zbatimi apo ekzekutimi i dënimeve ka qenë në Bekië, ose në ndonjë vend ku ka pasur hapësirë, ku e kanë falur namazin e Bajramit në periferi të Medinës. Njerëzit kanë prezantuar kur është ekzekutuar dënimi dhe po ashtu kanë marrë pjesë edhe vet në ekzekutim.

Në raste të veçanta dhe të domosdoshme kur shteti ka sekrete shtetërore, lejohet të bëhet gjykimi me dyer të mbyllura, me qëllim që armiqtë e shtetit të mos përfitojnë dhe të mos marrin informata prej kuvendeve gjyqësore brenda shtetit dhe ta zbulojnë gjendjen, numrin, besimin dhe sekretet e tjera shtetërore, informata të cilat do të dëmtonin paqen dhe sigurinë e shtetit.

* * * * *

DËNIMET LIGJORE TË SHERIATIT

NENI 71

Kryesisht dënimet e Sheriatit përkufizohen në krimet e prostitucionit, shpifjes për prostitucion, hajnisë (vjedhjes), plaçkitjes (në rrugë), alkoolizmit dhe tradhtisë së fesë.

Koment:

All-llahu ka vendosur dënime të përcaktuara për krime të caktuara, ligje të cilat patjetër duhet të ekzekutohen nëse plotësohen kushtet e atyre krimeve, dhe nuk lejohet kurrësi anashkalimi i atyre dënimeve të përcaktuara.

Këto dënime janë për:

1. Prostitucion

Ky dënim është dy llojesh:

a). **Prostitucioni i të martuarit.** Pra kur një grua e martuar dhe një burrë i martuar kanë bërë prostitucion, njëkohësisht kanë qenë të moshës madhore dhe të shëndoshë psikikisht, atëherë ata dy dënohen me gurëzim deri në vdekje.

Muhammedi a.s. ka urdhëruar të gurëzohet deri në vdekje Maizi dhe Gamidiji, po ashtu kanë vepruar edhe sahabët pas tij.

Në Sahihun e Muslimit, transmetohet nga Abdullah bin Abasi se Umer bin Hatabi, ndërsa ishte ulur në minber ka thënë: “Vërtet All-llahu e ka dërguar Muhammedin a.s. për drejtësi dhe ia ka zbritur atij Kur’anin. Prej ajeteve ka zbritur edhe ajeti i gurëzimit. E lexonim dhe e praktikonim. Muhammedi a.s. ka dënuar me gurëzim, ne kemi dënuar po ashtu pas tij, dhe frikësohem se do të vijë një kohë kur njerëzit do të thonë se në librin e All-llahut nuk ka ajet të gurëzimit dhe do të humbin duke i lënë anash obligimet e All-llahut. Dënimi me gurëzim për atë i cili është i martuar, burrë apo grua, në librin e All-llahut është i vërtetë, nëse ka argumente, nëse ekziston shtatzanësia, ose nëse (mëkatari) e deklaron dhe e pranon vetë.

b). **Prostitucioni i të pamartuarit, respektivisht i të pamartuarës**
Kur i pamartuari dhe e pamartuara bëjnë prostitucion, të cilët janë të lirë, të moshës madhore dhe të shëndoshë psiqikisht, gjykohen me të rëna të shkopinjve në lëkurën e trupit njëqind herë dhe dëbohen për një vit në një vend tjetër nga vendi i tyre.
Zoti i Madhëruar thotë:

الرَّانِيَّةُ وَالرَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِئَةً جَلْدَةً
وَلَا تَأْخُذْكُمْ بِهِمَا رَأْفَةٌ فِي دِينِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ
وَلِيَشْهَدْ عَذَابَهُمَا طَائِفَةٌ مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ

“(Dispozitë obliguese është që) Laviren dhe lavirin t’i rrihni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që i besoni All-llahut dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit të tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh”.

(En Nur, 2)

Në Sahihun e Muslimit, nga Ibadete bin Samed transmetohet se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Dëgjojeni dhe pranojeni këtë ligj prej meje: Të pamartuarit dhe të pamartuarat rrihini me nga njëqind të rëna dhe dëbojini nga vendi i tyre, ndërsa të martuarit dhe të martuarat rrihini me nga njëqind të rëna dhe gurëzohjini deri në vdekje”.

2. Shpifje (për prostitucion)

Akuzimi për prostitucion pa paraqitur fakte dhe argumente të cilat i ka paraparë Sheriati Islam quhet Kadhf - cenimi i nderit apo shpifje për prostitucion. Dënimi për këtë lloj krimi është tetëdhjetë të rëna. Zoti i Madhëruar thotë:

وَالَّذِينَ يَزْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوا بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَاجْلِدُوهُمْ ثَمَانِينَ جَلْدَةً
وَلَا يَقْبَلُوا لَهُمْ شَهَادَةٌ أَبَدًا وَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

“Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë t’i rrihni ata me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoni dëshminë kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm”.

(En Nur, 4)

3. Vjedhje (hajni)

Marrja e pasurisë së pronësuar me pronësim të plotë.

Dënimi për vjedhje është prerja e dorës së djathtë deri në nyje, e nëse vjedh për së dyti, i prehet këmba e majtë deri në zog të këmbës. Nëse vjedhë herën e tretë i pritet dora e majtë dhe nëse vjedhë herën e katërt i prehet këmba e djathtë.

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket minimumit të pasurisë së vjedhur (Nisabi). Disa kanë thënë $\frac{1}{4}$ e dinarit, ose katër dinarë, ose tre derhem, ose dhjetë, ose katërdhjetë. Ndërsa drejtimi dhahirij nuk e kushtëzon fare minimumin e shumës, por mendon se duhet të dënohet (me prerje të dorës) pa marrë parasysh se a ka vjedhur shumë apo pak.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا جَزَاءً بِمَا كَسَبَا نَكَالًا مِّنَ اللَّهِ
وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

“Vjedhësit dhe vjedhëses prejuani duart, si shpagim i veprës që bënë, (kjo masë është) dënim nga All-llahu. All-llahu është i fuqishëm, ligdhënës i urtë”.

(El Maide, 38)

Në Sahihun e Muslimit, transmetohet nga Aisha r.a. se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Për Zotin nëse edhe Fatimja bija (ime) e Muhammedit a.s. të kishte vjedhur do t’iu kishte prerë dora”.

4. Plaçkitje në rrugë (krim i organizuar)

Kur plaçkitësit u zënë rrugët njerëzve, i terrorizojnë ata, plaçkitin pasurinë e shoqërisë, vrasin kalimtarët me armët që i mbajnë pa leje – me fjalë tjera bëjnë krim të organizuar, Zoti i Madhëruar thotë:

إِنَّمَا جَزَاءُ الَّذِينَ يُحَارِبُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا أَنْ يُقَتَّلُوا أَوْ يُصَلَّبُوا أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ مِّنْ خِلَافٍ أَوْ يُنْفَوْا مِنَ الْأَرْضِ ذَلِكَ لَهُمْ خِزْيٌ فِي الدُّنْيَا وَلَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ

“Dënimi i atyre që luftojnë (kundërshtojnë) All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëm se të mbyten, ose të gozhdohen, ose (të gjymtohen), t’u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në dunja dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh”.

(El Maide, 33)

Sa i përket këtij ajeti Fukahatë (dijetarët më eminentë të jurisprudencës islame) kanë dhënë tre mendime:

1). Mendimi i Seid bin el Musajeb, Muxhahidit, Ataут, Ibrahim En Nahijut është se imami (kryetari) ka të drejtë të zgjedhë; ose t’i ekzekutojë, ose t’i ekzekutojë e pastaj ashtu të ekzekutuar t’i kryqëzojë; ose t’ua presë duart dhe këmbët e tyre; ose t’i dëbojë në një vend tjetër. Ai bën atë që parasheh se është më e dobishme për shoqërinë dhe më e efektshme për pengimin e shkatërrimtarëve.

2). Maliku dhe një pjesë e fukahave të Medinës mendojnë se dispozitat (vendimet) janë të ndërlidhura me cilësitë e kriminelit. Për shembull, kush planifikon atentat ndaj Imamit (Kryetarit) nuk i falet. Kush është arrogant dhe sillet me ashpërsi i priten duart dhe këmbët. Kush nuk është arrogant i tërhiqet vërejtja dhe burgoset.

3). Mendimi i Ibni Abasit, Hasanit, Katadës, Shafiiut dhe Ahmedit, është se dispozitat (vendimet) janë të ndërlidhura me veprimet konkrete. Kush vret dhe vjedh, vritet dhe kryqëzohet; ndërsa kush vjedh dhe nuk vret, i prihet njëra dorë dhe njëra këmbë; kush mban armë pa lejë, kërcënon, nuk plaçkit dhe nuk vret, dënohet me burgim ose me dënim prej një vendi në tjetrin.

5. Alkool

Në jurisprudencën islame alkool quhet pija e cila të deh, pa marrë parasysh prej cilës pemë prodhohet, prej rrushit apo jo, dhe pa marrë parasysh a është pak, apo shumë.

Në Sahihun e Muslimit transmetohet nga Enes bin Maliku:

“Muhamedit a.s. i ka ardhur një njeri i cili kishte pirë alkool, të cilin e ka rrahur me katërdhjetë të rëna. Po kështu ka vepruar edhe Ebu Bekri. Kur është emëruar Umeri halif, është konsultuar me sahabët, atëherë Abdurrahmani ka thënë se minimumi i dënimeve të caktuara (hudud) është tetëdhjetë të rëna, dhe Umeri e ka praktikuar ashtu.”

Në një transmetim tjetër thuhet kështu:

“Muhammedi a.s. për alkool ka dënuar me katërdhjetë të rëna, pastaj Ebu Bekri ka dënuar me katërdhjetë të rëna, ndërsa në kohën e hilafetit të Umerit r.a., në periferi ku kishte fusha me rrush, njerëzit kishin filluar të pinë me të madhe. Atëherë Umeri i ka pyetur shokët: çka mendoni për dënimin e alkoolit? Abdurrahman bin Aufi ka thënë: Dënimi të jetë minimumi i dënimeve të caktuara e a jo është tetëdhjetë, kështu që Umeri ka dënuar me tetëdhjetë të rëna”.

6. Tradhti të fesë (apostazi)

“Murted” – tradhtar apo i larguar prej feje quhet muslimani i cili e mohon fenë dhe mohon çka është e domosdoshme në fe.

Tradhtari i fesë është tradhtar i shoqërisë, shkatërrues i vlerave dhe karakterit dhe u sjell telashe muslimanëve.

Nëse nuk kthehet në Islam, atëherë ekzekutohet, duke u bazuar në thënien e Muhamedit a.s.:

“Nuk lejohet vrasja (ekzekutimi) i muslimanit i cili dëshmon se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut dhe Muhammedi a.s. është i dërguar i Tij, veçse në tre raste: për të martuarin që bën prostitucion, vrasësin dhe tradhtarin e fesë i cili ndahet prej shoqërisë”.

Ebu Jeali el Ferau thotë:

“Për tradhtarin e fesë nuk ka marrëveshje, as xhizje, nuk hahet mishi (i prerë) prej tij dhe nuk lejohet martesë me të. Nëse vritet nuk i falet namazi i kufomës, nuk pastrohet dhe nuk varroset në varret e muslimanëve për shkak të tradhtisë, po ashtu nuk varroset në varret e idhujtarëve, por varroset vetëm, ndërsa pasuria e tij mbetet në fondin e muslimanëve (bejtul mal), atë nuk mund ta trashëgojë as muslimani as pabesimtari³⁷.”

³⁷ “El-Ahkam Sultaniye”, nga Ebi Jeali El-Feraï, korrektioi Muhamed Hamid El-Fekiju.

DËNIMET E TJERA (TË PAPËRCAKTUARA)

NENI 72

Koment:

Në mes njerëzve ndodhin probleme dhe konfrontime, varësisht prej veprimtarive dhe kontratave në mes tyre. Zoti i Madhëruar ka paraparë dënime të caktuara dhe fikse, çka nuk lejohet as të shtojmë diçka në ato dënime, as të pakësojmë (lehtësojmë), nëse plotësohen kushtet. Ato janë dënimi për prostitucion, vjedhje, plaçkitje, alkool, tradhti feje dhe ekzekutimi për vrasje - nëse familjari ia fal ose ia jep dëmshpërblimin e pagimit të gjakut, atëherë nuk ekzekutohet.

Përpos këtyre dënimeve të caktuara, për dënimet e tjera nevojitet të konsultohen dijetarët për vendosjen e ligjeve për dënime të cilat janë të përshtatshme dhe kanë efekte pozitive për pengimin e krimeve. Nuk lejohet që secili gjyqtar të gjykojë si e parasheh vetë, por si e parasheh ligji për kundërvajtje për kryerjen e veprimeve përkatëse.

“Teazir” do të thotë pengim, ndërsa në Sheriatin Islam (terminologjinë juridike) quhet dënimi i papërcaktuar me Sheriat Islam.

Dijetarët më eminentë të jurisprudencës islame kanë dhënë mendime të ndryshme përse i përket masës së dënimit. Disa mendojnë se nuk mund të arrijë më shumë se dënimi për alkool. Disa mendojnë se mund të arrijë deri në maksimum të dënimeve të përcaktuara (hudud), e ai është ekzekutimi. Kjo është në kompetencë të Imamit respektivisht Qeverisë, e cila i lë duart e hapura, si e parasheh Organi Juridik.

* * * * *

NDIKIMI I PENDIMIT NË ZBUTJEN E DËNIMIT

NENI 73

Koment:

Shih nenin 35 të kësaj kushtetute.

NENI 74

Ligji i sqaron kushtet e pranimit të pendimit.

Koment:

Është me shumë rëndësi të dihet të dallohet falja e gabimit dhe pendimi për gabimin e bërë.

Falja e gabimit mund të bëhet prej Imamit, ose prej të dëmtuarit.

Pendimi bëhet vetëm prej dëmtuesit, kryerësit të veprimit.

Faljen e gabimit prej imamit e ka caktuar neni 59 i kësaj kushtetute.

Falja e gabimit, por jo edhe për ndëshkimet e përcaktuara fikse (hudud), mund të bëhet vetëm si është e paraparë me ligj. Imami (kryetari) ka të drejtë ta falë dënimin me kushte të posaçme, por jo dënimet fikse (hudud) dhe tradhtinë e shtetit.

Falja e gabimit prej të dëmtuarit është e paraparë në Islam dhe është rregullim i marrëdhënieve shoqërore dhe rregull i etikës e moralit.

Zoti i Madhëruar e ka përmend faljen në ajetin e hakmarrjes:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الْقِصَاصُ فِي الْقَتْلَى الْحُرُّ بِالْحُرِّ وَالْعَبْدُ بِالْعَبْدِ
وَالْأُنثَى بِالْأُنثَى فَمَنْ عَفِيَ لَهُ مِنْ أَخِيهِ شَيْءٌ فَاتَّبِعْ بِالْمَعْرُوفِ وَأَدَاءٌ إِلَيْهِ
بِإِحْسَانٍ ذَلِكَ تَخْفِيفٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَرَحْمَةٌ فَمَنِ اعْتَدَى بَعْدَ ذَلِكَ فَلَهُ عَذَابٌ أَلِيمٌ

“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënimin për mbytje: i liri për të lirin, rob për robin, femra për femrën. Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet (e atij që fal) kuptueshëm dhe shpagimi (nga dorasi) atij le t’i bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj. E kush tejkalon pas këtij (pajtimi), ai ka një dënim të hidhët”.

(El Bekare, 178)

Po ashtu Zoti i Madhëruar ka përmendur edhe mospajtimet bashkëshortore dhe të drejtat bashkëshortore. Zoti i Madhëruar thotë:

وَإِنْ طَلَّقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ وَقَدْ فَرَضْتُمْ لَهُنَّ فَرِيضَةً فَنِصْفُ مَا فَرَضْتُمْ إِلَّا أَنْ يَعْفُونَ أَوْ يَعْفُوَ الَّذِي بِيَدِهِ عُقْدَةُ النِّكَاحِ وَأَنْ تَعْفُوا أَقْرَبُ لِلتَّقْوَى وَلَا تَنْسُوا الْفَضْلَ بَيْنَكُمْ إِنَّ اللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ

“E nëse i lëshoni ato para se të kontaktoni, por u keni pas caktuar atyre një caktim (të kurorës), atëherë duhet t’u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveç nëse ato ua falin, ose ua fal ai në duart e të cilit është lidhja e kurorës. E të falni (burra ose gra) është më afër devotshmërisë, e mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush. Vërtet All-llahu sheh atë që veproni”.

(El Bekare, 237)

Po ashtu All-llahu ka përmendur edhe marrëdhëniet shoqërore:

وَجَزَاءُ سَيِّئَةٍ سَيِّئَةٌ مِثْلُهَا فَمَنْ عَفَا وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ

“Ndëshkimi i të keqes, bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët”.

(Esh Shura, 40)

Pendimi i gabimit është dy llojesh:

Lloji i parë ka të bëjë me të drejtat dhe obligimet ndaj All-llahut si lënia e namazit, mosagjërimi pa arsyetim, përqaftimi i femrës jashtëmartesore etj.

Pendimi nga këto mëkate bëhet vetëm duke u larguar nga ato, duke vendosur që mos të kthehet më në ato mëkate dhe të bëjë sa më shumë vepra të mira.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَأَقِمِ الصَّلَاةَ طَرَفِي النَّهَارِ وَزُلْفَا مَنْ اللَّيْلِ إِنَّ الْحَسَنَاتِ يُذْهِبْنَ السَّيِّئَاتِ
ذَلِكَ ذِكْرِي لِلذَّاكِرِينَ

“Dhe fale namazin në dy skajet e ditës, e edhe në orët e afërta (me ditën) të natës. S’ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat. Kjo është një këshillë për ata që pranojnë këshillat”.

(Hud, 114)

Lloji i dytë ka të bëjë me të drejtat e robërve dhe ndahet në dy kategori.

- **E para:** Veprat e fshehta ose veprat e hapta, por që nuk kanë të bëjnë me dënimet, ose kanë të bëjnë me dënimet, por nuk ka arritur në shkallën për të dalë para gjyqit.

Pendimi në këto raste bëhet duke i kërkuar falje të dëmtuarit dhe duke ia kthyer (kompesuar) të dëmtuarit. Falja e gabimeve dhe toleranca është e kërkuar në Sheriatin Islam që të bëhet lidhja e marrëdhënieve shoqërore dhe bashkimi i zemrave.

Në Sahihun e Buhariut, nga Ebi Hurejre r. a. transmetohet se Muhammedi a.s. ka thënë :

“Kush i ka bërë padrejtësi vëllait të tij, në nder ose në diçka tjetër, le ta zgjidhë sot, para se të vijë Dita, kur nuk do të ketë as dinarë, as dërhëm; nëse ka vepra të mira, do t’i merren atij në masë të padrejtësisë të cilën e ka bërë, nëse nuk ka të mira, atëherë ngarkohet me të këqijat e atij të cilit i ka bërë padrejtësi”.

- **E dyta:** Padrejtësitë të cilat i ka bërë haptazi para njerëzve dhe (për të cilat) ka argumente, e pastaj ngrihet aktpadia në gjyqi dhe hyn në ligjin e dënimeve, pa marrë parasysh a janë të shkallës së parë (dënime të caktuara fiks - hudud) ose të shkallës së dytë - dënime të papërcaktuara.

Këtu gjykatësi gjykon vetëm në bazë të ngritjes së aktpadisë, e cila i ka plotësuar kushtet.

Pendimi në këto raste nuk e heq dënimin, sepse dënimet janë e drejtë e shoqërisë, në përgjithësi, për pengimin apo ndalimin e kriminelëve.

Duhet, patjetër, që të bëhet barazimi i krimit me dënimin e paraparë, me qëllim që njerëzit ta respektojnë ligjin.

Muhammedi a.s. e ka ekzekutuar dënimin e krimit edhe pse kryerësi i veprës është penduar, kështu që, Qeveritari (Gjykatësi) nuk ka të drejtë të heqë dënimin, sepse pendimi është vepër e cila bëhet para All-llahut të Lartmadhëruar dhe nuk bie ndesh me të drejtën shoqërore, e cila i mbron qytetarët.

Pasi që është gurëzuar (ekzekutuar me vdekje) Maizi, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Është penduar me një pendim të singertë, saqë po të shpërndahej pendimi (i tij) do ta përfshinte (mjaftonte për) tërë shoqërinë”.

Po ashtu, edhe kur është gurëzuar Gamidije, Muhammedi a.s. ka thënë: ***“Është penduar me një pendim të singertë, sa që po të shpërndahej në 70 qytetarë të Medinës do t’i përfshinte (t’u mjaftonte)”.***

A ka pendim më të mirë se sa pendimi para All-llahut të Lartmadhëruar i cili e pranon (atë)?

Ndërsa kur kanë kërkuar për të ndërmjetësuar te Muhammedi a.s., nëpërmjet Usame bin Zejdit që mos t’i prihet dora gruas El Mahzumije, Muhammedi a.s. e ka refuzuar Usamen duke i thënë:

“Sikur Fatimja, e bija e Muhammedit a.s., të vidhte do t’i prihej dora!”.

Aisha r.a. ka thënë: “Mazumija është penduar, është martuar dhe vinte vazhdimisht tek unë, dhe i tregoja (për këtë) Muhammedit a.s.”

Ajeti i pendimit, i cili vjen pas ajetit të dënimit për vjedhje, nuk do të thotë mosekzekutim i dënimit.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا جَزَاءُ بِمَا كَسَبَا نَكَالًا مِّنَ اللَّهِ
وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ . فَمَن تَابَ مِن بَعْدِ ظُلْمِهِ وَأَصْلَحَ فَإِنَّ اللَّهَ يَتُوبُ عَلَيْهِ
إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ .

“Vjedhësit dhe vjedhëses prejuani duart, si shpagim i veprës që bënë (kjo masë është) dënim nga All-llahu. All-llahu është i fuqishëm, ligjdhënës i urtë. E kush pendohet pas punës së keqe (vjedhjes) dhe përmirësohet, s’ka dyshim, All-llahu ia pranon atij pendimin, All-llahu është që fal shumë, është mëshirues”.

(El Maide, 38-39)

Vazhdimi i ajetit “E kush pendohet pas punës së keqe”, nuk ka për qëllim mosekzekutimin e dënimit, por e hap derën e shpresës për jetë të re, para All-llahut dhe para njerëzve, për atë vjedhës që të jetojë i ndershëm dhe jeta e tij të jetë e sigurt dhe e garantuar.

Le të lexojmë fjalën e All-llahut në ajetin:

وَالَّذِينَ يَرْمُونَ الْمُحْصَنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَأْتُوا بِأَرْبَعَةِ شُهَدَاءَ فَاجْلِدُوهُمْ ثَمَانِينَ جَلْدَةً وَلَا تَقْبَلُوا لَهُمْ شَهَادَةً أَبَدًا وَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ . إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِنْ بَعْدِ ذَلِكَ وَأَصْلَحُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَحِيمٌ .

“Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t’i rrihni ata me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoi dëshminë kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm. Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen dhe përmirësohen, vërtet All-llahu është që fal shumë e mëshiron”.

(En Nur, 4-5)

Fjala “Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen”, nuk ka për qëllim mosekzekutimin e dënimit, pasi që gjykata ka marrë vendim, por përjashtimin nga fisku ose shkatërrimi kjo rezulton nga fjala “ata janë të pabesueshëm - shkatërrimtarë”. Pranohej “dëshmia” e atij që pendohet dhe përmirësohet dhe i hiqet vetia e “fiskut” për mospranimin e dëshmisë.

Në Kur’an lexojmë fjalën e Zotit të Lartmadhëruar ku tregon cilësitë e robërve të mirë:

وَالَّذِينَ لَا يَدْعُونَ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ وَلَا يَقْتُلُونَ النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَا يَزْنُونَ وَمَنْ يَفْعَلْ ذَلِكَ يَلْقَ أَثَامًا . يُضَاعَفْ لَهُ الْعَذَابُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَيَخْلُدْ فِيهِ مُهَانًا . إِلَّا مَنْ تَابَ وَآمَنَ وَعَمِلَ عَمَلًا صَالِحًا فَأُولَئِكَ يُبَدِّلُ اللَّهُ سَيِّئَاتِهِمْ حَسَنَاتٍ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا .

“Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin ndonjë Zot tjetër dhe nuk e mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai e gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi Ditën e Kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu ua shndërron të këqijat në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai fal shumë”.

(El Furkan, 68-71)

Pra fjalia përjashtuese “Përveç atij që është penduar”, nuk do të thotë që penduesi i krimit për idhujtari, për vrasje e kurvëri, të mos dënohet pasi që gjykata merr vendim, sepse kjo nuk përputhet me ligjin e All-llahut të Lartmadhëruar.

Po të ishte puna ashtu, çdo kriminel do të pendohej dhe kurrë nuk do të kishte dënime. Por fjalia “përjashtuese” “ata që pendohen”, ka për qëllim që krimineli ta ndiejë veten se ka gabuar dhe në të ardhmen të përmirësohet, të pastrohet dhe të dalë në dritë të jetës së vërtetë pa presione dhe pa brenga të brendshme, dhe zemërçelë para All-llahut të Madhëruar.

Të shikojmë tani ajetet e plaçkitësit të rrugëve:

إِنَّمَا جَزَاءُ الَّذِينَ يُحَارِبُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا أَنْ يُقَتَّلُوا أَوْ يُصَلَّبُوا أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ مِّنْ خِلَافٍ أَوْ يُنْفَوْا مِنَ الْأَرْضِ ذَلِكَ لَهُمْ خِزْيٌ فِي الدُّنْيَا وَلَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ

“Dënimi i atyre që luftojnë (kundërshtojnë) All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose (të gjymtohen), t’u priten duart dhe këmbët e tyre (të anëve të kundërta), ose të dëbohen nga vendi. Kjo (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në dunja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh”.

(El Maide, 33)

Fjala përjashtuese në vazhdim të ajetit “Përveç atyre që janë penduar para se t’i kapni”, ndoshta duket se është në kundërshtim me mendimin tonë, mirëpo këtu pendimi është para se të dalin para gjyqit dhe para ndalimit (burgosjes së tyre) dhe para akuzimit të tyre (pra këtu është fjala për amnistinë).

Këtu, amnistia bëhet kur pendohet apo është penduar para arrestimit dhe para marrjes së vendimit nga gjykata për vrasje, gozhdim, prerje të duarve, të këmbëve dhe deportimin (apo burgosjen) e tyre. Mirëpo nëse pendohet te dënimet e ashtuquajtura Kisas, siç është rasti te dënimi për vrasje me qëllim apo te vjedhja, nuk ka amnisti. Me fjalë të tjera vetëm i dëmtuari (familja e të vrarit) ka të drejtë ta amnistojë ose ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin, po ashtu edhe i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë sendin e vjedhur.

Në fund: do të kisha kërkuar heqjen e këtij neni nga kushtetuta, se pendimi nuk mund të ndryshojë shumë dënimin, pasi të merret vendimi i gjyqit. Pendimi ka të bëjë në raport me All-llahun e Lartmadhëruar, jo në raport me njerëzit. Të drejtat e njeriut duhet të mbrohen dhe duhet të parandalohen kriminelët.

* * * * *

DËNIMI ME VDEKJE

NENI 75

Nuk ka dënim me vdekje për krimin e vrasjes, veçse nëse familjari i të vrarit nuk ia fal, ose nuk pajtohet (që të mos dënohet me vdekje).

Koment:

Prej qëllimeve kryesore të Sheriatit Islam është mbrojtja e jetës së njeriut. Shpirti (jeta) është krijesë e All-llahut dhe mallkohet kush e shuan apo e shkatërron atë.

Jeta është e shenjtë. Përgjegjësinë e jetës së njeriut e mban Kabili, djali i Ademit, prej momentit kur e ka vrarë vëllain e tij Habilin, pa arsye dhe pa kurrfarë faji. Zoti i Madhëruar thotë:

فَطَوَّعَتْ لَهُ نَفْسُهُ قَتْلَ أَخِيهِ فَقَتَلَهُ فَأَصْبَحَ مِنَ الْخَاسِرِينَ

“Atëherë epshi i tij e bindi atë për mbytjen e të vëllait dhe e mbyti atë. Ai mbeti prej më të dëshpëruarve”.

(El Maide, 30)

Në Sahihun e Muslimit, Abdullahu transmeton se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush vret një njeri të pafajshëm do të jetë përgjegjës së bashku me djalin e parë të Ademit, sepse ai është i pari i cili ka vrarë njeri”.

Në Ditën e Kijametit kur All-llahu do t’i ringjallë të gjitha gjeneratat (të parat dhe të fundit) dhe do të gjykojë, çështja e vrasjes do të jetë pyetja dhe përgjegjësia e parë sepse i takon të drejtave të njeriut. Në Sahihun e Muslimit, Abdullahu transmeton se

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Çështja e parë për të cilën do të gjykoen njerëzit, për marrëdhëniet në mes vete, do të jetë vrasja”.

Kur njeriu vritet me qëllim, ngrihet aktpadia, ndalet (burgoset) krimineli dhe vendimi i Sheriatit është “Kisasi” (dënimi me vdekje) ose falja me kompensim (shpagim të gjakut) ose pa të.

Mirëpo deri te ky vendim duhet të kalohen dy faza:

E para:Kur familjarët (kujdestari) nuk pajtohet dhe nuk ia fal dorasit.

E dyta:Kur familjarët nuk e pranojnë DIJEN (shpagimin e gjakut) dhe insistojnë vetëm në ekzekutim.

Nëse ndonjëri i familjes ia fal, por të tjerët jo, hakmarrja nuk mund të pjesëtohet, atëherë mbetet vetëm DIJA (shpagimi i gjakut).

Nëse në mesin e familjarëve ka të vegjël ose të çmendur, atëherë të tjerët duhet të presin deri sa të rritet fëmija (ose të kthjellohet i çmenduri), që edhe ai të vendosë.

Ebu Hanifja dhe Maliku mendojnë se “gjykimi” për hakmarrje nuk mund të vonohet për shkak të tyre.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

وَلَا تَقْتُلُوا النَّفْسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ وَمَنْ قُتِلَ مَظْلُومًا
فَقَدْ جَعَلْنَا لَوْلِيٍّ سُلْطَانًا فَلَا يُسْرِفُ فِي الْقَتْلِ إِنَّهُ كَانَ مَنْصُورًا

“E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos e kalojë kufirin në mbytje, derisa ai është i ndihmuar (prej Zotit)”.

(El Isra, 33)

* * * * *

NENI 76

Lejohet pajtimi me marrëveshje për hakmarrje (kisas) me më shumë se një DIJE (shpagim).

Koment:

Shih nenin 35 për DIJEN dhe llojet e tij. Mirëpo vlen të shtojmë se kujdestari i të vrarit dhe familja e tij nëse pajtohen që të mos dënohet me vdekje, por kërkojnë shpagim (të gjakut) në të holla, atëherë nuk ka pengesë në Sheriatin Islam, pa marrë parasysh nëse shuma e kërkuar e tejkalon sa është e paraparë në Sheriat apo jo.

Çdo pajtim është i lejuar në mesin e muslimanëve, veçse jo në lejimin e haramit.

Kjo ndryshon nga vendimi i gjyqit, pasi Gjykatësi duhet të vendosë në bazë të ligjit, as mos t'ia shtojë as mos t'ia pakësojë dënimin. Nëse dënimi me vdekje nuk mund të realizohet për shkak të rrethanave të ndryshme dhe kërkohet vendimi i gjyqit, atëherë gjyqi mund të vendosë për shpagimin (DIJEN), i cili është e paraparë në Sheriatin Islam, e ajo është 100 deve, ose 200 lopë, ose 1000 dele.

Nëse këto kafshë nuk gjinden në atë vend, atëherë paguhet në kundërvlerë, disa mendojnë se duhet të paguhet 12 000 dërhëm.

* * * * *

BARAZIMI I “DIJES” SË DY GJINIVE

NENI 77

Lejohet barazimi i “DIJES” së dy gjinive.

Koment:

“DIJA” e cila është e paraparë në Sheriatin Islam nuk bën dallim në gjini. Që të dy janë të barabartë para All-llahut, dhe që të dy kanë të drejtë jete në këtë botë.

Zoti i Madhëruar thotë:

مِنْ أَجْلِ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَى بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنَّهُ مَنْ قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا ...

“Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush e mbyt një njeri (pa të drejtë) pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t’i kishte mbytur të gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai i gjallë) është si t’i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit”.

(El Maide, 32)

Kisasi (hakmarrja) është e ligjësuar edhe për femrën, edhe për mashkullin, po ashtu edhe shpagimi (DIJA) është i barabartë. Ndërsa teksti kur’anor “i liri për të lirin, rob për robin dhe femra për femrën” nuk nuk do të thotë se i liri dënohet vetëm për të lirin, e nuk dënohet me vdekje edhe për robin apo për femrën, ose rob dënohet vetëm për robin dhe nuk dënohet edhe për të lirin apo për femrën. Por qëllimi është që të mos kalohet vrasja te tjerët, pra të dënohen të tjerët përpos dorasit.

Sipas Sheriatit nuk lejohet që dorasi të jetë rob dhe të dënohet i liri i zotëriut të tij, ose dorasi të jetë femër e të dënohet ndonjë mashkull i familjes së saj, e kështu me radhë.

Njerëzit janë të barabartë dhe nuk kanë dallim gjinie, lloji apo feje dhe dënimi i krimit nuk kalon te të tjerët, por vetëm te vepërkryerësi.

Në Sahihun e Muslimit, nga Enesi r.a. transmetohet se *një jehudi e kishte mbytur një robërshë të ensarëve, pastaj e kishte thyer kokën e saj dhe e kishte hedhur në një humnerë. Pasi e kishin kapur (zënë), Muhammedi a.s. kishte urdhëruar që të gurëzohej deri sa të vdiste, dhe ashtu është bërë.*

Imam Neveviu thotë:

“Nga hadithi përfitohen shumë çështje:

- Dënimi i mashkullit për femrën. Ky mendim është mendim unanimit të gjithë dijetarëve islamë.

- Vrasja me qëllim ekzekutohet në të njëjtën mënyrë si ka ndodhur vrasja apo krimi. Nëse ka ndodhur vrasja me shpatë, ekzekutimi bëhet me shpatë, nëse ka ndodhur mbytja me gurë, ekzekutimi bëhet me gurë. Jehudiu e kishte mbytur femrën me gurë, prandaj ashtu edhe është gurëzuar.

Prej nenit të kësaj kushtetute propozoj që të hiqet fjala “lejohej” dhe të formulohet kështu:

“DIJA” – shpagimi edhe i femrës, edhe i mashkullit të jetë i barabartë”.

* * * * *

LIGJET PUBLIKE

NENI 78

Nëse plotësohen kushtet e hakmarrjes për pjesët e trupit, hakmarrja duhet të bëhet në mënyrë të njëjtë dhe precize.

Nëse plotësohen kushtet e hakmarrjes, atëherë gjykatësi (gjykata) merr vendim që hakmarrja në pjesët e trupit të bëhet e njëjtë, e plotë dhe precize.

Koment:

Dënimi për krimin e vrasjes dhe dënimi për pjesët e tjera të trupit është i argumentuar në ajetin kur'anor:

وَكَتَبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ
وَالْأَذْنَ بِالْأَذْنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ فَمَن تَصَدَّقَ بِهِ فَهُوَ كَفَّارَةٌ لَهُ
وَمَن لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

“Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmasat ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e fal atë (hakmarrjen) ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti All-llahu, ata janë mizorë (të padrejtë)”.

(El Maide, 45)

Ligjet e Zotit (të popujve) para nesh, janë të lidhura (të vlefshme) edhe për ne, vetëm nëse janë shfuqizuar prej Zotit. Kur'ani fisnik dhe famëlartë, ka paraparë ndëshkimin në të njëjtën masë edhe në ajet tjetër. Zoti i Madhëruar thotë:

وَإِنْ عَاقَبْتُمْ فَعَاقِبُوا بِمِثْلِ مَا عُوقِبْتُمْ بِهِ وَلَئِنْ صَبَرْتُمْ لَهُوَ خَيْرٌ لِلصَّابِرِينَ

“Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju”.

(En-Nah, 126)

Në Sahihun e Muslimit transmetohet nga Enesi r.a. *se motra e Rabijës-nëna e Harithit e ka lënduar një grua, kështu që kanë shkuar te Muhammedi a.s. për t'u gjykuar. Muhammedi a.s. ka thënë: "Ndëshkimi në të njëjtën masë (Kisasi), ndëshkimi në të njëjtën masë. Umi Rabia tha: O i dërguar i All-llahut të ndëshkohem për filanen!? -Nuk pranoj të ndëshkohem. Muhammedi a.s. i tha: "Subhanallah, oj Umi Rabije: Ndëshkimi në të njëjtën masë është vendim në librin e All-llahut. Ajo tha: - Por unë nuk dua.*

Kjo vazhdoi kështu deri sa në vend të lëndimit në kundërmasë, ajo pagoi kundërvlerën e lëndimi"t.

Muhammedi a.s. tha:

"Allahu ia falë robit të Tij (nuk e ndëshkon), nëse pendohet, kërkon falje prej Allahut dhe betohet në Allahun".

Në sqarimin e këtij hadithi, Imam Neveviu thotë:

"Fjala 'Për Zotin nuk lejoj të ndëshkohem për atë', nuk ka për qëllim mospranimin e vendimit të Muhammedit a.s., por ka për qëllim (të shprehë) dëshirën për t'iu falur, (pra) që Muhamedi a.s. t'i ndihmojë asaj që t'i falet (ndëshkimi). Sepse ajo është përbetuar sinqerisht që të mos e thyejë betimin, (por) Muhamedi a.s. të ndikojë që t'ia falë asaj.

"Vërtet, ka robë të Zotit, të cilët përбетohen për All-llahun dhe nuk dëshirojnë ta thyejnë atë premtim".

Nga ky hadith mund të nxirren disa konkluzione:

- Lejohet përbetimi në një çështje, e cila nuk është e sigurtë;
- Ndërmjetësimi për të falur është Mustehab (i pëlqyer);
- Hakmarrjen ose shpagimin (DIJEN) ka të drejtë ta zgjedhë i dëmtuari, e jo dëmtuesi;
- Hakmarrja (KISASI) është i barabartë edhe për mashkullin edhe për femrën.

Dijetarët kanë dhënë sqarime përsa i përket hakmarrjes (Kisasit) për pjesët e trupit. Nuk ka hakmarrje (Kisas) për lëndimet, përpos nëse lëndimi e shqyen lëkurën, ka depërtuar në mish ose në eshtra.

Nëse nuk është kështu, atëherë gjykata (gjykatësi) merr vendim vetëm për dëmshpërblim (Dije), e jo hakmarrje të drejtpërdrejtë në pjesë të trupit.

Për shembull, në lëndimin DAMIJE - të mbledhurit e gjakut nën lëkurë, gjykata (gjykatësi) merr vendim për t'iu kompensuar dëmi dhe, varësisht prej dëmit, vendos shumën që duhet të paguhet.

Ndërsa për eshtrat, apo për ashtin i cili dëmtohet por nuk thyhet, atëherë i dëmtuari hakmerret në atë çka depërton në lëkurë e mish, dhe nuk ka të drejtë të kërkojë që t'ia dëmtojë (dëmtuesit) ashtin në brendësi, sepse kjo është e pamundur (sepse dëmtuesit mund t'i thyhet ashti në tërësi), kështu që është e pamundur të bëhet hakmarrja proporcionale.

Të dëmtuarit i takon një shumë, të cilin gjyqi e parasheh pas ekzekutimit të hakmarrjes (në lëkurë dhe në mish).

Në rastin e prerjes së duarve, nëse i dëmtuari nuk kërkon hakmarrje (prerjen e dorës), atëherë kundërmasa në vlerën e të hollave (Dija) caktohet sipas ligjit të Sheriatit, duke përpjesëtuar pjesët e trupit në (kundërvlerën për) dënimin me vrasje.

Për prerjen e njërës dorë bëhet përpjesëtimi i Dijes përgjysmë.

Gjykatësi (gjykata), kur të marrë vendim për hakmarrjen e pjesëve të trupit, duhet që të bëjë barazi të plotë. Kjo bëhet duke i pyetur ekspertët (mjekët specialistë të secilës pjesë të trupit), derisa mënyra e hakmarrjes të bëhet e sigurtë (e saktë).

* * * * *

BAZA E DËNIMIT TË PAPËRCAKTUAR ËSHTË RRAHJA

NENI 79

Rrahja është dënimi bazë për dënimet e tjera të papërcaktuara (T'azir)

Koment:

“T’azir” është masë përmirësuese e papërcaktuar në Sheriatin Islam. Përcaktimi është në kompetencën e gjykatësit (gjykatësit), pas konsultimit të ekspertëve të jurisprudencës, me qëllim që shoqëria të jetë e qetë dhe e sigurtë.

Dijetarët, për këtë çështje, kanë dhënë dy mendime:

Mendimi i parë: Përcaktimi i dënimit (deri në atë shkallë) që mos ta arrijë shkallën e dënimeve të përcaktuara fikse (Hudud), e ajo është rrahja për shkak të pirjes së alkoolit.

Mendimi i dytë: Dënimi mund të arrijë edhe deri në shkallën më të lartë të dënimeve të caktuara fikse, pra deri në dënimin me vdekje.

Sido që të jetë, masa shkallëzuese e dënimeve është çështje e ixhtihadi dhe ndryshon varësisht prej personave, kohërave dhe rrethanave. Çka vlen për një kohë, ndoshta nuk vlen për një kohë tjetër. Çka ndikon pozitivisht te një person, ndoshta nuk ndikon te tjetri.

Mirëpo, bazë e ndëshkimit dhe dënimit, te dënimet e papërcaktuara, është rrahja, sepse dëmtuesit i depërtojnë dhimbjet drejtpërsëdrejti, gjë që ndikon në ndalimin e veprimit të mëtutjeshëm.

All-llahu ka vendosur dënimin me rrahje për shpifje, prostitucion dhe alkool.

Në Sahihun e Muslimit, transmetohet se Ebi Burdete el Ensariju e ka dëgjuar Muhammedin a.s. duke thënë:

“Çdo kush i cili dënohet me dhjetë të rëna e më shumë, ai është dënuar me dënim (të caktuar) prej dënimeve të All-llahut”.

Ne mendojmë, siç mendojnë disa shpjegues të hadithit, se ky numër i caktuar i dënimit ka mjaftuar për kriminelin në kohën e të Dërguarit s.a.v.s. Në atë kohë shoqëria ka qenë e sigurtë dhe e pastër, pasi pjesa dërmuese (e njerëzve) kanë qenë të mirë, kanë

ndihmuar në të mirë dhe e kanë larguar të keqen dhe nuk ka ekzistuar fitneja - shkatërrimi i shoqërisë.

Në dënimet e përcaktuara (Hudud) të All-llahut nuk ekziston dënimi me burgim. Me fjalë të tjera, ndëshkimet e tjera vijnë në shprehje vetëm në raste të domosdoshme dhe për krime me dënim (të papërcaktuar), i cili rregullohet me ligj, siç janë burgu dhe paraburgimi.

Praktika ka vërtetuar se burgimi i kriminelëve i kushton shumë shtetit, duke filluar prej ndërtimit të tij (të burgut), përkujdesjes për të me policë, rojtarë, ushqimi, shërimi etj.

Burgjet janë shndërruar në shkolla të krimit ku takohen kriminelët dhe ku ata mësojnë edhe më shumë për metodat dhe mënyrat e vjedhjes, kryerjes së krimeve e të ngjashme.

Përveç kësaj, në mes të burgosurve paraqitet imoraliteti dhe homoseksualiteti, për shkak të gjendjes dhe kushteve ku ata jetojnë. Gjithashtu, në familjet e atyre të burgosurve, shkaktohet dëm i madh. Ato (gratë e të burgosurve) as nuk e kanë humbur statusin familjar, as nuk e kanë fituar statusin e të vejës dhe rritjes së jetimëve, dhe as nuk kalojnë jetë bashkëshortore.

Ndonjëherë dënimi me burg është shifer rekord, i cili nuk përputhet me realitetin. Sa për ilustrim po përmendim vendimin të cilin e ka marrë gjykata federale e New Yorkut më 24.05.1994, për tre persona, të cilët janë akuzuar për vendosjen e eksplozivit në Qendrën Tregtare Ndërkombëtare, ku humbën jetën 6 persona dhe u lënduan 1000 persona. Secili prej tyre është dënuar me 240 vjet burg.

Gjykatësi, pas marrjes së vendimit, ka thënë: “Që të tre personat kanë mundur të jetojnë 180 vite, që do të thotë secili ka mundur të jetojë 60 vite.

A nuk është ky dënim me 240 vjet vetëm një shifër (sa për t’u dënuar), sepse cili mund të jetojë në burg 240 vjet?

Sa i kushton shtetit ushqimi dhe përkujdesja ndaj atyre të burgosurve dhe atyre të tjerëve?

Në Kongresin e Nëntë të Sigurimit Shtetëror të Egjiptit, me temën “Ndalja e Krimit”, i cili është mbajtur në Kajro në Maj të vitit 1995, është dhënë një deklaratë se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës numri i të burgosurve ka arritur në një milionë të burgosur.

* * * * *

E DREJTA E TË BURGOSURIT

NENI 80

Nuk lejohet nënçmimi i të burgosurit, ose cenimi i nderit të tij.

Koment:

Kemi thënë se rrahja është dënimi bazë në dënimet e papërcaktuara dhe se burgu është i ndaluar, përpos paraburgimit, për shkak të krimeve të caktuara.

Mirëpo, në paraburgim (burgim), i burgosuri duhet të kalojë jetë të mirë, të pastër psiqikisht dhe moralisht. Nuk lejohet abuzimi i tij apo cenimi i nderit të tij, apo dëmtimi i familjes së tij. Në burg nuk lejohet të punojnë punonjës patetikë dhe të pandërgjegjshëm.

* * * * *

GJYKATA SUPREME

NENI 81

Duhet të themelohen gjykatat supreme të Kushtetutës, të cilat ndajnë sektorët për ekzekutimin e vendimeve dhe ligjeve të Sheriatit Islam dhe të kësaj Kushtetute. Gjykatat e tjera caktohen me ligj.

Koment:

Kjo është një çështje shumë e rëndësishme, për arsye se dijetarët e mëhershëm gjyqin e kanë lënë të lirë për të vendosur rreth organizimit të tij, dhe i kanë lënë fushë të gjerë veprimi. Secili gjykatës (gjyq) ka gjykuar sipas medhhebit të tij. Kështu, si pasojë e vendimeve të ndryshme, janë themeluar gjykata të shumënumërta.

Mirëpo, shteti bashkëkohor nuk mund të shkojë në një rrugë të tillë, sepse kohërat kanë ndryshuar, ndërsa njerëzit kanë veprime të afërta dhe kërkojnë mënyra të tjera. Më mirë do të ishte që në një shtet të jetë gjykata supreme dhe gjykimi unik për të gjithë. Ligji vendos për formën e krimit dhe mënyrën e dënimit, e cila është e përshtatshme në bazë të Sheriatit Islam, pasi shumica e gjykatësve nuk janë kompetentë (nuk i plotësojnë kushtet) për ixhtihad të pavarur, kështu që ata kanë mundësira të kufizuara për zbulimin e çështjeve për mënyrat e veprimit të njeriut.

Vendimi për rregulloret dhe ligjet është detyrë e organit juridik të shtetit. Kur ndodh mospajtim rreth vendimit, i cili nuk është i përshtatshëm në baza të ligjeve të Sheriatit, atëherë paraqitet nevoja për gjykatën supreme kushtetuese, e cila është e specializuar dhe kompetente për vendim. Gjykata Supreme është shtylla e sqarimeve të vendimeve dhe të Kushtetutës.

Juristët janë ata të cilët i vendosin rregullat e kësaj gjykate, mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve në fushëveprimin e tyre, mënyrën e emërimit dhe të sektorëve.

* * * * *

AKTPADIA NË SHKALLËN E PARË (E LARTË)

NENI 82

**Duhet të themelohet Gjykata për ankesa në shkallën e lartë.
Ligji cakton formën, strukturën dhe specializimin e tij.**

Koment:

Aktpadia në shkallën e parë (lartë) është sistem i organizimit të gjyqeve të kohës bashkëkohore islame dhe kjo për arsyen e heqjes së padrejtësive që nëpunësit më të ulët shtetërorë i bëjnë shoqërisë.

Në fillim të Islamit nuk ka pasur nevojë për ngritjen e aktpadisë në shkallën e parë, sepse drita e Pejgamberit s.a.v.s. dhe drejtësia e halifëve të drejtë, iu siguroi njerëzve garancione të drejtësisë dhe të vërtetës. Prandaj njerëzit ka qenë të lidhur ngushtë si vëllezër, kanë qenë të ndjeshëm dhe tepër të mëshirshëm në mes vete, kështu që mospajtimet dhe konfliktet kanë qenë të natyrës së lehtë. Ata iu janë përmbajtur vendimeve të Muhammedit a.s. dhe halifëve vullnetarisht, pa presione dhe me dëshirën më të madhe.

Ebu Jeali el Feraï, në librin e tij, përmend rastin e parë të rishqyrtimit të aktpadisë. Ky rast ka qenë atëherë kur Abdul Melik bin Mervani gjykonte në sallën e gjyqit dhe kishte nevojë për sqarim, ose për rishqyrtimin e vendimit të tij dhe ai vetë, personalisht si gjykatës, pas marrjes së vendimit e dërgonte atë te gjykatësi (i cili ishte më i njohur) Ebi Idriz el Ezdi për ta verifikuar para se ta fuqizonte vendimin. Kështu, Ebu Idrizi ishte vendimmarrës i drejtpërdrejtë, ndërsa Abdul Meliku e zbatonte (me fjalë tjera e fuqizonte vendimin e marrë nga Ebu Idrizi).

Vetëm më vonë udhëheqësit e padrejtë filluan të gjykonin për anën e tyre, derisa udhëheqësi i muslimanëve (Halifi) Umer bin Abdul Azizi vendosi që familjes së Beni Umejes t'i rishqyrtohet aktpadia dhe të gjykohet në dobi të tyre, pasi ata kishin të drejtë dhe gjatë gjykimit i ishte bërë padrejtësi.

Pastaj vazhdojnë halifë të tjerë: El Mehdi, Err Rreshid, El Memunë, pastaj El Mehdiu.

Në librin “Muruxhu dheheb”, Mes’udi tregon se Halifi El Muhtedi ka ndërtuar një objekt (gjkate), e cila ishte e mbuluar me kube dhe e cila ka pasur 4 dyer. Ky objekt është quajtur Kubja e rishqyrtimeve të aktpadive dhe e vendimeve të drejta, në të cilën janë ulur për të vrojtuar rigjykimin edhe të specializuarit për gjykime, edhe njerëzit e e zakonshëm³⁸.

El Mes’udi transmeton nga Salih bin El Hashimiju, se ai ka thënë: “Një ditë prej ditësh kam qenë prezent në kuvendin e gjykatës, ku El Muhtedi bënte rishqyrtimin e vendimit ndaj të ankuarit, dhe kam parë se si i shqyrtonte të gjitha librat (ku ishin vendimet) dhe merrte vendim si ishte më së miri.

Sujutiu, në librin e tij “Historia e Halifëve”, citon: ‘Nëna e Halifit Muktedar, e quajtur Sejide, në vitin 306 të Hixhretit, e ka zgjeruar sallën e kuvendit gjyqësor dhe ka caktuar për vete një vend të posaçëm, që për çdo të premte, pas namazit të xhumasë, t’i përcjellë proceset gjyqësore. Me të aty ishin prezentë kadi (gjyqtarë) të njohur dhe, në fund, pasi ata i analizonin vendimet, në shumicën e rasteve ajodhënë vendimin më të mirë.

Në librin “AHKAMUL SULTANIJE”, Mavrudi dhe Ebu Jeali Firiai kanë përmendur se Kuvendi gjyqësor i ankesave plotësohet me prezantimin e pesë personave (pesë funksionarëve gjyqësorë), pa të cilët vendimi nuk mund të merret:

1. Mbrojtësit (avokatët) për të (palën ankuese)
2. Gjyqtarët dhe Qeveritarët për të parë se a i është bërë padrejtësi në shkallën e parë, dhe a ka të drejtë.
3. Dijetarët (Fukahatë) e jurisprudencës islame për të shqyrtuar atë që është e dyshimtë dhe për t’i pyetur për çështjet e paqarta.
4. Regjistratorët për të treguar zgjidhjen e konflikteve të të njëjtës natyrë, si e kanë fituar të drejtën dhe si është zgjedhur e njëjta lëndë.
5. Dëshmitarët për të dëshmuar edhe njëherë për të drejtën e palës.

³⁸ Transmetuar nga libri “Tarihul Islam”, nga dr. Hasan Ibrahim Hasan, vëll.III, fq.341.

Mavrudi dhe Ebu Jeali El Ferrai ankesat e shkallës së parë i kanë ndarë në dhjetë lloje:

1. Për të parë se si prokurorët dhe gjyqtarët u bëjnë padrejtësi qytetarëve.
2. Për të parë funksionarët (gjykatësit), të cilët e korruptojnë popullin me mito, ndërkohë që rishikimi i vendimit i zbulon ato dhe pronarëve iu kthehet e drejta e tyre. Ndërsa nëse zbulohet mitoja, atëherë ajo shumë kthehet.
3. Protokolluesit. Ata janë sigurimi i pasurisë së muslimanëve, sepse i regjistrojnë dhe i protokolojnë pasuritë që mos të keqpërdoren.
4. Inspektimi i ruajtjes së pasurive
5. Të kthyerit e pasurisë së uzurpuar e cila është dy llojesh:
 - Uzurpimi diktatorial, pra, kur udhëheqësi ia uzurpon pronën ndonjë qytetari me padrejtësi.
 - Uzurpimi i të fuqishmit ndaj të dobët.
6. Mbikqyrja e vakëfeve e cila është dy llojesh:
 - 1). Vakëfet e përgjithshme të cilat duhet të jenë të destinuara vetëm sipas kushteve të parapara.
 - 2). Vakëfet e veçanta të cilat duhet të shfrytëzohen për atë destinim të caktuar (të veçant) të vakëflënës.
7. Për t'i shfuqizuar vendimet e padrejta, nëse ekzistojnë fakte dhe shenja të padrejtësisë dhe për t'ia kompensuar dëmin të dëmtuarit për shkak të vendimit të padrejtë.
8. Për t'i zbuluar dëshmitë e rreme dhe për t'i dëgjuar dëshmitë e vërteta.
9. Lejohet që gjykatësi i shkallës së parë të kërkojë dëshmitarë të drejtë, në vend të dëshmitarëve të paguar apo të rremë, ose të kërkojë që të shtohet numri i dëshmitarëve, për t'i hequr njollat e dyshimta të vendimeve të dyshimta.
10. Gjykatësi i shkallës së parë i fton dëshmitarët për të dytën herë dhe i pyet ata për marrëdhëniet me palët e konfrontuara, zakonisht për akuzuesin kërkohen dëshmi për t'u dëgjuar edhe një herë.

Funksionarët sot janë të angazhuar në shumë çështje, kështu që kohën e kanë të kufizuar, për këtë arsye, do të ishte më mirë që të formohen me ligj gjykatat e shkallës së lartë për t'i mbuluar zbrazëtirat.

Çdo ministër, çdo kryetar i regjionit ose drejtor, duhet të përkujdeset që nëpunësit të mos bëjnë padrejtësi dhe ai, vetë, duhet të planifikojë një pjesë të kohës për t'i përcjellë ankesat e qytetarit dhe të marrë pjesë vetë, personalisht, që atij t'i kthehet e drejta.

Çdo mizor le ta përkujtojë hadithin e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s., që thotë:

“Në Ditën e Kijametit do të vijë njerëz të rëndë dhe të mëdhenj, ndërsa nuk do të peshojnë (nuk do të kenë vlerë) as sa fleta e mizës”.

(Buhari dhe Muslimi)

Një ditë Ebu Merjem el Ezdiju r.a., e ka ndalur Muavinë, të birin e Sufjanit dhe i ka thënë: E kam dëgjuar të dërguarin e All-llahut duke thënë:

“Kush merr një post për t'u përkujdesur për çështjet e muslimanëve, ndërsa ai angazhohet për çështje të tjera e jo për çështjet e muslimanëve, gjë që bën që muslimanët të varfërohen, All-llahu në Ditën e Kijametit do ta varfërojë dhe nuk do të përkujdeset për të”.

(Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

* * * * *

KAPITULLI I SHTATË

KUVENDI KËSHILLUES, INSPEKTIMI (KONTROLLIMI) DHE MËNYRA E MARRJES SË VENDIMEVE

Përbëhet prej 2 neneve:

Prej nenit 83

Deri në nenin 84

SPECIALIZIMI I KUVENDIT TË GJYKATËS

NENI 83

Shteti formon Kuvendin e këshillit të gjykatës i cili merret me këto çështje:

1. Vendosjen e ligjeve dhe marrjen e vendimeve të cilat nuk janë në kundërshtim me ligjet e Sheriatit Islam.
2. Hartimin e Projektbuxhetit shtetëror vjetor dhe llogaritjen në fund të vitit.
3. Kontrollimin dhe inspektimin e organit ekzekutiv.
4. Raportin e ministrive për punën e tyre dhe heqjen e imunitetit të tyre nëse e shkelin ligjin.

* * * * *

Ligji cakton kushtet e zgjedhjeve, mënyrën dhe rrugën e zgjedhjeve, kushtet e kandidatëve dhe këtë (e bën) në bazë të konsultimit (dhe anketimit) të të gjithëve që janë të moshës madhore, të mençur, që kanë reputacion, që kanë aftësi dhe që janë vizionarë. Po ashtu, cakton shumën e shpërblimit (pagave) të anëtarëve të kuvendit (deputetëve). Kuvendi vendos rregulloren për ekzekutim.

Koment:

Sistemi parlamentar është bazë e Sheriatit Islam. Zoti i Madhëruar e ka urdhëruar Muhammedin a.s., të dërguarin e tij, për këtë:

فَبِمَا رَحْمَةٍ مِّنَ اللَّهِ لِنْتَ لَهُمْ وَلَوْ كُنْتَ فَظًّا غَلِيظَ الْقَلْبِ لَانفَضُّوا مِنْ حَوْلِكَ
فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاسْتَغْفِرْ لَهُمْ وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ
فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falja atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që i mbështeten”.

(Ali Imran, 159)

Në Kur'an, një sure quhet “Sureja e Konsultimit” (sistemi parlamentar). Është quajtur kështu pasi një prej tipareve të veçanta të besimtarëve është konsultimi mes vete.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَالَّذِينَ اسْتَجَابُوا لِرَبِّهِمْ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَمْرُهُمْ شُورَى بَيْنَهُمْ
وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ

“Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë”.

(Esh Shura, 38)

Këshillimi është obligim me të gjithë ata të cilët janë vizionarë të urtë dhe kanë prirje për të dhënë ide.

Zoti i Madhëruar ka pranuar që të paaftit të mos marrin pjesë në luftë, por ka kërkuar prej tyre që të japin këshilla dhe të ndihmojnë me ide.

Zoti i Madhëruar thotë:

لَيْسَ عَلَى الضُّعَفَاءِ وَلَا عَلَى الْمَرْضَى وَلَا عَلَى الَّذِينَ لَا يَجِدُونَ مَا يُنْفِقُونَ حَرَجٌ
إِذَا نَصَحُوا لِلَّهِ وَرَسُولِهِ مَا عَلَى الْمُحْسِنِينَ مِنْ سَبِيلٍ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

“Nuk është ndonjë mëkat për të dobëtit, as për të sëmurët, e as për ata që nuk kanë me çka të përgatiten, kur janë të singertë (dhe japin këshilla) ndaj All-llahut dhe të dërguarit të Tij, pra për të mirët nuk ka rrugë qortimi. All-llahu fal shumë, është mëshirues”.

(Et Tevbe, 91)

E tërë feja nuk është gjë tjetër përpos këshillë dhe konsultim, të cilën pejgamberët dhe thirrësit e kanë bartur në rrugën e organizimit sa më të mirë të jetës së tyre dhe ekzistencës.

Nuhu alejhi selam i ka thënë popullit të tij:

لَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَقَالَ يَا قَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ . قَالَ الْمَلَأُ مِنْ قَوْمِهِ إِنَّا لَنَرَاكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ . قَالَ يَا قَوْمِ لَيْسَ بِي ضَلَالَةٌ وَلَكِنِّي رَسُولٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ . أُبَلِّغُكُمْ رِسَالَاتِ رَبِّي وَأُنصَحُ لَكُمْ وَأَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ .

“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai i tha: O populli im, adhurojeni All-llahun, nuk keni Zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin tuaj në një ditë të madhe! Paria e popullit të tij tha: Ne po të shohim (në këtë që na thërret) plotësisht të humbur. Nuhu tha: O populli im, unë nuk kam kurrfarë humbje, por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve! Unë ju kumtoj juve shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe unë di nga Zoti im çka ju nuk dini!”.

(El-A'rafë, 59-62)

Po ashtu ka vepruar edhe Hudi me popullin e tij:
 قَالَ يَا قَوْمِ لَيْسَ بِي سَفَاهَةٌ وَلَكِنِّي رَسُولٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ . أُبَلِّغُكُمْ رِسَالَاتِ رَبِّي
 وَأَنَا لَكُم نَاصِحٌ أَمِينٌ .

“Tha (Hudi): O populli im, nuk jam mendjelehtë (nuk kam të metë mendore), por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve”. (Jam dërguar) Që t’u komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju”.

(El-A’rafë, 67, 68)

Dhe kështu ka vepruar çdo peygamber dhe kështu veprojnë të gjithë të mirët deri në Ditën e Kijametit.

Muslimi, nga Ebi Ruhijete Timimi bin Evs Ed-Dari, transmeton se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Feja është këshillë. E kemi pyetur: Për kë o i dërguar i All-llahut? - e ai është përgjigjur:

- **Për All-llahun;**
- **Për librin e Tij;**
- **Për të dërguarin e Tij;**
- **Për dijetarët muslimanë dhe**
- **Për të gjithë muslimanët”.**

- Këshilla për All-llahun është besimi në një Zot të vetëm, të Lartmadhëruar dhe të përsosur me të gjitha vetitë dhe cilësitë.

- Këshilla për librin e Tij, është leximi sa më i mirë i librit të Tij me rregulla (të bukurshkrimit-bukurleximit), praktikimi i ligjit të librit të Tij dhe shpjegimi i ajeteve të librit të Tij.

- Këshilla për të dërguarin e Tij është veprimi sipas thënieve dhe veprimtarisë së tij dhe vazhdimi i qeverisjes sipas parimeve të tij, ashtu siç janë shpallur.

- Këshilla për dijetarët e muslimanëve është ndihma në mes vete për punë të mira dhe devotshmëri, përkujtimi për të vepruar drejtë, dhe udhëzimi në punë të mira, të dobishme dhe për atë që sjell zhvillim dhe jetë sa më të mirë për shoqërinë.

- Këshilla për të gjithë muslimanët është për t’i mësuar të pamësuarit, për t’i edukuar dhe arsimuar të paarsimuarit dhe të paedukuarit, për mbulimin e të metave të tyre dhe angazhimi për plotësimin e nevojave të tyre.

Më mirë është që shteti të ketë edhe kuvendin, edhe parlamentin, varësisht si e sheh shteti rregullimin dhe organizimin shtetëror.

Nëse projektin e Kushtetutës Islame, të cilën e kemi në këtë punim, Instituti për Hulumtime Shkencore e pranon, atëherë sa i përket këtij neni, në vazhdim veprohet kështu:

- Sistemi organizativ, i cili nuk e parasheh që shteti të ketë kuvendin, e fshin këtë pjesë. Por, unë e shoh se ky sqarim nuk e ka vendin këtu, por më mirë është të thuhet: Shteti, i cili në sistemin organizativ nuk e ka kuvendin, nevojitet që të angazhohet sa më shpejt për formimin e tij dhe për të vepruar me atë sistem.

Autokracia e dëmton Ummetin, padrejtësitë janë të shumta aty ku nuk ka kuvend e as parlament për të vendosur ligje. Koha ndryshon, sot njerëzit janë të dobët në fenë e tyre dhe është shumë-shumë vështirë që ketë udhëheqës të drejtë, gjë për të cilën është bërë apel në të kaluarën. Vërtet drejtësia, autokracia dhe burokracia nuk mund të qëndrojnë në të njëjtën kohë, në të njëjtin vend.

Kuvendi ka për detyrë të specializohet në këto çështje:

- Vendosjen e ligjeve të cilat nuk janë në kundërshtim me ligjet e Sheriatit;
- Hartimin e projektbuxhetit dhe llogaritjen në fund të vitit;
- Kontrollimin apo inspektimin e organit ekzekutiv;
- Raportin e ministrave dhe përgjegjësinë e tyre për punën e tyre, si edhe shkarkimin e tyre nëse e kërkon ligji (nëse veprojnë në kundërshtim me ligjin).

Disa mund ta kundërshtojnë këtë me arsyetim se:

- Ligjvënien e ka të drejtë vetëm All-llahu, ndërsa njeriu nuk ka të drejtë me vendosë ligje.

- Për këtë, përgjigjemi kështu:

Kjo thënie në pamjen e jashtme duket se është mëshirë, ndërsa në brendësi ka vetëm vështirësi dhe dënim, sepse ligjet e Sheriatit sqarojnë disa çështje, ndërsa disa të tjera i tregojnë në mënyrë gjenerale.

Sfera e vendosjes së ligjeve dhe e marrjes së vendimeve është shumë e gjerë dhe nuk është në kundërshtim me bazat e fesë dhe rregullave të Sheriatit.

Ku e gjejmë ligjin e shtypjes së monedhave, ligjin e themelimit të Bankave dhe të ndërmarrjeve të ndërrimit të valutave, të

cilat kryejnë veprimtari të shumta? Ku e gjejmë ligjin ushtarak, ligjin e punëtorëve, ligjin e universiteteve, ligjin e arsimit, ligjin e sindikatave të punëtorëve, ligjin e udhëtarëve civilë me aeroplan, anije etj. etj.?

Në shkencën e Usulul Fikhut thuhet:

“Hukmi (gjykimi) është urdhri i All-llahut të Lartmadhëruar, i cili urdhëron të obliguarit (njerëzit) për arsye se është i obliguar, nga këtu nuk ka gjykim përpos ligjit të All-llahut.

Por kjo ka për qëllim obligimin e njeriut për të cilën njeriu meriton shpërblim ose dënim në botën tjetër.

Ndërsa sa i përket organizimit të jetës dhe të mirave materiale, mendja e njeriut ka kufi (hapësirë) të cilën duhet ta shfrytëzojë, të punojë me të, të hulumtojë dhe këtë duke u bazuar në rregullën e Sheriatit “*Ju i dini më së miri veprimtaritë dhe çështjet e jetës suaj*”.

Në Kur’anin fënisht fjala “ligj-gjykim (hukm)” është përdorur edhe për All-llahun, por edhe për njeriun.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَكَيْفَ يُحْكُمُونَكَ وَعِنْدَهُمُ التَّوْرَةُ فِيهَا حُكْمُ اللَّهِ ...

“E si e kërkojnë ata gjykimin tënd, kur ata kanë Tevratin në të cilin është vendimi i All-llahut”.

(El Maide, 43)

Po ashtu Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ وَتُدْلُوا بِهَا إِلَى الْحُكَّامِ لِتَأْكُلُوا فَرِيقًا مِّنْ أَمْوَالِ
النَّاسِ بِالْإِثْمِ وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, e as mos u paraqitni me të (me ryshfet) te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve”.

(El Bekare, 188)

All-llahu ka lënë në disponim të njerëzve të drejtën për ta caktuar dënimin (dijen) e atij, i cili është me ihram dhe gjuan ndonjë kafshë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْتُلُوا الصَّيْدَ وَأَنْتُمْ حُرْمٌ وَمَنْ قَتَلَهُ مِنْكُمْ مُتَعَمَّدًا
فَجَزَاءٌ مِّثْلُ مَا قَتَلَ مِنَ النَّعَمِ يَحْكُمُ بِهِ ذَوَا عَدْلٍ مِّنْكُمْ هَدْيًا بَالِغَ الْكَعْبَةِ ...

“O ju që besuat, mos e mbytni gjahun, duke qenë ju në ihram. E kush e mbyt atë me qëllim, atëherë dënimi është therorizimi i një kafsheje shtëpiake të ngjashme me atë (të egrën) që e ka mbytur. Për këtë çështje vendosin (marrin vendim-gjykojnë) dy njerëz të drejtë nga mesi juaj, duke e bërë atë kurban për Qabe ...”.

(El Maide, 95)

Nuk do të ishte e tepërt nëse themi se shumica e vendimeve të Fikhut janë çështje të ixhtihadit të supozuara (dhanije), të cilat nuk janë obligative për medhhebin tjetër dhe as të ndonjë mendimi tjetër.

Kjo dëshmon nevojën e angazhimit (ixhtihadit) të vazhdueshëm për zhvillimin sa më të lumtur e jetës në këtë botë dhe fitimin e botës tjetër, dhe ndërlidhjen e marrëdhënieve njerëzore, duke u bazuar në bazat e Sheriatit.

Në Usulul Fikh, ixhtihadi është definuar kështu:

“Të shpenzuarit dhe të harxhuarit e maksimumit të energjisë së ekspertit juridik (fekihut) për të vendosur një ligj, i cili nuk është i përkryer, por është i nevojshëm”.

Pasi që çështja nuk është absolute, atëherë çdo muxhtehid mund t’ia qëllojë, ndërsa është thënë se e vërteta është një, nuk mund të jenë dy të vërteta.

Muslimi, nga Sulejman bin Beridete, e ai nga babai i tij, transmeton hadithin e cili ka të bëjë me urdhrin e Imamit (Udhëheqësit) dhe porositë e tij, ku shihet qartë (se çfarë thuhet) për rregullat e luftës dhe të xhihadit. Teksti i Muhammedit a.s., i cili ka domethënien e urtësisë, është kështu:

“Nëse je i rrethuar dhe prej teje kërkojnë që të kryesh patjetër një premtim për All-llahun dhe të dërguarin e Tij, mos vepro ashtu, por bëje për vete dhe për shokët e tu, pasi nëse ata e thyejnë premtimin, më lehtë është thyerja e premtimit të tyre, se sa thyerja e premtimit të All-llahut dhe të dërguarit të Tij.

Nëse je i rrethuar dhe prej teje kërkojnë që të mos gjykos me ligjin e All-llahut dhe të dërguarit të Tij, ti gjyko vetë dhe thuaju jam duke gjykuar vetë, pasi nuk e di ia ke qëlluar saktësisht sipas ligjit të All-llahut, apo jo”.

Kjo çështje bën një lehtësim dhe një qetësim nga pjesa më e madhe e vendimeve të ixhtihadit, sepse mund t'ia qëllojmë, por edhe mund të gabojmë, por edhe nëse gabojmë nuk na shkruhet mëkat sepse çdo muxhtehid e ka shpërblimin për mundin e tij.

* * * * *

KAPITULLI I TETË

QEVERIA

Përbëhet prej 2 neneve:

Prej nenit 85

deri në nenin 86

PËRGJEGJËSIA E QEVERISË

Kushtet e emërimit të ministrave (Formimi i kabinetit)

NENI 85

Qeveria merr përsipër përgjegjësinë e çështjeve të ligjit dhe realizimin e pikësnyimit të Sheriatit dhe është përgjegjëse para Imamit (Kryetarit).

NENI 86

Ligji përcakton kushtet e emërimit të ministrave, veprimet të cilat ata nuk guxojnë t'i kryejë derisa të jenë në pozitë dhe mënyrën e gjykimit të tyre, nëse i tejkalojnë kompetencat.

Koment:

Fjala “vuzera” (ministra) e ka prejardhjen prej fjalës “vizer” që do të thotë vështirësi, barrë, sepse veziri (ministri) merr barrën apo përgjegjësinë për qeverisje prej Qeveritarit (hakim).

Ka mendime se (kjo fjalë) ka domethënien e mbështetjes dhe vendstrehimit, sepse qeveritari kërkon mbështetje dhe ndihmë prej tyre për qeverisje.

Po ashtu, ka mendime se ka domethënien e “krahut” apo “të shpinës”, sepse Qeveritari e përforcon krahun e tij me ministra, sikurse trapi përforcohet me krahë dhe me shpinë.

Në Kur'anin Famëlartë fjala “vezir” - ministër ka ardhur në rastin e Musait a.s., kur All-llahu e ngarkoi atë me detyrë që të shkonte te faraoni dhe te populli i tij, mirëpo Musai a.s. e kish kuptuar mizorinë e faraonit dhe të popullit të tij, prandaj e luti All-llahun që ta ndihmnte me ministër (vezir) të drejtë që ta krynte me sukses atë detyrë. Zoti i Madhëruar thotë:

قَالَ رَبِّ اشْرَحْ لِي صَدْرِي . وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي . وَاحْلُلْ عُقْدَةً مِّن لِّسَانِي . يَفْقَهُوا قَوْلِي . وَاجْعَلْ لِّيَ وَزِيرًا مِّنْ أَهْلِي . هَازُونَ أَخِي . اشْدُدْ بِهِ أَزْرِي . وَأَشْرِكْهُ فِي أَمْرِي . كَيْ نُسَبِّحَكَ كَثِيرًا . وَنَذْكُرَكَ كَثِيرًا . إِنَّكَ كُنْتَ بِنَا بَصِيرًا .

“Ai (Musai) tha: Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim! Dhe më lehtëso në këtë punë timen! Më zgjidh nyjën e gjuhës sime! Që ta kuptojnë fjalën time! Më cakto një ndihmëtar (ministër) nga familja ime, Harunin, vëllain tim, që me të të ma forcosh fuqinë time. Bëma shok atë në punën time. Në mënyrë që të madhërojmë Ty më shumë, dhe të përkujtojmë Ty shpesh. Vërtet, Ti je Ai që na sheh dhe na i di punët”.

(Ta Ha, 25-35)

Ministrat janë të ngarkuar dhe janë përgjegjës për punët e shtetit, për përmirësimin e kushteve të qytetarëve dhe për vendosjen e rendit dhe drejtësisë në shoqëri.

Për këtë arsye është thënë:

Ministrat në Qeveri (janë) si shikimi në pasqyrë. Ashtu sikurse ai që nuk e shikon veten në pasqyrë nuk mund t’i shohë vijat e mira dhe vijat e dobëta (të metat) e fytyrës së tij, ashtu edhe qeveritari (kryetari), nëse nuk i ka ministrat nuk mund t’i dijë të mirat, përparësitë dhe, po ashtu, edhe të metat dhe dobësitë e shtetit.

Dijetarët i kanë paraparë edhe kushtet e ministrit e ato janë: të jetë i drejtë dhe i sinqertë, i përqendruar në fenë e tij, besnik, vizionar, i mëshirshëm dhe i moralshëm.

Qeveritari duhet të jetë i kujdesshëm, që kur ta formojë kabinetin ministror të mos emërojë ministër korruptues, i cili formon familjarizim në pushtet, forcon pozitën, bëhet kryelartë dhe i largon të mençurit, të urtit dhe profesionistët.

Gjëja e parë që duhet të ketë Qeveritari është që të jetë vizionar dhe të ketë aftësi për t’i zgjedhur ministrat dhe para se ta formojë kabinetin të bisedojë të konsultohet me dijetarët për emërimin të tyre.

Aftësia e udhëheqësit kuptohet dhe ai e fiton besimin tek populli që në fillim³⁹.

Fikhu dallon dy lloje të ministrive:

Ministrat për marrjen e vendimeve, zëvendësministrat (Tefvid) dhe ministrat për ekzekutimin e vendimeve (Tenfidh).

³⁹ “El-Mustetриф kuli fenin Mustetриф”, autor Shehabudijn Muhamed bin Ahmed, Ebi El-Fet-h El-Ebshihju, korrekti Muhamed Kanijakate, fq.102, Botoi “Kutubul Ilmije”, Bejrut.

Me zëvendësministra (Tefvid) organi juridik ka për qëllim kur qeveritari emëron ministrin që, pas një angazhimi maksimal, t'i planifikojë vetë çështjet qysh e sheh më së miri dhe i cili ka të drejtë të lirë veprimi për interesin kombëtar dhe i jep vendim apo leje të lirë veprimi.

Kushtet e ministrit të pavarur në veprim (Tefvid), janë të njëjtat kushte sikurse të imamit (kryetarit): të jetë i lirë, i mençur, i profesionalizuar dhe vizionar, për arsye se ai merret me çështjet e shtetit i pavarur.

Me ministrat për ekzekutimin e ligjeve (Tenfidh) kihet për qëllim kur imami (kryetari) e emëron ministrin për ekzekutimin e ligjeve dhe shpjegimin e drejtë të tyre qytetarëve.

Për ministrin ekzekutiv dijetarët nuk kanë paraparë të njëjtat kushte, sikurse për ministrin juridik. Me fjalë të tjera, ministër ekzekutiv mund të jetë jomuslimani, rob i ose ai i cili nuk është fekih (jurist).

Dijetarët kanë paraparë shtatë kushte për emërimin e ministrit e ato janë:

E para: Besnikëria – të mos ta tradhtojë atë çka i besohet.

E dyta: Orator dhe i drejtë në fjalë, që do të thotë, ta praktikojë atë që thotë.

E treta: Të mos jetë lakmues, sepse mund të mashtrohet me ryshfet dhe mund t'i shkelë ligjet.

E katërta: Të mos ketë armiqësi të qartë ndërmjet tij dhe qytetarëve, sepse armiqësia ndikon që të mos jetë i butë dhe i mëshirshëm (i drejtë) në ligje.

E pesta: Të ketë memorie të zhvilluar, sepse ai i përcjell kërkesat dhe nevojat e qytetarëve te Imami (kryetari) dhe anasjelltas.

E gjashta: Të jetë mendjemprehtë, që do të thotë të mos tradhtohet (mashtrohet) lehtë.

E shtata: Të mos i pasojë epshet, që do të thotë se nëse epshet (e tij) mbizotërojnë mbi të vërtetën dhe realitetin, atëherë ai bën ngatërrimin e të vërtetës me të pavërtetën. Epshet e tradhtojnë mendjen dhe e largojnë nga e vërteta. Nga Pejgamberi a.s., është transmetuar. se:

“Dashuria për diçka të verbëron dhe të shurdhon”⁴⁰.

(Ahmedi, Ebu Davudi, në isnad hasen)

⁴⁰ “El-Ahkam Sultaniye”, nga autori Ebi Jeali El-Ferai, fq.31.

Në Projektkushtetutën Islame, në Nenin 85, tekstualisht thuhet: Qeveria është përgjegjëse para Kryetarit (Imamit), mirëpo ky tekst hiqet në shtetet të cilat e kanë kuvendin. Dhe unë mendoj se përgjegjësia e qeverisë para qeveritarit apo kuvendit është çështje e cila vendoset me ligj, sepse qeveria i përgjigjet që të dyve.

Këtu paraqiten disa pyetje:

- Qeveria, a është e formuar në sistemin e Kryetarit të kryesisë (presedencial) apo në sistemin e Kryetarit të ministrave (parlamentar)?

- Kryeministri ia dorëzon (paraqet) emrat e ministrave të kabinetit të tij, Kryetarit apo Kuvendit?

- Pasi të formohet qeveria, a ka nevojë për pëlqimin e Kuvendit, apo jo?

Përgjigjet në këto pyetje duhet t'i japin juristët (fukahatë) ekspertët dhe dijetarët, për vendosjen e ligjit të organit ekzekutiv.

* * * * *

KAPITULLI I NËNTË

LIGJET TRANZICIONALE DHE TË PËRGJITHSHME

Përbëhet prej 7 neneve:

Prej nenit nr. 87

deri në nenin nr. 93

KRYEQYTETI

NENI 87

Qyteti është kryeqendra e vendeve të tjera.

Koment:

Zgjedhja e Kryeqytetit është çështje me të cilën është marrë ixhmai dhe për të cilën kanë folur dijetarët e të gjitha kohërave dhe të gjitha vendeve.

Pasi Muhammedi a.s. u shpërngul në Jethrib, Jethribi u bë Kryeqytet i shtetit islam dhe u quajt qyteti i të Dërguarit (Medinetu Resul) ose Qyteti i ndriçuar (Medinetul Munevere). Në këtë (qytet), Muhammedi a.s., ndërtoi xhaminë, e cila ishte Qendër Qeverisjeje, Kuvend Shtetëror, Gjykatë Supreme, Komandë Supreme dhe qendër për të gjitha çështjet e tjera të muslimanëve.

Afër xhamisë (ngjitur) u ndërtuan shtëpitë e nënave të muslimanëve.

Medina e ndriçuar ka qenë kryeqyteti islam gjatë epokës së udhëheqjes së halifëve (Kryetarëve) të drejtë: të Ebu Bekrit, Umerit dhe Uthmanit deri në udhëheqjen e Aliut r.a., ku kryeqytet u bë Kufeja. Qyteti Kufe është ndërtuar gjatë udhëheqjes së Umer bin el Hatabit, pas ndërtimit të qytetit Basra. Këtë vend e ka zgjedhur: Selman el Farisiju dhe Hudhejfe bin el Jeman në perëndim të lumit Eufrat, afër Hirës.

Kur, nën udhëheqjen e Muavi bin Ebi Sufjanit, u formua shteti umevit, kryeqyteti u zhvendos në Damask, i cili ishte një qytet i lashtë dhe i njohur. Specifike për të ishte se kishte shumë lumenj dhe burime ujërash.

Në kohën e abasitëve, Ebu Xhafer El Mensuri e zhvendosi kryeqytetin në Bagdad dhe e quajti Shtëpia e Paqes (Darus-selam).

Pas çlirimit të Egjiptit, Amr bin Asi themeloi qytetin Fustat dhe themeloi kryeqytetin e Egjiptit, në të cilin ndërtoi xhaminë e parë në Kontinentin e Afrikës.

Pastaj qyteti u shndërrua në kamp ushtarak, të cilin e themeloi Salih bin Ali el Abas, në vitin 132 të Hixhretit.

Kur u shtuan, pasuesit e Ibni Tulunit e zgjeruan shtetin dhe formuan sektorët (shtetet) në shumë anë, ku sudanezët kishin shtetin e tyre, nubijnët kishin shtetin e tyre, romakët shtetin e tyre, pastaj ishin sektorët e tregtarëve, industrialistëve etj.

Kur Egjipti u çlirua në tërësi nga Xhevher es-Salahu, u formua shteti i Fatimijëve, i cili ndërtoi themelet e kryeqytetit të Egjiptit në Kajro, më 17 Shaban të vitit 358 (H.). Në fillim është quajtur el Mensurije, në bazë të udhëheqësit el Mensur Ebi el Muiz. Kur el Muizi ka pranuar fenë islame e quajti Kajro e Muizit. Në këtë qytet është ndërtuar universiteti i El Ez'herit më 14 Ramazan të vitit 359 H. Ndërtimi i objektit ka përfunduar brenda dy viteve dhe namazi i parë në xhami është falur (hapja solemne e xhamisë) më 7 Ramazan të vitit 361 të Hixhretit.

* * * * *

STEMA SHTETËRORE

NENI 88

Ligji sqaron stemën shtetërore, sqaron çka simbolizon ajo dhe e përkufizon secilën pjesë të stemës me vendim.

Koment:

Stema dhe simboli shtetëror janë shumë të rëndësishme për historinë e një shteti, i përforcojnë ndjenjat, i bashkojnë zemrat dhe i rritin shpresat derisa valojnë dhe qëndrojnë lart.

Në Islam, flamuri dhe stema kanë rëndësi të posaçme, sa që bartja e tyre ka Umerit, në luftën e Uhudit, që ka qenë flamurtar (e ka mbajtur flamurin) dhe të cilit iu pre dora e djathtë (me të cilën mbante flamurin), dhe se pastaj ai e ka marrë atë në dorën e majtë duke thënë: qenë nder për udhëheqësit, komandantët dhe ata që kanë pasur reputacion. Për mbajtjen dhe ngritjen e flamurit janë sakrifikuar edhe sahabët të mirënjohur, të cilët janë regjistruar në historinë islame si trima dhe heronj. Për shembull, tregohet rasti i sahabit Musab ibn

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ أَفَإِنْ مَاتَ أَوْ قُتِلَ انْقَلَبْتُمْ عَلَى
أَعْقَابِكُمْ وَمَنْ يَنْقَلِبْ عَلَى عَقْبَيْهِ فَلَنْ يَضُرَّ اللَّهَ شَيْئًا وَسَيَجْزِي اللَّهُ الشَّاكِرِينَ

“Muhammedi nuk është tjetër veçse i Dërguar. Edhe para tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose nga lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm All-llahut aspak, kurse All-llahu do t’i shpërblejë mirënjohësit”.

(Ali Imran, 144)

Pastaj në front i pritet edhe dora e majtë dhe ai e ka rrokur flamurin me pjesët e mbetura të duarve dhe me gjoksin e tij, duke përsëritur të njëjtin ajet, derisa ra dëshmor dhe i ra flamuri.

Deri në këtë moment, ka patur ajete kur’anore që ende nuk kishin zbritur, por që kanë zbritur më vonë⁴¹.

⁴¹ Kthehu te libri “Err-Rrusul vel Muvafekat”, fq.76, botoi “Muessesetul El-Arabije El-Hadithë”.

Në betejën e M'uetes, Muhammedi a.s. ia ka dhënë Zejd ibn Harithit flamurin për ta mbajtur dhe ka thënë se pas tij (nëse ai mbytet) ta mbajë Abdullah bin Revaha, nëse edhe ai mbytet, atëherë flamurin ta mbajë Xhafer bin Ebi Talibi.

Me dëshirën dhe caktimin e Zotit që të tre kanë rënë dëshmorë dhe ushtria është tubuar (dhe ka vendosur) që udhëheqës dhe mbajtës i flamurit të jetë Halid bin Velidi, i cili me strategjinë e tij ushtarake e arriti qëllimin e tij, duke dalë me sukses në atë betejë dhe duke u kthyer në Medinetul Munevere, pasi ushtria romake po përgatiste një ushtri të madhe. Për shkak të këtij rasti, Muhammedi a.s. e ka quajtur Halid bin Velidin “Shpata e Zotit”.

Mos të harrojmë se, rreth çështjes së flamurit dhe mbajtjes së tij, ka mospajtime ndërmjet shi'itëve dhe sunitëve. Në betejën e Hajberit, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Nesër do t’ia jap flamurin njeriut të cilin e do All-llahu dhe i dërguari i Tij, dhe ai e do All-llahun dhe të dërguarin e Tij, i cili është i palëkundur, i qëndrueshëm dhe nuk largohet nga fronti”. Secili prej ensarëve dhe muhaxhirëve shpresonte se flamuri do t’i jepej ndonjërit prej tyre.

Të nesërmen Muhammedi a.s. pyeti: Ku është Ali bin Ebi Talibi?, - dhe ia dha atij flamurin”.

Nga ky rast shi'itët argumentojnë se halif (kryetar) pas Muhamedit a.s. i takon të zgjidhet vetëm Ali bin Ebi Talibit e askush tjetër prej sahabëve. Prandaj ata i japin përparësi Ali bin Ebi Talibit ndaj Ebu Bekrit, Uthmanit dhe Umerit.

Sunitët nuk pajtohen me këtë argumentim. Ata këtë rast e paraqesin si rast të posaçëm të betejës së Hajberit, e jo për halif (Kryetar) pas Muhammedit a.s.

Disa shfaqin dyshime se përshëndetja e flamurit dhe simbolet shtetërore janë një lloj shirku-idhujtarie, mirëpo ky lloj mendimi është i cekët, i pakuptimtë dhe mendim i gabuar.

Shteti islam e adhuron vetëm All-llahun Një, e di dhe e njeh vetëm madhërinë e Tij dhe i përmbahet ligjeve dhe vendimeve të Tij, ndërsa ngritja e flamurit dhe e simbolit është respektim i Tij, si sunnet i Muhammedit a.s., të cilën ai ka praktikuar vetë dhe, pas tij, (e kanë praktikuar) edhe halifët e drejtë.

* * * * *

DATA E HYRJES SË LIGJIT NË FUQI

NENI 89

Ligjet hyjnë në fuqi në datën e vendimeve dhe është e vlefshme vetëm ajo që është shkruar në tekst. Për fuqizimin e ligjit nevojitet votimi i dy të tretave të parlamentit, ndërsa, ekzekutimi i veprave penale, të cilat janë kryer para hyrjes në fuqi të ligjit, nuk kryhet.

Koment:

Ekzistojnë dy lloje ligjesh:

Lloji i parë:

Ligjet penale dhe vendimet shkallëzore, të cilat rregullojnë jetën shoqërore në përgjithësi.

Ligjet, kur të hyjnë në fuqi, nuk duhet të kenë indikacione të veprimeve të mëhershme, por ato hyjnë në fuqi prej momentit të marrjes së vendimit: Kjo vërtetohet në mënyrën e ligjësismit dhe Sheriatit të All-llahut: kanë zbritur ajete kur'anore, të cilat kanë patur të bëjnë me statusin personal dhe rregullat e familjes, ndërsa Kur'ani i ka përjashtuar (nuk i ka marrë në konsiderim) veprimet në kohën e injorancës.

Martesa me bashkëshorten (e shkurorëzuar) të babait ka qenë traditë në kohën e injorancës, ose nëse ka vdekur burri dhe ka lënë pas bashkëshorte, dhe njëkohësisht ka pasur fëmijë (djalë) me një bashkëshorte tjetër, ai (djali i tij) ka pasur përparësi ndaj të tjerëve që të martohet me të (bashkëshorten e babait të tij të vdekur). Nëse ka dëshiruar, ai është martuar me të pa ia caktuar as mehrin, nëse ka dëshiruar e ka martuar me tjetërkënd, ndërsa mehrin e ka marrë për vete. Nëse ka dëshiruar, e ka ndaluar të martohet (me dikë tjetër) me qëllim që pasurinë e saj të trashëguar prej babait të tij, ta trashëgojë ai vetë, pasi ajo të vdesë.

Ligji i All-llahut, i cili i ka rregulluar marrëdhëniet brenda familjes ka zbritur në ajetin kur'anor, në të cilin All-llahu i Lartmadhëruar thotë:

وَلَا تَنْكِحُوا مَا نَكَحَ آبَاؤُكُمْ مِنَ النِّسَاءِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ
إِنَّهُ كَانَ فَاحِشَةً وَمَقْتًا وَسَاءَ سَبِيلًا

“Dhe mos u martoni me ato gra me të cilat qenë martuar prindërit tuaj, me përjashtim të asaj që ka kaluar (para Islamit) pse ajo ishte turpësi, përbuzje e traditë e shëmtuar”.

(En Nisa, 22)

Në kohën e injorancës ka qenë e lejuar martesë me dy motra në të njëjtën kohë, ndërsa ka zbritur një ajet kur'anor, i cili e ka ndaluar këtë. Zoti i Madhëruar, kur flet për ndalesat në martesë, thotë:

... وَأَنْ تَجْمَعُوا بَيْنَ الْأُخْتَيْنِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَحِيمًا .

“...(dhe është e ndaluar) të bashkoni (përnjëherë në një niqah) dy motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtet, All-llahu falë shumë, është mëshirues i madh”.

(En Nisa, 23)

Ajo çka është kryer në kohën e injorancës përjashtohet nga dënimi dhe vendimi i ligjit të All-llahut dhe ajo e drejtë nuk iu mohohet as prindërve, as fëmijëve, as grave, ndërsa në momentin e pranimit të Islamit (besimit), vendimi nevojitet të hyjë në fuqi dhe të bëhet ekzekutimi i ligjit. Po ashtu, nëse ndonjëri e ka pranuar Islamin dhe ka pasur më shumë se katër gra, Muhamedi a.s. i ka thënë: **“Mbaj katër gra, ndërsa të tjerat shkurorëzoji”**. Pra, prej momentit kur e ka pranuar Islamin, njeriu obligohet t’iu përmbahet ligjeve të All-llahut dhe nuk ka të drejtë të mbajë më shumë se katër gra nën kurorë, e nëse mban më tepër, ato nuk janë gratë e tij. Ndërsa të drejtat e tyre vazhdojnë sa i përket dhuratës së kurorës (mehrit), furnizimit, ushqimit, përkujdesjes dhe vazhdon e drejta për fëmijët e tyre (që kanë lindur më herët) që të jenë legjitimë dhe ata fëmijë (por edhe gratë) i realizojnë të drejtat e Sheriatit.

Alkooli është ndaluar në mënyrë graduale derisa ka zbritur ajeti:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَامُ
رِجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar”

(El Maide, 90)

Askush nuk është dënuar nëse ka pirë alkool para zbritjes së këtij ajeti.

Është e njohur në Fikh se vjedhësi i cili ka vjedhur shumë herë, ose alkoolisti që ka pirë shumë herë alkool, ose prostituti që ka bërë shumë herë prostitucion para ekzekutimit të dënimit, ai ekzekutohet vetëm për një dënim.

Lloji i dytë:

Ligjet penale dhe dënimet të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Këto vepra penale nuk vjetërsohen dhe mëkatari për mëkatën - kryerjen e veprimit, ndiqet gjithmonë edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër dhe pastrimi bëhet vetëm kur t’i kthehet e drejta të dëmtuarit. Në hadithin, të cilin e ka regjistruar Buhariu nga transmetimi i Ebu Hurejres, thuhet se Muhammedi a.s. ka thënë:

“Kush i ka bërë padrejtësi vëllait të tij, në aspekt të pasurisë, nderit apo diçka tjetër le t’ia kthejë të drejtën para se të vijë Dita kur kompensimi nuk bëhet as me dinarë, as me dërrhem, por veprat e mira i jepen atij të cilit i ke bërë padrejtësi, po nëse nuk ka të mira atëherë të këqijat e vëllait (të cilit i ke bërë padrejtësi) do të ngarkohen në supet e tij.”

Në hadithin, të cilin e ka regjistruar Muslimi nga Ebu Hurejre r.a., Muhammedi a.s. ka pyetur:

“A e dini çka është bankrotuesi (Muflisi)?” Sahabët iu përgjigjën se Muflis është ai i cili nuk ka as dërrhem, as pasuri. Muhammedi a.s. ka thënë: “Bankrotuesi (Muflisi) i Ummetit tim në Ditën e Kijametit vjen me kryerjen e namazit, agjërimin e Ramazanit dhe me dhënien e zekatit, mirëpo dikë e ka ofenduar, për dikë ka shpifur, ka ngrënë pasurinë e dikujt tjetër në mënyrë të padrejtë, dikujt i ka mëshuar, dikë tjetër e ka gjakosur (e ka vrarë). Atëherë, në Ditën e Kijametit, kur të vendoset vaga e drejtësisë do të merren të mirat e tij për t’i dëmshpërblyer të gjithëve, dhe nëse të mirat e tij do të shpenzohen, atëherë do të merren veprat e këqija të tjerëve dhe do të ngarkohen në supet e tij dhe për ato vepra të këqija ai do të hidhet në zjarr (xhehennem).”

BOTIMI I LIGJEVE DHE AMENDAMENTEVE KUSHTETUESE

NENI 90

Ligjet botohen në gazetatat zyrtare në një afat prej dy javësh pas vendimit të tyre dhe ato hyjnë në fuqi një muaj më vonë pasi që të botohen, me përjashtim të rastit nëse ligji cakton që të hyjë në fuqi prej afatit të caktuar me ligj.

NENI 91

Edhe kryetari (Imami), edhe parlamenti kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin e një ose më shumë neneve të Kushtetutës.

Në kërkesë duhet cekur se cilin nen duhet ndryshuar dhe arsyeja e ndryshimit. Nëse kërkesa bëhet prej parlamentit, atëherë duhet që kërkesën ta nënshkruajnë, më së paku, dy të tretat e deputetëve.

Të gjitha kërkesat duhen shqyrtuar në parlament, duhen shikuar parimet e ndryshimit dhe në fund merret vendimi me dy të tretat, apo me shumicën absolute.

Nëse kërkesa refuzohet, nuk lejohet kërkesa tjetër (ankesa) e ndryshimit të neneve, pa kaluar një vit prej ditës së refuzimit.

Nëse parlamenti pajtohet për ndryshimin e nenit, në parim, diskutimet për ndryshimin e atyre neneve për të cilat janë pajtuar duhet të fillojnë pas dy muajve.

Nëse dy të tretat e parlamentit votojnë për ndryshimin e nenit, atëherë i jepet e drejta Ummetit (popullit) për të dalë në referendum.

Nëse në referendum votohet pozitivisht për ndryshimin e nenit, atëherë amendamenti, apo neni i ri, hyn në fuqi prej datës së daljes së rezultatit të referendumit.

NENI 92

Çdo vendim, ligj, apo nen, i cili ka qenë para kësaj kushtetute, mbetet i plotfuqishëm. Së bashku me këtë, lejohet shfuqizimi apo ndryshimi në pajtim me rregullat dhe procedurat e parapara në këtë kushtetutë.

Nëse kanë qenë në kundërshtim me ligjet e Sheriatit Islam duhen shfuqizuar dhe zëvendësuar me ligje të tjera.

NENI 93

Kjo kushtetutë hyn në fuqi prej datës së shpalljes dhe pajtimit të Ummetit (popullit) me referendum.

* * * * *

FJALA E FUNDIT

Sheriati Islam ka vendin kryesor dhe qëllimet e pikësyzimët janë të përsosura dhe të ndershme.

Zoti i Madhëruar thotë:

لَنْ يَنَالَ اللَّهُ لُحُومَهَا وَلَا دِمَاؤُهَا وَلَكِنْ يَنَالُهُ التَّقْوَىٰ مِنْكُمْ ...

“Tek All-llahu nuk arrin as mishin e as gjaku i tyre (kurbaneve), por të Ai arrin bindja dhe devotshmëria e juaj”.

(El Haxhxh, 37)

Muhammedi a.s. në hadithin sahih, të cilin e transmeton Umer bin Hatabi r.a., ka thënë:

“Vërtet, veprat shpërblehen sipas qëllimit, dhe secili njeri do të shpërblehet për atë për çka e kryen një veprim. Nëse bën hixhret (migrim) për All-llahun dhe të dërguarin e Tij, për atë do të shpërblehet. Nëse bën hixhret (migrim) për përfitim të kësaj bote, apo për t’u martuar me ndonjë femër, atëherë shpërblimi i hixhretit është për atë për çka ka bërë hixhret (migruar)”.

Vendimet e prera janë bazë e Sheriatit, në ta bazohet dhe përqendrohet Sheriati dhe prej aty fillon diskutimi, dhe në fund arrihet deri te vendimi.

Zoti i Madhëruar thotë:

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ
ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

“Për Zotin tënd, jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty, as të asaj para teje) derisa të mos të të zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht”.

(En-nisa, 65)

Zoti i Madhëruar thotë:

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ مِنْهُ آيَاتٌ مُحْكَمَاتٌ هُنَّ أُمُّ الْكِتَابِ وَأُخَرُ مُتَشَابِهَاتٌ
فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زِينٌ فَيَسْتَبِغُونَ مَا تُشَابِهَ مِنْهُ ابْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ وَابْتِغَاءَ تَأْوِيلِهِ
وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلَّا اللَّهُ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ يَقُولُونَ آمَنَّا بِهِ كُلٌّ مِنْ عِنْدِ رَبِّنَا
وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ

“Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). E ata që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hutë, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: Ne u kemi besuar atyre (që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes”.

(Ali Imran, 7)

Ka fushë dhe hapësirë për të dhënë një mendim, por edhe për të dhënë një mendim tjetër, sidomos përse i pëket nevojave bashkëkohore dhe civilizuese të cilat janë zgjeruar me shkencat shoqërore, politike, administrative dhe organizative në frymën e Sheriatit Islam. Për këtë ka argumente e argumente të panumërta. Për këtë arsye, Muhammedi a.s., ka thënë:

“Ju i dini më së miri çështjet e jetës suaj”.

Nga Ibn Mes’udi r.a. është transmetuar:

“Vërtet All-llahu i ka shikuar zemrat e robërve të Tij dhe te Muhammedi a.s. ka parë zemrën më të mirë, për këtë e ka zgjedhur për Vete për t’i dërguar shpallje, pastaj përsëri ka shikuar në zemrat e robërve dhe ka parë se, pas zemrës së Muhammedit a.s., zemrat më të mira janë të sahabëve dhe ata i ka caktuar për përkrahës dhe ministra të Muhamedit a.s., për të luftuar dhe për ta mbrojtur fenë. Çka është e mirë për muslimanët, është e mirë te All-llahu, çka është e keqe për muslimanët, edhe për Allahun është e keqe”.

Nevojitet të shikohet cilësia e termit “musliman” nga aspekti i besimit të sinqertë, i kuptimit të drejtë të Kur’anit, sunnetit dhe kryerjes së detyrave të All-llahut dhe të dërguarit të tij me përpikëri.

Bazat e Jurisprudencës Islame (Fikhut) janë të bazuara në:

1. Kur’an
2. Sunnet
3. Ixhma
4. Kijas
5. Ligjet para neve
6. Istihsan
7. Maslahatul mursele
8. Sedu Dherai

E gjithë kjo me angazhim dhe ixhtihad të sinqertë, me hulumtim dhe studim të kulluar, mençuri të plotë, analizë të thellë, me vizion të qartë për zgjidhjen me kohë të problemeve, ose për parandalimin e problemeve.

Parim i tyre është “puna e mirë” pa marrë parasysh në çështje të kësaj bote apo të botës tjetër, duke iu përgjigjur thirrjes së All-llahut: “Punoni mirë më qëllim që të jeni të sigurt dhe të shpëtuar”.

Imami Nexhmudin Et Tufi thotë:

“Atë çka e argumenton më së shumti dobinë dhe interesin gjithëkombëtar është se sahabët r.a. kanë vepruar në momente të caktuara për interes gjithëpopullor, jo sipërfaqësisht, por thellësisht. Si p.sh. shkrimi i Kur’anit në Mus’haf, i cili nuk ka qenë më herët, po ashtu emërimi halif i Ebu Bekrit dhe Umerit r.a., emërim i cili nuk ka qenë më herët. Po ashtu, pas tyre emërimi i parlamentit me konsensus apo në parlament, po ashtu edhe regjistrat, po ashtu ndërtimi i burgjeve, të cilën e ka bërë Umeri r.a. Po ashtu, prishja dhe rindërtimi më i mirë i vakëfeve, siç është rasti i xhamisë së Muhammedit a.s., zgjerimi i xhamisë pasi që me kalimin e kohës ka qenë e pamjaftueshme. Thirrja e ezanit të parë në namazin e xhumasë, të cilën e ka bërë Uthmani r.a. për shkak të nevojës dhe interesit të përgjithshëm.

Në fund shoqëria është ndarë në dy grupe:

- Grupi i parë i cili është i ndikuar nga rryma marksiste dhe idetë e uesternizmit dhe nga armiqtë e Ummetit.
- Grupi i dytë, ata të cilët dëshirojnë që ta ngurosin mendimin, që të jenë statikë dhe me të cilët as që mund të bisedohet për projektin e Kushtetutës Islame.

Ne i bëjmë ftesë mendjeve dhe zemrave të ummetit, pleqve, të rinjve, burrave, grave, qeveritarëve, qytetarëve, dijetarëve, juristëve, që të bashkohen në një fjalë, që ta njohin All-llahun me të Lartin, atdheun më të shenjtin, njerëzit më të respektuarit, jetën më të sigurt dhe ummetin më të zhvilluarin dhe që në tërë botën të mbizotërojë paqa, siguria dhe bashkëpunimi.

... وَاللَّهُ يَدْعُو إِلَى الْجَنَّةِ وَالْمَغْفِرَةِ بِإِذْنِهِ وَيُبَيِّنُ آيَاتِهِ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ

“E All-llahu me mëshirën e vet ju fton për në xhennet, për në shpëtim dhe u sqaron njerëzve argumentet e Veta, ashtu që ata të përkujtojnë”.

(El Bekare, 221)

وَاللَّهُ يَدْعُو إِلَى دَارِ السَّلَامِ وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“... All-llahu thërret për në xhennet, dhe atë që do, e vë në rrugë të drejtë”⁴².

(Junus, 25)

E falënderojmë All-llahun, me emrin e të Cilit plotësohen të mirat.

MEKKETU MUKERR-RREME

Pas namazit të xhumasë

7 Dhul Ka'de 1415

7 Prill 1995

⁴² “Sherh Muhtesar er evdati”, korrektioi dr. Abdullah bin Abdul Hasen Et-Tarkij, vëll.III, fq.213, botoi “Muessesetu Err-Risletu”.

AUTORI NË RRESHTA

Dr. Muhamed Sejid Ahmed el Musejer

- Profesor i Akides dhe filozofisë në fakultetin e “Usuludinit, Universiteti i El Ez’herit”, në Kajro.
- Profesor dhe kryetar (rektor) i degës së gjuhës arabe dhe shkencave islame në fakultetin “Et-Terbije” si degë e universitetit Melik Abdul Aziz të Medinetul Muneveres, gjatë viteve 1983-1987.
- Profesor i degës së “Daves” në fakultetin “Usulud-din” Universiteti “Umul-kurra” të Mekketul Mukerremes prej vitit 1993.
- Rektor i Institutit për Përgatitjen e Imamëve dhe Studimin e Shkencave Islame në Matarie, e cila është nën patronazhin e shoqatës së Sheriatit.
- Anëtar i “Kuvendit Suprem për Çështje Islame të Ministrisë së Vakëfeve”.
- Anëtar i Institutit të Shkencave Islame në Zemalik.
- Anëtar i Shoqatës së Filozofëve Egjiptianë.
- Ka shkruar artikuj e revista islame në Egjipt dhe botën islame.
- Ka marrë pjesë në përgatitjen e programeve të radio-televizionit të Egjiptit dhe të mediave në botën islame të El Ez’herit në vitin 1383 h. (1964) në shkollën fillore fetare “Shibin Kunë”.
- Ka qenë i renditur në vendin e gjashtëmbëdhjetë si nxënësi më i mirë i shkollave të mesme të Egjiptit, në vitin 1389 h. (1969), atëherë shkolla e mesme ka zgjatur pesë vjet.
- Ka pasur sukses shembullor në provimet posdiplomike të Fakultetit “Akidetu vel felsefetu” të “Usuli dinit” në Kajro, më 1393 h. (1973).
- Ka doktoruar me sukses shembullor në universitetin e El Ez’herit më 1398 h. (1978).
- Ka marrë pjesë në kongrese dhe simpoziume të ndryshme.
- Kongresi i Njëmbëdhjetë i Institutit Shkencor për Hulumtime Islame të El Ez’herit, në muajin Rexheb, të vitit 1408 h.
- Asambleja e Fikhut Islamik në Aman, e mbajtur në muajin Shaban 1408 h.
- Seminare kulturore në Kuvajt gjatë muajit Ramazan 1409 h.
- Asambleja Popullore për ballafaqimin e ndotjes së popullit, në Bagdad, më 22-24 të muajit Xhumadel Ula të vitit 1410 h.

- Kongresi Islamik Botëror për Irakun, i mbajtur në Bagdad, në muajin Dhul K'ade 1410 H., para luftës (së parë) të Irakut.
- Kongresi Popullor të cilin e ka organizuar “Qendra Arabe për Kulturë” në Kajro, me temën “Çështje Bashkëkohore” i mbajtur prej 18 – 20 shkurt 1990.
- Kongresi Islamik Botëror për diskutimin rreth krizës së Gadishullit Arabik, të cilën e ka organizuar “Lidhja Botërore Islame” në Mekketul-Mukerreme, më 21-23 të muajit Sefer 1411 h.
- Asambleja Botërore për të Drejtat e Njeriut në Islam dhe në Perëndim, mbajtur në Teheran, më 9-12 të muajit Shtator të vitit 1991.
- Kongresin botëror islam në Kuvajt për lirimin e robërve të luftës nga burgjet e Irakut, mbajtur më 19-21 Janar 1992 .
- Seminari Kulturor i Muajit Ramazan, i mbajtur në Emiratet e Bashkuara Arabe, më 1412 h.
- Asambleja Kulturore Islame në mes të realitetit të sotëm dhe perspektivës së nesërme, të cilën e ka organizuar Shoqata Humanitare Bamirëse “Ikre”, në bashkëpunim me Universitetin e El Ez’herit, e mbajtur në muajin Dhul K’ade të vitit 1412 h. (Maj 1992)
- Ka marrë pjesë në delegacionin me ministrinë e Vakëfeve të Egjiptit, në Shtetet e Komenuelthit islamik, mbajtur më 13-25 shtator 1992.
- Ka marrë pjesë në Kongresin e Dymbëdhjetë të Institutit Shkencor për Hulumtime Islame të El Ez’herit, mbajtur më 2-5 të muajit Xhumadel Ula, të vitit 1413 h.
- Kongresi për orientim shkencor-islam, të cilin e ka organizuar Lidhja e Universiteteve islame në bashkëpunim me Universitetin e El Ez’herit, në vitin 1413 h.

VEPRAT E AUTORIT

1. “Shpirti në studimet e filozofëve dhe mutekeliminëve (apologjetëve)”
2. “Shoqëria shembullore në kuptimin filozofik dhe qëndrimi i Islamit për të”
3. “Në dritën e Akides islame”
4. “Edukata e diskutimit për All-llahun”
5. “Bazat e praktikimit të Sheriatit”
6. “Hyrje në studimet fetare”
7. “Për Kushtetutën Islame”

Filozofi dhe Biografi të Muhammedit a.s.

8. “I dërguari në Ramazan”
9. “I dërguari rreth Qabes”
10. “I dërguari dhe shpallja”
11. “I dërguari dhe çështjet shoqërore”
12. “I dërguari dhe pranimet e tij”
13. “Bazat e Krishterizmit në kandar”
14. “Evropa dhe krishterizmi”
15. “Mesihu dhe shpallja e tij në Kur'an”
16. “Sunneti me Kur'anin”
17. “Sunneti i Pastër”
18. “Kur'ani obligon materialistët dhe të pasurit”
19. “Studime Kur'anore”.

LIBRAT E PËRKTHYESIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. Besimi në Zotin
2. Melaqet e Zotit
3. Besimi në Librat e Zotit
4. Pejgamberët e Zotit
5. Besimi në Ditën e Kijametit
6. Besimi në Kaderin e Zotit
7. Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.
8. Fikhu i Namazit
9. Fikhu i Zekatit
10. Fikhu i Agjërimit
11. Fikhu i Haxhit
12. Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur
13. Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re
14. Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. Nata e Dhëndërisë
16. Fadil Çaka – Komandant Sharri

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. Këshilltari Fisnik për djem dhe vajza *(nga autori Muhamed Sajim)*
2. Islami dhe Politika *(nga autori Jusuf Kardavi)*
3. Mrekullitë Numerike në Kur'anin Fisnik *(nga autori Abdurrezak Nufel)*
4. Për Kushtetutën Islame *(nga autori Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer)*
5. Kryesore në Terminologjinë e Hadithit *(nga autori Abduhu Abas El- Velidi)*
6. Vlera e Kohës *(Amër Halid)*

PËRMBAJTJA:

PROJEKTI I KUSHTETUTËS ISLAME	9
PROJEKTI I KËSHILLTARIT ASHMAVI	11
ARTIKULLI I PARË	13

KAPITULLI I PARË

SHOQËRIA ISLAME (UMMETI ISLAM)	15
SHOQËRI UNIKE DHE KUSHTETUTË UNIKE	
Neni 1	17
FEDERALIZMI I SHTETEVE DHE UNIFIKIMI	
NENI 2	23
NENI 3	23
NENI 4	27

KAPITULLI I DYTË

BAZAT E SHOQËRISË ISLAME	33
NDIHMJA RECIPROKE	
Neni 5	35
VENDOSJA E RENDIT (EL EMRU BIL MEARUF) DHE LUFTA KUNDËR KRIMIT (EN NEHJU ANIL MUNKER)	
Neni 6	40
FAMILJA BAZË E SHOQËRISË	
NENI 7	44
RUAJTJA E FAMILJES	
NENI 8	46
SHËNDETI (SHËNDETESIA)	
NENI 9	48
ARSIMI	
NENI 10	49
EDUKIMI FETAR	
NENI 11	51
PLANPROGRAMI I EDUKIMIT DHE ARSIMIT ISLAM	
NENI 12	52
NENI 13	52
VEHJA ISLAME E FEMRËS	
NENI 14	55
GJUHA ARABE DHE KALENDARI I HIXHRETIT	
NENI 15	58
DETYRA E QEVERISË	
NENI 16	60
NENI 17	60

KAPITULLI I TRETË

EKONOMIA ISLAME	63
EKONOMIA ISLAME	
NENI 18	65
TREGTIA E LIRË, INDUSTRIJA DHE BUJQËSIA	
NENI 19	68
PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK	
Neni 20	72
LUFTIMI I MONOPOLIT	
NENI 21	76
PUNIMI I TOKËS	
NENI 22	79
NDALIMI I KAMATËS	
NENI 23	81
PRONA SHETETËRORE DHE PASURITË NATYRORE	
NENI 24	84
NENI 25	84
ROLI I ZEKATIT NË EKONOMIN ISLAME	
NENI 26	88
VAKËFET	
NENI 27	96

KAPITULLI I KATËRT

TË DREJTAT DHE LIRITË QYTETARE	99
BAZË LIGJORE DREJTËSIA	
NENI 28	101
LIRIA E BESIMIT, MENDIMIT DHE VEPRIMIT	
NENI 29	106
E DREJTA E PRONËS PRIVATE DHE NDERI JANË TË SHENJTA	
NENI 30	113
E DREJTA E QARKULLIMIT TË LIRË KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR	
NENI 31	116
E DREJTA PËR AZIL POLITIK	
NENI 32	120
KEQTRAJTIMI DHE TORTURIMI	
NENI 33	123
DËNIMI PËR MOSLAJMËRIMIN E RASTIT	
NENI 34	126
PËRGJEGJËSIA E SHETIT NDAJ TË AKUZUARIT	
NENI 35	128
E DREJTA PËR ANKESA	
NENI 36	133
E DREJTA E PUNËS DHE E PRONËSISË	
NENI 37	135

PUNA E FEMRËS	
NENI 38	138
E DREJTA PRONËSORE	
NENI 39	141
KUSHTET E SHPRONËSIMIT (EKSPORPURIMI)	
NENI 40	145
LIRIA E GAZETARISË	
NENI 41	147
SHOQATAT DHE SINDIKATAT	
NENI 42	151
REALIZIMI I TË DREJTAVE NË PËRPUTHSHMËRI ME	
QËLLIMET E SHERIATIT	
NENI 43	153

KAPITULLI I PESTË

IMAMI (KRYETARI)	157
DËGJUESHMËRIA NDAJ IMAMIT (Kryetarit)	
Neni 44	159
NUK DËGJOHET NË MËKATE	
NENI 45	163
MËNYRA E EMËRIMIT TË IMAMIT	
NENI 46	166
KUSHTET E IMAMIT (KRYETARIT)	
NENI 47	170
PJESËMARRJA GJITHËPOPULLORE (E UMMETIT) NË	
ZGJEDHJEN E KRYETARIT (IMAMIT)	
NENI 48	174
KRIKTA NDAJ TË KANDIDUARVE PËR IMAM (KRYETAR)	
NENI 49	176
SHKARKIMI I IMAMIT (KRYETARIT)	
NENI 50	179
ORGANI JURIDIK MBI IMAMIN (KRYETARIN)	
NENI 51	184
TË DREJTAT E KRYETARIT TË BARABARTA ME	
TË DREJTAT E QYTETARIT	
NENI 52	186
TË ARDHURAT E IMAMIT (KRYETARIT)	
NENI 53	189
KRYETARI NUK KA TË DREJTË TË PRANOJË DHURATA	
NENI 54	191
PËRGJEGJËSIA E IMAMIT (KRYETARIT) PARA UMMETIT ISLAM	
NENI 55	194
DETYRA DHE PËRGJEGJËSIA E IMAMIT (KRYETARIT) NË	
MBROJTJE TË POPULLIT DHE SHTETIT	
NENI 56	198

PËRGJEGJËSIA MORALE E IMAMIT	
NENI 57	202
PËRGJEGJËSIA E IMAMIT (KRYETARIT) NË SISTEMIN ORGANIZATIV	
NENI 58	205
E DREJTA E IMAMIT (KRYETARIT) PËR TË FALUR GABIMIN DHE RREGULLAT E FALJES SË GABIMIT	
NENI 59	206
LIGJET E JASHTËZAKONSHME	
NENI 60	210
KAPITULLI I GJASHTË	
GJYKATA	213
DREJTËSIA DHE BARAZIA	
NENI 61	215
NENI 62	215
LIGJET PUBLIKE	
NENI 63	218
GJYKIMI NË BAZË TË SHERIATIT ISLAM	
NENI 64	220
NENI 65	220
PËRGJEGJËSIA E SHTETIT NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE (LIGJEVE)	
NENI 66	224
PAVARËSIA E GJYQIT	
NENI 67	226
KUSHTET E GJYKATËSIT	
NENI 68	231
GJYKIMI NË PREZENCË TË AKUZUARIT	
NENI 69	237
GJYKIMI ME DYER TË HAPURA	
NENI 70	242
DËNIMET LIGJORE TË SHERIATIT	
NENI 71	244
DËNIMET E TJERA (TË PAPËRCAKTUARA)	
NENI 72	249
NDIKIMI I PENDIMIT NË ZBUTJEN E DËNIMIT	
NENI 73	250
NENI 74	250
DËNIMI ME VDEKJE	
NENI 75	257
NENI 76	259
BARAZIMI I “DIJES” SË DY GJINIVE	
NENI 77	260

LIGJET PUBLIKE	
NENI 78	262
BAZA E DËNIMIT TË PAPËRCAKTUAR ËSHTË RRAHJA	
NENI 79	265
E DREJTA E TË BURGOSURIT	
NENI 80	267
GJYKATA SUPREME	
NENI 81	268
AKTPADIA NË SHKALLËN E PARË (E LARTË)	
NENI 82	269
 KAPITULLI I SHTATË	
KUVENDI KËSHILLUES, INSPEKTIMI (KONTROLLIMI) DHE MËNYRA E MARRJES SË VENDIMEVE	273
SPECIALIZIMI I KUVENDIT TË GJYKATËS	
NENI 83	275
NENI 84	276
 KAPITULLI E TETË	
QEVERIA	283
PËRGJEGJËSIA E QEVERISË	
Kushtet e emërimit të ministrave (Formimi i kabinetit)	
NENI 85	285
NENI 86	285
 KAPITULLI I NËNTË	
LIGJET TRANZICIONALE DHE TË PËRGJITHSHME	289
KRYEQYTETI	
NENI 87	291
STEMA SHTETËRORE	
NENI 88	293
DATA E HYRJES SË LIGJIT NË FUQI	
NENI 89	295
BOTIMI I LIGJEVE DHE AMENDAMENTEVE KUSHTETUESE	
NENI 90	298
NENI 91	298
NENI 92	299
NENI 93	299
FJALA E FUNDIT	300
AUTORI NË RRESHTA	304
VEPRAT E AUTORIT	306
VEPRAT E PËRKTHYESIT (Dr. Musli Vërbani)	306